

BIBLIOTEKA

854-31

A 14.

Ali Abdihoxha

**KRONIKA  
E NJË NATE**  
Roman







84-21  
814

Ali Abdihoxa

KRONIKA  
E NJË NATE

Roman

29691

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

Illegible mirrored text at the top of the page.

Redaktore

IRENA DONO

Illegible mirrored text in the middle of the page.

Illegible mirrored text below the middle of the page.

Illegible mirrored text at the bottom of the page.

1.

Gjermanë të vrarë në Mushibë	1500
Robër në Mushibë	400
Të ikur e të vrarë rrugës e brenda në Tiranë	300
Shuma gjithsej	2200

Në fytyrën e re të Xhako Rinës u pasqyrua ajo pakënaqësi që pasqyrohet në fytyrën e nxënësit, kur, megjithëse lodhet, problemin nuk e zgjidh dot. Tha me vete (për të dytën a për të pestën herë), ishin pra gjithsej 3000 gjermanë, të vrarë e robër 2200, po atëherë ku shkuan 800 gjermanë? Ku? Dhe shkroi:

Gjithsej gjermanë	+ 3000
Të vrarë e robër	- 2200
Të zhdukur pa lënë gjurmë	- 800

Ishte nëntor dhe ishte butë, kishte re, kishte edhe lagështirë, por shi nuk binte prej disa ditësh. Dhe kudo ishte qetë, veç në qiell dëgjoheshin herë-herë klithmat



e rosave të egra që kalonin përmbi fshat e që kërkonin pëllgje e kënetë për të dimëruar. Xhako Rina herë shkruante, herë i kthehej prapë problemit të pazgjidhur të 800 gjermanëve të zhdukur dhe, njëkohësisht, krejt padashur përpiqej të merrte me mend lartësinë dhe formacionin e shtegtimit të rosave, që edhe ato dukeshin të shqetësuara.

Dita, që ishte ngrysur shpejt, ia kishte lëshuar vendin errësirës, e cila kishte ardhur me vrull e me vrap, kishte ardhur e ngjeshur, e dendur, duke mbuluar më parë fushat e lumin atje poshtë, pastaj luginat e kodrat, pllajajat, grykat, honet e shkrepat e maleve të Kërrabës, që janë të shumtë e të modeluar në forma e variacione të papritura. E megjithatë, në fund fare errësira arriti edhe Mushibën, një fshat pak a shumë i hapur, me toka të buta anës lumit Erzen e me faqe të pjerrëta, përkundruall të veshura me koçimare, po edhe me ullinj, ndonëse të rrallë, por sidoqoftë ullinj.

Atë natë frynte një erë e lehtë, që nuk mbahej mend kur kishte filluar. Ndoshta dy javë më parë, ndoshta dy muaj më parë, kjo s'dihej me siguri, por dihej që frynte e megjithatë ishte butë dhe ishte qetë. Bufët mbi pemë, të gëzuar se ishte errësuar, po fillonin jetën e tyre me klithma, të cilat, pavarësisht nga gëzimi, janë gjithmonë qaramane.

Kishte kaluar një copë herë që në dritën e dridhshme të një kandili të vogël, Xhako Rina i kthehej sërish që nga e para llogarisë së përgjithshme të gjermanëve të vrarë, robër e të humbur, por ja që llogaria nuk po i dilte ashtu siç e kërkonin të dhënat dhe informatat e Komandës Eprorë. Xhakoja vërtet s'kishte bërë vecse dy klasët e ulëta të Normales së Elbasanit, por s'kishte qenë aspak i dobët, bie fiala në problemet e çurgjeve e të çiklistëve. P.sh. marrim këtë të fundit: një çiklist niset nga Tirana për Elbasan në iks orë, ecën kaq e aq km në orë. Një tietër niset nga Elbasani për Tiranë në iks orë, ecën kaq e aq km në orë, Në cilën orë e në cilin kilometër të rrugës Elbasan-Tiranë do të takohen këta dy çiklistë? Atij i kujtohej se

këtë lloj problemi që lidhej me rrugën automobilistike të Kërrabës, e donin shumë profesorët e matematikës të Elbasanit. Dhe kishte ndodhur një gjë e çuditshme, mendonte Xhako Rina, pikërisht edhe problemi që ai donte të zgjidhte atë mbrëmje lidhej me të njëjtën rrugë automobilistike: Kërrabë, nëntor 1944. E, megjithëse ky problem ishte fare i thjeshtë, shumë më i thjeshtë se i çiklistëve apo i çurgjeve që mbushnin hanzet me ujë, ai bazohej vetëm në dy nga katër veprimet themelore të aritmetikës, mbledhje-zbritje, dhe ishte vetëm me një të panjohur, prapëseprapë Xhako Rina nuk po e zgjidhte dot. Ishin 3000 gjermanë, 1500 nga të cilët u vranë në betejën e Mushibës, mbetën të gjallë 1500. Nga këta 400 ishin zënë robër, 300 të tjerë, që kishin mundur të dilnin gjallë nga Mushiba, qenë vranë nga forcat e tjera të Korparmatës së Parë gjatë rrugës për në Tiranë, si dhe në vetë qendrën e kryeqytetit. Kështu që shkruar për fundin e këtyre 300 gjermanëve në një komunikatë që përshkruante betejat për çlirimin e Tiranës. Atëherë vetiu ngrihej pyetja: po 800 të tjerët ku mund të ishin?

Ja pra ku e kishte burimin shqetësimi i Xhako Rinës atë mbrëmje nëntori, të qetë e të butë, megjithëse me erë të lehtë, me rosa të egra në qiell, me kukumjaçka në çatitë e shtëpive e me bufë qaramanë në pyllin aty pranë. Ku ishin, pra, 800 gjermanët e humbur pa lënë gjurmë?... Fundja, në mos 800, sa mund të ishin ata?... I pakënaqur për këtë enigmë, ai e mënjanoi fletën ku kishte bërë llogaritë dhe vazhdoi të shkruante raportin, të cilin duhej ta niste të nesërmen në mëngjes në Komandën Eprore.

Xhako Rina ngriti kokën ngadalë nga tavolina (apo nga ajo si tavolinë, diçka e sajuar shpejt e shpejt nga një dorë e pastërvitur ose e stërvitur keq, me ca dërrasa të çara e plot gdhënçka, por që kishte të përbashkët me tavolinat vetëm katër këmbët, edhe ato të shtrembra, me hunj të rastit), ngriti pra kokën ngadalë nga kjo tavolinë dhe, pa asnjë qëllim, nguli sytë tek opingat e mëdha të këshilltar Danit, i cili me gëzhjohën në majën

e shkopit të trashë prej thane, tërë xhunga e nyja, vazh-  
donte të bënte rrathë e katrorë në dërrasat e vjetra  
të dyshemesë.

Tha:

— Ti, Dan, do të bëje mirë sikur të shkoje tashti, të  
flije e të çlodheshe, se nesër na presin një tok me punë.

— Jo, komisar, unë do të rri këtu!

— E pse të mundohesh kot?

— Përveç derrave të egër kam edhe një shkak tjetër  
më të madh për të qëndruar këtu.

— Pa ma thuaj!

— Meqë Rubi është grua e ve, unë dua t'i bëj nder  
mysafirrit dhe së zunjës së shtëpisë. Siç e di ti, zakoni  
e kërkon që mikun të mos e lëmë vetëm në konak.

Komisari e shikoi Danin në sytë e zgjuar dhe e pra-  
noi në heshtje shpjegimin e tij. Këshilltar Dani, pasi  
kroi me njërën opingë noçkën e këmbës tjetër, tha:

— Meqë ra fjala për derrat, si do t'ia bëjmë, ko-  
misar?

— Do t'u vijë radha edhe derrave të egër, — tha  
Xhako Rina.

— Po kur?

— Nesër mbrëma.

— Sonte, sonte them unë.

— Sonte do të vazhdojmë kërkimin e tyre si çdo  
natë vetëm me skuadrat e caktuara për këtë punë. Të  
tjerët janë të lodhur.

— E di, — psherëtiu me keqardhje Dani. — Po ç'të  
bëjmë ne të shkretët, që derri i egër na e firosi misrin,  
mbetur arave pa u ngritur!

— Do ta bisedojmë.

— Po kur? — Edhe pamja e Danit, edhe opingat  
e mëdha të palëvizura mbi dysheme, edhe shkopi i  
rëndë prej thane, murrëtyer nga përdorimi e nga djer-  
sa e viteve, edhe zëri edhe gjithçka tjetër, sikur dësh-  
monin se kisha të bëje me një njëri këmbëngulës e ko-  
këngjeshur dhe mjaft të vendosur në kërkesën e tij. Të  
gjitha këto i mendoj Xhako Rina, por edhe ai ishte i  
vendosur në të tijën. Tha:



— Nesër mbrëma, Dan!

— Jo, sonte, komisar!

Aty në qoshe pranë vatrës, ku digjej një kërcu i madh, u dëgjua zëri i njomë i pionier Isës, që s'kishte të bënte as me tá, as me veten, por thjesht i mësonte abetaren një shokut të vet, që ishte pak më i madh se Isa. Ç'është e vërteta, dy çunakët çuqurisnin me zë të ulët, se e dinin që komisari atë natë ishte shumë i zënë me raportin për Komandën Eprore. Prej dy javësh Isa ia kishte ndërprerë shokut mësimin e abetares, sepse s'kishin pasur kushte. Gati dy javë kishin pritur në llogore kolonën gjermane. Dhe pastaj beteja. Por tashti që ishin mundësitë, komisari i kishte thirrur vetë, se dhoma ku u ndodh ai kishte zjarr, ishte e madhe, pastaj edhe ai donte të kishte njëfarë shoqërie, se kushedi, mund ta zinte gjumi nga lodhja, kurse të nesërmen në mëngjes Tirana priste raportin.

— Z-z-z...

— Po ç'është kjo z-z-z, — tha Dani. — Kjo më ngjan me fjalën zagarr!

— As topi s'e luan, — tha ai që mësonte e që nga mosha ishte pak më i madh se Isa. — Shkronja e parafundit e abetares.

— Pse, me zagarr mbaroka abetarja jonë! — deshi të bënte shaka këshilltar Dani.

— Me shkronjat Z e ZH, — foli me seriozitet pionier Isa.

Khako Rina uli kokën mbi letrat e bardha e të zhubrosura.

Këshilltar Dani vazhdoi të bënte me majën e shkopit figurat e tij mbi dysHEME. Rrathë e katrorë. Edhe më të thjeshtë. Gjysmërrathë e gjysmëkatrorë.

— Z-z-z...

$$+ 3000 - 2200 = + 800$$

— Pa hajde një herë këtu, çun, — tha befaz Dani.  
— Hajde më trego abetaren tënde.

Isa shikoi shokun dhe buzëqeshi. Buzëqeshi edhe ai që ishte pak më i madh se Isa. Pastaj Isa u ngrit tërë gjallëri dhe shkoi pranë këshilltar Danit. Ky i fundit,

pa lëvizur nga minderi, vuri shkopin në prehër, abetaren mbi shkop dhe me duart e ashpra e me gishtat e trashur nga kallot, zuri ta shfletonte. Pas çdo faqeje lyente gishtin me pështymë dhe, kur hapte faqen e re, thoshte:

— Edhe kjo me bojna! — Shikoi nga Isa (por sytë dhe shikimin i kishte të turbullt këshilltar Dani). — Të gjitha me bojna!

— Me bojna, xha Dan!

— Hë-ë, e bukur qenka!

— E bukur!

— Po ku shiten?

— Nuk e di. Abetaret me bojna, na tha komisari (dhe Isa shikoi nga komisari) kanë ardhur nga jashtë.

— Heu-u-u! — u çudit këshilltar Dani.

— Po, po, — tundi kokën Isa dhe shikoi prapë nga komisari.

Komisari i buzëqeshi. I buzëqeshi edhe Danit.

— Së shpejti do të kemi abetaret tona! — tha ai, tashmë me kokën të kërrusur mbi raportin që shkruante.

## 2.

Shumë nga ata që s'kanë pasur rast të marrin pjesë në ndonjë luftë, mund të pandehin se në një betejë partizane shumë-shumë mund të vriten disa dhjetëra gjermanë. Por unë që shkruaj këto shënime jam dëshmitar se në ndonjë ndeshje me armiqtë, kam numëruar jo vetëm me dhjetëra, por edhe me qindra të vrarë. Kësaj radhe me mijëra. Një mijë e pesëqind. E diçka

më tepër: kufoma të tjera të zbuluara gjatë dy ditëve të fundit. I kam numëruar vetë një për një dhe të gjithë u varrosën e po varrosen gati në praninë time, atje përfund fshatit Mushibë. Një mijë e pesëqind. Dhe diçka më tepër. Përveç robërve dhe atyre që u vranë gjatë rrugës për në Tiranë dhe brenda në Tiranë. Se ajo s'qe një betejë sidokudo. Por qe një betejë e madhe, bile shumë e madhe...

... Qëmtonte, por nuk mund të quhej akoma shi: toka kishte mbetur e tharë si më parë. Sapo ishte ngrysur kur nga faqet e Kërrabës erdhi deri në pozicionet e brigadës një uturimë e mbytur. Ata po vinin. Po zbrisnin. Po afroreshin shumë ngadalë, aq sa hapi i tyre mund të thuash se ishte një zvarrisje e vërtetë. Kur maja e kolonës u dëgjua më afër, Xhako Rina mori dy partizanë dhe ra poshtë kodrës, që ishte një kodër jo aq e pjerrët, por që çahet nga një përrua i thellë e që mbulohej me ullinj. Nëpër atë përrua zbriti Xhako Rina me dy partizanët dhe zuri vend njëzet metra mbi rrugë, pikërisht aty ku me urdhër të tij ishte çarë asfalti tejpertej dhe kishte marrë formën e një hendeku katër metra të gjerë dhe dy të thellë, por ishte çarë me marifet, thuaise e kishin prishur rrëketë e ujërave. Ai gjithmonë i kishte dhënë rëndësi çastit kur duhej të fillonte një betejë. (Në këtë çështje ai ndiqte shembullin e komandantit të brigadës, prandaj, herë ai, herë komandanti e merrnin vetë përsipër të jepnin sinjalin e parë të fillimit të betejës. Por komandanti s'ishte më. Ai ishte transferuar dy muaj më parë dhe, në vrullin e betejave të fundit, s'kishte qenë e mundur të emërohej një tjetër.) Aq më tepër, fillimit të kësaj beteje Xhako Rina i jepte shumë rëndësi. Të gjithë ata, kuadro e partizanë, e kishin ndier se kjo do të ishte një nga betejat e mëdha që kishte bërë Ushtria Nacionalçlirimtare e që do të hynte patjetër në historinë e saj. Kjo ndihej në korrespondencën dhe në urdhrat që kishte lëshuar Shtabi i Korparmatës së Parë; që s'do të ngjante me betejat e aq më pak me pritrat e zakonshme, kjo shikohej në vetë përgatitjet që ishin bërë për ta



pritur atë; në llogoret që kishin hapur, ku mund të qëndroje gati në këmbë; në përforcimin me armë pak a shumë të rënda, si mitralozë, mortaja e pushkë anti-tank etj.; në studimet që kishin bërë ata vetë, në mënyrë që rrezja e qitjes e çdo arme të vendosej në pozicion të atillë e në largësi të atillë që fuqia goditëse e fishekut apo fuqia shpërthyesë e predhës të ishte në maksimum; në fiksimin e shënjestrave në drejtim të rrugës, në rast se lufta ndizej natën; në dislokimin e forcave, në përforcimin e pozicioneve të brigadës me forca të tjera të divizionit të parë; në parashikimet e në variantet më të mundshme, qoftë të shpërthimit të partizanëve mbi gjermanët, qoftë të pykave e të krah-marriëve që mund të bënin gjermanët për t'u dalë partizanëve në shpinë. Pothuaj të gjitha ishin parashikuar, fitoret dhe humbjet, ashtu sikurse ishte parashikuar edhe fitorja përfundimtare. Që kjo s'do të ishte një betejë e zakonshme, për këtë dëshmonte edhe vetë mobilizimi i fshatrave rrotull, të cilët dhanë jo vetëm mjetet e punës dhe krahun e tyre për pozicionet që u shtrinë katër kilometra gjatë rrugës automobilistike, por shumë nga ata u rreshtuan edhe vetë me armë në dorë për të luftuar bashkë me partizanët. Ajo u ndie edhe në ndihmat që dha populli (megjithëse i dëmtuar rëndë nga lufta) për plotësimin e shumë rezervave ushqimore, për të cilat indendentit ishte gati ta nxirrte kaq kokrrën e lojit. E kudo, e kudo, në vetë lagështirën e nëntorit, në retë që trazoheshin vazhdimisht, që kërcënonin për shi e nuk lëshonin, në vetë errësirën apo në dritën e vranë të ditëve, e së fundi, në atë evakuim madhështor e të qetë të të gjithë fshatrave ku mendohej se do të zhvillohej betejja, apo në numrin e vullnetarëve të fshatrave më të largët e deri në miaullimën e maceve, të cilat çanin majë mureve të shtëpive të boshatisura.

Po edhe komanda gjermane e kishte parandier se diçka tronditëse do t'i ndodhte në faqet e këtij mali, që quhej Kërrabë e që mund të bëhej varri ose çelësi shpëtimtar i vetë kolonës dhe i vetë fatit të luftës për çlirimin e Tiranës, që vazhdonte prej gjashtë javësh,

por që dy javët e fundit, d.m.th. deri më 12 nëntor, kishte arritur pikën e saj kulminante. Një aeroplan zbulimi fluturonte disa herë në ditë, rrotullohej shkrepave e majave të Kërrabës, ulej poshtë pllajave, honave e luginave, ndiqte dredhat e lumit e pastaj, pajtjetër e me kujdes varte herë njërin krah herë tjetrin gjatë rrugës automobilistike, që ishte kthyer prej kohësh në Golgotë të vërtetë të ushtrisë gjermane, qëllimi i fundit i së cilës tashmë ishte të bashkohej me garnizonin e Tiranës e të tërhiqej duke çarë drejt kufijve veriorë.

Të gjitha këto, bile deri cicërimat e zogjve — që pajtjetër dukeshin të trishtuara — flisnin sa e madhe do të ishte kjo betejë e ardhme. Së fundi, për përmasat e kësaj beteje dëshmoi edhe takimi apo biseda që bëri me partizanët komisari i brigadës, Xhako Rina. Ai, si gjithmonë, edhe atë ditë ishte i qetë dhe po ashtu me qetësi bënte ecejaket e tij para brigadës së rreshtuar dhe thoshte se detyra e brigadës ishte të mos lejonte asnjë këmbë gjermani të arrinte në Tiranë, përndryshe e gjithë kjo forcë armike do të binte mbi shpinën e Brigadës së Parë, të Katërt, të Tetë e të Dhjetë e mbi të gjithë popullin e Tiranës, që kishte dalë në rrugë e në barrikada për të ndihmuar partizanët. Sa e madhe do të ishte kjo betejë, brigada e kuptoi edhe nga zëri i komisarit, kur u transmetoi mendimin e komandave eprorë, që kërkonin nga secili partizan të luftonte deri në pikën e fundit të gjakut. Dhe po në zërin e komisarit, në qetësinë dhe ecejaket e tij të matura, ata kishin paraparë gjithashtu besimin e patundur në fitoren përfundimtare...

Të gjitha këto, tashmë, i përkisnin së kaluarës, të gjitha këto tashmë kishin ndodhur: tashti kishte ardhur çasti vendimtar, tashti komisari ndodhëj njëzet metra mbi rrugë. Zhurma e mbytur e kolonës, e makinave në minimo, e tankeve dhe autobllindave, që zvarriseshin ngadalë, krikëllima e rrotave të karrocave dhe hingëllimat e kuajve, dritat e shuara, nata dhe lagështia — të gjitha tashmë ndiheshin e dëgjoheshin më shkoqur, dë-

gjoheshin edhe më afër. Gjëmimi i mbytur i dy motoçikletave përshkoi më së fundi errësirën gjatë pozicioneve të brigadës. Duke ecur fare ngadalë, dy motoçikletat qëndruan në buzë të kanalit të hapur. Ato qëndruan më pak se një minutë dhe ndezën dritat më pak se një sekondë. Pastaj u kthyen. Pastaj — disa minuta më vonë, dhjetë ose njëzet minuta, jo më pak — erdhën njëri pas tjetrit disa kamionë, gjithashtu në minimo, gjithashtu ngadalë, gjithashtu me drita të shuara. Hapën karrocëritë dhe ushtarët filluan të mbushnin kanalën. (Vetëm pas betejës u kuptua se kanali ishte mbushur me thasë orizi, mielli, makaronash e fasulesh e deri me thasë sheqeri e arka me marmelatë.) Ushtria gjermane s'kishte më kohë për të pritur. Ajo duhej të arrinte sa më parë në Tiranë, përndryshe garnizoni i Tiranës mund të asgjësohej, Tirana mund të çlirohej dhe atëherë ata do të mbeteshin të bllokuar, të dënuar plotësisht me vdekje. Ç'është e vërteta, kjo do të ishte një luftë e dëshpëruar, por me luftime të këtilla ushtria e *Rendit të Ri* në Evropë ishte mësuar prej kohësh dhe prej kohësh ishte mësuar t'i shiste ato si fitore të shkëlqyera të Rajhut të Tretë. Pastaj makinat u larguan dhe pati një pushim heshtjeje, errësire dhe qetësie, që zgjati më shumë se një orë. Asnjë lëvizje. Dhe as qëmtim. Veç erës së lehtë, veç rosave në qiell e bufëve në pyll dhe pranisë së hënës, të fshehur diku prapa shtresave të trasha të reve. Thuajse asgjë s'kishte ndodhur. Thuajse ajo s'ishte veçse një natë e zakonshme nëntori. Një natë paqeje. «Të zënë si miu në çark, kolonelët e Hitlerit kanë hapur xhamat e veturave, bisedojnë me njëri-tjetrin dhe bëjnë kështu mbledhjen më fatkeqe të shtabit të tyre të mjerë!» Këto e të tjera si këto mendonte Xhako Rina, u buzëqeshte në errësirë dy partizanëve që kishte në krah dhe mbështillte herë-herë qafën me jakën e ngritur të kapotës. Mund të kishin kaluar afër dy orë, kur filloi përsëri po ai marshim i mbytur, i ngadalshëm, i vajtueshëm, që u mbante aq mirë iso errësirës dhe erës së lehtë, tek vajtonte edhe ajo pas gjetheve të thara të vjeshtës. U desh edhe



një tjetër orë, derisa pararoja të kalonte ish-kanalin, derisa rreshtat e parë të ushtrisë të arrinin ish kanalin, d.m.th, të arrinte aty ku priste Xhako Rina me dy partizanët. I bindur se ky nuk ishte një mashtrim, i bindur se kolona armike marshonte kompakte sipas rregulloreve të mendjemadhësisë prusiane, ai, Xhako Rina, i shoqëruar nga dy shokët e tij, ngjiti kurrizin e kodrës nëpër përruan e thellë dhe, kur iu mbush mendja se ishte ngjitur aty ku duhej, ngriti automatikun lart dhe shtiu tri herë.

Ashtu filloi ajo, që dy ditë më vonë do të quhej *varri i gjermanëve...*

Xhako Rina sikur e ndiente kurrizin pak të mpirë. Zakonisht lodhja i vinte më vonë. Por ai nuk deshë të lodhej, ose, më mirë të themi, ai nuk kishte kohë të lodhej, prandaj u ngrit në këmbë dhe eci pak nëpër dhomë që të shpihej. Ishte i gjatë, i hollë dhe i dobët ose i dobësuar, me buzët të modeluara pak shtrembër, me sytë të ndritur (të përhimë, të thellë e pak të vegjël, por të ndritur), shikimi i të cilëve ishte gjithmonë i shqetësuar, kur e gjithë pjesa tjetër e genes së tij shprehte të kundërtën: qetësi të përjetshme.

— Mbarove, komisar? — pyeti këshilltar Dani.

— Jo, s'kam mbaruar, — tha Xhako Rina pa ndërprerë ecejaket.

— Z-z-z... — dëgjohej zëri i atij që mësonte shkronjën e parafundit të alfabetit, ndërsa Isa vetë, që luante edhe rolin e mësuesit, rrotullonte kokën pas ecejakeve të Xhakos, sikur të kishte një lidhje me pejza të padukshme midis tyre.

— Mirë, mbaro punë, pres unë, herët është për gjue-tinë e dërrit! — tha prapë këshilltar Dani, zgjati përpara opingat e mëdha dhe, me majën e shkopit të rëndë tërë xhunga, vazhdoi të bënte në dyshemë variante të atyre figurave, që tashmë mund të quheshin fare të thjeshta: rrathë, gjysmërrathë, katrorë, gjysmëkatrorë.

Xhako Rina buzëqeshi me vete. Por me sa duket buzëqeshjen ia kishte treguar edhe fytyra. Ai dyshoi për këtë se edhe Dani atje përballë, ulur në minder rrëzë murit, pati një buzëqeshje të njëjtë, e cila s'mund të kishte asnjë arsye dhe asnjë shkak tjetër, veçse të ishte thjesht një pasqyrim i buzëqeshjes së tij.

E kush je ti, i tha komisari vetes (e prapë buzëqeshi) që përpiqesh të shkruash një raport kaq të vështirë brenda disa orësh? Deri dje ti s'ishe veçse një djalosh, që mblidhje shkronja në shtypshkronjën e vogël të qytetit. Kur shikove për herë të parë një gjeneral fashist, kjo ndodhi në prillin e vitit 1939, atëherë ti s'ishe as njëzet vjeç. Ti e shikove dhe u trondite. Deri në atë kohë vetëm kishe dëgjuar se në Tiranë pranë pallatit mbretëror ndodhej i vetmi gjeneral me një emër të çuditshëm, Seregji. Ishe ti që radhite shkronjat për të shtypur lajmërimin, ku bëhej fjalë për vizitën që do t'i bënin qytetit motrat e mbretit, sovranet auguste, e që do të shoqëroheshin nga gjenerali i pallatit me emrin Seregji. Por, disa vjet më vonë kur pe në ballkonin e prefekturës gjeneralin fashist me tërë atë mjekër të zezë, me dekorata e kordele ngjyrë ari, kur pe edhe flamurin tringjyrësh me sëpatën e fashizmit italian, ti pate një dridhje të brendshme. Pastaj shokët të dhanë një komunikatë për ta lexuar. Pastaj të dhanë një komunikatë tjetër për ta shtypur. Dhe ti e shtype. Shtype edhe të tjera, kurse shokët i shpërndanin. Pastaj të bënë një thirrje. Atëherë ishte verë e vitit 1942. Ti gjete një revole gati të ndryshkur, e ngjeshe pas brezit, u përqafove me nënën dhe, duke fishkëllyer, me një cigare të ndezur midis gishtave e me një tjetër rrëzë veshit (e tërë pasuria jote e tundshme — të patundshme sikishe fare) shkove në male te partizanët, ku shokët të pritën me brohori dhe një vit më vonë po këta shokë të zgjodhën përgjegjës rinie në batalion, pastaj komi-

sar batalioni e së fundi komisar të brigadës së tanishme. Ja kush je ti. Dhe mos pandeh se je profesori me gjzylykë i gjuhës shqipe, që të mund të shkruash brenda disa orëve një raport për luftën më të madhe që ke parë e që ke bërë në jetën tënde!...

Buzëqeshi Xhako Rina. (Buzëqeshi edhe këshilltar Dani aty përballë.) Kësaj radhe komisari buzëqeshi, sepse i kishin shkuar sytë te këpucët e veta, të cilat, në vrullin e betejës së fundit, i qenë grisur në majë. Kështu ndodhte me të: këpucët i griseshin gjithmonë në majë. Me këpucë të grisura kishte shikuar gjeneralin fashist në prillin e vitit 1939, me këpucë të grisura kishte dalë partizan dhe ja, me këpucë të grisura e kishte mbaruar luftën. Dhe buzëqeshi. Pastaj u kujtua se nuk ishte vetëm. Z-z-z-të e shokut të Isës dhe gërvishtja e gëzhjës së shkopit të këshilltar Danit, që bënte figura në dysheme, e detyruan të ngrinte kokën ngadalë siç e kishte zakon dhe, kur e mbërtheu vështrimin në fytyrën e këshilltarit, mbeti pakëz i çuditur. Këshilltari ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, pjesëmarrës i vjetër në luftë, që kishte bashkëpunuar shumë herë me Xhakon dhe disa kohë më parë vetë Xhako Rina e kishte propozuar për këshilltar. Dani vërtet ishte pesëdhjetë vjeç, por punën që i ngarkohej e kryente me këmbëngulje si një djalosh njëzetvjeçar. Mund të të bezdiste pak derisa t'i kuptonte gjërat me themel, por, me t'i kuptuar, jepfe kokën, veç detyrën nuk e linte pa e plotësuar. Por kishte një të metë: ishte kokëfortë. Po t'i mbushej mendja për një gjë, sikur tërë njerëzimi të mblidhej para tij në një fushë të madhe, zor se ia kthente mendjen. «S'ka njeri pa të meta!» — tha atëherë Xhako Rina, kur e propozoi për këshilltar. Dhe kishte pjesën e vet pikërisht edhe kjo këmbëngulje që e kishte sjellë atë natë aty dhe e kishte ngujuar në minderin përballë. Të gjitha këto veti Xhako Rina kishte pasur rast dhe kohë t'ia njihte, por, të gabonte kaq shumë në fiziominë e tij, këtë Xhako Rina nuk e paskësh ditur. Ja pse ai mbeti i çuditur, kur pak më parë ngriti kokën dhe e pa me ngulm në fytyrë. Xhakos i qe fiksuar

p.sh. se këshilltar Dani kishte hundë të rregullt dhe faqe të zakonshme, kurse pikërisht këto të dyja ai i paskësh krejt ndryshe. Hundën p.sh. Dani e paskësh të gjërë e gati të rrafshët si feçkë dashi dhe faqet të fryra e pak të rrëzuara, pothuaj të shpërbëra. Çudi, ai e njihnte prej më se një viti dhe të mos dinte tamam si i kishte Dani faqet dhe hundën? Mos qe dashur kjo gjysmë ore që Dani të rrinte ulur aty, të priste, të parashtronte atë kërkesë, gati të çuditshme për derrat e egër dhe që me shkopin e trashë të bënte në dysheme katrorë e rrathë, që Xhako Rina të mund të fiksonte një herë e përgjithmonë pamjen e tij të vërtetë? Ndoshta fajet nuk i kishin faqet dhe hunda e Danit, por ai vetë, që e ndiente kurrizin të mpirë (pas mpirjes do t'i vinte lodhja) dhe që prej dy javësh s'e kishte bërë gjumin veçse copa-copa, përndryshe s'mund të shpje-gohej që të ngatërronte fytyrën e Danit me fytyra të tjera që kishte parë e njohur në vallen e luftës. Po ndoshta fajet i kishte edhe kandili me atë dritë të zbehtë e tepër të dridhshme.

Këshilltar Dani, që nuk buzëqeshte më, e shikonte tashti Xhakon gjatë e me durim, si të ishte edhe ai duke hetuar diçka të re në fytyrën e tij.

— Si je, komisar?

— Ashtu... mirë!

— Sikur të flesh pak. Edhe partizanët le të flenë. Herët është hala. Derri del vonë. Hala.

— Por dua të mbaroj këtë punë, — tregoi komisar i letrat e bardha që kishte përpara.

— Ti mbaroje punën, vetëm jep urdhër që pas dy orësh, bie fjala, pas jacisë, partizanët të ngrihen e të dalin me mua.

— Partizanët akoma s'janë mbledhur mirë nëpër baza. Pastaj, të thashë, Dan, ata janë të lodhur, dy javë qëndruan jashtë në pozicione!

— E di!

— Luftuan tri net e tri ditë pa e vënë syrin në gjumë.

— E di!

— Dy net e dy ditë të tjera brodhën pyjeve për të ndjekur mbeturinat e një çete balliste.

— E di!

— E si thua ti, t'i zgjoj?

— T'i zgjosh pas një ore!

— Jo!

— Misri, komisar, buka!

— Bëni si të bëni edhe sonte, nesër mbrëma i ngre unë partizanët dhe u futemi derrave...

— Jo, sonte!

— Të thashë, pra, bjeruni teneqeve dhe ndizni zjarre.

— Ai derr, me sa duket, u mësua pesë vjet me luftën e s'u trembet as teneqeve, as britmave, as zjarrit. E di ç'bën ai?

— Kush? — pyeti i hutuar komisar.

— Derri, pra!

— Çfarë bën?

— Ne i gjëmojmë me britma e me teneqe, ai largohet nga njëra arë dhe mësyn arën tjetër. Na-a-a e bën...

— Nesër mbrëma.

— S'më thua, ç'është ajo punë që paske sonte?

— Pse më pyet?

— Sepse e shoh, se ç'ke një zor e një shqetësim, — tha Dani.

— Tirana më kërkon të përshkruaj betejën që bëmë!

— Po shkruaje, o shoku komisar!

— Nuk po e shkruaj dot!

— Shkruaje ashtu si ndodhi. Ne pleqtë e sakatët, që ishim mbledhur në majë prapa shkëmbit, sa herë jua qamë hallin, kur shikonim gjermanët të ngjiteshin përpjetë si miza në dru. Pastaj ngriheshit edhe ju përballë tyre. Hajde-e-e, ç'ka shkruar ato tri ditë derisa i thyet!

Pas këtyre fjalëve dhoma kishte rënë në heshtje. Kishte heshtur edhe z-z-z-ja e Isës dhe e shokut të Isës. Çuditërisht komisar vuri re se, duke thënë ato fjalë, sytë e Danit sikur ishin veshur me lot, ndërsa faqet e varura(!) i qenë ngritur, muskujt i qenë sforcurar dhe shkopi i trashë i dridhej në duart leshtore.

— Por kam edhe një si hall tjetër, — u ngut komisari për të thyer këtë heshtje të rëndë.

— Ç'hall, shoku komisar?

— Më mungojnë disa qindra gjermanë!

— Nuk të kuptoj, — tha Dani. — Gjermanët i kemi aty. Të plagosurit, të sëmurët e më të dobëtit nëpër dhoma, të tjerët, nëpër ahure e nëpër vatha.

— Jo, nuk e kam fjalën për ata katërqind që u dorëzuan dhe u kapën menjëherë pas betejës. Nuk më del llogaria e plotë. Ja ta dëgjosh edhe ti. Ishin tri mijë gjermanë. U vranë një mijë e pesëqind. Kështu? Mbetën një mijë e pesëqind. Nga këta u zunë rob katërqind. Rrugës për në Tiranë e brenda në Tiranë u vranë edhe treqind, që mundën të çanin rrethimin tonë këtu. Kështu?

— Po.

— Po ku na u fshehën atëherë ta zëmë, tetëqind gjermanë, që të mbushet numri tri mijë? — pyeti komisari.

Këshilltar Dani bëri akoma një llogari me sytë gjysmë të mbyllur dhe në fund të kësaj llogarie mbështeti shkopin në dysheme, mbështeti trupin te shkopi dhe u ngrit në këmbë.

— Si, ore! — tha dhe mbeti ashtu në këmbë si dëshmi e një dyshimi të pashfaqur.

— Më vjen të pëlcas, Dan, — tha komisari. — S'më ka ndodhur kurrë. Nga m'u zhdukën qindra gjermanë. S'janë pak. S'janë pesë, as dhjetë, as njëzet, por qindra!

Dani u mendua.

— Pyjeve, — tha më në fund dhe ai dyshimi sikur i qe tërhequr nga fytyra.

— E besoj, por si na ikën!

— Ikën! — tha më thjesht Dani. — Bile, një rob që kapëm, ishte dehur duke ngrënë koçimare.

Pasoi një heshtje.

— Telashe nga disa egërsira, — tha Xhako Rina me inat.

— Ti nga gjermanët, unë nga derrat, — tha Dani si me shaka.

— Hë de, pra!

— Gjermanët dhe derrat për telashe janë! — tha Dani.

— Ç'ua punoi Hitleri, u hodhi trutë e gomarit. Dhe të mendosh, Dan, ç'popull i vjetër e me kulturë janë. E di ti ç'njerëz të mëdhenj ka nxjerrë Gjermania?

— Jo, nuk i di, po ti i di?

— I di ca, se kam punuar në shtypshkronjë, por jo të gjithë!

— Pa hë, ç'janë këta?

— Ç'të duash janë. Marksi, Engelsi prej andej janë!

— Kush, ore?

— Ata që kanë folur të parët për komunizmin!

— Jo, ore-e-e!

— Një muzikant i madh, Bethoven e quajnë!

— Gjallë është?

— Jo!

— T'i rrojë emri, — tha Dani. — Duhet edhe muzikantët. Një dasmë të bësh e s'e bën dot pa ta.

Xhako Rina vuri buzën në gaz, por vazhdoi:

— E sa e sa burra të tjerë, shkrimtarë e komunistë, disa nga të cilët Hitleri i zhduku nëpër kampet e shfarrosjes.

— Lum nëna që i bëri, — uroi Dani. — Por e kam fjalën për këta derrat e këtushëm, tetëqind, që thua ti, a je i sigurt se ata ishin tri mijë?... — Danit i mbeti fjala në gojë, sepse te shkallët e drunjta u dëgjuan një palë këmbë të rrëmbyera, të cilat ai i njihte fare mirë.

— Shoku komisar, Shak aga Dëllinja ka hapur fjalë, — u dëgjua që përtej pragut zëri i një gruaje, — se partizanët gënjejnë, kështu thotë ai, Shaku!

Ajo që foli ishte e zonja e shtëpisë, veshur me të zeza e me shami në kokë, në cepat e së cilës i dukeshin cullufet gjysmë të thinjura. Trupin e kishte të lidhur dhe dukej akoma e fuqishme, por s'ishte vështirë të dalloje se fytyrën e të gjithë pamjen e saj i zotëronte një notë e përhershme dëshpërimi.

— Cili është ky Shak Dëllinja, teze Rubi? — pyeti komisar.

- Një aga, se bejlerë s'kemi në fshat, — tha Dani.
- E ç'thotë?
- Thotë se partizanët s'kanë vrarë as dyqind gjermanë, që i plaçin sytë, sikur nuk i shikon kufomat që mezi po i mbulojmë atje poshtë!
- Tjetër, ç'thotë?
- Thotë se gjermanët arritën mirë e bukur në Tiranë, u bashkuan me shokët e tyre, që luftuan atje dhe vërtet që ikën, por i paskan premtuar parisë se nuk do të jetë e largët dita kur do të kthehen prapë!
- Tjetër ç'thotë? — pyeti i gjallëruar Xhako Rina.
- Në mos u ktheftë gjermani, thotë Shaku, do të vijë anglezi, patjetër që do të vijë anglezi, kështu thotë!
- Ti u besove këtyre fjalëve, teze Rubi?
- Jo!
- Po a do ta lëmë ne anglezin edhe po të dojë të vijë?
- Jo, — tha Rubi.
- Po të tjerët ç'thonë, i besojnë atij?
- Ku ta di unë, njerëzit janë të ndryshëm!
- Në rastin më të parë të mbledhim fshatin e ta demaskojmë, — tha komisari.
- Pasoi një heshtje.
- Komisar, a t'ju sjell të hani darkë? — Shikoi ajo komisarin, Isën, Danin, shokun e Isës, që mësonte z-z-z...
- Xhako Rina shikoi gjithashtu Isën, Danin dhe shokun e Isës (pak më i madh se Isa) dhe, si të kishte marrë nga heshtja e tyre përgjigjen që i duhej, tha:
- Më vonë, teze Rubi!
- Mirë, si të domi, — tha Rubi. — Por jeni të lodhur. S'janë kthyer as ata të dhomës tjetër.
- Bëjnë rojë. Kur të kthehen, jepu ç'të të ndodhet!
- Mirë, — tha Rubi. — Nesër, kur të jenë të gjithë në fshat, të mbledhim popullin e t'i tregojmë Shakut



se iku koha e tyre! — Kështu tha ajo, shikoi nga Isa që mbante abetaren në dorë, buzëqeshi dhe iku, duke marrë me vete notën e dëshpërimit.

#### 4.

Ta zëmë se atje në Komandën Eprore e lexuan raportin që po shkruaj unë dhe mbetën të pakënaqur, ose të paktën u mbetën shumë pika të paqarta. Ta zëmë se më thirrën vetë e më pyetën si shkoi beteja e Mushibës, ajo që ishte dhe është një nga betejat tona më të mëdha. Ç'do të them unë, si do t'u përgjigjem pyetjeve të tyre? Që t'u them se u ndeshëm trup me trup, besoj se s'do të jetë fare e nevojshme për hollësira të tilla, sepse ndeshjet trup me trup s'kanë qenë të rralla për ushtrinë tonë. Edhe se si gjermanët sulmuan tetë herë në faqet e një kodre dhe hoqën dorë vetëm kur u vranë më se gjysma e tyre, edhe këtë e kuptojnë, ose e marrin me mend, pa qenë nevoja për mua. E megjithatë, edhe sikur t'ua them të gjitha, prapëseprapë nuk do të mund ta përshkruaj tablonë e plotë si u zhvillua beteja. Sulme e kundërsulme. Zjarr mbështetës, luftë guerile në kurrizin tonë, d m th depërtim i ushtarëve nazistë me grupe të vogla prej tre a katër vetash, pastaj artileria e të gjitha kalibrave, tanket, antitanket, mortajat, autobлиндat e njëqind veprime të tjera dhe prapë sulme e kundërsulme, — gjithë kjo terminologji e luftës sikur e ngushton shikimin, sikur i merr frymën, sikur nuk lejon apo nuk ndihmon të tregosh thelbin e asaj që ngjau apo përmasat e vërteta të be-

tejtës vetë. Ta zëmë se do të jetë e nevojshme të tregoj se, pa kaluar mirë një orë aty nga fillimi i betejës, errësira e natës së nëntorit u ndriçua nga dhjetëra zjarre të mëdha. Digjeshin kamionë, karroca, përmbyseshin topa, vraponin kuaj në flakë e njerëz në flakë. Rruga ishte kthyer në një skenë teatri, kurse gjermanët atje poshtë lëviznin si kukulla të përgjakura në një dekor të madh natyror që pushtonte një hapësirë prej gati katër kilometrash. Kështu vazhdoi beteja për disa orë, derisa errësira u mund dhe mëngjesi erdhi me muzgjet e tij vazhdimisht të lagura. Tashti u hap pamja e vërtetë, që tregonte se çfarë kishin mundur t'i bënin armikut gjatë natës kalibrimi i krahut të partizanëve për të hedhur me saktësi bombën e dorës në rrugë, fiksimi me kohë i shënjestrave të mortajave, të mitralozëve të rëndë e të lehtë, qëndresa jonë ndaj mijëra grykave automatike të armikut, që mund të thuash pa e tepruar, se kishin kositur gjysmën e degëve të koçimareve, përmes të cilave zgjateshin pozicionet e brigadës. Por kishte qenë natë dhe asgjë s'ishte parë me sy, veç që ndihej kur binin mbi kokën e partizanëve gjethë, bisqe e degë koçimaresh dhe shpesh atyre u duhej që me një dorë të largonin ato, me tjetrën të hidhnin bombën, ose të mbanin shokun e plagosur, që rënkonte mbytur e lehtë, se beteja dhe nata nuk duronin e nuk pranonin të tjera zhurma, përveç krismave e buçitjeve. Por mëngjesi e zuri sheshin e betejës plotësisht të heshtur. Këtë heshtje nuk e kishte diktuar asnjë urdhër. Ajo kishte ardhur vetiu. Mos ndoshta të dyja palët e ndien të nevojshme të shikonin se ç'kishte ndodhur e ç'kishin bërë gjatë natës? Mos ishte kjo një stepje e natyreshme, një hutim, një hetim, për të menduar, për të peshuar gjendjen, për të kalkuluar se ç'forca kishin mbetur e se ç'duhej bërë e ç'mund të bëhej më tej?... Të gjitha bashkë ishin përzier, e, meqë ishin përzier të gjitha bashkë, treva e përkohshme, e shpallur vetiu, pa marrëveshje paraprake, nuk zgjati një çast e një minutë, siç është bërë zakon të flitet e të shkruhet, por ajo zgjati gati një orë. Mund të merrej me mend se të dyja palët shqetësoheshin për të

vrarët e për të plagosurit. Katër partizanë të shëndoshë me katër partizanë të vrarë në krah, partizanë të tjerë me të plagosur e të shtrirë në vigje, ngjiteshin përpjetë kodrave, drejt majës, ku ndodhej infirmieria dhe intendenca ose, në gjuhën ushtarake, prapavija e luftës. Nga ana e armikut, atje poshtë, përveç ndonjë kali, që kishte shkëputur palldëmin dhe ecte kuturu në rrugë, e ndonjë rrote, apo topi e karroce që gremisej vetë në hendek e kamionëve që digjeshin me flakë tashmë të zbehura nga ndriçimi, e gjithë pjesa tjetër mbulohej nga misteri, padijenja dhe heshtja. Mos armiku kishte gjetur ndonjë të çarë gjatë natës dhe kishte kaluar?... Mos vallë tashti ai kishte arritur në Tiranë?... Asgjë nuk dihej, asgjë s'merrej dot me mend. Atëherë?... Atëherë duhej provokuar...

Kështu, gati një orë pas heshtjes një skuadër partizane bëri provokimin e parë, doli nga pozicionet dhe rrëshqiti poshtë. Atëherë... armiku filloi një qitje njëherësh me të gjitha armët që kishte në arsenalin e tij e me të gjitha armët që ishin krijuar e shpikur për një ushtri moderne. Gati tri mijë veta (thëmi gati, sepse të vrarët e armikut gjatë natës duhej të kishin arritur disa qindra) ishin drejtuar nga kodrat ku gjarpëronin paralel me rrugën pozicionet partizane. Shtinin topa me qitje direkte e jodirekte, topa fushorë e malorë e deri antiajrorë, shumica e të cilëve nuk arrinin të qëllonin kodrat, por vlenin vetëm për të krijuar ushtima qiellore. Shtinin tanke e autoblanda, pushkë antitanke, mortaja të të gjitha kalibreve, mitralozë të rëndë e të lehtë, pushkë snajperësh, automatikë e bomba dore e shumë lloje të tjera e deri revolverë. Jo brenda një minute, por disa herë brenda një minute partizanët ishin të detyruar të largonin gjethet, bisqet e degët e koçimareve, që u binin mbi pozicione e mbi kokë. Pastaj qitja ndërpritej dhe diku në një sektor të rrugës apo në këmbët e një kodre dukeshin oficerë, që, ndërsa i binin bilbilit, ngrinin niëren dorë lart dhe menjëherë, me shpejtësi të rrufeshme, rreshtoheshin prapa tyre, bile gati në radhë të drejta, pesëdhjetë ushtarë

(kurrë më shumë se njëqind) dhe, si një makinë e vetme, të gjithë oficerët njëherësh ulnin dorën e ngritur, tregonin faqet e kodrave përballë dhe fillonin kështu sulmin e tyre me britma nga më të ndryshmet. (Dhe ishin pikërisht ato britma, që pasqyronin dhe dëshmonin sa thellë u ishte futur tmërri në shpirt e sa dëshirë e vullnet kishin ata për ta fituar këtë betejë).

Atëherë partizanët, që kishin arritur të bënin pastrimin e mundshëm të pozicioneve nga mbeturinat e komandantëve, nxirrnin më parë kokën, pastaj tytën e armës dhe fillonte kështu kundërpërgjigja, që përbëhej as më pak as më shumë sesa nga një mijë e dyqind gryka zjarri, gjithashtu gati të të gjitha llojeve të armëve të këmbësorisë.

Një orë pasi kishte aguar filloi ajo që mund të quhej etapa e dytë e luftimeve e që do të ishte edhe etapa vendimtare...

Khako Rina e kishte kokën të rëndë. Tashmë ai e ndiente kurrizin jo si më parë, pak të mpirë, por gati të mpirë. Ngriti qepallat ngadalë dhe hodhi sytë nëpër dysheme. Pastaj vështrimi i tij u ngul tek opingat e mëdha të këshilltar Danit e te maja e shkopit të tij, që bënte mbi dysheme tërë ato figura, të cilat me sa iu dukën Xhakos, nuk ishin fare të thjeshta si ca kohë më parë, nuk bënin më katrorë e rrathë, por diçka më tepër, diçka më të ndërlikuar. Por Khako Rina ishte në pragun e lodhjes dhe as kishte ndër mend dhe as kishte dëshirë e fuqi të deshifronte ato që shkruante Dani me shkopin e tij.

Za... za... be... li... dëgjoi ai një zë të largët si nga fundi i botës. Shoku i Isës paska filluar të bashkojë shkronjën Z me të tjerat, tha me vete Khako Rina. Tashti ai s'mund të quhet më analfabet. Bukur. Mund të themi se shoku i Isës, duke pasur Isën si mësues, e zhduku analfabetizmin në prag të Çlirimit. Bukur. Por ama... pastaj filluan kundërsulmet tona. Dhe punët këtu u bënë lëmsh. Pastaj filluam ne të sulmojmë dhe ata të kundërsulmojnë. Dhe punët u ngatërruan më shumë. E kështu me radhë. Por do të ishte më mirë të

dihej se erdhi një çast që përleshja u zhvillua në shtratit e përroit, pikërisht në deltën që ai krijonte pranë rrugës, para se të futej nën një urë të vogël. Kjo deltë e ky shtrat që ishin shkelur nga këmbët tona e të gjermanëve, qenë kthyer në baltë e në disa vende në llucë të vërtetë. Bile, kishte raste, që në ultësirat pranë rrugës, edhe partizanët edhe gjermanët të ngecnin në këtë llucë dhe atëherë të dyja palët kundërshtare, duke qenë përballë njëra-tjetrës hundë më hundë, luftonin e mbërtheheshin vetëm me duar, si pemë të ngulura thellë në tokë, degët e të cilave kapërthehen midis tyre nga furtuna. Ja, kështu beteja bëhet më e kuptueshme dhe më e ndjeshme, tha me vete Xhako Rina. Po a do të mund t'i shkruaj të gjitha këto? Pastaj ndodhi ajo, që në luftë quhet zbrapsje. Zbrapsja e gjermanëve, ose më mirë të themi zbrapsja e parë e gjermanëve, sepse gjatë tri ditëve e tri netëve që zgjati beteja, do të ketë disa sulme e kundërsulme, disa përparime e zbrapsje nga të dyja palët. Por e kishim fjalën të zbrapsja e parë e gjermanëve. Në fillim fronti i tyre u lëkund lehtë, pastaj radhët e tyre u tronditën, pastaj u çanë. Repartet e grupimet e sulmit prej pesëdhjetë deri njëqind veta, filluan të luftonin të veçuara nga njëra-tjetra. Atëherë ne i sulmuam, i detyruam të zbrisnin prapë në rrugë, ku ata zunë përsëri pozicione mbrojtje...

## 5.

Pyeti këshilltar Dani:

— Hala s'i gjete gjermanët e humbur, komisar?

— S'di ç'të të them, Dan! — u përgjigj Xhako Rina.

— Si më parë, të humbur!

— Oj, çudi! — tha Dani dhe përmbi fytyrë i doli së-  
rish si një dëshmi ai dyshimi i vjetër e i pashfaqur,  
i cili e siguronte për diçka e që hëpërhtë ishte thjesht  
një e fshehtë vetëm e tij. Por shpejt e mblodhi veten  
dhe tha: — Kaq rëndësi paskan këta gjermanë të hum-  
bur ferrave?

— Jo dhe aq, Dan!

— Atëherë, lëri gjermanët dhe të merremi me de-  
rrat, që po na firosin misrin, — tha Dani gjysmë me  
shaka gjysmë me seriozitet dhe e shikoi me ngulm ko-  
misarin, si për të fshehur e, në të njëjtën kohë, si për  
të zbuluar vetëm një pjesë të atij dyshimi të vjetër e  
të pashfaqur.

— Por ama, këta gjermanë të humbur pa lënë gjur-  
më, janë një dëshmi e gjallë që tregon se ata u bënë  
leckë, se u detyruan të struken ferrave si breshkat e  
si derrat e egër dhe se e mbaruan luftën për turp, si  
gjithë agresorët e tjerë që kanë ardhur te ne.

— Shiko shiko, bukur e the, komisar, me turp e  
mbyllën luftën!

— Tjetër rëndësi pothuaj nuk kanë, përveç bezdisë  
që na shkaktojnë, kur e dimë se këtu rrotull nesh vër-  
titen akoma disa qindra gjermanë, e ndonjë dëm të  
rastit që mund të na bëjnë në përpjekjet për të shuar  
urinë e tyre.

— Thua, aq shumë të jenë ata, komisar?

— Nuk dihet, Dan. Mund të jenë njëqind, mund të  
jenë pesëqind, mund të jenë... ku ta dish... Në luftë  
asnjëherë s'dihet me saktësi numri i armikut. Këtë e  
mëson vetëm në fund, kur e rrethon, e asgjëson ose  
e zë rob të gjithë. Por unë, për lehtësi të punës sime  
në përpilimin e raportit, kam marrë për bazë shifrën  
tri mijë gjermanë. Një informacion që na erdhi ditët e  
para thoshte se nga Elbasani kanë dalë afërsisht gjashtë  
mijë gjermanë. Gjysmat e tyre u nisën për Durrës, për  
të dalë në Vorë e për të sulmuar nga prapa forcat  
partizane që luftonin për çlirimin e Tiranës. Gjysmat,  
pra rreth tri mijë, ngjiten Kërrabën, me qëllim që të  
sulmonin Tiranën nga ana tjetër. Kaq dimë ne. Dimë

që këtu në Mushibë kemi vranë një mijë e pesëqind gjermanë, kemi zënë robër katërqind dhe vetëm treqind, pasi kapërcyen pozicionet tona, u vranë rrugës dhe te sheshi para ministrive. Këta bëjnë gjithsej dy mijë e dyqind. Nga shifra tri mijë mungojnë tetëqind...

— Ou-u-u! — prishi fytyrën Dani. — S'thua, më mirë, tetëqind derra të egër, komisar!

— Të shohim, kur t'i kemi zënë të gjithë, atëherë do t'i bëjmë llogaritë të sakta, — vuri buzën në gaz Xhako Rina.

— Po kur do t'i zëmë?

— Mos u mërzit, Dan, në xhep i kemi! Skuadrat që kemi caktuar vazhdojnë kërkimet!

Këshilltar Dani tundi kokën dhe u duk sikur deshi të thoshte akoma diçka, por, në çastin e fundit, u pendua, heshti, dhe vetëm disa minuta më vonë, murmuriti:

— Po, komisar, po!

Pas «po-së» së fundit të këshilltar Danit, midis tyre u vendos prapë heshtja. Por nuk zgjati shumë.

— Je i lodhur, komisar! — tha befas Dani.

— Jam ca i lodhur.

— Jo ca, por shumë!

— Shumë thua? — pyeti Xhako Rina, pa e prishur megjithatë qetësinë e fytyrës.

— Je edhe i pagjumë! — thia këshilltar Dani, ndërsa hetonte sytë e skuqur të komisarit.

— Do të flej nesër sa të ngopem.

— Nesër jo, — tha me këmbënguljen e tij të njohur këshilltar Dani dhe hunda e gjerë si e dashit diç u përpoq të nuhaste në ajër. — Nesër mund të të thërrisin në Tiranë.

— Edhe po më thirrën, sa të raportoj, do të kthehem menjëherë.

Pasoi një heshtje.

— Dua të të them diçka, komisar!

— Thuama.

— E shoh që e paske zor atë punën e Tiranës.

— Zor e kam.

— Nganjëherë e shikoj që shkruan tek ato letrat e gjata...

— Raporti!

— Nganjëherë në copa të vogla letrash.

— Mbaj shënime. Shkruaj dhe në të njëjtën kohë mbaj shënime për t'u përgatitur me gojë.

— Sikur të flije pak. Pastaj të zgjoheshe e të mbaroje këtë punë, — tregoi ai me majën e shklopit letrat e bardha e të zhubrosura mbi tavolinë ose mbi atë si tavolinë! — Pastaj hamë pak nga turshitë e Rubit dhe shkojmë atje!

— Ku atje?

— Të trembim e të vrasim derrat e egër pra!

— Prapë e ktheve fjalën te derrat? Që të shkojmë atje, duhet të zgjojmë partizanët!

— Le të flenë edhe ca. Vetëm pas jaxisë derri fillon të lëvizë!

— Të thashë, partizanët nuk i zgjoj!

— Edhe unë të thashë, është fjala për misrin, për bukën e gojës!

— Bëni si të bëni edhe sonte!

(Erdhi koha të themi se në këtë bisedë e në këtë këmbëngulje të përsëritur për derrat e egër që hanin misrin e për partizanët që duhej të flinin, pra, në këtë bisedë midis dy burrave kokëfortë, kishte diçka aq sa të drejtë e me vend për secilin, aq edhe arkaike e të padrejtë për secilin.)

— Të shikoj dorën që të dridhet, komisar!

— Cilën dorë?

— Atë që shkruan!

«Komisari zgjati dorën e djathtë përpara. I dridhej vërtet. Zgjati tjetrën. I dridhej më shumë.

— Të dyja, — tha këshilltari.

— Po, — tha i menduar Xhako Rina.

— Keq na ndodhi, komisar!

Xhako Rina uli kokën mbi tavolinë.

— Duhet të çlodhem pak, — tha ai.

— Fli pak.

— Do të fle, ja kështu siç jam, — tha ai.



— Por para se të marrësh një sy gjumë, sikur të urdhëroje që, pas jacisë, një batalion partizan të vijë prapa meje! Nuk është punë e një ose dy skuadrave kjo!

— Do ta kisha dhënë urdhrin menjëherë, — tha Xhako Rina, — por...

— ?...

— ... Të gjithë janë të lodhur! — tha më në fund komisari, i trishtuar dhe i mërzitur. Kjo ishte hera e parë që ai jepte shenja trishtimi e mërzitjeje. Dhe ishte hera e parë që ai nxori një si zhurmë të ngjashme me një rënkim, e cila u duk sikur nuk i doli vetëm nga goja, por nga i gjithë trupi i tij, që ishte një trup i gjatë, i hollë dhe gjithmonë i lodhur, megjithatë gjithmonë energjik dhe gjithmonë në këmbë, përjashtuar këto orë të mbrëmjes, ngujuar aty për të shkruar raportin. Pastaj, krejt padashur, koka e komisarit u ul derisa u mbështet mbi krahun e lëshuar mbi tavolinë.

Këshilltar Dani e shikoi Xhako Rinën me dhembshuri dhe tha me vete se, po të që nga mosha, komisari mund të ishte fare mirë djali i tij. Pas këtij zbulimi të vonuar të Danit, në dhomë u bë heshtje, sa edhe Isa me shokun e vet, me të parë komisarin që uli ballin mbi krah, e ndërpre në leximin e gjermës Z. Veç drutë kërcisnin në vatër, por kërcitja e tyre nuk e prishte heshtjen, përkundrazi sikur e theksonte më tepër atmosferën e përgjumur të dhomës. Dani e kishte vënë shkopin në prehër dhe padashur e fërkonte si një fëmijë të vogël.

Jashtë nata ishte e errët dhe errësira ishte e qetë. Era e lehtë, që befasi lëshonte ndonjë gulsh, duhej të ta bënte gjumin shumë të këndshëm dhe për këtë gjumë dëshmonte edhe frymëmarrja ritmike e komisarit. S'dihej se pse në ato çaste këshilltar Dani mallkoi gjermanët dhe derrat e egër, që dy netët e fundit (sonte ishte nata e tretë) po u binin më qafë arave me misër të fshatit Mushibë, që ishte një fshat buzë rrugës automobilistike e që kishte pësuar tërë ato kusure nga lufta. Dhe prapë i qau hallin rinisë që, siç e kishte dëgjuar ai, pa mbaruar mirë kjo luftë, do të nisnin menjëherë një tjetër luftë, që ata e quanin lufta për ndër-

timin e Shqipërisë së re. Kur mendimet i arrinin deri te Shqipëria e re, Danit se pse i visheshin sytë, sikur kishte një perde, sikur nuk shikonte mirë. Fajet, sigurisht, nuk m'i kanë sytë, mendonte ai, m'i ka koka që s'para merr vesh nga këto punë. Dani kishte bindje se populli do të ishte më mirë, do të kishte partinë e tij, që bënte ashtu si donte populli (për këtë Dani kishte shumë prova gjatë luftës), nuk do të vuante më për bukën e gojës dhe do të punonte shumë. Sa për punë, thua ti, o burra, veç të mos na shkojë kot, se tërë jetën punë kemi bërë, por gëzim s'kemi parë! — Këto tha Dani me vete dhe pa e ditur se ç'bënte, përplasi shkopin pas dyshemesë. Ah, zgjova komisarin, tha me inat e me keqardhje.

Xhako Rina mori frymë thellë, tundi kokën, mbësh-teti faqen tjetër në dorën tjetër dhe ra prapë në gjumë. Jasthtë kishte filluar të binte shi i imët, po që nuk e prishte qetësinë. Kandili i Rubit kërciste e përpëlitej kushedi pse dhe herë-herë nëpër xhamin e dritares së vetme rrëshqiste ose gërvishte ndonjë gjethe e tharë nga fiku i oborrit, degët e të cilit zgjateshin drejt mu-reve të dhomës.

Diku më larg e lart në qiell gagarisnin rosat. Në pyll klithnin bufët. Dhe kukumjaçkat sikur qanin mbi çatitë e fshatit.

## 6.

— Xhako, u lodhe, bir, t'ju sjell të hani, pastaj t'ju shtroj të dyvë për të fjetur, — tha Rubi duke shikuar nga Isa, që, pasi kishte mbetur vetëm (shoku i tij ishte kthyer në skuadrën e vet për të kryer shërbimin e ro-

jës), kishte zënë të lexonte një nga ato broshurat, që u shpërndareshin komunistëve gjatë luftës.

— Edhe pak, — tha Xhako Rina, duke ngritur kokën nga letrat. — Po ti, Isë, a do të hash?

Isa ngriti edhe ai sytë dhe shikoi teze Rubin. Sytë i kishte të kaltër Isa dhe nuk i kishte të mëdhenj, por as të vegjël nuk i kishte. Një copë herë as nuk diti, as nuk qe i vendosur ç'të thoshte. Po, me të parë komisar-in, që kishte filluar nga puna, tha:

— C-c-c...

— Po ha, more bir, — tha Rubi. — Të paktën ha ti që je i vogël!

— Do të ha me komisar-in, teze Rubi, — tha ai.

— Komisari do të hajë me Danin, — tha Rubi. — Ata janë burra!

— Edhe unë me burrat do të ha, — tha ai dhe vuri buzën në gaz. Kur buzëqeshi, nëpër faqe iu bënë dy burma të vogla fëmijërore.

Tek pa ato burma, në sytë e Rubit doli më në pah ajo nota e njohur e dëshpërimit. Por të ecurit e kishte të kundërt Rubi, e kishte të vrullshëm, ashtu siç kishte edhe zërin, të fortë dhe gjestet të gjalla. Ajo vendosi llambën në qoshe të tavolinës dhe largoi kandilin. Llamba ishte e madhe, me pasqyrë të rrumbullakët, të zbukuruar anëve. Ishte edhe e re, gjë që kuptohej menjëherë.

— Këtë llambë e kemi blerë në kohën e Haxhi Qamilit, — tha ajo. — E bleu im shoq, rahmet pastë. Atë kohë Baftjari, Zyberi, Shaku, Bajaziti dhe agallarë të tjerë u zhdukën nga fshati. Ne thamë se shpëtuam një herë e mirë. Një ditë kaluan nëpër fshat ushtarët e babë Haxhiut dhe të nesërmen u hap fjala se nëpër Mushibë do të kalonte babë Haxhiu vetë. Im shoq u ngrit, shkoi në Tiranë, bleu këtë llambë dhe tha se do ta ndizte kur babë Haxhiu t'i pinte kafën. Por ai s'erdhi as të nesërmen dhe asnjëherë nuk erdhi në Mushibë, derisa e zunë shokët e Zyberit e të Bajazitit dhe e varën! — Rubi heshti aq sa iu desh për të hequr poçin e llambës. — Pastaj tha: — Edhe disa vjet më vonë

thamë se e fituam. Atë vit u bë ajo çaçamerja e madhe, që ne e thërrisnim revolucion e që flitej se ky revolucion do t'ua merrte tokat bejlerëve dhe agallarëve dhe do t'ia shpërndantë fukarasë. Im shoq tha se llambën do ta ndizte atë natë që do të merrnim tokën. Por tokën nuk e morëm dhe llambën nuk e ndezëm. Atëherë im shoq tha se do ta ndizte kur të martonim vajzën e vetme që kishim. Por vajza u sëmur... dhe nuk u bë për martesë! — Rubi nuk foli më, ndërta nota e njohur e dëshpërimit tashti i qe mbuluar nga një vel i verdhë, që i kishte rënë mbi fytyrë. Me duar të dridhura Rubi ndezi fitilin dhe llamba, në krahasim me kandilin, lëshoi një dritë më të bukur, një dritë më të bardhë dhe pa luhatje.

— Paska qenë thënë të ndizej kur të vinte Partia! — tha ajo, mori kandilin dhe tha prapë: — Sikur të hanit pak bukë! — dhe shikoi nga të tre. Sigurisht, më parë nga Isa e nga komisari, pastaj nga këshilltar Dani, që ishte vendas e që nuk mund të quhej mysafir si partizanët, por gati njeri i shtëpisë.

— Po çfarë do të na japësh? — pyeti me shaka Dani.

— Turshi, — tha Rubi. — Bukë misri me turshi! — Edhe ajo kishte folur me shaka. Dhe nga kjo shaka, veli i verdhë sikur i ra nga fytyra dhe i mbeti vetëm nota e përhershme e dëshpërimit, pa të cilën as që mund të përfytyrohej teze Rubi.

— A s'bën të na japësh pak më vonë! — u lut prapë Xhako Rina.

— Kur më vonë?

— Ja, sa të mbaroj këtë, — tha ai duke treguar letrat.

— Me sa shikoj unë, komisar, — tha Rubi me zërin e fortë e me gjestet e gjalla, — punët tuaja s'mbarojnë kurrë! — Ajo i kishte shqiptuar këto fjalë pak me zemërim e me keqardhje për komisarin. — Hani dhe flini. Dy javë që mezi vidhni një sy gjumë!

— Sa të mbarojnë kusuret e luftës, — tha Xhako Rina, — pastaj do të punojmë e do të flemë siç i përket njeriut!

— Kurse unë do t'jua sjell bukën kur të më teket,

pa ju pyetur fare! — tha Rubi dhe doli me vrull, duke lënë pas vetes zërin e fortë e gjestet e gjalla.

Tashti që ishte hequr kandili, tashti që dhoma ishte pastruar disi nga era e vajgurit, ndihej më e fortë era e tymit të duhanit, që pinte shpesh këshilltar Dani, e më rrallë edhe Xhako Rina. Ajo dhomë mbante edhe erë pajimesh ushtrie përzier me djersë. Jo se ishin aty komisarë, Isa dhe Dani. Nga ata po se po. Por në atë dhomë prej tri ditësh e tri netësh, menjëherë pas mbarimit të betejës, hynin e dilnin partizanë, komandantë e komisarë etj. etj., sepse aty në shtëpinë e Rubit, që kishte shpëtuar pa u djegur, komisarë kishte ngritur shtabin e brigadës.

## 7.

— Vajza iu sëmur kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, — tha Dani me sytë tek opingat e mëdha. Në përgjithësi nga ana e jashtme Dani ishte njeri i qetë dhe i duruar, vetëm shkopi dridhej paksa në duart e tij leshtore, maja e të cilit nuk bënte më katrorë e rrathë, por ca figura të pakuptueshme plot zigzage, që të kujtonin zvarrisjen e gjarprit të egërsuar. Fytyra e tij, që sidomos në profil dukej si rrasë (këtë përshtypje ta jepte hunda e dashit) tashti që fliste për vajzën e Rubit, ishte bërë e padepërtueshme, si fytyra e sfinksit. Ai ishte akoma i fuqishëm, por ishte gati i moshuar për t'i pasur flokët të zez. Por ja që i kishte të zez. Dhe moshën pesëdhjetëvjeçare.

— Kishte një sëmundje të çuditshme vajza e Rubit.

Në pamje dukej e shëndetshme dhe e pashme si Rubi. Por natën shikonte ëndrra të lahtarshme, ashtu thoshte, flinte a s'flinte një orë gjumë dhe vetëm në mëngjes, kur njerëzia shkonin në punë, ajo kapitej e flinte pothuaj tërë ditën. I thanë Rubit dhe të shoqit ta çonte vajzën në doktor, se ajo na qenkësh një sëmundje që kishte të bënte me nervat. Po ku t'i gjenin paratë Rubi dhe i shoqi? Atëherë iu drejuan hoxhë efendiut, i cili kërkoi ta merrte vajzën në shtëpi, ta mbante dy javë, dhe u premtoi se do ta shëronte. Hoxhë efendi u mori vajzën, e mbajti dy javë, vajza u kthye në shtëpi, por nuk u shërua. Bile u bë më keq se më parë. Nga pagjumësia syri iu bë dollap, i themi ne, fytyra iu murrëtye dhe e zinte një e qarë, që e mbante me ditë të tëra. Më vonë vajza u mbyll fare e s'u duk më në njerëz. Një mëngjes, nja shtatë muaj pasi kishte dalë nga hoxhë efendi, vajza e Rubit u gjend e mbytur. Lumi e kishte hedhur atje poshtë në fshatin tjetër. Kurse këtu në bregun tonë u gjend një fëmijë shtatanik që kuiste si mace e vogël dhe që vdiq në agim. Gratë e kuptuan menjëherë se vajza e Rubit kishte qenë lehonë. Hoxhë efendi! — tha Dani dhe maja e shkopit të rëndë bëri rrugën e gjarprit të egërsuar.

Pas këtij rrëfimi Xhako Rina vuri re një gjë: megjithëse deri te shtëpia e Rubit uturima e lumit vinte e qartë, ai pyeti veten si ishte e mundur që s'e kishte dëgjuar më parë atë uturimë?

Broshura e Isës kishte rënë në vatrë dhe sytë e tij të kaltër ishin veshur si me re të holla të tejdukshme.

— Po hoxha ç'bëhet sot pas dhjetë vjetësh? — pyeti Xhako Rina.

— Rron, qeni! — tha Dani, lëvizti nga vendi dhe u duk sikur murmuriti një syre nga kurani. — Rron. Gjatë luftës u lut për të dyja palët njësoj, si për partizanët edhe për ballistët. Robtë e perëndisë, thoshte!

— Po tashti ku është?

— Dy javë më parë, kur ndjeu erën e barutit, u largua nga fshati. Por do të kthehet. Ja këtu e ka xhaminë, një të hedhur guri!

Isa shikonte komisarin, komisari shikonte Danin, Dani bënte gjarpërinj të egërsuar në dysHEME. Mund të ishte një lodër e dritës së llambës, por në të vërtetë fytyrat e të treve ishin njësoj të tendosura. Veç nata ishte e qetë, e errët, ndonjë gjethe fiku fërkohej pas xhamit dhe binte në tokë. Frynte rrallë.

— Thonë, — tha befaz këshilltar Dani, — atë natë disa kalimtarë dëgjuan një zë vajze nga mesi i lumit që thërriste, o ba-a-a, o ma-a-a!... Me sa duket, kur pa vdekjen me sy, siç ndodh nganjëherë, vajza e Rubit u pendua dhe kërkoi ndihmë. Kalimtarët u hodhën në lumë, por e arritën të mbytur në fshatin tjetër.

Pasoï një heshtje, që e ngarkoi akoma më tepër fytyrën e Danit me kujtime të vjetra. Ai thirri prapë, por kësaj radhe thirrja e tij tingëlloi si zemërim, si dhimbje e si kërcënim.

— O ma-a-a, o ba-a-a!

Pranë vatrës, partizani i vogël, Isa, ishte zverdhur dhe ishte kthyer i tëri në sy e veshë. Por Dani nuk e vinte re: atë e kishin mbuluar kujtimet dhe zemërimet e vjetra. Vetëm Xhako Rina, që e dinte se të paktën kjo thirrje kishte të bënte me njëfarë mënyre me jetën e Isës, e pikërisht me motrën e tij, shikoi nga vatra Isën, pastaj Danin, si t'i lutej të heshte.

— Xha Dan...? — pyeti Isa.

Këshilltar Dani ktheu kokën nga vatra, por u duk qartë se sytë e tij të vagëlluar nuk shikonin Isën, nuk shikonin asgjë nga e tanishmja, por të kaluarën, bëlle, edhe thirrja O ma-a-a, o baba-a-a, sikur nuk dilte nga goja e tij, por nga ata sy të përhumbur në mjegullat e viteve.

— Ç'deshe të më thoshe, Isë? — e pyeti Dani, i cili, më në fund, kishte zbritur në të tanishmen me shqisa e me mendje dhe shikonte Isën, që ishte tronditur, që ishte zverdhur e trishtuar e që Dani me përvojën e tij prej pesëdhjetëvjeçari, kuptoi se Isa nuk do të fliste më. Atëherë ai gjeti rastin kur Isa kishte ulur

sytë, shikoi nga komisari, dhe ky i fundit, që ishte zhytur vetë në kujtime, i pëshpëriti ngadalë:

— Dan, ky është ai pionieri i ngjarjes që të kam treguar!

8.

## RRËFIMI I ISËS

Shtëpia e Kostaq Bedenit ngrihej menjëherë pas murit të oborrit tonë. Anash ajo kishte një si kopsht të vogël. Por jo tamam kopsht. Aty vërtet kishte disa pemë frutore e jofrutore, por toka s'punohej kurrë, pemët ishin lënë krejt pas dore dhe pulat kakarisnin kudo gropave e ferrave të këtij kopshti të braktisur, me të cilin xha Kostaqi s'kishte pasur kurrë kohë të merrej.

Dy djemtë e xha Kostaqit, Dhimitri dhe Stefani, ishin shokët e mi. Sidomos Dhimitri, që ishte moshatar me mua, por që e kishte lënë shkollën dhe i ati po i mësonte zanatin e marangozit siç ishte vetë. Ne ishim fqinjë dhe shkonim mirë. Babai im ka qenë nëpunës i vogël, por një vit më parë fashistët italianë e kishin pushuar dhe ai u bë shitës ambulant. Bleu një kalë, e ngarkonte kalin me çikërrima, fshihte disa letra nën samarin e kalit (më vonë unë mësova se ato ishin komunikata të Partisë Komuniste të Shqipërisë) dhe largohej fshatrave. Pas një jave kthehej dhe sigurisht do të më pyeste se ç'libra të rinj kisha lexuar nga ata, që ai i mbante në një raft pranë krevatit dhe që i kishte caktuar për mua.

Unë mbetësha shpesh pa lexuar, sepse më pëlqente



të dëgjoja kur bisedonin me njëra-tjetrën nëna ime me Uraninë, që ishte gruaja e xha Kostaqit. Sidomos kjo ndodhte në verë e në vjeshtë. Sapo ngrohej koha, Urania ulej në çardhak (Bedenët kishin trashëguar një shtëpi të vjetër me dy kate) dhe, po të shikonte nënën time në oborr, duke nderë ndonjë çarçaf ose duke prashitur ndonjë lule, ua niste muhabetëve të pafund. Zakonisht ajo fliste për kohën, për të mirat që sillnin me vete vera dhe vjeshta, sidomos për fukarenjtë e të papunët, për jetën që ishte më e lirë në këto stina, për zarzavatet që zëvendësonin mishin, për këmishët e xhaketat që zëvendësonin trikot e leshit e palltot e mëdha, për gjellën që mund të kishin vënë në zjarr dy gratë, për lakrorët me hithra apo për kripanikët, për djathin me vrima të bakejve, që s'kishte fare yndyrë, për minjtë që ishin bërë të padurueshëm, për macet e dembelosura, për burrat që ktheheshin të lodhur e për shumë gjëra të tjera, që unë i dija, i njihja dhe të paktën i merrja me mend.

Po të ishte mëngjes herët, unë çliroja veshët nga jastëku dhe dëgjoja bisedën e dy grave. Zakonisht unë zgjohesha para se papuçet e nënës të rrihnin korridorin, bile para se babai të ngarkonte kalin dhe potkonjtë të rrihnin kalldrëmin e oborrit. Por, ndonëse zgjohesha herët, më pëlqente të rrija shtrirë në dyshek e të ëndërrroja me sy hapur. Nganjëherë më bëhej sikur më pëlqente të vdisja. Por jo, shpejt kujtohesha se nuk kisha dëshirë të vdisja, dhe befas më pushtonte një dëshirë e re, që ishte krejt e kundërta e së parës: të bëhesha hero. Por si të bëhesha hero e çfarë heroi të bëhesha, këtë nuk e dija akoma, as nuk e përfytyroja dot. Nganjëherë dëshiroja të krahasohesha me heronjtë e librave që më jepte babai për të lexuar, ose të imitoja apo t'u ngjaja heronjve të komunikatave të Partisë, që unë i lexoja shpesh, se e kisha mësuar vendin ku i fshihte babai. Në 'Shqipëri kishte nisur një luftë e madhe, por fantazia ime për këtë luftë aty fillonte, aty mbaronte, bile më parë mbaronte sa fillonte. S'kisha parë akoma shumë gjëra nga jeta. Isha fëmijë dhe këtë

ma thoshin shpesh edhe të tjerët. Atëherë, si nga inati, më shkante mendja të pija duhan, po edhe të vërtisja stekën e të luaja bilardo si të rriturit, që i kisha parë përtej xhamave të klubit dhe prapë, si nga inati, ëndërrja të bëhesha kampion botëror në bilardo. Shpesh pyesja veten: Pse duhet shkolla? Ja, ta zëmë mësova vite e vite, e pastaj? Do të emërohesha një nëpunës i vogël siç kishte qenë babai im, derisa një ditë do të më pushonin nga puna dhe atëherë do të bëhesha shitës ambulant, duke bredhur pas 'bishtit të një kali. A s'ishte më mirë të mësoja një zanat, bie fjala, të mësoja për marangoz, si Dhimitri, i biri i xha Kostaqit, që ishte moshatar me mua e që ishte shoku im i ngushtë? Sigurish, diçka duhej të bëja. Kështu nuk rrihej, duarkryq, si i thonë fjalës. Dhe prapë mendoja... Edhe kur i kujtoj sot ato mendime, sot që jam partizan, më duket se disa prej tyre, cigaret, bilardoja, apo dëshira për të vdekur e tjera kanë qenë nga mendimet më të marra, që mund të kishte menduar një njeri në atë kohë.

Atje midis çardhakut dhe oborrit shkëmbeheshin dy zërat e njohur. Nga çardhaku vinte zëri i trashë si zë burri i Uranisë së xha Kostaqit, nga oborri zëri i hollë e si i trishtuar i nënës sime. Mua më dukej se zëri i nënës sime ishte bërë i trishtuar që kur babanë e pushuan nga puna.

Ne të vegjlit luanim në kopshtin e Dhimitrit e në magazin që ndodhej në fund të kopshtit, ku bedenët mbanin ca vietërsira të panevojshme. Ai kopsht i papunuar, me ferra e me pemë të pakrasitura kurrë, ku ndrisnin fijet e merimangave, ku cicëronin zogjtë dhe ku maçoku i zi i Bedenëve ecte tinëzisht duke spërdredhur bishtin si gjarpër, kjo pjesë e botës, ky kopsht, më dukej shumë i bukur në dritën e diellit. Them në dritën e diellit, sepse natën jo, përkundrazi, sa herë që më ndodhte të kaloja natën nëpër oborrin e shtëpisë sonë, kopshti i Bedenëve aty pas murit më shtinte frikën me ato pemë të hardallosura e me ato hije që shumëzoheshin dhe e bënin të ngjashëm me roma-

nin «Misteri i Luvrit», që e kisha lexuar pa lejen e babait tim. Veçanërisht magazja e Bedenëve, me çatinë gjysmë të shembur, më kallte tmerrin, kur mendoja se fantazma e Luvrit e kishte fare lehtë të dilte natën nga ajo çati, të më përgjonte kur unë kthehesha vonë, të hidhej në oborrin e shtëpisë sonë e të më vërsulej me thonjtë e saj të gjatë e të llahtarshëm. Por ditën, jo. Ditën, ajo pjesë e botës dukej e bukur në dritën e diellit dhe shumë e dashur e pa mistere.

Por një pasdite Dhimitër Bedeni u kthye bashkë me të atin dhe nuk shkoi më në punë. Xha Kostaqin, që kishte ndrydhur krahun dhe e kishte lidhur pas qafës, shoqëria italiane, ku ai punonte kohët e fundit, e kishte zëvendësuar me një tjetër më të fuqishëm. Ishte verë, shkollat ishin mbyllur dhe ne luanim gjithë ditën me Dhimitrin, me vëllanë e tij më të vogël, Stefani, me të motrat e tij, sidomos me Kristinën, që ishte motra më e madhe e Dhimitrit, një vit më e madhe se ne, katërmbëdhjetëvjeçare dhe që ishte e bukur, pak e trishtuar e nganjëherë qesharake, edhe si komike, por gjithmonë e bukur. Motra ime nuk ishte e hedhur si Kristina, ishte pak e turpshme dhe tepër e verdhë, si lule e rritur në hije. Dy motrat e tjera të Dhimitrit ishin të vogla, më të vogla se motra ime, dy qurrashe, që më shumë na pengonin sesa dinin të luanim. Gjatë tërë qershorit gjëmoi kopshti me ferra i Bedenëve nga lodrat tona, kurse në magaze ne improvizonim pjesë teatrale, të cilat jo që s'ishin të tilla, por as skeçe nuk ishin, nuk ishin asgjë, e megjithatë ne mbeteshim të kënaqur me to. Ndërsa Arta ime, Stefani, sidomos dy motrat e vogla të Dhimitrit luanin role pa vlerë (këto të fundit ne i quanim çapaçule), të paktën Dhimitrit dhe mua na jepej rasti të ndryshonim fizionominë, të vinim mustaqe prej misri, të bëheshim trima që vrisnin kuçedra, që i lëshonin ujin fshatit, që bënin atentate nga ato që kishim dëgjuar herë pas here rrugëve të qytetit dhe në këto atentate ne vrisnim vetëm njerëz, që i kishin majat e mustaqeve të ngritura lart si bisht miu. Pastaj heronjtë apo partizanët e bashkë me ta edhe

armiqtë e partizanëve (zakonisht çapaçulet) shpërndaheshin sapo të na thërrisnin për ndonjë punë ose për të ngrënë drekën ose darkën. Ishte verë e vitit 1943. Por atë verë ndodhi një çudi edhe në kopshtin e Bedenëve. Një mëngjes, xha Kostaqi (me krah të lidhur) ishte ngritur menatë dhe kishte ndrequr derën e magazines. I kishte vënë një dry të madh derës dhe e kishte mbyllur.

— Që sot e këndej në magazine s'do të luani më, — na tha ai.

Ne u çuditëm, por magazja nuk u hap as atë ditë, as ditët e tjera. Dalëngadalë ne e harruam magazinën, harruam të ashtuquajturit skeçe, harruam trimat e kuçedrat, heronjtë, partizanët e spiunët dhe krijuam lodra të tjera rreth pemëve e ferrave të kopshtit. Por mua më vinte inat kur dëgjoja babanë dhe nënën, që më thërrisnin për të ngrënë drekë.

— S'dua, thosha unë.

Babai më shikonte me qortim.

— Pse nuk do? — pyeste ai.

— Nuk dua të shkëputem nga lodrat!

— Po ata a nuk i thërresin për të ngrënë?

— Jo! — thosha unë dhe çuditesha me vete, — pse Dhimitrin, të vëllanë dhe tri motrat e tij nuk i thërrisnin si më parë për të ngrënë?

Babai e nëna ime shikonin të çuditur njëri-tjetrin, më shikonin edhe mua me dyshim, por këto dyshime zhdukeshin shpejt dhe ne fillonim të hanim. Më kujtohet një vit më parë, kur babai ishte në punë, ne hanim disi mirë, por, që kur e hoqën nga puna dhe babai bleu kalin dhe zuri të shkonte fshatrave për të shitur gikërrima, që nga ajo kohë ne hanim gjithnjë më keq. P.sh. trahananë që e kishim ngrënë zakonisht mëngjesve, tashti po e hanim shpesh e më shpesh drekave. E kështu për të gjitha. Më pak djathë, më pak oriz, më pak gjalpë, më pak sheqer, por sidoqoftë hanim tri herë në ditë dhe babai e nëna ishin të kënaqur me oreksin tim më tepër se me oreksin e Artës, që vinte e dobët dhe e verdhë.

Nuk di se si një ditë vura re që Dhimitri, jo vetëm

Dhimitri, por edhe vëllai më i vogël, Stefani, edhe Kristina e bukur, edhe dy qurrashet e tjera ishin dobësuar shumë. Nuk kishin dëshirë të luanin, rrinin mbështetur pas trungjeve të pemëve dhe shikonin die-llin, siç bëjnë të sëmurët kur, më në fund, ngrihen nga shtrati dhe dalin jashtë. Pas dy ditësh ata nuk na thirrën fare për të luajtur si zakonisht, as mua as motrën time, Artën, ata nuk dolën as në kopsht, bile, edhe kur unë e Artë i thirrëm, ata nuk u përgjigjën. **Ku të ishin? Asgjëkundi! Ishin mbyllur brenda! E pse?...**

**Por unë nuk di pse bëra njëfarë lidhjeje midis gjendjes së tyre të dobësuar dhe magazines, që na e kishte mbyllur xha Kostaqi dy javë më parë. Megjithatë kjo lidhje nuk mund të quhej e rastit. Po atë ditë që Dhimitri e të tjerët nuk dolën për të luajtur, unë kisha dëgjuar disa britma në shtëpinë e Bedenëve. Britmat kishin qenë të xha Kostaqit e të Uranisë. Diçka i thoshte, diçka i lutej Urania xha Kostaqit. Pastaj për diçka zuri t'i bërtiste. Prastaj zuri t'i përmendte fëmijët, që ishin dobësuar, i përmendi edhe magazinën. Sikur i tha se nuk bëhej kiameti po të merrnin një dorë oriz për fëmijët, vetëm për fëmijët. Por aty xha Kostaqi që bërë nervoz, i bëri Uranisë, përplasi këmbët në dyshemenë e vjetër, bëri prapë, tha disa herë «jo, jo, jo», atëherë Urania qau dhe i kërkoi falje të shoqit dhe unë e dëgjova fare qartë kur ajo i kërkoi falje.**

— Ke të drejtë! — i tha. — Ke të drejtë!

Kaq. Në shtëpinë e Bedenëve ra heshtja.

Dëgjova prapë xha Kostaqin që foli me zë të zbutur e si i penduar për britmat:

— Sa të më shërohet edhe pak krahu, do të hap një barakë e do të filloj menjëherë nga puna!

Atë ditë Urania nuk u duk në çardhak që të bisedonte si zakonisht me nënën time, megjithëse nëna ime tërë paraditen u vërtit nëpër oborr, lau rroba në koritë, i nderu në tel, i thau, i hekurosi të shkallët e sallonit. Më kujtohet se biseda e tyre e fundit kishte qenë para dy ditësh. Dhe ato kishin biseduar për ma-

çokun e mi të Bedenëve, që kishte filluar të gjuante minj e për macen e Bedenëve, që kishte pjellë katër këlyshë. Urania i kishte premtuar nënës sime t'i jep-te këlyshin e zi, që ishte shumë i bukur e që unë e doja fort.

Pas kësaj bisede Urania s'kishte dalë më në çardhak. Ajo nuk doli as pas grindjes me të shoqin dhe tashti që Dhimitri, Kristina, Stefani e dy çapaçulet ishin mbyllur brenda, unë shpesh shikoja qiellin përmbi majat e pemëve të kopshtit, përmbi çatitë e hallakatura të shtëpisë së vjetër e të magazines po aq të vjetër të Bedenëve dhe e ndieja veten shumë të trishtuar për çdo gjë: trishtim e mall për lodrat që kishim luajtur e që tashti nuk luanim më; trishtim për vetminë e madhe apo për diçka të papërcaktuar, që Dhimitri, i vëllai e tri motrat e Dhimitrit ishin dobësuar, ishin hutuar e nuk qeshnin më; trishtim për mbrëmjet që do të vinin, për krahun e sëmurë të xha Kostaqit, për Uraninë, që s'kishte dalë më në çardhak të bisedonte me nënën time, për grindjen që kisha dëgjuar në shtëpinë e Bedenëve; trishtim për të ardhmen, që nuk e dija se ç'do të bëhej e ç'do të ndodhte me ne, se diçka jo e mirë (kështu më dukej mua) na vërtitej mbi kokë të gjithëve, na vërtitej ditë dhe natë...

Por diçka duhej të bëja. Kështu nuk mund të rrija: Dhe gjëja e parë që më shkoi në mendje ishte të përgjoja Dhimitrin kur të dilte nga shtëpia. E për fatin tim të mirë atë mbrëmje Dhimitri doli vërtet nga porta e shtëpisë dhe u nis diku pa më folur. Atëherë unë u lëshova me vrap prapa tij.

- Dhimitër! — thirra unë.
- Çfarë do, Isë?
- Dua të më thuash, pse je ndarë nga unë.
- Nuk është e vërtetë që jam ndarë nga ti!
- E pse nuk del të luajmë?
- Nuk më pëlqen të luaj!
- Atëherë unë dua të më thuash pse je dobësuar?
- Nuk jam dobësuar!

— Janë dobësuar edhe të tjerët! — thashë unë.

— Cilët? — pyeti ai.

— Kristina!

— Tjetër?

— Stefani dhe dy çapaçulet!

— Asnjë nuk është dobësuar!

— Më thuaj, — thashë unë, — pse u grindën sot me fjalë xha Kostaqi me nënën tënde?

— Nuk e di! — tha ai dhe, për mënyrën si m'i tha ato dy fjalë, unë besova se ai nuk dinte gjë. Pasi më shikoi në heshtje, ndoshta një minutë të tërë, befaz u largua nga unë jo pa keqardhje.

— Dhimitër! — thirra unë.

Ai qëndroi dhe më shikoi i pavendosur.

— E di si është puna, — tha ai, — ne hamë vetëm një herë në ditë. Babait iu mbaruan paratë, kurse krahu... — dhe iku.

— Dhimitër! — thirra unë, por aty për aty e ndjeva se e kisha thirrur kot. Isha krejt i pafuqishëm dhe fare në pamundësi për ta ndihmuar e për ta lehtësuar sadopak nga brenga, që sapo më kishte treguar.

Ai qëndroi.

— Ku shkon? — e pyeta përsëri kot.

Dhimitri shikoi anëve dhe më pëshpëriti në vesh:

— Do të lajmëroj një mikun e babait për të boshatisur magazin!

— Çfarë ka në magaze?

— Nuk e di, — tha Dhimitri. — Ka gjëra të ndaluara, që i dinë vetëm babai, nëna dhe ai miku i babait.

— Kur do ta boshatisni?

— Sonte në mesnatë.

— A të vij dhe unë?

Dhimitri u mendua një minutë të tërë.

— Të lajmëroj vetë, — tha ai. — Por është tepër sekret! — Kështu tha dhe iku. — Kundër fashizmit! — shtoi.

Unë gjithmonë kisha ëndërruar aventura e prapa aventurave heroizma të panumërt, frymëzuar nga vetë jeta e qytetit, nga jeta e rinisë, nga leximi i komuni-

katave, që fshihte babai nën samarin e kalit, dëgjuar nga të rriturit, nga prindërit, rastësisht. Ndoshta ajo që do të bëja atë natë mund të mos quhej heroizëm, por të paktën do të zbuloja enigmën e magazës. Po ndoshta kjo që do të bëja atë natë, do të krijonte edhe mundësira, që shoku im të ngopej me bukë, që Kristina e bukur të mos venitej, që vëllai tjetër e dy motrat e tjera të Dhimitrit të mos i kishin më sytë të skuqur nga të qarët e nga të pangrënët.

Por para se të vinte nata, unë duhej të kryeja edhe një punë tjetër që më shqetësonte. Në mbrëmje i thashë babait:

— Bedenët hanë vetëm një herë në ditë!

Babai u kthye ngadalë nga unë për të më shikuar dhe, sipas zakonisht, më shikoi gjysmë minute pa folur.

— Më tha Dhimitri se dje nuk kishin ngrënë fare,  
— thashë unë.

Babai u mendua.

— Janë dobësuar të gjithë, — thashë unë. — Nuk u ka mbetur asgjë. Xhà Kostaqit iu mbaruan rezervat. Krahu s'po i shërohet.

— Prej sa kohësh hanë vetëm një herë në ditë? — pyeti babai.

— Prej disa ditësh, — thashë unë.

— E besoj, — tha babai. — Diçka duhet të bëjmë, derisa Kostaqit t'i shërohet krahu.

I kënaqur për bisedën që bëra me babanë dhe i kënaqur nga premtimi i tij, shkova në dhomën e gjumit, por më kot, se atë natë gati nuk fjeta. Nuk kisha orë me zile. Nuk kisha fare orë. Një orë me zile që kishim, e mbante nëna në komodinën e vet, sepse nëna ishte ajo që ngrihej e para në shtëpinë tonë. Ja pse unë nuk fjeta fare atë natë. Përgjoja Artën që flinte në këndin tjetër të dhomës dhe mbaja veshët përperjetë: me të dëgjuar zhurmën e parë në kopshtin e Bedenëve, do të ngrihesha, do të vishesha e do të kapërceja murin e oborrit fshehurazi nga babai e nga nëna. Kështu kaluan nuk di sa orë, duke ëndërruar për aventurën që më priste. Po para se të dëgjoja zhurmën



në kopshtin e bedenëve, dëgjova zilen e sahatit në dhomën tjetër. Pastaj dëgjova hapat e babait e të nënës në korridor. Kjo më çuditi, po s'ishte koha të çuditesha e s'ishte koha të prisja. U veshja, përgjova për herë të fundit Artën, më erdhi keq për të që kishte lindur katër vjet më vonë se unë, eca në majë të këmbëve dhe, kur babai me nënën ishin në kopshtin e Bedenëve, menjëherë pas tyre shkela edhe unë.

— Po ky?! — u çudit nëna.

Babai më shikoi në heshtje në dritën e zbehtë të hënës, pastaj foli:

— Le të vijë! — Këto fjalë ia kishte drejtuar nënës. — Por... — Këtë «por» ma kishte drejtuar mua.

Unë vura gishtin në buzë: sekret! Babai e kuptoi dhe në dritën e zbehtë të hënës fytyra e tij u qetësua.

Në rrugë ne dëgjuam zhaurimën e këpucëve me gozhdë të rojave fashiste. Ne pritëm derisa zhurma u shua, pastaj... Kur arritëm të tre në fund të kopshtit ku ndodhej magazja, atje ishin mbledhur të gjithë, xha Kostaqi dhe miku i tij, Urania, Dhimitri, Kristina dhe një tjetër i panjohur me yll në kasketë (unë u drodha nga gëzimi: partizan). Tre më të vegjlit, Stefani dhe dy çapaçulet apo qurrashet duket s'dinin gjë dhe sigurisht flinin, ashtu siç flinte Arta jonë. Puna ishte e thjeshtë: do të ngarkonim thasët dhe trastat që ndodheshin në magaze mbi një kamion, i cili priste në rrugicën prapa shtëpisë. Të mëdhenjtë mbartnin thasët, ne të vegjlit, bashkë me ne edhe xha Kostaqi me një dorë, mbartnim trastat. Në thasët dhe në trastat kishte oriz, fasule, miell, vaj, sheqer, makarona. Kjo punë zgjati një orë. Pastaj partizani me yll në kasketë — aty unë njoha Xhako Rinën, që e kishte shtëpinë në lagjen tonë e që kishte punuar në shtypshkronjën e vogël të qytetit — ky Xhako, që asokohe pas-kësh qenë përgjegjës rinie në batalion, na shtrëngoi dorën të gjithëve, mua më ra edhe faqeve me përkëdheli, ngriti grushtin dhe tha:

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — i thamë ne.

Xhako Rina hipi në kamion (kamionin e drejtonte ai miku i xha Kostaqit) dhe kamioni u nis me drita të shuara, kurse ne, të lodhur e të djersitur, u ndamë me Bedenët me një «natën e mirë» dhe u kthym në shtëpinë tonë, ku ramë të flinim.

Mua përsëri nuk më zuri gjumi menjëherë. Isha i gëzuar për pjesëmarrjen time në këtë aksion të bukur, por isha i gëzuar edhe për derën e magazines që mbeti e hapur si më parë. Përsëri do të luanim teatër: unë, që isha trimi i përrallave, Kristina e bukur, që priste ta shpëtoja nga keqbërësit e nga fashistët. Isha lodhur dhe isha djersitur, duke menduar e duke u vërtitur me pizhame të zbërthyera nëpër krevat. Befas çdo gjë që deri atë ditë më ishte dukur e zakonshme dhe, për më tepër, e kotë e pa kuptim, tashti para syve të mi kishte marrë një pamje tjetër, një pamje të jashtëzakonshme, gati heroike. Ashtu më zuri gjumi. Po para se të mbyllja sytë, përgjova edhe një herë Artën. Ajo flinte.

Në mëngjes unë shkova nga Bedenët për t'i treguar Dhimitrit se babai im do të bënte diçka për t'i ndihmuar, por nuk qëndrova gjatë, u ktheva, bile shpejt, dhe mjaft i gëzuar. Babanë e prita në sallon. Ishim vetëm dhe unë e pyeta:

— E more vesh, baba?

— Jo, çfarë? — më pyeti ai.

— Xhako Rina, ai partizani që ngriti mbrëmë ushqimet nga magazja e Bedenëve, u kishte lënë prapa derës trasta me miell, me fasule, me oriz e me kripë, shishe me vaj, makarona dhe përmbi trastat kishte vënë një pusullë, ku e qortonte xha Kostaqin që s'u kishte treguar më parë shokëve për gjendjen e rëndë të krijuar në familjen e tyre nga mungesa e ushqimeve.

— Kush t'i tha? — më pyeti babai.

— Dhimitri. I kishte gjetur xha Kostaqi në mëngjes herët prapa derës së magazines.

Ne heshtëm një copë herë dhe ishim të dy të kënaqur. Deri në sallonin tonë erdhi era e vajit që digjej. E morëm me mend se Bedenët po hanin mëngjes. Pas-

taj dëgjuam këngë. Këndonin si dikur Kristina me dy çapaçulet. Dhe këndonin bukur. Kurse Dhimitri më thirri:

— Isë!

— Po!

— Eja të luajmë!

Zëri i Dhimitrit tringëlloi gëzueshëm si dikur.

— Erdha!

Por, para se të shkoja në kopshtin e Bedenëve, nuk di çfarë më shqetësonte akoma. Qëndrova, shikova nga babai dhe i thashë:

— Megjithatë, një trastë miell mund ta kishin marrë nga magazja, pa qenë nevoja t'u merrnin leje partizanëve!

— Jo, — tha babai. Ai kishte folur prerë dhe menjëherë, sikur ta kishte ditur e ta kishte pritur në gjë të tillë nga unë. Dhe kjo «jo» e babait më kujtoi ato tri «jo» të xha Kostaqit, kur grindej me Uraninë dhe Urania, pasi i kishte dhënë të drejtë xha Kostaqit, kishte qarë.

Por me ditët që kaluan, edhe kjo ngjarje, si shumë të tjera, e humbi rëndësinë e saj dhe midis nesh u kthyen përsëri jeta dhe lodrat e dikurshme. Nuk e mbaj mend mirë me saktësi sa zgjati akoma fëmijëria jonë, por një natë aty nga fundi i gushtit ndodhi diçka, që do ta ndryshonte krejt e menjëherë të gjithë këtë jetë, jetën time, të familjes sonë e të fqinjëve tanë...

\*

Unë nuk e di ç'orë ishte, di që ishte verë dhe natë e ngrohtë gushti, kur më zgjuan ca britma të egërsuara. Ca britma të panjohura të një gjuhe të huaj. Një palë

krahë të fuqishëm më tërhoqën nga krevati dhe më hodhën jashtë, ku për shumë kohë akoma pandeha se po shikoja një ëndërr të keqe me sy hapur. Më në fund erdha në vete dhe kuptova se në qiell kishte hënë të prerë, kuptova se ndodhesha në oborr në pizhame, se fashistët që ndriçonin me elektrikët e dorës, kishin rrethuar shtëpinë, e kishin lyer me benzinë dhe i kishin vënë shkrepësen. Kur flaka u ngrit lart, unë nuk e di se si u gjenda midis njerëzve të mi, që edhe ata ishin mjaft të trullësor. Pak më vonë kuptova se bashkë me në ishte aty edhe familja e Kostaq Bedenit me të mëdhenj e me të vegjël dhe se bashkë me shtëpinë tonë, digjej edhe shtëpia dykatëshe me çardhak e Bedenëve. Kur dy shtëpitë ishin rrethuar nga flakët dhe flakët ishin ngjitur lart, befas, u dëgjua një klithmë tmërri. Arta. Atje brenda kishte mbetur Arta. Të gjithë e njohën menjëherë se ai ishte zëri i Artës. Mua përsëri si në ëndërr m'u kujtua se, kur më kishin rrëmbyer nëpër gjumë, unë kisha dashur të zgjoja Artën, që flinte pranë meje, por s'kishin pasur kohë: krahët e fuqishëm më kishin hedhur nga dritarja dhe Arta kishte mbetur në gjumë nën mbullesat e natës. Tashti ajo kërkonte ndihmë, e rrethuar nga flakët që ngriheshin deri në kulm.

— O ma-a-a, o ba-a-a! — thërriste Arta.

Dhe prapë;

— O I-i-i-së! Po ku je, o I-i-i-së! — Dhe zëri dëgjohej sa në një kënd të dhomës, në tjetrin. — O ma-a-a, o ba-a-a!

U bë zhurmë, klithma e të qara midis nesh. I pari që vrapoi në drejtim të flakëve isha unë. Por mua përsëri më penguan krahët e fuqishëm, që më kthyen atje ku kisha qenë. Pastaj klithi dhe vrapoi nëna ime. Por ajo ra nga një e goditur kondaku në kokë dhe mbeti ashtu gjysmë e humbur dhe e pafuqishme. Mua nuk më kujtohet sa zgjatën britmat e Artës atje brenda, por ato nuk zgjatën pak, ndërsa fashistët, të ndriçuar nga flakët e dy shtëpive, qëndronin të patundur, me rripat nën mjekër, me helmetat në kokë, me automatikët para gjoksit, me këmbët pak të hapura dhe ishin

bërë zinxhir rrotull nesh dhe rrotull dy shtëpive që digjeshin.

— O ma-a-a-a, o ba-a-a! O I-i-isë. Po ku je, o I-i-i-së!

Pastaj zëri i Artës u bë i shurdhër dhe unë e mora me mend se flakët i qenë afruar fare pranë. Pastaj ankimet dhe thirrjet e saj erdhën duke u shuar, derisa u shuan fare, derisa s'u dëgjua gjë tjetër veç një rënkimi të mbytur dhe teftikut të flakëve e të trarëve që këputeshin. Pastaj shtëpia u shemb, e shoqëruar nga një klithmë e përbashkët.

Më kujtohet si tashti, ashtu të mpirë, me mendjen tek Arta e djegur atje brenda, fashistët na vunë përpara nëpër rrugët e errëta të qytetit (duke lënë në oborr, me të qara e me të lebetitura Stefanin dhe dy çapaçulet e vogla). Hëna ndriçonte pak, fashistët ndiznin elektrikat e dorës, nënën e mbanin xha Kostaqi me babanë dhe në të njëjtën kohë xha Kostaqi me babanë na luteshin mua dhe Dhimitrit që të vraponim, të shpëtonim të paktën ne, por Dhimitri dhe unë kundërshtonim, ne thoshim se nuk donim të ndaheshim nga ata. Xha Kostaqi dhe babai ngulnin këmbë se ishim në rrezik të gjithë, se nuk dihej qfarë na priste dhe kjo mund të ndodhte menjëherë sapo të arrinim në bodrumet e SIM-it, por mund të ndodhte edhe të nesërmen e të pasnesërmen, prandaj le të shpëtonim të paktën unë me Dhimitrin, të paktën të mbeteshim gjallë ne të dy, sa për Kristinën le të pësonte fatin e tyre, por ne duhej patjetër të mbeteshim gjallë, për t'i thënë botës të vërtetën e asaj nate, po edhe të shkonim deri te partizanët e të luftonim bashkë me ta.

— Ik, Isë! — pëshpëriste babai im.

— Ik, Dhimitër! — pëshpëriste xha Kostaqi.

Rrugicat po mbaronin dhe pastaj do të ecnim në rrugët e qytetit, ku largimi do të ishte më i rrezikshëm.

— Ik, Isë, ik, Dhimitër! — pëshpërisnin ata sa herë që kalonim pranë ndonjë rrugice të errët, ku mundësitë e shpëtimit ishin më të mëdha.

— Jo, thosha unë, jo, thoshte Dhimitri. Duam të vdesim me ju!

Dhe unë qaja për Artën me lotët rrëke e me mjekrën që më dridhej.

— Ik, Isë, rrugicat po mbarojnë, ti duhet të marrësh hakun e Artës! Hakun tonë!

Erdhi një çast që unë i harrova të gjitha dhe veshët zunë të më jehonin nga hakmarrja për Artën.

— Ik, Isë!

Dhe unë ika.

Më vonë, kur tashmë isha në batalionin partizan, dëgjova se edhe Dhimitri kishte vrapuar menjëherë pas meje, por Dhimitrin e kishin vrarë. Dhe po në batalionin partizan dëgjova se të pestë ata, babai, nëna dhe Bedenët, me ta edhe Kristina ishin zhdukur pa lënë gjurmë në bodrumet e SIM-it.

9.

**Njëherë** Xhako Rina përqëndroi shikimin e syve të përhimë, që i kishte zakonisht të shqetësuar, tek Isa, i cili kishte mbetur me broshurën në prehër e me vështrimin të përhumur kushedi se ku.

Sa kohë kishte kaluar, thoshte me vete Xhako Rina, qëkur Isa kishte ardhur për herë të parë në batalion?

— A më pranoni partizan? — ishte lutur ai.

— Sa vjeç u bëre, Isë? — e kishte pyetur Xhako Rina.

— Katërbëdhjetë! (Si banorë të një lagjeje, Xha-



koja e dinte mirë që ai nuk mund të ishte më shumë se trembëdhjetë.)

Sa kohë kishin kaluar, pyeste veten Xhako Rina, që kur Isa vrau gjermanin e parë? Por, kur e pa armikun të shtrihej pa frymë, ai qau dhe kërkoi mbrojtje te komisari. Sa kohë kishin kaluar, kur një natë, ndërsa sulmonin kazermat, Isa u ngjiti fshehurazi në murin e lartë dhe, me gjithë thirrjet e komisarit për t'u kthyer ai ra në oborr dhe u fut midis pemëve, nëpër një shteg që llamburiste nga drita e bardhë e hënës. Pas disa minutash ai u gjend prapa kurrizit të Xhakos, e tërhoqi nga xhaketa, Xhako Rina përkuli trupin e hollë e të gjatë dhe Isa i tha në vesh se nga ana e prapme e kazermave kishte hapur një deriçkë, nëpër të cilën ai kishte kaluar kaq herë kur luante me shokët në fëmijërinë e tij... Këto kishin qenë dy aksionet e para të Isës dhe këto mundi të kujtonte hëpërhë Xhako Rina, se pastaj Isa u quajt partizan me përvojë dhe u fut në radhët e tyre me të drejta të barabarta...

— Pse nuk më ke pyetur fare sonte? — e pyeti Xhako Rina.

Isa e shikoi po me ata sy të përhumbur në kujtime, heshti një çast sa të mblidhte veten dhe në çastin tjetër foli me zë të ulët, si për të mos prishur qetësinë e dhomës:

— Nesër do të të pyes, shoku komisar!

— Pse nesër? Nuk është e lehtë në moshën tënde t'i kuptosh të gjitha çfarë lexon, për rrugën e shoqërisë njerëzore, për klasat, shtypjen, shfrytëzimin, Komunën e Parisit, Revolucionin Socialist të Tetorit në Rusi e për shumë gjëra të tjera, për të cilat unë vetë kur i lexova për herë të parë, i pyeta shokët e mi derisa i mërzita.

— Sonte je i zënë me punë, shoku komisar! — tha Isa dhe, pasi ngriti broshurën nga prehri, shikoi prapë nga komisari që tashmë shkruante, sepse në orën shtatë të mëngjesit raporti duhej të ndodhej në Komandën Eprore.

Përballë, te minderi në fund të dhomës, shkopi i këshilltar Danit bënte jo vetëm figura të zakonshme,

por herë-herë këto figura i shoqëronte me një trokitje të lehtë e ritmike. Diçka midis durimit dhe padurimit, mendoi komisar, si për trokitjet e lëvizjet e shkopit të Danit, ashtu edhe për vështrimet e përhumbura të Isës.

Diku rrotull shtëpisë së Rubit u ngritën zhurma të ndryshme: hapa dhe çapitje potkonjsh. Pastaj pëlliti një gomar.

— Po kthehet Zimi! — tha Dani.

— Cili është Zimi? — pyeti pas pak Xhako Rina.

— Farkëtari i fshatit, — tha Dani. — Sa herë që gomari i Zimit pëlltet, e ka zakon ta dredhë në fund. Ja, e dëgjon?

Xhako Rina qeshi me atë të qeshurën e tij, që zakonisht e kishte njënotëshe.

— Si doli Zimi nga lufta? — pyeti ai pastaj.

— Sa për shtëpitë e kolibet i ke parë vetë, në mos janë shembur e djegur të gjitha, të paktën tjegullat e çative kanë fluturuar nga gjylet e topit. Por Zimit të shkretë nuk i eci fare. Ditën e parë të luftës gjermanët arritën deri te kolibja e tij dhe i vunë zjarrin. Fati, që arritët ju dhe e shuat zjarrin, por farkëtoren ia kishin shembur më parë. Mbeti pa gjyryk Zimi!

— Do rregullohet edhe gjyryku i Zimit, — tha komisar. — Farkëtarët do të na duhen shumë në të ardhmen!

— Më larg u dëgjuan sërish zëra e zhurma. Dani mbajti prapë vesh. Qante një fëmijë.

— Po kthehen edhe të tjerë, — tha. — Deri nesër në mëngjes do të jenë kthyer të gjithë.

Tashmë vështrimi i kaltër i Isës ishte kthjelluar disi. Fytyra e tij e re, por e vrrarë nga mundimet e luftës, sikur ishte shkarkuar nga kujtimet e së kaluarës. Tashti edhe ai dëgjonte si Dani zhurmat e fshatit.



Ka disa fytyra që janë jashtëzakonisht të reja e jashtëzakonisht të bukura, me një rini dhe bukuri të veçantë, deri në shkëlqim, para të cilave mbetesh si i ngurosur. Ashtu mbeti edhe Bajazit aga Palla kur ndezi llambën dhe nga errësira i doli përpara zonja Dirë me tërë magjinë e freskisë së saj. Ai e njihte mirë jetën e kryeqytetit, ai kishte atje shokë e miq të shumtë dhe më se një herë pat dëgjuar nga ata se zonja Dirë e bënte politikën edhe përmes hireve të bukurisë së saj, dhe, megjithatë, kishin qenë fare të paktë ata që, në rrethana tepër të veçanta, kishin mundur ta shtinin në dorë. Por këto mendime, që ia kishte nxitur prania dhe shkëlqimi i zonjës Dirë, tek i kishte dalë nga errësira si shtojzovale veshur me të zeza, qenë fare kalimtare e fare të rastit për Bajazit Pallën. Ai e mbledhi shpejt veten dhe deshi të dinte sa më parë çfarë shpresash e ç'gjë të mirë i sillte zonja Dirë me ardhjen e saj.

— Qenkeni lodhur, zonja Dirë!

— Duhej të lodhesha!

— Dhe nata ju paska zënë në rrugë!

— Ka ardhur koha të lëvizim në errësirë!

— Vetëm?

— Jo, me shërbëtorin.

— Po ku është shërbëtori?

— E ktheva prapë!

Bajaziti mbeti i çuditur.

— Ai do të ishte i tepërt, — shpjegoi zonja Dirë.

— Po zotin Idriz ku e paske?

— Zoti Idriz iku me një autokolonë gjermane para se të bëhej rrethimi i plotë i Tiranës!

Trupi i gjatë dhe i drejtë i Bajazit Pallës u duk akoma më i gjatë dhe më i drejtë: aq shumë kishtë shtangur nga kjo e papritur e madhe. Sytë e tij të shkruar, ndonëse të verdhë e pak të ngushtë, kishin një vështrim

të zgjuar, megjithëse përjetë të pakënaqur. Duart që i kishte të buta e të bardha, ku pavarësisht nga mosha e tij gati pesëdhjetëvjeçare, mezi vihej re zgjerimi i indeve, dëshmonin se ishin duar të fisme (në kuptimin e vjetër të kësaj fjale) dhe se Bajaziti duhej të rridhte nga një derë e pasur denbabaden. Edhe hundën e buzën i kishte të vogla, të holla, nazike, pra të fisme edhe ato. Zonja Diri, që, me përvojën e saj, tashmë kishte studiuar çdo tipar të tij, mbeti pakëz e çuditur, kur sidomos për shkakun e mustaqeve të gjata, të drejta e të holla e pak të thinjura, Bajazit aga Palla i kujtoi gjeneralët e Kiplingut me të cilët ajo kishte qenë gjithmonë e dashuruar (siç kishte qenë e dashuruar edhe me vetë pushtimet kolonialiste të Anglisë). Vetëm nga zëri jo, mendoi ajo, zërin ai nuk e kishte as të fortë, as të kumbueshëm dhe, si për të vërtetuar vërejtjet e saj të pagabueshme, Bajaziti pyeti pikërisht me atë zërin që ndryshonte nga ai i gjeneralëve të Kiplingut:

— Ç'do të bëjë me gjermanët zoti Idriz?

— Nuk do të shkojë deri në Berlin. Ajo është rrugë e gjatë dhe gati e pamundur!

— Po ku?

— Deri në Shkodër. Atje do të gjejë një anije e do të hidhet matanë. Miqtë tanë nuk do të na harrojnë. Partia e Nacionalçlirimtares, që mundi të gënjejë popullin për njëfarë kohe, nuk do ta ketë të gjatë!

Bajazit aga Palla vuri dorën në ballë dhe nga sytë e tij të ngushtë, të verdhë, por të shkruar e tërheqës, dhe nga gjithë pamja e tij me tipare prej fisniku të vjetër, të veshur gjysmëfshatar e gjysmëqytetar, me setër e këmishë pa jakë, por me çizme e kilota, nga e gjithë kjo pamje, dolën ca shkëndijime gëzimi, që e kishin bazën te një shqetësim, i cili duhej të ishte shumë i madh për ta mbajtur mbi kurriz vetëm një njeri.

— Zonja Diri, të jenë të vërteta këto fjalë që thua? — pyeti ai.

— Po, — tha zonja Diri dhe Bajazit Pallës iu duk shumë më e bukur kur shqiptoi atë «po». Dhe më e zgjuar. Dhe fare e re.

Ai psherëtiu.

— Mundet, i kam dëgjuar edhe unë, — tha ai.

— Bile, zoti Idriz të çon të fala. Kur u nda nga unë, më porositi të mos mërzhitesh, se këto punë nuk do të zgjaten shumë.

Pas këtyre fjalëve zonja Dirri eci ngadalë përmes dhomës (prapa saj eci edhe Bajaziti), u ul në minderin pranë dritares dhe hodhi vështrimin jashtë në qiellin e errët, ku çuditërisht vezulloi për disa çaste një yll i vetmuar. Ajri ishte i lagësht dhe kudo zotëronte një heshtje e thellë, që dukej aq e natyrshme në atë errësi të plotë e të lagësht sa edhe klithmat e rralla të një zogu grabitqar apo kakarisja e çakërdisur e një pule, ndoshta sulmuar nga dhelpra, jo që nuk e prishnin atë heshtje, por sikur e nënvizonin më shumë. Me përvojën e një gruaje, vërtet të re, por të dalë e të parë nëpër botë, zonja Dirri e kuptoi se Bajaziti ishte befasuar nga ardhja e saj, e pashoqëruar nga zoti Idriz e nga askush tjetër. Po edhe nga qëndrimi e nga frymëmarrja e tij, ajo gjithashtu përfytyroi se Bajaziti (si shumë burra të tjerë) që mahnitur nga tiparet e saj delikate, nga duart e bardha, të vogla e të bukura e sidomos nga ajo përveshje tekanjoze e buzës së sipërme, që ajo nuk e zotëronte e nuk e nënshtronte dot as në çastet e në rastet më serioze e më të rënda të jetës. Shkurt, ajo kuptoi se i zoti i shtëpisë, që ishte një nga miqtë e tyre më të vjetër e më besnikë, e trajtonte atë (si shumë burra të tjerë) si një porcelanë të kushtueshme e delikate, gati për t'u thyer në përplasjen më të parë. Por, duke pasur parasysh qëllimet e detyrat për të cilat ajo kishte ardhur deri këtu, një trajtim i tillë e zemëronte paksa zonjën Dirri, prandaj, pas një heshtjeje të shkurtër ajo hoqi vështrimin nga qielli i errët dhe befas u kthye me vrull nga Bajaziti Palla.

— E morëm letrën që na dërgoje dhe i vlerësuam guximin dhe bujarinë për të na strehuar në shtëpinë tënde. Vlerësuam edhe lajmet e trazirat që na shkruaje se po ndodhin në fshatin tuaj këto ditë. Siç e shikon, është pikërisht ajo letër që më ngriti e më solli këtu!

— Dhe unë, zonjë, ju kam pritur me padurim prej dy ditësh e dy netësh, — tha ai.

— Ë besoj, — tha Zonja Diri. — Zoti Idriz më porositi që të jeni i kujdesshëm. Ata janë tepër të zemëruar e të egërsuar me ne. Po morën vesh që ti me disa agallarë të tjerë keni qenë mbështetja jonë e fshehtë gjatë luftës, janë gati t'ju arrestojnë menjëherë. Do të ngrenë gjyqe, do të burgosin të dyshimtët, do të bëjnë edhe vrasje, prandaj në këtë kohë duhet të silleni me ta pa rënë fare në sy, pa treguar as gatishmëri për t'i shërbyer pushtetit të tyre dhe pa shfaqur as pakënaqësira për reformën e tokës e për reformat e tjera që kanë premtuar se do t'i bëjnë së shpejti. Ti s'je veçse një njeri si gjithë të tjerët. Kur të tjerët do të sillen si njerëz të pagdhendur ose si njerëz të çuditur apo të gatshëm, edhe ti e shokët e tu do të silleni të pagdhendur, të çuditur apo të gatshëm. Në rast se njerëzit tonë, të Ballit e të Bazit, të cilët ndodhen me armë në dorë pyjeve, do t'ju kërkojnë ndonjë ndihmë, t'ua jepni menjëherë, po veç me një kusht, kur të jeni të sigurt se nuk do të bini në sy.

— Ah, sa të rrezikshëm janë këta!

— Do të kemi kohë të bisedojmë më shtruar, por hëpërhë unë desha të di ca hollësira të mëtejshme për ato që na shkruaje në pusullën tënde...

— Ku je, o Bajazit aga? — u dëgjua një zë në oborr.

Dy qen të mëdhenj kërcitën zinxhirët dhe lehën.

— Ç'është? — pyeti zonja Diri.

Bajazit Palla uli fitilin e llambës dhe, megjithëse e kishte njohur fare mirë zërin, nxori kokën në dritaren e vogël.

— Bajazit aga, a të shkoj të fle pak në tokën time?

— Të shkosh, Turhan, si jo! — i tha Bajazit agai.

— A të ngre edhe një kasolle me fier për të ruajtur misrin?

— Ngreje, posi!

— Ja ta zëmë se shkova, po ç'do të bëj unë atje?

— Të ruash misrin, pra!

— Jo, unë dua vetëm të fle mbi tokën time!

— Të flesh, posi!  
— Kush tha të fle?  
— Ti the të flesh!  
— Jo, unë nuk thashë të fle!  
— The!  
— As unë nuk e di se ç'thashë!  
— Ik, Turhan, ik!  
— Mirë, ja ku po iki! — dhe iku. Dy qentë e mëdhenj të Bajazit aga Pallës u qetësuan. Zinxhirët hesh-tën.

— Cili është ai? — pyeti zonja Diri.  
— Një si i çmendur!  
— Po në qoftë se është i çmendur, ç'të duhet të dalësh e t'i flasësh vetë?!

— Po kush t'i flasë? Përmdryshe, të qepet si rrodhe!  
— Ku i ke njerëzit e shtëpisë?  
— I largova para dy javësh!  
— Po, vërtet, këtu u bë luftë e madhe!

— U bë, — tha Bajaziti. Tha prapë: — Kërdinë kanë bërë mbi gjermanët!

— E di. Po ç'është ajo që na shkruan për disa qindra gjermanë të humbur?

— Nuk u del një hlogari. Kështu flitet nëpër fshat.  
— Pa ma thuaj më shkoqur, ç'llogari është ajo që s'u del?

— Zonja Diri, a është e vërtetë se nga Mushiba mundën të arrinin në Tiranë vetëm treqind gjermanë?  
— pyeti edhe Bajaziti.

— Kjo është e vërtetë!  
— Bile edhe ata i paskan vrarë rrugës e para ministrive.

— Po!  
— Kanë vrarë edhe gati dy mijë këtu, që po i varrosin atje poshtë. Kanë zënë robër dhe kanë mbushur me ta ahuret e fshatit.

— Edhe këtu në kullat e tua?  
— Jo, i futa në stallën e lopëve aty përtej.  
— Po ç'keni dëgjuar për gjermanët e humbur?

— Thonë që ai komisari i tyre ka dhënë urdhër të gjenden sa më parë.

— Si e quajnë?

— Njëfarë Xhako Rina, nga ata që shtypnin libra e gazeta.

— Si gjithë të tjerët, fundërrinë.

— Fundërrinë, por sot është bërë zot!

— Nuk do ta kenë të gjatë. Por duhet të mendojmë për gjermanët e humbur.

— Ç'rëndësi kanë tashti për ne disa qindra gjermanë të humbur?

Pamja e bukur, por e egër e zonjës Diri dëshmonte se ajo kishte ardhur këtu me një vendim të prerë. Tha:

— Sigurisht, asnjë rëndësi!

— As tri mijë të kolonës që u asgjësua!

— Megjithatë gjermanët e humbur, — foli si me vete zonja Diri, — duhet të kenë shkaktuar njëfarë gjendjeje të turbullt e të pasigurt në Mushibë e rrotull Mushibës.

Fytyra gati pesëdhjetëvjeçare e Bajazit agës, e mbajtur mirë dhe simpatike, por edhe e zgjuar, u duk sikur e kapi mendimin e zonjës Diri.

— Pra, — tha zonja Diri, — një apo pesë nga këta qindra gjermanë, ta zëmë se mund të vrasin komisarin, apo një tjetër person që atyre u djeg në zemër. — Pasi një heshtje. — Fundja, ta zëmë, nga ferrat ku mund të jenë fshehur, vrasin edhe partizanë të rastit. — Zonja Diri ngriti sytë e mëdhenj dhe e mbërtheu Bajazitin me një vështrim, ku plekseshin bashkë, femra, ngacmimi, joshja, politika dhe urdhri. — Por gjermanët, sigurisht këtë nuk e bëjnë më. Ata morën fund. Këtë e bëjmë ne në vend të tyre, e bëjmë ti dhe unë dhe agallarët e tjerë që janë këtu në fshat. Kësaj i thonë të përfitojmë nga situata, nga rrethanat. Kurse partizanët do t'ua vënë fajin gjermanëve të humbur! — Drita e llambës mbytej në flokët e saj të verdhë. Tashmë ajo ishte ngritur dhe ecte nëpër dhomë me një lakim të bukur të belit të hollë e me një tundje të lehtë të vitheve, si një qenie që i për-

kiste një botë tjetër. Me gjithë bisedat e fjalët e pre-ra, kishte diçka të korruptuar ose të paktën diçka që të kujtonit korruptionin tek ajo grua e re.

Bajazit aga Palla, i mbërthyer nga ky mendim, hoqi çizmet, u ul këmbëkryq në minder, me pamjen e gjeneralëve të Kiplingut, por me qëndrimin e një Bude, dhe e shikoi drejt në sy zonjën Dirin. E gjithë dukja e tij s'ishte tjetër veçse një topitje, veçse dorëzim, po edhe ngurrim ishte. Dhe të gjitha këto ia kishin bërë ballin shumë të ngrysur. Tha:

— Ja ku vramë një, edhe pesë. Të zëmë se vramë komisarin vetë, edhe një pionier që komisarit e mban prapa si manar. Gjermani, italianit dhe ballisti e zogisti vranë mijëra dhe ata s'deshën t'ia dinin. Një shoku im këtu, Shak aga Dëllinja i thonë, i ka punët keq. Një vit më parë vrau një partizan dhe ata të këshillit, me sa duket, sikur i kanë rënë pak në gjurmë.

— A kanë fakte?

— Nuk e di, por i vijnë rrotull, — tha Bajaziti. — E pse vuan Shaku?... Për hiçgjë! Për një partizan; fundja ushtritë e huaja dhe ballistët vranë me mijëra, megjithatë nuk i zhdukën dot!

— Ma the një herë këtë, Bajazit aga, mijëra, mijëra! — ia priti me inat dhe e pakënaqur zonja Dirin. — Por mos harro se vrasjet e tanishme marrin tjetër kuptim. Hëpërhë ato shërbejnë për t'u thyer vrullin, për t'u hequr sigurinë në fitoren e tyre gjoja përfundimtare, për t'u lëkundur besimin në vetvete, për t'i çoroditur, për t'i demoralizuar, për t'i dëshpëruar. E di ti ç'do të thotë sidomos një turbullirë rrëzë Tiranës? Dhe mos pandeh se turbullira dhe vrasje të tilla do të ndodhin vetëm në Mushibë? Kudo do t'u priset qetësia. Ne s'i kemi hedhur armët. Mos harro, kemi dashamirë, të cilët kanë nevojë të mbahen me kurajë, kanë nevojë të dinë që ne jemi gjallë. Puna është t'i luftojmë me të gjitha mënyrat, të mos u japim kohë të çlodhen një minutë. Detyra jonë është të mos qëndrojmë asnjë ditë duarkryq. Koha është e shkurtër. Im shoq me miqtë tanë të jashtëm do të kthehen fare

shpejt. Dhe ne duhet t'i presim ballëhapur. Pastaj e kupton vetë ti ç'do të ndodhë në Shqipëri pas ardhjes së tyre. Do të fillojë fushata e vrasjeve dhe e shfarosjes në masë, terrori i bardhë apo i zi, siç mund t'i thonë këta, një terror i tillë, që për njëqind vjet të flemë rehat mbi dafina ne dhe stërnipërit tanë! — Ndërsa ecte nëpër dhomë, në të gjithë trupin e saj të brishtë e në të gjithë fytyrën e re e të bukur të zonjës Diri, lexohej si në një libër të hapur ndjenja e pamëshirshme e revanshit.

Balli i Bajazit aga Pallës sikur u ndriçua. Sikur. Dhe, kur ngriti kokën, ndeshi përsëri me vështrimin e zonjës Diri, por kësaj radhe ai vështrim ishte thjesht femëror, thjesht provokues e joshës. Diçka e ngrohtë lëvizi nëpër trupin e gjatë të Bajazitit dhe një copë herë ai s'qe në gjendje as të fliste, as të ndryshonte pozicion. Më vonë ai u kujtua se fjalët e egra të zonjës Diri kundër Nacionalçlirimtarëve, si dhe vështrimet e saj, kishin bërë të njëjtën punë në shpirtin e tij, të etur jo më pak se ajo për hakmarrje.

— Tashti më thuaj, si e pësoi Mafuz Torobojka? —  
— pyeti befaz zonja Diri.

— Ah! — gati kërceu përperjetë Bajazit Palla. — E paske marrë vesh, zonjë?!

— Të gjithë e morën vesh.

— Lëre lëre, sa keq e pësoi zoti Mafuz!

— Fol!

— E di ti, zonjë, kush e zuri zotin Mafuz?

— Hollësirat nuk i dimë!

— Ai udhëtonte me kolonën gjermane!

— Këtë e dimë me kohë!

— Me kolonën që u shkatërrua këtu!

— Po, e dinim!

— Zotin Mafuz e zuri një çapaçul një pëllëmbë mbi tokë. Pionier i thonë. Isë e thërresin. Ai e zuri. Mbrëmë zoti Mafuz fjeti në grazhdaren time, sot në mëngjes i tregova një ferrë të madhe. Aty e zuri ai, pionieri, që i thonë këta. Por si e qysh e zuri e çfarë ndodhi



asgjë tjetër s'dimë! — Bajazit Palla tundi kokën. — I shkreti Mafuz!

— Kështu pra, pi-o-ni-er, si i thonë a-ta, — rrokëzoi si me vete zonja Dirë. — Ë-ë-ë, — hungëriu ajo, me hungërimën, që edhe atë e kishte të bukur.

Heshtje.

• — Më dhembin veshët kur dëgjoj, se edhe fëmijët i futën në vallen e luftës këta terroristë të kuq!

Heshtje. Prapë heshtje.

— Atëherë dëgjo, Bajazit aga, pak më parë thamë se, për të shkaktuar turbullira e pasiguri në radhët e tyre, mund të vrasim cilindo nga ata, çdo komisar e çdo partizan, mjafton të na dalë në shteg. Me keqardhje, por edhe atë Isën duhet ta kemi në shënjestër. Dhe bile kjo vrasje duhet bërë shumë shpejt, për të mos u dhënë kohë të stërhollojnë historira për zotin Mafuz e të krijojnë dyshime pas dyshimesh! Kush të siguron se ai pionier nuk e ka parë kur zoti Mafuz doli nga grazhdarja jote?

Bajazit Palla e dëgjonte me vëmendje dhe se pse tashti i kishte rënë një çehre e verdhë. Një gjë të këtillë ai e kishte menduar edhe vetë më parë. Tha si i përhumbur:

— Thua ta kenë parë zotin Mafuz kur doli nga grazhdarja ime? — Dhe u bë më i verdhë. — Ta ketë parë ai pionieri?

— Këtë nuk e dimë! — tha ajo si e çliruar nga ky ankth i çastit, sepse zonjës Dirë nuk i interesonte hë-përhë ta frikësonte më shumë sesa duhej Bajazit Pallën. Helmi i parë u hodh, mendoi ajo, por megjithatë shtoi: — Në këto njëzet orë ai mund të mos ketë pasur rast për ta denoncuar ngjarjen, prandaj... shpejt! — dhe bëri një shenjë me dorë që tregonte se i duhej dhënë fund sa më parë atij dëshmitari të rrezikshëm.

Midis tyre ra një heshtje e gjatë, të cilën zonja Dirë vendosi ta prishte, duke ndërruar bisedë. Pyeti:

— Kur e ke ndër mend t'i kthesh njerëzit e shtëpisë?

— Kur të më urdhërosh zotrote! — i shpëtoi Bajazitit. Tashmë fytyra e tij, pas pyetjes së zonjës Dirë, që iu

duk plotësisht provokuese, sikur nuk pasqyronte më rreziqet imagjinare të një çasti më parë.

— Unë duhet të qëndroj e fshehur, — tha ajo. — Askush të mos dijë për ardhjen time këtu, veç ndonjë besniku!

— Këtu janë pesëmbëdhjetë dhoma. Pesë nga ato janë në katin e dytë dhe fare të mënjanuara. Aty unë mbaj edhe zahiretë! — Dhe tundi një xhufkë celësash në dorë. — Ato do të jenë për ty, zonjë. Kanë edhe shkallë të veçanta, për çdo rrezik, shtegut, në pyll!

Tashti sytë e zonjës Dirë ishin mbushur me dinakëri, (por dukej qartë se ajo nuk dinte gjë për dinakërinë e syve të vet), kurse sytë e Bajazit Pallës ishin bërë opakë, të pazbulueshëm, asnjë hetim nuk mund të bëhej në ata sy të verdhë, të ngushtë, por tërheqës e të shkruar.

Poshtë në oborr zinxhirët trokëllinë dhe qentë lehën.

— Ku je, o Bajazit aga!

— Prapë ai i çmenduri? — pyeti zonja Dirë.

Bajazit Palla, si më parë, uli fitilin e llambës, nxori kokën në dritare dhe tha:

— Turhan, eja nesër!

— E dëgjon ti, Bajazit aga, si më thërret toka?

— Jo, nuk e dëgjoj!

— Po unë çfarë dëgjoj?

— Ku ta di unë çfarë dëgjon ti?

— Por ti më the se unë dëgjoj, — tha Turhani nga oborri.

— Unë thashë?

— E po as unë nuk thashë!

— Po kush tha?

— Ik pra, Turhan, eja nesër!

— Mirë, Bajazit aga, po shkoj të fle në varreza, atje ku janë dy djemtë, dy vajzat dhe gruaja ime!

Zinxhirët nuk trokëllinë më. E lehura e qenve erdhi duke u shuar. Jashtë kishte rënë prapë qetësi. Veç frynte pak. Dhe dëgjoheshin britmat dhe zhurmat e teneqeve që binin: fshatarët trembnin derrat e egër.

Bajaziti u ul përsëri mbi shilte me dorën në ballë i merakosur.

— Për një të çmendur re prapë në mendime, Bajazit aga?

— Por unë dua të di, a është vallë i çmendur?

— E pse të duhet kjo?

— Sot e gjeti ai të më flasë për tokën e për varrezat?... Ai ka pesëmbëdhjetë vjet që më vjen rrotull, por s'ka guxuar të më hedhë një fjalë.

— Bajazit aga, do të kemi kohë të bisedojmë për të gjitha. Tashti mjaft me atë farë Turhani.

— Si të duash, zonjë, — tha Bajaziti, që kishte ndër se zonja Diri ishte kthyer sërish në urdhër.

— Mos harro, për të ardhur deri këtu kam bërë rrugë të gjatë në këmbë!

— Po, zonjë!

— Jam e lodhur!

— Tashti të hash e të flesh!

— Më parë dua të bëj një banjë!

— Të të ngroh një kusi me ujë?

— Po.

— Ja, shkova!

— Unë dua çdo mbrëmje të bëj banjë!

— Po, zonjë!

— Këtë mos e harro!

Bajazit Palla doli nga dhoma me disa mendime njëherësh. Me mendimin se me këtë banjë ndoshta zonja Diri dëshironte të përgatiste jatakun për të kryer aktin e lashtë të kurvërisë. Dhe me mendimin tjetër se ai pionier që quhej Isë, duhej zhdukur patjetër. Po të kishte mundësi, ai do të zhdukte edhe zotin Mafuz. Përderisa ndodhej në duart e tyre, zoti Mafuz ishte një gojë e gjallë dhe gjithmonë e rrezikshme për të. Pastaj ai mendoi se do të ishte e nevojshme të gjente rast të shkonte një herë tek ai komisar për të blerë ndonjë dyshim nga qëndrimi e nga sytë e tij. I dërrmuar, i sulmuar, i rrethuar dhe fundja, edhe pak i përkëdhelur nga gjithë këto mendime, ai u fut në dhomën tjetër dhe vuri kusinë në zjarr për zonjën Diri.

Në karrigen e vetme që ndodhej në dhomën e miqve të Rubit, në të cilën do të bëje mirë të mos uleshe, tundej komandanti i kompanisë së shtabit të brigadës, që quhej Kozma Peti. Ky Kozma kishte sy shumë të zinj, fytyrë ezmere prej kokoroçi të ri e të fuqishëm, që, me një të parë, mund të kuptoje pa u lodhur e të mos dilje i gabuar se atij i pëlqente muzika, i pëlqente të pinte pak raki sa për të kënduar një këngë e për të hedhur një valle. Për këtë karakteristikë sikur dëshmonte edhe lulja e egër në ngjyrë të kuqe të errët, që ai kishte vënë në njërën vesh, cigarja në veshin tjetër dhe kësula partizane, e kthyer aq sa buza e saj gati i çikte vetullën e djathtë. Ja, ky komandant ishte ulur tashti pranë tavolinës, apo asaj si tavolinë dhe midis tij e komisarit zhvillohej ky dialog:

— Edhe sa gjermanë kanë mbetur pa u groposur? — pyeti komisari.

— Më shumë se gjysma! — tha Kozma Peti.

— Nga e keni filluar?

— Nga ata të kodrës së Butë me ullinj, të cilët i kallëm në gropat që hapi vetë artileria e tyre. Më e pakta gropë ishte dy metra e thellë. Kjo që një punë pak a shumë e lehtë për ne, se, vallahi, partizanët i kemi të lodhur sa unë po vrisja mendjen si t'ia bëja me të tjerët, me ata të kodrave të pjerrëta, që janë kapicë njëri mbi tjetrin. Më të ngrita, katërqind robërit dhe u thashë, hajde marrsh, varrosni shokët tuaj. Kanë hapur, që thua ti, o komisar, ca gropa të thella, që marrin njëherësh pesëdhjetë kufoma! — Kozma Peti mori cigaren e gatshme nga veshi, ndezi eshkën me një të goditur të masatit dhe e nxori xhufkë tymin, që zëvendësoi menjëherë erën e eshkës.

— Bukur! — tha komisari. — Një mendim i mirë!

— Komisari kishte provuar një gëzim të mprehtë e të

hidhur, baras me dhimbjen. Ai vuri re se edhe sytë si të fjetur të këshilltar Danit, ulur aty mbi minder, ishin bërë të gëzuar. Befas Xhako Rina qeshi me notën e vetme dhe u duk si një pemë e përkulur nga era.

Tha Dani:

— Ashtu i pafshim gjithë armiqtë, në gropat që hapin me gjylet e me duart e veta dhe gjithmonë varrosnin njëri-tjetrin!

Kozma Peti, që ishte tepër i ri për t'u marrë me mallkime të tilla, qeshi, si të shtinte me revole dhe lulja e egër i ra nga veshi, por ai e ngriti, e vuri prapë po në atë vesh, pastaj pyeti:

— Shoku komisar, ç'është ajo pafte hekuri që kanë të varur në qafë të gjithë të vrrarët?

— Ajo është pasaporta e tyre për të ardhur në Shqipëri! — bëri shaka Xhako Rina. — Aty kanë të shkruar emrin, repartin ku bënin pjesë dhe një numër!

— Kanë edhe damkën e kryqit të thyer!

— Po-o-o, — pohoi Xhako Rina.

— Unë them t'ua heqim!

— E pse?

— Për t'i çuar nëpër muzerat, që ti na ke thënë se do të hapen pas luftës.

— Ti mirë e ke, Kozma, — tha komisar, — por nuk do t'ua heqim! Sa për muzerat, që thua ti, janë mbledhur e do të mblidhen shumë materiale e dokumente të tjera. Kam dëgjuar, gjithashtu, se pas Luftës së Parë Botërore, disa shtete, me kërkesën e të afërmeve, i ngritën kockat e ushtarëve të tyre. Vetëm përmes atij medalioni ata do të mund të njihen se cilët kanë qenë, cilit popull i përkisnin e prej nga vinin.

— E-e-ej!

— Sa më shpejt t'i gjejnë e sa më shpejt t'i njohin, aq mirë për ta e aq më pak do të na vërtiten nëpër këmbë të dërguarit e tyre!

— E-e-ej! — u çudit prapë Kozma Peti, pa ditur çfarë t'u shtonte e ç'përgjigje t'u jepte fjalëve të komisarit. Veç bërbeliti diçka, që mund të kuptohej edhe kështu: — Më duket se ke të drejtë, shoku komisar. Çdo njeri,

i mirë apo i keq qoftë, ka të afërt, që një ditë do t'i kërkojnë!

Jashtë era zuri të frynte me ca fishkëllima vërtet të lehta akoma, por pak si të larta e plot trille.

— Po robërit si i kanë punët? — pyeti komisarari.

— Ç'robër? — pyeti edhe Kozma Peti dhe sytë e tij të zez si qymyr i lagur e mbërthyen komisararin me dashmirësi e me pikëpyetje. — Ata janë bërë lakër!

— I veçuat oficerët nga ushtarët?

— E pamundur!

— Ç'ju pengon, gjuha?

— Për gjuhën kemi studentin që të thanë, por...

— Por?

— Janë kthyer si një tufë bagëtish, hanë dy herë në ditë racionin që u japim, varrosin shokët e tyre, pastaj rrinë ulur dhe shikojnë këmbët e veta. Po sa të rinj që janë disa! Ku e paska gjetur gjithë atë rini ajo Gjermani!

— Desha të di, pse nuk keni pasur mundësi të veçoni oficerët nga ushtarët? — e ktheu bisedën tek e para Xhako Rina.

— Sepse pikësëpari janë veshur të gjithë si ushtarë!

— Tjetër?

— Sepse ti i vë gishtin dikujt, për të cilin dyshon se është oficer, pas tij dalin njëzet të tjerë. Unë u them, rrinin aty. Ata të shikojnë në sy si derdimenë të pafajshëm. Ca e kanë humbur fare. Ca heshtin. Dhe rrinë kokë më kokë, si delet kur mërzejnë. Ç'po na shohin sytë, shoku komisar. Thotë njeriu me vete këta janë ata që erdhën me pendë e me bujë më se një vit më parë? Atëherë, në shtatorin e vitit një mijë e nëntëqind e dyzet e tre, kur ra Italia dhe te ne u fut gjermani, unë u ndodha në qytet dhe veç t'i shikoje si qëndronin nëpër makina, radhë-radhë, me helmëta në kokë, me pushkët midis këmbëve dhe as sytë nuk lëviznin, si ato prej guri që gjetëm njëherë në fshatin tonë...

— Si statuja! — tha komisarari.

— S'e luan topi, si statuja!

— Ç'e zgjat, — tha Dani dhe shkopi i tij trokiti

në dysheme. — Deri para dy ditësh ata të hidheshin hala në grykë.

Kozma Peti buzëqeshi me buzët vesh më vesh (dhëmbët i kishte shumë të bardhë Kozmai), thithi cigaren dhe tha:

— Por u mjaftoi një ditë që t'u ngjanin lopëve. Aty ku hanë, aty bëjnë me nder jush... E ku t'i njohësh kush është oficer e kush ushtar? Kemi veçuar disa si më të moshuar. Po ku u dihet atyre. Na ka ndodhur që më plaku të ishte ushtar. Më i riu oficer. T'ju them të drejtën, mua më duken sikur të gjithë një fytyrë kanë. Edhe lopët që janë lopë, se unë bari kam qenë, jam në gjendje t'i shquaj menjëherë nga njëra-tjetra, nga thua ti, nga forma e syve, nga turinjte, nga feçka, pa le nga brinjët, nga zëri e nga pullat e nga lëkura. Kurse këta për dy ditë kanë marrë të gjithë një fytyrë e janë bërë aq pis, si të kenë një jetë të tërë që jetojnë baltërave. I çojmë në lumë dhe u themi të lahen, të pastrojnë edhe rrobat. por ata, e di, të shikojnë të gjithë si një tufë dhish, kur humbasin çjapin, e s'dinë ç'bëjnë. Ne i kishim pandehur kushedi çfarë. kurse ata paskan qenë fyçkë. U paska lëvizur krimbi përbrenda. Pam, dhe u plasi sheshit. Por kjo s'është gjë hiç. Dhjetë herë në ditë grinden me njëri-tjetrin. E çfarë s'bëjnë. E pyeta studentin, ç'dreqin kanë që zihen e gjakosen? Për një thërrime bukë, më tha studenti, ose për një hiçmosgjë. U ka hyrë sherr i madh. As deshtë nuk zihen e nuk gjakosen si ata, se unë bari kam qenë. Po mua më çudit një llaf që kam dëgjuar, shoku komisar. Sikur nuk do të pushkatojmë as ata që dvshohen për oficerë!

— Jo, nuk do të vrasim asnjë! — tha Xhako Rina. duke u rënduar qartë dhe fort këtyre fjalëve, si një urdhër i prerë.

— Po si?

— Robër lufte!

— Nga mbiu kjo fjalë!

— Ne jemi ushtri e rregullt me qeveri, me kryeqytet të çliruar e me të gjitha të tjerat që i duhen një pushteti popullor!

— Por ata s'na kanë mbajtur një minutë, na kanë shkuar në plumb menjëherë. Na kanë djegur të gjallë, sa herë që kanë pasur mundësi... — Kozma Peti e mbajti fjalën instinktivisht, sepse instinktivisht Isa, që ishte pranë vatrës, kishte pasur një lëvizje të fortë. Ata e vunë re, e shikuan me bisht të syrit, por kokën nuk e këthyen nga ai. Sidoqoftë, Kozma Peti ishte çuditur vërtet me këtë urdhër të shtabeve më të larta. Kjo shikohej në sytë e topitur e në veshët e skuqur, në mënyrën si e thithte cigaren e si kishte zënë të dridhte një tjetër. I zgjati komisarit cigaren e sapodredhur dhe nuk ia ndezi me cigaren e vet, as me shkrepëse, por me eshkë, se e dinte që komisarit i pëlqente era e eshkës. Tha: — Kollaj të thuash, nuk do të vrasim asnië, por, kur gjeta mitraljerin tonë pa sy, m'u drodh shpirti..

— Për mitraljerin ne u hakmorëm aty për aty dhe vazhdimisht jemi hakmarrë. Ata bam një herë, ne bam dy herë! — tha Xhako Rina. — Tashti janë robër lufte!

— E po nuk harrohet kur gjermani e hodhi fëmijën në greminë në sy të së ëmës!

— Kurse e ëma i ra gjermanit me dru në kokë dhe e hodhi po në atë greminë!

— Pse, o shoku komisar, një fëmijë tonin me një oficer nazist do të krahasoimë ne?!

Xhakos i kishte pëlqyer kundërpërgjigjja e Kozmait, por nuk ia zgjati.

— Po sa masakra e sa shkatërtime të tjera na kanë bërë ata qen nazistë. — shtoi Kozmai. — Ata i kanë rënë disa herë tejmbanë Shqipërisë, duke rrafshuar fshatra të tëra, ja, si Mushiba jonë këtu, duke diegur e shkatërruar cdo gjë, shtëpitë, urat, centralët elektrike, fabrikat, kanë hedhur në erë puse nafte e miniera, kanë therur e shfarosur bagëtinë e çfarë tjetër më thuaj, o komisar, kanë lënë ata pa bërë?

Pas këtyre fjalëve, komisarit kishte ngrysur vetullat dhe kishte rënë në heshtje. Në heshtje kishin rënë edhe Isa me Danin. Veç druve që digjeshin dhe erës që fishkëllente jashhtë.

— Ne jemi vend i vogël dhe i pazhvilluar ekono-



mikisht, — tha komisari pas pak. — Ashtu është vërtet, dëmet që na kanë bërë ata janë të pallogaritshme. Por ne do t'u kërkojmë dëmshpërblimin e luftës.

— Dëmshpërblimin?! — tha si me vete Kozmai. — Nuk e paskam ditur këtë gjë!

— Se të tjerat na i dike të gjitha ti! — bëri shaka Dani nga minderi.

— Ama jo! — tha Kozmai. — Po a do të na e japin këtë dëmshpërblim?

— Çdo gjë do të jetë e dokumentuar, — tha Xhako Rina. — Flasin vetë masakrat dhe shkatërrimet në të gjithë popullin dhe truallin shqiptar!

Pas një heshtjeje tjetër të rëndë, Xhako Rina tha prapë:

— Për sa u përket robërve, bëj si të thashë unë, asnjë të mos vritet e të mos preket, veç kriminelëve, të cilëve do t'u bëjmë gjyq të rregullt. Por kini kujdes mos na ikin e na nxierrin telashe. Mos i shiko që janë katandisur si mos më keq. Pak t'u buzëqeshë fati, bëhen përsëri si bisha.

— E ku mund të ikin?

— Se mos e dinë ata që Tirana ka rënë në duart tona!

— Jo, nuk e dinë!

Xhako Rina u mbështet me bërryla mbi tavolinë, u duk i lodhur, u përkul, ndjeu rehat (kjo u kuptua nga shprehja e fytyrës) dhe tha:

— Dëgjo, Kozma, ti je komandant i kompanisë së shtabit dhe unë dua që jo vetëm t'u tregosh situatën gjermanëve, por të bësh edhe punë politike me ta!

Nga çudia, Kozma Peti u ngrit në këmbë.

— Ulu, ulu. — i tha komisari me zërin e tij një-tonësh, gjithmonë të qetë.

Kozmai u ul.

— C'punë politike do të jetë kjo? — pyeti ai.

— Ajo që bëjmë ne. Merr studentin në krah dhe pikësëpari t'u tregosh gjendjen e vërtetë të luftës në botë. Ku e si janë frontet, se ma merr mendia që oficerët i kanë gënjyer me pashë. T'u flasësh sidomos për

fitoret e Ushtrisë së Kuqe, për luftën çlirimtare të popujve të robëruar, pastaj t'u flasësh edhe për Shqipërinë, t'u thuash se jemi pushtet i ri popullor, që po krijojmë ligjet tona e në sajë të këtyre ligjeve ata quhen robër lufte e nuk do të pushkatohen, veç ndonjërit që ka lyer duart me gjak. Bile, kërko ndihmën e tyre vetë. Thuaju se ne do t'i zbulojmë kriminelët, dhe se do të vijmë shokë të specializuar me informata të sakta.

— A të të bëj një pyetje, komisar?... Ç'do të bëhet më vonë me robërit?

— Së shpejti do t'i marrë në dorëzim Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë sonë!

Kozma Peti u ngrit në këmbë, i dha Danit një cigare të sapodredhur dhe nuk ia ndezi me eshkë, por me cigaren e vet, se këshilltar Dani fshatar ishte si ai dhe s'para kishte mall për eshkë, as çuditej. U ul prapë dhe karrigia lëshoi disa krisma, si t'i qenë zberthyer të gjitha kockat. Pyeti:

— Ç'do të bëjë me këta kërma Shtabi i Përgjithshëm?

— Atë që je duke bërë ti. Ti a i ke vënë në punë për të varrosur njëri-tjetrin?

— Po!

— Ja pra, do t'i vëmë në punë të ndryshme sipas zanatit, sipas mundësisë e sipas nevojës sonë. Nesër a do t'i futësh në punë për t'u ndrequr nga një dhomë fshatarëve dhe për t'u mbartur duajt e misrit nga arat?

— Po!

— Kështu, derisa t'u vijë radha t'i riatdhesojmë.

— Shiko, shiko! — u çudit prapë Kozma Peti. — S'e kisha menduar këtë gjë. — Pas pak tha: — Po n'u bëshin prapë fashistë atje?

— Se ç'do të bëjnë atje, me ta le të merret populli gjerman. Po s'patën vënë mend, le ta ngrenë prapë në këmbë fashizmin e le ta thyejnë prapë kokën. Tashti ne kemi hallet tona. Ne duhet të shikojmë përpara, të ardhmen! — Kështu tha komisar i me zërin e tij të butë njëtonësh dhe këto fjalë i tha tepër i sigurt dhe tepër i bindur në vetvete. Tha prapë: — Çdo gjë që bëjmë sot duhet t'i shërbejë së ardhmes dhe duhet të

përmbajë patjetër mendimin e së ardhmes. Kështu, Kozma?

Jashtë nata heshtte në errësirë të plotë. Një zog nate lëshoi një klithmë. Përsëri një klithmë tjetër. Prapë heshtje. Dhe pas heshtjes, lart në qiell u dëgjuan thirrjet e rosave në shtegtim. Dhe bufët.

Kozma Peti qëndroi një copë herë me pamje të menduar, hoqi nga veshi lulen e egër, që kishte ngjyrë të kuqe të errët, s'dihet pse e la mbi tavolinë, pastaj u ngrit me vull dhe nderoi me grusht. Prapa tij karrigia rakitike e Rubit u tund, lëshoi ca rënkime, por nuk u rrëzua.

Xhako Rina e mbajti edhe pak në këmbë Kozma Petin.

— Si shkon kërkimi për gjermanët e humbur?

— Gjithë ditën i kërkua ferrave e shkarrëzimeve në afërsi. Nesër do t'i futemi pyllit përpjetë.

Tha Dani:

— Aq, sa mund të gjendet gjilpëra në kashtë, aq mund të gjenden ata pyjeve e shkarrëzimeve!

— Ferrë e madhe dhe mal i vështirë, — pohoi Kozma Peti.

— Por ne duhet t'i gjejmë patjetër; — tha Xhako Rina.

— Do t'i kërkojmë, — tha Kozmai.

— Nuk mund të kenë shkuar shumë larg, — tha Xhako Rina.

— Larg jo, — tha Dani, — por është zor të përqo- ket një mal i tërë!

— Buka do t'i detyrojë të dalin sheshit, — tha ko- misari.

— Buka, posi, — shpejtoi Kozmai. — Megjithëse ku ta dish, mund të kenë marrë me vete për disa ditë bukë e peksimete.

— S'para kishin kohë në zjarrin e luftës për t'i parashikuar të gjitha! — tha Xhako Rina.

— Do kërkojmë, — tha Kozma Peti. — Me të aguar dita...

— Por jo vetëm ferrave e gropave, — tha Dani. —

Gjermani s'është aq budalla të fshihet aty ku të shkon mendja ty.

— Po ku?

— Ku ta di unë. Për t'i gjetur, duhet të jesh gjuetar i zoti, t'u zësh pritë si egërsirës, aty ku pi ujë e ku gjen ushqim. Gjermani është si derri i egër që natën bën çapër, ditën zhduket pa lënë gjurmë! — Me të përmendur derrat e egër e me të krahasuar gjermanët me ta, në fytyrën e Danit doli sërish si një dëshmi ai dyshimi i vjetër e i pashfaqur dhe që ishte thjesht një e fshehtë vetëm e tij.

— Do kërkojmë, — përsëriti Kozmai, duke shikuar me respekt nga Dani e nga opingat e palëvizshme të tij. — Nesër në mëngjes herët!

— Nesër do të ngremë në këmbë një batalion të tërë, — tha komisar. — Po hëpërhë dyfisho rojat brenda dhe rrotull fshatit!

— Po, shoku komisar, — tha Kozmai dhe nderoi me grusht, por komisar. — mbajti prapë:

— Ç'bëjnë ata të intendencës me trofetë? — pyeti ai.

— Vazhdojnë të mbledhin, — u përgjigj Kozmai. — Deri tashti kanë numëruar pesëqind kaseta me fishekë, treqind arka me bomba dore, një mijë automatikë, tëmbëdhjetë topa. Pushkët me dylbi për snajperët, mortajat, mitralozët dhe shumë armatime e pajime të tjera nuk i kanë numëruar akoma.

— Tjetër?

— Tri autoblanda e dy tanke të shkatërruara. Tanku i tretë ka mbetur pa u dëmtuar. Dy të tjerët, thonë se kanë ikur me ata treqind gjermanët, që u vranë rrugës dhe te sheshi i ministrive.

— E nget kush tankun e padëmtuar?

— Në kompaninë e shtabit kemi një partizan ish-shofer dhe një rob tankist!

— Tjetër ç'kanë mbledhur?

— Intendenti ka përveshur mëngët dhe duket si bakall qyteti. Me qindra kuintalë miell, sheqer, makarona, oriz, djáthë, salcë, kripë, marmallatë, çaj e ku ta di unë.

— Dëgjo, Kozma, të takosh intendentin dhe t'i thuash, t'u japë ca marmallatë për mëngjes partizanëve.

— Patjetër!

— Për drekë t'u bëjë hallvë!

— Menjëherë!

— Po mish a do të kenë gjetur?

— Mish bualli, më tha.

— Buall plak?

— Kokën e ka të vogël.

— Kush do të gatujë tashti që kuzhinieri u plagos?

— Unë, — tha Kozmai pas pak.

— A mundesh? — e pyeti këshilltar Dani nga prapa.

— Kam gatuar njëherë këtu e pesë vjet!

— Oho-o-o! — qeshi Dani që nga minderi. — Me sa duket, s'kanë për të ngrënë gjë nesër partizanët!

— Sido që të gatuhet, — tha Kozmai me seriozitet, — në luftë hahet dhe shijohet çdo gjë!

Khako Rina qeshi me të qeshurën e tij njënotëshe, qeshi edhe këshilltar Dani, që Xhakos iu duk si blegërimë dashi, por fajet ndoshta i kishte hunda dhe jo zëri i tij.

Tha Xhako Rina:

— Por mos kujtoni se të gjitha ushqimet e zëna do t'i hamë ne. Do të mbajmë për brigadën sa për një javë! Pjesën tjetër do t'ia nisim Tiranës. S'mund të bëjmë sipas qejfit. Jemi shtet i organizuar.

Kozmai pyeti:

— Po pas një jave ç'do të bëhet?

— Mund të nisemi në rrugë të largët, Kozma, për të ndihmuar në pastrimin e krahinave të Veriut nga disa mbeturina të çetave të Ballit e të Legalitetit, që po bëjnë dëme në popullsi.

Kozmai nderoi me grusht:

— Të largohem, shoku komisar?

Pas mpirjes së kurrizit vinte lodhja. Pas lodhjes vinte dhimbja. Këtë e dinte që më parë Xhako Rina. Dhe ajo (dhimbja e kurrizit) do të vinte, përderisa lodhja ishte bërë e plotfuqishme. Çudi: tashti që ishte lodhur, Xhakos filluan t'i rridhnin mendimet më lirisht dhe ndoshta nuk do t'i duhej më shumë se një orë (po ta linin të qetë) për ta mbaruar krejt raportin. Megjithatë nuk do të bënte keq sikur të dremiste edhe një herë, siç bëri pak më parë, me kokën mbi duar e me duart mbi tavolinë. Se si i shkuan sytë tek opingat e mëdha të këshilltar Danit. Ah, de-rrat e egër, u kujtua. Por të mbaroj më parë raportin. Pastaj të vendos se ç'duhet të bëjmë me de-rrat e Da-nit.

Isë Brezari, këmbëkryq anës vatrës lexonte broshurën dhe, meqë gjente vështirësi për ta kuptuar, lexonte gati me zë, pspspss...

Jashtë era, me fishkëllimën e saj të lashtë, po vinte duke u zbutur, por po fillonte prapë të qëmtonte në xhamin e dhomës. Ai qëmtim i imët, as vesë as shi, sillte me vete një zyrti të qetë e të plogët. Partizanët flinin. Ata ishin të lodhur dhe flinin. Atë natë vetëm kompania e shtabit me Kozma Petin në krye bënte shërbimet e rojës me radhë sipas skuadrave.

Tak-tak-tak, shkopi në dysheme dhe rreth opingës së madhe: figura e gjarprit të egërsuar spërdridhej e pastaj zgjatej e zgjatej...

Komisari shkruante, por zakonisht, për të shkruar një apo njëmbëdhjetë rreshta, në sytë e tij vërshonin tablo të tëra dhe, jo të gjitha ato që vërshonin, do të shkruheshin në raport.

... Aty nga mesdita beteja bëhej në të gjithë vijën e frontit. Gjatë më se tri kilometrave në pozicionet e

të dyja palëve, që ishin plot bërryla e zigzage, siç ishte edhe vetë rruga automobilistike, fluturonin predha e plumba të të gjitha kalibrave. Nganjëherë sulmi ose kundërsulmi i njëres palë ose i palës tjetër përfshinte të gjithë vijën e frontit. Atëherë kishte më pak krisma, më shumë britma, më shumë vringëllimë kondakësh e bajonetash. Por më shpesh beteja përqendrohej në pika të veçanta, sidomos në ato pika ku terreni ishte më i përshtatshëm, qoftë për partizanët, objektivi i të cilëve tashmë ishte të zbrisnin përfundimisht në rrugë e me këtë t'i jepnin fund qëndresës së gjermanëve, qoftë për gjermanët, objektivi i të cilëve ishte të shpartallonin kundërsulmet partizane për të mbajtur gjithashtu rrugën, që ishte shpresa e vetme për të arritur në Tiranë, vërtet të sakatuar, të përgjysmuar, por sidoqoftë të gjallë. Ndoshta rrallë mund të ketë ndodhur në ndonjë luftë partizane që një pjesë e shkurtër rruge as katër kilometra, e cila shtrihej e përgjakur, e mbuluar me kufoma ushtarësh, me kuaj të vrarë, me makina në flakë, me tanke e autobllinda, që gërvishtnin rrotat e zinxhirët rreth vetes, të ishte bërë objektivi i disa mijëra njerëzve nga të dyja anët dhe të ishte pikërisht kjo pjesë rruge, zotërimi i së cilës do të përcaktonte fitimtarin ose të mundurin përfundimtar. Por, sado që luftohej në të gjithë vijën e frontit, në luftë do të ketë gjithnjë një pikë nevralgjike, rreth së cilës beteja bëhet më e egër, më vendimtare, ku grumbullohet palca e ushtrisë, mjetet më të fuqishme, ku shprehen më qartë qëllimi, guximi e trimëria, ku shprehen më qartë teknika dhe strategjia e të dyja palëve. Kështu, pas dështimeve të njëpasnjëshme të paradites për t'i marrë krahët brigadës partizane e për ta rrethuar, po atë mesditë në të gjithë shtrirjen e luftës së fshatit Mushibë, një pikë e këtillë nevralgjike ishte bërë ajo që në gjuhën e partizanëve mori emrin Kodra e Gjelbër, që ishte një kodër me pjerrësi të vogël, mbuluar me shkurre, me gurë të rrallë, por të mëdhenj në bojën e njeriut, një kodër e rrumbullakët si kurriz breshke dhe

aty-këtu e veshur me ullinj. U kuptua menjëherë se në gjendjen që ndodheshin luftimet, pikërisht këtë kodër shtabi armik e quante hallkën më të dobët dhe prandaj aty ai shpresonte të fuste pykën e parë e t'u dilte partizanëve prapa krahëve. Vlera e kësaj kodre rritej akoma edhe nga fakti se ajo ndodhej në mes ose gati në mes të vijës së frontit, në mes të luftimeve.

Por një gjë të këtille e kishte kuptuar menjëherë edhe shtabi partizan, bile edhe vetë shtabi partizan pikërisht nga Kodra e Gjelbër mendonte të jepte goditjen përfundimtare për pushtimin e rrugës, ose të paktën për prerjen në mes të forcave gjermane. Tashti merrret me mend se ç'ndodhi e ç'do të ndodhte në kurrizin e kësaj kodre. Ne nuk e dimë cila palë e filloi e para sulmin dhe cila palë që e detyruar të kundërsulmonte, fundja kjo s'ka rëndësi, por dimë që sulmet e kundërsulmet zëvendësonin njëri-tjetrin dhe beteja në kurrizin e Kodrës së Gjelbër nuk njohu asnjë çast pushimi. Vetë komisari, Xhako Rina, aty u ngujua, aty luftoi, aty drejtoi dhe po aty prënë, prapa Kodrës së Gjelbër ai mbajti rezervën e vetme të të gjithë brigadës, kompaninë e shtabit, me Kozma Petin komandant. Beteja kishte një rend kronologjik e një parashtrim shumë të thjeshtë: kur majat dhe faqet e Kodrës së Gjelbër mbuloheshin nga partizanët, ishte radha e gjermanëve të hidheshin në kundërsulm. Kur ato pushtoheshin nga gjermanët, ishte radha e partizanëve të kundërsulmonin. Shpesh këto sulme e kundërsulme përgatiteshin me kujdes, por ndodhte të bëheshin edhe spontanisht, bile të merrnin shkak nga diçka pa rëndësi, bie fjala, nga një gur i vogël që rrokullisej diku etj. etj. dhe jorrallë luftimet përfundonin trup me trup. Por në qoftë se fuqia, dendësia e zjarrit dhe sasia e njerëzve ishin në favorin e gjermanëve, në favorin e partizanëve ishte vazhdimisht terreni i pjerrët dhe lartësia, sepse partizanët, edhe kur ishin të detyruar të lironin majën e Kodrës së Gjelbër për të zënë pozicionet e dyta, prapëseprapë ishin gjithmonë më lart se gjermanët.

30 me 100, afërsisht ky ishte raporti midis partiza-



nëve dhe gjermanëve, që kishte mundur të numëronte Xhako Rina.

Duke grumbulluar një sasi të madhe armësh automatike, të rënda e të lehta, nga topat me qitje të largët e direkte e deri te mitralozët dhe pushkët automatike, pa zënë në gojë mortajat e të gjitha kalibrave, armiku, që kishte mundur të hapte ndonjë rrugë, duke lëvizur disa nga gurët e mëdhenj faqe Kodrës, prej më se një ore mbështeste kështu kundërsulmet e veta me anën e pesë tankeve dhe tri autoblivdave, prapa të cilave fshihej dhe mbrohej këmbësoria deri në afërsi të majave të Kodrës — këtij armiku, të cilit iu duk se kishte filluar t'i buzëqeshte pak fati, aty nga pasditja befaz iu hap oreksi dhe bëri tentativa për t'u futur më thellë, d.m.th. për të pushtuar pozicionet e dyta.

Atëherë, Xhako Rina, që kishte vënë re edhe lodhjen fizike të partizanëve, pa harruar të ftohtët që u kishte hyrë në trup, vendosi të hidhte në betejë rezervën, kompaninë e shtabit të brigadës, që ishte edhe reparti më i specializuar për të luftuar kundër mjeteve të korracuara. Po, megjithatë, para se të jepte urdhrin për të hedhur rezervën e fundit në betejë, u përpoq të çonte nëpër mend se si vallë do të kishte vepruar në këtë rast ish-komandanti i brigadës po të ishte ndodhur aty. Edhe pse u bind nga përvoja e luftës njëvjeçare me të, edhe pse të gjitha rastet që çoi nëpër mend vërtetonin se komandanti s'do të kishte vepruar ndryshe, veçse duke hedhur rezervën në betejë, ai prapëseprapë mori edhe mendimin e komandantëve të batalioneve. Pastaj veprimi. Thirri Kozma Petin, i cili erdhi me një frymë.

Kozmai nuk ishte i gjatë, por nuk ishte as i shkurtër, veçse, kur i afroheshe, kur bisedoje me të, kuptoje menjëherë se ishte një shpirt i pastër dhe nga trupi i tij buronte një fuqi e natyrshme, pa poza e pa zbukurime. Sidomos këmbët e duart i kishte të gjalla e tepër të shkathëta. Këpucët e rënda, automatiku gjerman, gjerdanët e fishekët, revolva e dy bombat, dukeshin si ca stolira të vogla pa rëndësi e pa peshë në trupin e tij të ngjeshur. Sidomos një cullufe e zezë, që në raste

betejash i varej patjetër mbi ballë nën kësulën partizane — të gjitha këto e gjithçka tjetër që buronte nga trupi i tij, le të shpejtojme të themi, i jepnin Kozma Petit pamjen e një kokoroçi sypatrembur. Këtë pamje e ndihmonte edhe zakoni që kishte ai për të mbajtur në njërin vesh një cigare të dredhur e në tjetrin një lule të egër mali, mundësisht të kuqe të errët. Me atë lule u paraqit edhe para komisarit të brigadës.

Tha Xhako Rina:

— E, Kozma, u bë një natë e gati dy ditë që të mbajmë të paprekur, të glodhur e të ngrënë.

— E kuptoj, shoku komisar, vetëm jep urdhër!

— Atëherë lëshoi njëqind partizanët mbi ta!

— Do t'i lëshoj, shoku komisar. Duke dëgjuar luftën prapa kodrës, partizanët janë bërë të paduruar.

— Vepro, Kozma!

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit!

Kjo bisedë u bë midis atyre të dyve nën ciflat e imëta të gurëve të thërrmuar nga predhat e mortajave.

Disa minuta më vonë Kozma Peti qëndroi para kompanisë së shtabit dhe tha:

— Ai që është frikacak, le të mbulohet me turp një herë e përgjithmonë, kurse ai që dëshiron të hakmerret një herë e mirë e për të fundit herë, ja ku i ka gjermanët, aty përpara, në kodër e në xhade, ku ata duhet të asgjësohen të tërë deri tek i fundit!

Të gjithë partizanët, si një trup i vetëm kthyen kokën nga rruga automobilistike, asfalti i zi i së cilës dredhonte përmes gjelbërimit heterogjen të nëntorit si një gjarpër laraman, i plagosur në të gjithë gjatësinë e trupit të tij. Dhe më afër ata panë faqet e kodrës ku ziente lufta dhe zhurmonin motorët e tankeve dhe të autobindave e ku gurët e mëdhenj, si barinj të ngurosur, dukej sikur shprehnin pakënaqësinë që i kishin lëvizur nga vendi.

Pastaj Kozma Peti armatosi skuadrat me pushkë antitank e me lëndë eksplozive, dha porositë e fundit, i tregoi secilës skuadër drejtimin nga duhej të

kundërsulmonte, ndërsa vetë, me kurriz nga partizanët e me fytyrë nga gjermanët, tha:

— Fillojmë, shokë!

Kozma Peti dukej sikur luftonte si i verbër, por s'ishte ashtu. Ai kishte nuhatje të madhe dhe përvojë të gjatë luftarake. Ai dinte kur duhej zmbropsur apo sulmuar befaz, ballas apo anash, kur duhej zvarrisur, kur duhej minuar tanku, kur duhej heshtur apo ngritur në këmbë dhe thirrur:

— Para, partizanë!

Dhe kështu mund të themi se mbarësia filloi që në sekondat e para, kur ndonjë tank u zvarris në flakë e kur filloi kundërsulmi partizan, Dhe atë, mbarësinë, e filloi vetë Kozma Peti. Pas një kërcimi të gjatë, dy këmbët e tij me këpucë të rënda ranë mbi gjoksin e një gjermani që u rrokullis tatëpjetë, duke marrë me vete një të dytë, ndërsa lulja e egër, që fluturoi nga veshi i Kozma Petit, u shpupurish në petale të kuqe të errëta, si gjuhë zjarri. Dhe pastaj...

Xhako Rinës, që hetonte e vrojtonte nga pozicioni, shpejt iu ngatërruan përfytyrimet. Një çast më vonë atij iu bë sikur të gjithë partizanët shëmbëllenin me Kozma Petin. Ata ngriheshin e shkëputeshin nga toka, hidheshin përpara me vrull, u fluturonin kësulata nga koka dhe sulmonin të gjithë, përfytyreshin dhe të gjithë ata ishin Kozma Petër. Ky ishte një moment kritik i betejës në Kodrën e Gjelbër. Atëherë Xhako Rina urdhëroi sulmin e përbashkët të forcave rreth Kodrës, ngriti lart automatikun, vrapoi i pari dhe briti:

— Para, partizanë!

... Xhako Rina mblodhi letrat që kishte shkruar dhe i shikoi me dyshim. Jo, ky s'është raport, mendoi ai. Unë nuk e di çfarë është ky, por të paktën raport nuk është. Kështu tha dhe i vuri letrat në cep të tavolinës. Dhe nga gjithë ato që kishte shkruar, ai përmbloodhi vetëm këta rreshta në formë raporti: *Partizanët përfytuan nga terreni i pjerrët dhe, megjithëse ishin më*

të paktë në numër e në armatime, e thyen keq armikun, sidomos aty nga mbrëmja e ditës së dytë, duke e detyruar të mblidhej e të strukej sërish në rrugë. Ndërsa nata e dytë pati beteja të shkëputura, kryqëzime zjarri, ndonjë depërtim të zbuluesve tanë dhe të zbuluesve gjermanë në prapavijat tona. Pati edhe vrasje pas kurrizit nga të dyja anët.

Kështu i përfundoi komisar i betejet e ditës së dytë në Mushibë dhe, kur e rilexoi këtë pjesë të raportit, buzëqeshi me vete, i bindur edhe një herë se raportet dhe terminologjia e artit ushtarak nuk lejonin të paraqitej imtësisht ajo që kishte ngjarë me të vërtetë. P.sh. në raport atij nuk i lejohej të përshkruante errësirën e natës, as ajrin i cili qe mbushur me erë baruti, as ndjesinë e tymit, që ngjitej nga rruga deri në pozicionet partizane, as flakët e makinave që digjeshin e, ndërsa digjeshin, përhapnin kudo erë pajimesh ushtrie, erë lufte... Pa le, pastaj, të përshkruante të gjitha ato që shkroi e përfytyroi më sipër...

13.

— A të të them një gjë, komisar, — tha këshilltar Dani. — Mos u mendo kaq shumë e mos shkruaj kaq shumë. A nuk mund t'i biesh më shkurt asaj pune që të kërkon Tirana?... Të të them të drejtën, sikur po vjen koha, të zgjojmë partizanët, se derri i egër, ja, sikur ka filluar të lëvizë.

— S'paske hequr dorë nga derri, shoku Dan? — pyeti Xhako Rina. Si gjithmonë, vështtrimin e kishte të

shqetësuar Xhako Rina, ndërkohë që e gjithë pjesa tjetër e qenies së tij shprehte qetësi të përjetshme. — Unë pandeha se u binde, — tha pas pak ai.

— Jo, nuk bindem unë, — tha këshilltar Dani.

— Kujtova se po qëndron këtu për të më bërë shoqëri!

— Të thashë, për t'i bërë nder mikut. Por jo vetëm për t'i bërë nder!

— Për të ngrënë darkën e teze Rubit! — shakatoi komisarari.

— Darkën do ta ha, se Rubin e kam të njohur, dhe është zemërbardhë, është edhe fatkeq!

Pasoi një heshtje.

— Ti jepi fund asaj pune, komisar, — tha Dani me autoritetin e një këshilltari. — Pastaj e di unë se ç'na mbetet për të bërë!

— Unë ta kam thënë mendimin tim!

— Edhe unë ta kam thënë, derrat e egër na e ngritën misrin! — Ai e shikoi komisararin në mënyrë të atillë thujse deshi të peshonte qëndrimin, mendimin dhe vendimin e tij: e vllente ta vazhonte bisedën me të, e vllente të ngulte këmbë e t'i shpjegonte se ç'donte të thoshte për fshatarin t'i dëmtohej ai pak misër që kishte bërë atë vit!

— Ti je babai im, — tha Xhako Rina, — dhe mua më vjen keq që s'ta plotësoj dëshirën.

Tjetri e shikoi një hōp në heshtje, pastaj tha me dashamirësi:

— Xhako, unë dua të na ndihmosh!

— Të thashë, sonte jo!

— Po kur?

— Vetëm sonte jo!

— E-e-ej!

— Ti e di më mirë se unë, ç'ndodhi këtu tri ditë e tri net me radhë! Ti e di ç'ndodhi dy javë me radhë, që bëmë llogore e që fjetëm jashtë. Dhe kur? Në nëntor, në këmbët e Kërrabës! Edhe këto ditë e net pas lufte, një minutë s'kemi pushuar, pa le edhe qindra

gjermanët e humbur, që, sipas radhës, kanë mbajtur në këmbë një kompani partizane!

— E ti m'i thua të gjitha këto fjalë, që unë të mbledh shkopin, t'ua hipi opingave e çalë-çalë të shkoj në shtëpi e të fle, kur derri...

— Vetëm sonte jo!

— Edhe derri u çakërgjos, komisar. E çakërgjosi lufta. Nuk është më ai derr që kemi njohur kohë më parë! Tjetër derr ky, krejt tjetër! Është mbledhur në tufa të mëdha, vargan-vargan. Dhe e beson? As zhurme nuk të bën! Po më të ngrihet me dy këmbët e para e më t'i hidhet misrit, krrap, krrap, krrap! — Dhe ai dyshimi i vjetër, që ishte, si të thuash, baras me një sekret të Danit, sikur i doli përsëri mbi fytyrë dhe i ngeci pikërisht në bebëzat e syve, që ndërkohë kishin ngulur vështrimin e tyre në sytë e komisarit.

Xhako Rina shikoi edhe ai diçka me dyshim brenda atyre bebëzave, sikur lexoi edhe ai në to një nënkuptim të fshehtë, pastaj tha:

— Ç'të të them, Dan. Po qe kështu, prit një herë të mbaroj punë, të hamë edhe darkë, pastaj shohim e bëjmë. Mua do të më pëlqente të të mbushej mendja të hiqje dorë për sonte!

— Do të pres, posi, por dorë nuk heq. fundja, le të flenë edhe pak partizanët, se mua më dhimbsen po aq sa të dhimbsen ty!

Aty pranë vatrës, ku digjej një kërcu i madh, Isë Brezarin e kishte zënë gjumi me kurriz pas murit e me broshurë në prehër. Ai flinte me sytë gjysmë të hapur, dhe ashtu në gjumë, kaltërsia e tyre ishte shumë e pastër, si qiell pranvere. Megjithatë fytyra e njomë me inde të reja e Isës, dukej e lodhur. Teze Rubi u fut brenda me vrull, por, tek p'a Isën në gjumë, stepi pak, eci në majë të gishtave, e shtriu Isën ngadalë, e mbuloi me një velenxë të hollë dhe vetë u ul në cep të minderit, ku rrinte ulur prej më se dy orësh këshilltar Dani. Tha, duke treguar Isën:

— I vogël për të duruar mundimet e luftës!

— Pati ca vështirësi në fillim, — tha Xhako Rina me

një zë që shprehte dhimbje dhe keqardhje. — Jeta partizane kishte qenë vetëm në ëndrrat e tij. Në fillim qëndronte i veçuar, i menduar dhe i heshtur. Tashti Isa lexon broshura që janë për të rritur dhe i lodhet shpejt truri. — Zëri njëtonësh i Xhako Rinës ishte bërë akoma më i dhimbsur. — Ai filloi një jetë të re, por mbeti jetim!

— E di, m'i ke treguar të gjitha, — tha Dani dhe shikoi nga Isa.

— E di! — tha edhe Rubi.

— Po ti, teze Rubi, nga e di? — pyeti Xhako Rina.

— M'i kanë treguar shokët e tij, — tha ajo.

Isa pati një frymëmarrje, që ngjau me një gërrhitje fëmijërore, me një gërrhitje të lehtë, të këndshme, freskuese.

— Por është trim, — tha komisari, duke ngulur majën e lapsit në një pikë të letrës që kishte përpara. — Në mbrëmjen e ditës së dytë të betejës së këtushme, pas një kundërsulmi të partizanëve, pashë Isën tek po ngjitej përpjetë gjysmë i kërrusur me një shok në krah, një partizan më të rëndë se veten. Ç'bën, Isë, e pyeta unë. Ai më shikoi drejt në sy. Më besoni, sytë i kishin kërcyer jashtë. Dukej mjaft qesharak. Se edhe lot kishte në sy. Qemalin, shoku komisar, më tha. Pa dale ta shikoj Qemalin, thashë unë. Unë dyshova. Krahët e Qemalit vareshin poshtë dhe tundeshin si të prerë. Ule, i thashë. Ai e uli. Ka vdekur, i thashë dhe m'u pre fryma. Isa qau me zë, kurse unë e mora për krahu, e çova në çadrën e infermierisë që kishim ngritur aty pranë dhe e ula mbi rrogos. Si ndodhi, Isë, e pyeta unë. Mos më pyet, tha ai si i madh. Si, ore, të mos të pyës? Unë dhe Qemali u nisëm poshtë, tha Isa dhe na hipi në kokë të zbrisnim deri në rrugë. Po pse, e pyeta unë. Të zinim të gjallë një oficer, ulur në parafangon e një kamioni të shkatërruar dhe që mbante sytë me dorë. Por, kur zbritëm në rrugë dhe iu hodhëm përsipër, oficeri u rrëzua. Ai paskësh qenë i vdekur me kohë. Atëherë varëm disa automatikë nëpër supet, mbushëm xhapat me krehra që gjetëm në rrugë e menjëherë u ngjitëm

nëpër mugëtirë. Por, sa hipëm mbi rrugë, tre gjermanë, me një qen që nuhaste, na u vunë prapa. Atëherë ne vendosëm të ndaheshim e të vraponim në drejtime të ndryshme. Do të takoheshim te guri i madh pranë ullirit të parë. U ndamë, por nuk u takuam më, Qemali nuk erdhi. Kur u ndamë, unë vura re se qeni shkoi pas gjurmëve të Qemalit. Unë e vrava qenin. Pastaj prita te guri. Por ai nuk erdhi, atëherë shkova vetë poshtë, e gjeta Qemalin të plagosur, e hodha në krah... Kaq më tha Isa, se pastaj humbi si në gjumë mu aty në çadrën e infermierisë...

Këto tregoi Xhako Rina. Të dy ata (Dani dhe Rubi) shikuan nga Isa, që flinte pranë vatrës, mbuluar me velenxë dhe merrte frymë butë, lehtë dhe këndshëm.

— Është lodhur, — tha komisarari. — E lodhin edhe broshurat që lexon! — Në zërin e tij u shqua përsëri nota e dashurisë dhe e dhembshurisë për Isën.

Rubi dëgjoi frymëmarrjen apo gërhitjen e lehtë gati fëmijërore të Isës, për një çast u duk sikur e përshkoi një drithërimë e brendshme, shikoi prapë Isën, shikoi edhe komisarin e Danin dhe doli jashtë, duke marrë me vete notën e njohur të dëshpërimit e duke thënë:

— Pas pak do t'ju sjell të hani. Po afrohet jacia, të hani e të flini, se u lodhët!

Këshilltar Dani lëshoi një psherëtimë gati si të lëshonte një fishkëllimë, por nuk lëvizi nga minderi, mbeti i patundshëm në pozën e tij të pritjes, dhe kjo vendosmëri i lexohej edhe në hundën e gjerë e të shtypur si të dashit, edhe në opingat e mëdha si të ngjitura pas dyshemesë, edhe në shkopin e rëndë, të trashë e të thantë, që dikur duhej të kishte qenë i bardhë, por djersa dhe koha i kishin dhënë ngjyrën e drurit të staxhionuar.



Komisari kishte ndier dhimbje në kurriz dhe, si për ta përballuar atë, ishte ngritur në këmbë. I kërrusur si pemë e përkulur nga era, ai lexonte diçka në raport, por ajo që lexonte, me sa dukej nuk i pëlqente, sepse s'mund të kishte kuptim tjetër, që buzët e tij të moduluara pak shtrembër, ishin bërë plotësisht të shtrembra.

— Shoku komisar, — dëgjoi ta thërrisnin. Xhako Rina vendosi fletën mbi tavolinë dhe ngriti kokën. Para tij qëndronte një fshatar afër të dyzetave, i lagur, i lodhur, por më shumë i merakosur, gjë që theksohej në sytë e tij, rrethuar me qenar të zi. Përpara këmbëve i qëndronin dy fëmijë, një vajzë e një djalë tre e pesë vjeç, të lagur e të lodhur edhe ata, dhe, si dy mace të vogla shikonin të trembur e si me çudi atë xhaxha të hollë e të gjatë, me të cilin po fliste i ati. Pasi u përshëndet me komisarin, krahun e të cilit e tundi fort, pasi i hodhi një shikim Isës që flinte pranë vatrës, pasi përshëndeti nga larg me dorën në zemër Danin, këtë të fundit si një të njohur të vjetër, kërkoi pastaj me sy një vend ku të ulej edhe vetë. Përveç mindereve të pastra që rrethonin dhomën, ndodhej e lirë nga ana e vatrës vetëm ajo karrigia e vjetër në të cilën ishte e këshillueshme të mos uleshe fare. Por ai e mori, e afroi pranë komisarit dhe u ul. Karrigia lëshoi një kërkëllimë të mbytur, këmbët e saj raketike u shtrembëruan akoma, por nuk u thyen. Hoqi qeleshen e gjatë, rrethi i së cilës kishte zënë një gisht djersë e zhul, dhe e rrotulloi nëpër duar. Aty Xhako Rina vuri re se i porsaardhuri ishte pa një vesh. Ashtu në heshtje, komisar i shikoi me vëmendje fshatarin, pastaj dy fëmijët dhe tha:

— Si e ke hallin?

— Unë u largova nga shtëpia para se ju të fillonit luftën në Mushibë. Tashti që u ktheva, e gjeta shtëpinë rrafsh nga një gjyle topi. Erdha t'ju qaj hallin, — tha

ai, duke treguar me dorë dy fëmijët, që dridheshin si mace të lagura. Ata shikuan nga poshtë-lart xhaxhanë e gjatë dhe, nga njëra anë u përlotën, nga ana tjetër buzëqeshën me frikë, duke zbuluar gojën me dhëmbët e parë të rënë.

— Të flini këtu të tre, — tha Xhako Rina, duke treguar me dorë këndin e vatrës, ku flinte Isa. — Nuk e ke gruan?

— Më ka vdekur para dy vjetësh, — tha fshatari.

— Ja, aty të flini!

Fshatari ra ngushtë.

— Të kanë mbetur mure në këmbë? — pyeti Xhako Rina.

— Po edhe kanë mbetur!

— Së shpejti do të të mbulojmë një dhomë sa për të kaluar ca kohë. Po miell a të ka mbetur?

— Një trastë që kisha, e mora me vete dhe e hëngra me fëmijët te miku ku futa kokën.

— Ç'qenke ngritur natën nga miku?

— Meraku i shtëpisë. Meraku i arës. Mora vesh se ka rënë derr i madh në misra.

Pasoi një heshtje aq sa mjaftoi që Xhako Rina dhe këshilltar Dani të shikoheshin sy në sy.

— Do të të japim pak miell e si fillim do të të mbulojmë një dhomë me ç'të mundim, me copa tjegullash, me kashtë e me rrasa, — tha Xhako Rina.

Fshatari mbeti në këmbë, si në mëdyshje për fjalët që donte të thoshte. Dukej qartë se ishte në zor dhe i vinte turp.

— Fol, — i tha Xhako Rina.

— Ç'të flas. punën e shtëpisë lëreni, se e mbuloj vetë dalëngadalë. Fëmijët mund t'i mbaj ca kohë në një shpellë që kam aty afër. Por miellin, po ma dhatë hua... s'kam para në dorë, as për shtëpinë, as për miellin.

Këshilltar Dani qeshi mbytur dhe tha:

— Mbetë po ai që ke qënë, Tush, i mënjanuar nga shokët. Askush nuk të kërkon para!

— Qysh? — pyeti më se i çuditur Tushi dhe, nga

çudia, më parë kroi vendin e veshit që i mungonte, pastaj veshin që kishte.

— Këshilli Nacionalçlirimtar i fshatit dhe shtabi i brigadës kanë marrë vendim që të gjithë ne së bashku, partizanët, fshatarët e robërit gjermanë t'i ngremë secilit nga një kolibe sa për të kaluar dimrin!

— Na shpëtuat, shoku komisar, — tha Tushi duke treguar dy fëmijët që dridheshin. (Fëmijët shikonin komisarin me gjerdan e me revole në brez dhe s'u kishte dalë as çudia, as kureshtja. Syskuqur, përloteshin e buzëqeshnin. Dhe dridheshin). — Po ofarë t'i themi këtij, që të ndreq shtëpinë e të jep miell pa para?

— Pushtet demokratik popullor, — tha komisari. — Vetëm pushteti popullor mund të ndihmojë pa interes të gjithë ata që bien ngushtë!

Fshatari e shikoi komisarin me shumë ndjenja e mendime të përziera bashkë dhe mbeti ashtu, pa folur, as i gëzuar, as i shqetësuar, por thjesht një njeri i lagur, i lodhur, në ndërgjegjen e të cilit bëhej një luftë besimi e mosbesimi për të gjitha ato që kishte dëgjuar.

— Sa tokë ke, Tush? — e pyeti komisari.

— Një arë të vetme, që e kam me misër të pambledhur

— Sa bëhet ajo arë?

— Pesë dynymë.

— Pak paske!

— Pak kam, shoku komisar. Dy muaj bukë në vit.

— E ka edhe të keqe, — tha këshilltar Dëni, duke shoqëruar fjalët me lëvizjen e shkopit të rëndë. — Zhurishtë!

— Tokat e mira i kanë agallarët e fshatit, — tha Tushi.

— Cilët janë ata?

— Hoxhë efendi, Shak aga Dëllinja, Bajazit aga Palla, një Sherif e një Zyber e ca të tjerë që ishin me Ballin e që u humbi vula.

— Ç'pasuri kanë?

— Ne dimë atë që shohim me sy, — tha Tushi. —

Nga njëqind hektarë tokë, gati nga dy mijë a tri mijë kokë dhen e dhi, lopë e viça, ullinj e pyje, kullota e toka djerr.

— Shumë paskan!

— Kanë edhe këpucë edhe çizme, — foli befaz njëri nga dy fëmijët e Tushit, djali pesëvjeçar. — Shkojnë në shko-o-o-llë! — tha prapë ai.

Ky zë, këto fjalë dhe në përgjithësi kjo ndërhyrje e të voglit, i kishte lënë të gjithë të çuditur. Pasi një heshtje. Pastaj një e qeshur e fortë. Kishte qeshur komisari, këshilltar Dani, vetë Tushi dhe teze Rubi, që sapo ishte futur në dhomë dhe kishte qëndruar te pragu për të dëgjuar bisedën e tyre. Ndërkohë që kjo e fundit i tërhoqi fëmijët pranë zjarrit dhe po u fshinte flokët e lagur me peshqir, komisari tha:

— Do të bëjmë reformën agrare, Tush. Ke dëgjuar të flitet për të?

— Italianët e gjermanët nuk i ka dashur Tushi, por megjithatë ka qëndruar mënjanë luftës, — tha Dani. — S'para i di këto punë megjithëse një vajzë e ka partizane në Brigadën e Tetë, por ajo iku pa e pyetur.

Tha Tushi:

— Kam dëgjuar për tokën që kur isha i vogël, por nuk di si do të bëhet ajo, reforma.

— Ja kështu, do t'ua marrim tepricat atyre që kanë dhe do t'i pjesëtojmë midis jush që s'keni, — tha komisari.

— Sa do të na jepni? — pyeti ai.

— Sa tokë do t'i duhej një fshatari për të jetuar si njëri?

Ai fshiu mustaqet e lagura me kurrizin e dorës dhe mbeti në heshtje, pa guxuar të fliste.

— Fol, Tush, gjashtë hektarë duhen, — tha Dani.

— Jo, bre Dan, janë shumë gjashtë hektarë! — tha Tushi. — Ka të jetuar e të jetuar.

— Jo si bej e si aga, me teprica që të shkojnë kot, por mesatarisht, — ndërhyri komisari.

— Se mos varet nga ne, — tha Tushi. — Sa të na japin, aq do të marrim,

- Nga ju do të varet, — tha komisari.
- Gjashtë, — tha prapë Dani.
- Gjashtë do t'u japin! — tha komisari.
- Të lumtë goja komisar, — tha Tushi si i frikësuar.
- Po ju, komisar, a do të merrni rroga? — pyeti ai si pa të keq.

Xhako Rina kishte shtangur nga kjo pyetje. Trupi i tij i gjatë, i hollë, u kërrus si pemë e përkulur nga era. Ai ishte punëtor politik, ai ishte ngjitur deri në rangun e komisarit të brigadës dhe jeta vetë, puna e lufta i kishin mësuar shumë gjëra, por ja që për rrogat as kishte rënë ndonjëherë fjala në Parti, qoftë midis shokësh e në biseda të thjeshta, as ai vetë s'kishte menduar kurrë. Kjo pyetje e kishte zënë aq në befasi dhe aq ngushtë, sa ai u përkul prapë e gati u thye mbi tavolinë. Por si gjithmonë, përjashtuar shikimin që e kishte vazhdimisht të shqetësuar, e gjithë pjesa tjetër e genies së tij shprehte qetësi të përjetshme.

- S'di ç't'ju them, — tha i hutuar.
- Do t'ju japin me siguri, — tha Dani nga minderi.
- Xhako Rina ngriti supet në mëdyshje.
- Ndryshe si do të rroni?! — pyeti Dani.
- Në kazanin e ushtrisë?! — pyeti edhe Tushi.
- Unë nuk i di të gjitha, — tha komisari, — por di që ne s'luftuam për grada e për rroga!
- S'del mirë kështu puna, ne marrim toka, ju asgjë!
- tha Tushi me keqardhje. — Ja, njeri je edhe ti, këpucët i pasqe të grisura!

Nga këto biseda Xhako Rinës iu bë sikur ishte çlodhur disi, sikur i kishte kaluar disi dhimbja e kurrizit. Jashtë sqota ishte zëvendësuar me shiun e imët dhe nata merrte frymë qetësisht, nga ato qetësi që të ngjallin parandjenjën e një lumturie dehëse. Isa gërhiste lehtë. Teze Rubi u kishte fshirë fëmijëve kokën, u kishte larë këmbët dhe tashti ata thaheshin pranë zjarrit të gëzuar e duke i pëshpëritur njëri-tjetrit ps-ps-ps. Larg dëgjoheshin teneqetë dhe britmat e rralla të fshatarëve, që trembnin derrat e egër. Babai i dy fëmijëve, Tushi, me sytë rrethuar me qenar të zi, sikur erdhi

në vete, fshiu sërish mustaqet e lagura, ngjeshi në kokë qeleshen, si të ishte kjo një shenjë se kishte ardhur koha që edhe ai të bënte diçka, pastaj tha:

— Do të shkoj në arën e misrit!

— Nisu, Tush, — tha Dani.

Tushi u ngrit me dorën në zemër, prapa tij karrigia rakitike e Rubit u tund, lëshoi ca rënkime dhe, si një gjë e pritur prej kohësh, u shkriërua e ra në dysheme si një grumbull vjetërsirash pa asnjë vlerë. Rubi, me buzën në gaz, i mbloodhi copërat dhe i hodhi në zjarr.

— Për mirë qoftë! — tha Tushi, i dha dorën komisarit, përshëndeti nga larg Danin e Rubin dhe u zmbraps. Por te dera qëndroi, mendoi diçka dhe befasi u kthye prapë:

— Ç'bëhet atje poshtë, komisar? — pyeti.

— Ku poshtë? — deshi të sqaronte Xhako Rina.

— Në Tiranë, — tha ai. — Atje kam vajzën e madhe në Brigadën e Tetë. Hedije e quajnë, Hedije Sojani, por ne e thërresim Dije!

— Ajo brigadë mund të ndjekë armikun në Veri, — tha komisar, që tashmë shqyrtonte letrat e zhubrosura mbi tavolinë, po edhe Tushin, i cili, ngaqë ishte shumë i singertë, shumë naiv, të linte përshtypjen se nuk ishte njeri i zgjuar, por të paktën ishte i drejtë dhe i ndershëm.

— Ashtu dëgjova dhe unë! — Pasi një heshtje. — Drejt Shkodrës. Pisk do ta kenë gjermanët. Kudo i ndjekin. E bëri fora Shqipëria. Por vajzën ishalla e kam gjallë.

— Gjallë e ke, Tush! — i erdhi nga prapa zëri i Danit. — E keqja merret vesh shpejt! Gjallë e ke!

— Të lumtë goja, Dan! — tha ai, por u kthye prapë nga Xhako Rina. — Komisar, po dëgjove gjë për vajzën time, më thuaj një fjalë. Hedije nga Mushiba i thonë. Hedije Sojani. Por ne e thërresim Dije.

— Mirë, — tha komisar, — mos u bëj merak.

— E ke fare mirë Dijen, — përsëriti Dani. — E keqja përhapet menjëherë. Mirë e ke!

— Të lumtë goja, Dan.

— Bjeruni teneqeve dhe ndizni zjarre, — tha Dani.  
— Po afrohet koha që derri të dalë nga strofka. Por pushkë nuk lejohet të qisni. Lufta sa ka mbaruar dhe nuk i dihet!

— Lufta u largua, — tha Tushi.

— Por na mungojnë qindra gjermanë, që as i kemi vrarë, as i kemi zënë robër, — tha komisari. — Ata mund të jenë edhe të armatosur. Mund të bëjnë dëme edhe në njerëz. Duke pandehur se Tirana është akoma në duart e tyre, do të përpiqen të çajnë andej.

Tushi, si të zgjohej nga gjumi, tha:

— Zëruni shtigjet!

— Ua kemi zënë të gjitha shtigjet që shkojnë drejt Tiranës, — tha komisari. — Kudo kemi vënë roja!

— Zëruni urat!

— Ua kemi zënë.

— Atëherë na marrshin të keqen! — tha njeriu pa një vesh, që, si më parë, dukej pak naiv dhe jo i zgjuar, por aspak idiot.

— Ik, o Tush, ik! — e arriti sërish nga prapa zëri i këshilltar Danit. — Mblidh ata burra e pleq që janë kthyer dhe ndizni zjarre e bjeruni teneqeve. Se edhe partizanët do të dalin së shpejti arave.

Tush Sojani doli, por gjithmonë si në mëdyshje. Në dhomë mbetën prapë Xhako Rina, këshilltar Dani, dy fëmijët në anë të vatrës dhe në anën tjetër Isa, që flinte me broshurë të hapur mbi gjoks.

Larg, në thellësi të natës dhe të errësirës, si nga Tirana, si nga mali i Dajtit u dëgjuan ca të shtëna zinxhir kllu-kllu-kllu. Ato ishin të shtëna të një mitalozi të rëndë. Pastaj u dëgjuan edhe krisma të veçuara pushkësh. Jashtë nuk frynte më e me që retë ishin hapur diku, deri poshtë kishin rënë ca rreze të verdha e fare të dobëta të hënës së prerë. Por ishte qetë. Veç rrallë e tek dëgjohej fëshfërima e ashpër e njëkohësisht e lehtë e gjetheve të thara të fikut që fërkoheshin pas xhamit e binin në tokë. Xhako Rina

u përpoq të merrte me mend se si bimësia po zhvishet e po hidhte petkun e fundit të gjelbërimit vjeshtak. Përpara i priste dimri, që do të ishte i vështirë, i varfër, i rreptë, po edhe luftë do të kishte ai dimër, sepse të gjithë e dinin ose e merrnin me mend se, në rrëmujën e ditëve të fundit, lukunitë e feudoborgjezisë shqiptare s'mund të kishin ikur e s'do të mund të iknin të gjitha pas gjermanëve, as që do të mund t'i kalonin të gjithë kufijtë, as barka për të çarë detin s'do të kishte e s'do të gjendeshin për të gjithë. Përveç që disa mund të kishin qëndruar e do të qëndronin me qëllim, për të pritur në vend ndërhyrjen e reaksionit botëror, për të cilin kishin kohë që ëndërronin.

Kur mitralozi i rëndë dhe pushkët rrëzë Dajlit erdhën duke u rralluar, të dera u duk përsëri koka e njeriut pa një vesh.

— Harrova të të them, shoku komisar, se Hedijen e kam të re, por e punon bukur mitralozin, ja atë, që ia bën kllu-kllu-kllu. Breda i themi ne këndeje.

— Breda i themi të gjithë, — tha komisari me të qeshur.

— Më kanë thënë se vajza ime, Hedija, e ka syrin të fortë.

— E dimë, o Tush, — tha Dani. — Ik tashti, mbledh burrat që janë kthyer, bjeruni teneqeve dhe ndizni zjarre.

Tush Sojani u zbraps një hap. Opingat e tij si lundra të çartallosura shkelën në prag.

— Si thua ti, komisar, — tha ai, — a do të jenë të rrepta luftimet në Veri?

— Do të jenë, — tha komisari, — por ushtria jonë e ka treguar veten se është në gjendje të përballojë çdo luftë!

— Të lumtë goja, komisar, — tha Tushi. Shikoi nga këshilltar Dani. — Po shkoj të mbledh burrat, t'u biem teneqeve e të ndezim zjarre. Po ti e di që ata s'bëhen as dhjetë veta, kurse arat e fshatit janë shumë të përhapura.



— E di, Tush, por janë duke u kthyer gjithnjë të tjerë, do të ndihmojnë edhe partizanët.

Kur Tush Sojani u largua, Dani tha:

— Ka pesë fëmijë. Dy të mesmit i ka çuar larg te një motër. Dy të vegjlit, — tregoi me sy nga vatra, — i heq pas vetes. Më të madhen ka Dijen. Ajo doli partizane pa lejen e Tushit. Ai e ndoqi prapa, e rrahu, por ajo nuk e dëgjoi. Tashti i ka mbetur peng në zemër. Është penduar që e rrahu.

— E kuptoj, — tha Xhako Rina. — Gjëra që ndodhin!

— Dija është trimëreshë, siç e tha vetë, e punon mirë mitralozin.

Te vatra fëmijët dëgjonin të flitej për motrën e tyre të madhe dhe ia bënëin të gëzuar vesh më vesh ps-ps-ps...

15

— Ja, ky është shoku komisar!

Hollë-hollë, Xhako Rina nuk ishte një vëzhgues i thjeshtë. Ai nuk shikonte, siç mund të shikojnë disa njerëz, por gjithmonë shqyrtonte, gjithmonë hetonte me ata sytë e tij pak të thellë, pak të vegjël e me ngjyrë të përhimë, që, nga reflekset e llambës me vajguri, dukeshin të bardhë, gati pa ngjyrë, por gjithmonë tërheqës e të ëmbël, të dashur e të afërt, sidomos për ata që e njihnin mirë. Dhe të zgjuar. Por atë çast sytë e Xhakos qenë fiksuar në fytyrën e të porsardhurit në mënyrë krejt të ndryshme e të befasishme

dhe ishin aq shumë të përqëndruar, sa ai nuk i ngjante më një vështrimi, por një kërcënimi, po se po një hetimi të thellë. I porsaardhuri uli sytë, uli kokën, si të qe trembur e të kishte frikë se mos vallë komisari i lexonte mendimet. Dhe qëndroi ashtu, si të ndiente se plakej në çdo sekondë që kalonte, por shpejt mori pamjen e një qeni të tërbuar në çastin kur bëhet gati të hidhet praptas. Dhe kjo ndodhi pikërisht kur dëgjoji akuzën që i bënte skuadërkomandanti:

— Ky surrat nuk i pranoi partizanët në konak. As bukë, thotë, nuk kam.

Xhako Rina shikoi nga këshilltar Dani. Këshilltar Dani lëvizi shkopin në shenjë kërcënimi.

— Bajazit aga Palla, i thonë, — tha ai.

Xhako Rinës nuk i pëlqyen sytë e shkruar, por të verdhë e të ngushtë, me një vështrim të zgjuar e të pakënaqur për jetë. të Bajazit aga Pallës. As duart e buta e të bardha. As mosha e tij e papërcaktuar midis të dyzetave dhe të pesëdhjetave. Asgjë nuk i pëlqeu tek ai, bile as buzëqeshjet e tij nazike, dhe kjo ndodhi edhe pse e mori zët që kur dëgjoji se i pranishmi ishte aga, ose pse kishte huqin që s'të shikonte drejt në sy. Dhe sa më i pashëm që dukej, aq më i urrejtsëm i bëhej.

— Na mbylli derën, — tha skuadërkomandanti.

— Sa dhoma ka? — pyeti komisari Danin.

— Pesë poshtë e pesë sipër, — tha Dani. — Ka edhe pesë të tjera të veçuara me shkallë më vete ku mban zahiretë!

— Kthehuni dhe vendosuni në katin e parë, — tha komisari.

— I zoti i shtëpisë jam unë, komisar, — foli Bajaziti me një zë të butë e gati miqësor.

Komisari shikoi nga skuadërkomandanti.

— Por mos bëni dëme, — tha.

— Jo!

— Pushtoni pra, dhomat e poshtme dhe flini!

— Po!

— Dhe pa zhurmë!  
— Zhurmë bën ai! — Skuadërkomandanti tregoi Bajazit aga Pallën.

— Ai le të bëjë!

— Mirë!

Komisari shikoi nga këshilltar Dani;

— Që nga ky çast, ato quhen dhoma të konfiskuara.

Tha Bajazit Palla po me atë zë të butë e gati me buzëqeshje:

— Nuk e kemi dëgjuar këtë fjalë dhe as e kuptojmë nga bie?

— Cilën fjalë?

— Konfiskim.

— Do ta dëgjosh edhe herë të tjera. Do ta dëgjoni të gjithë ju që keni ara, pyje, lumenj, male, bagëti, bletë e... çfarë tjetër akoma e që keni ditur ta dridhni gjatë luftës! — Tashti ishte komisari ai që nuk shikonte nga Bajazit Palla. I qenë neveritur sytë e tij, që shikonin poshtë, po edhe buzëqeshja, që sikur të kompromentonte për diçka.

— E kuptove ti, Dan? — pyeti ai pas pak.

— Po.

Shikoi nga skuadërkomandanti.

— Po ti?

— Fare bukur, shoku komisar! — tha skuadërkomandanti.

Xhako Rina shikoi prapë nga Dani.

— Në ato dhoma së shpejti do të jenë zyrat e këshillit të fshatit. Kështu, Dan?

— S'ka ku shkon më mirë, komisar! — tha Dani.

Pastaj komisari bëri një sforco dhe u kthye për herë të parë nga Bajazit aga Palla.

— Ç'ke për të thënë? — e pyeti.

— Erdhën vonë, — tha ai, — prandaj nuk i pranova!

— Ashtu, ë?! — U kthye nga partizanët që qëndronin prapa skuadërkomandantit e prapa Bajazit aga Pallës.

— Ku ishit ju?

— Ishim rojë! — tha skuadërkomandanti.

Ndërhyri Dani gati me një të kërcyer të shkopit e të trupit:

— Ku?

— Te shpella e Shkëmbit.

— Çfarë patë andej? — pyeti Dani.

— Qetësi, — tha skuadërkomandanti.

— A s'kishte derra?

— Jo, nuk pamë. Pamë zjarre të ndezura dhe dëgjuam teneqera!

Këshilltar Dani shikoi nga komisari. Unë kaq kisha, deshi të thoshte me atë shikim. Komisarit tregoi me dorë Bajazit Pallën dhe tha:

— Nisuni dhe sa më shpejt bile. Partizanët kanë nevojë të hanë e të çlodhen.

Bajazit aga Palla zbërtheu sërish një nga ato buzëqeshjet e tij nazike e të bardha. Tha butë:

— Të na kishit paralajmëruar, shoku komisar, pa e dija unë ç'do t'u gatuaja sonte partizanëve, megjithëse s'më janë kthyer robtë e shtëpisë.

Fjala «shoku komisar» në buzët e holla dhe nazike të Bajazit Pallës, iu duk Xhako Rinës sikur e kafshoi në grykë. I vërshoi një zemërim i ri kundër tij, që mezi e përmbajti, duke manifestuar një drithmë të brendshme, por të dukshme për të gjithë.

— Edhe atë të voglin, shoku komisar, që fle atje, të ma kishte dhënë mua ta mbaja disa ditë, se kam dorë të mirë për të gatuar gjellë. — Kështu foli ai, si të mos e kishte vënë re fare zemërimin e tjetrit dhe nuk e hoqi një copë herë vështrimin gati të përdëlyer nga Isë Brezari që gërhiste lehtë, sikur fluturonte, ndërsa dy fëmijët e Tush Sojanit thaheshin rreth vatrës dhe pëshpërisnin të gëzuar me njëri-tjetrin.

Nuk mund të dimë nëse vërtet sytë dhe vështrimi i Bajazit aga Pallës ngjasonin me sytë e gjarprit (apo ishte kjo një lojë e dritës së llambës), por ajo që mund të themi me siguri, është se komisarit të tillë i qenë dukur ata sy që në çastin e parë, të ndyrë, tinëzarë e të neveritshëm.

— As tashti që lufta mbaroi, shoku komisar, s'keni



ndër mend të bëheni më të butë!? — dëgjoi Xhako Rina pyetjen e matur të tjetrit.

Komisari dyshoi se Bajazit Palla jo vetëm që fliste me thumba tepër të maskuar, por ai sikur përpiquej ta vinte edhe në lojë. I foli pa e ndryshuar zërin e tij të zakonshëm, që e kishte njëtonësh dhe të butë prej natyre:

— Askurrë nuk do të zbutemi me ata që s'duan të na kuptojnë. Për ne s'ka mbaruar asnjë luftë! Bile fare së shpejti ne do të fillojmë një luftë të re kundër çdo gjëje që na ka lënë nëpër këmbë bota e vjetër!

Bajazit aga Palla s'lëvizi nga vendi, por dukej qartë që në të njëjtën kohë ishte edhe i zemëruar edhe i trembur. Fytyra e bardhë i qe zverdhur dhe i qe bërë e ftohtë si mermeri.

Xhako Rina shikoi prapë nga skuadërkomandanti.

— Sa partizanë ishin caktuar për të fjetur tek ai?

— Pesë!

— Dhjetë! — e rriti shifrën komisari. — Merre të gjithë skuadrën që ke prapa.

Skuadërkomandanti shikoi nga Bajaziti.

— E çfarë fitove, — foli ai, — Ore budalla, a e kupton ti se ç'përmbysje ka ndodhur në Shqipëri? Ç'më shikon ashtu si gjarpër nën gur. Ne s'u trembëm nga italianit e nga gjermanit e të trembemi nga zotëria jote, hajde marsh!

Para se të lëvizte nga vendi për t'u larguar, Bajazit Palla hodhi përsëri vështrimin nga Isë Brezari që flinte e gërhiste lehtë, pastaj tha:

— Unë i jashtëm jam. Luftën e bëtë ju dhe juve ju përket të vendosni. Jepni urdhër të bëhet kështu, kështu si thoni ju do të bëhet. Jepni urdhër të bëhet ashtu, ashtu si...

— Mjaft, ore ti... se jemi të lodhur e duam të hamë e të flemë, — ia priti skuadërkomandanti.

— Po deshe të dish se kush jam unë, shoku komisar, — tha Bajazit Palla, — pyet po deshe Dan Zavallin që ke aty pranë!

Khako Rina bëri vetëm një shenjë me dorë: «Zhduk!»

— Të shoh, o komisar, të shoh, — tha ai si me vete.  
— S'di ç'libra paske lexuar që sillësh kështu me popullin. Dan Zavalli na ka thënë të tjera fjalë!

— Po të jetë për Dan Zavallin, — foli për vete këshilltar Dani, — unë të kisha varur me kohë për gjuhe!

Një apo dy minuta më vonë, në oborrin e shtëpisë së Rubit, u dëgjua një thirrje e thekshme:

— Këtu qenke, o Bajazit aga?

Heshtje. Dhe çapitjet e skuadrës partizane, që ngjitej zhurishtës përpjetë monopatit drejt shtëpisë së Bajazit Pallës.

Zëri u dëgjua më i largët:

— O Bajazit aga, i shikon ti duart e fëmijëve dhe të gruas sime, që kanë dalë mbi varre e më thërresin?... A, si thua ti...

Zëri nuk u dëgjua më. As çapitjet monopatit përpjetë. Khako Rina pyeti:

— Ç'bëhet kështu, Dan?

— Nodhi para njëzet vjetësh, — tha këshilltar Dani, — që Bajazit aga Palla i mori tokat Turhanit për shkakun e një borxhi të stërgjyshit. E humbi i shkreti Turhan! Atë vit që plasi zia e bukës, këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë, Turhanit i vdiqën robtë e shtëpisë një nga një, nga e keqja e nga sëmundjet. I vdiq gruaja, dy vajzat e dy djemtë, më i madhi dhjetë vjeç. Dhe vetë u bë ja, as i mirë, as i keq, as hutaq, as i çmendur. S'merret vesh se ç'u bë Turhani. Por, të të them të drejtën, komisar, gjatë këtyre ditëve që jemi çliruar, ne të fshatit kemi vënë re se Turhani i është qepur keq Bajazitit. Pesëmbëdhjetë vjet që hyn e del nëpër shtëpitë tona, diku mëngjesin, diku drekën, por me sa duket nuk paska qenë fare i çmendur. Diçka ka kuptuar edhe ai, një ndryshim, një përmbysje, siç tha ai partizani pak më parë.

Khako Rina mbeti një copë herë i menduar, pa e hequr vështrimin nga opingat e mëdha të Danit, si dhe nga shkopi i tij me gëzhgjë në majë telk vazh-



donte të bënte figura nëpër dysHEME e që Xhakoja nuk i kuptonte më: as rrathë e as katrorë e as gjar-përinj të egërsuar. Ishte lodhur ose po lodhej këshilltar Dani. Po edhe Xhako Rina ishte lodhur dhe ashtu i lodhur nuk kuptohej, ku mund të rrihnin mendimet e tij në këto çaste, tek opingat e mëdha të Danit, te figurat që bënte shkopi i tij, te Turhani apo te Bajazit Palla, që sapo ishte larguar prej aty.

— Sahanlëpirës i parisë së Tiranës ka qenë dhe mbetet ai — tha këshilltar Dani, — por fjalën ta dredh për bukuri, si gomari i Zimit, kur pëllet!

— Ç'tjetër gjë di për të? — pyeti Xhako Rina.

— Këtu në fshat s'para është përzier me Ballin e Legalitetin. Bile edhe ndonjë fjalë të mirë e ka thënë për partizanët. Edhe ndonjë kilo miell e ka dhënë. Dhe i ka pritur. I themi ne, një dorë në kabuni, tjetrën në pilaf, se lidhjet e vërteta i ka atje në Tiranë me ata të parisë e të politikës, si e kanë quajtur veten.

— Do të kemi kohë të merremi me këta ndyrësira, Dan, patjetër që do të merremi! — tha Xhako Rina me zërin e tij të qetë niëtonësh. Dhe, po me atë zë, shtoi: — I kanë vrarë dhe i kanë çmendur njerëzit këta maskarenit!

Pastaj në dhomë ra heshtje, që thyhej nga kërcuri në zjarr, nga mbeturinat e karriges që digjej, nga gërrhitjet e lehta e të rralla të Isës e nga pëspëset e gëzuarara të fëmijëve të Tushit, që avullonin pranë vatrës.

Me sa duket, Xhako Rinës i pëlqeu kjo skenë nate dhe vendosi të shkëputej pak nga puna për raportin e betejës në Mushibë. Po, duke u shkëputur hëpërhë nga raporti, ai zbuloi se mendja dhe përfytyrimet e tij padashur nuk ishin shkëputur akoma nga ngjaria e fundit me Bajazit Pallën, pamja e jashtme e të cilit, se pse i kujtonte Xhako Rinës ndonjërin nga filozofët, kundër të cilëve kishte luftuar tërë jetën e vet, bie fjala, Karl Marksi, apo Frederik Engelsi, apo Lenini. Të vaktën të tillë i kishte pas menduar gjithmonë ata filozofë, të bardhë, të pavarur nga puna, me sy të ngushtë, të verdhë, të zgjuar e dinakë. Dhe prapë se si i erdhi, ose më mirë

të themi, nuk i pëlqeu fare, që ata filozofë, të cilët i kishte pranuar si armiq edhe Marksii vetë, të ngjnin me Bajazitin, e Bajaziti me ta. Kështu që edhe kjo figurë iu rrëzua, iu përdhos, iu bë pluhur e hi, dhe padashur mendoi me një gaz të brendshëm se në të ardhmen do t'i duhej të sajonte një tjetër pamje të përafërt për ata filozofë. Shikoi nga këshilltar Dani dhe tha me vete, mos duhet të jenë të ngjashëm, bie fjala, me Danin? (Veç hunda e shëmton ca Danin, ajo hundë e gjerë si prej dashi.) Dhe u çudit Xhako Rina se ku e gjente kohën të merrej me shakara kaq të kota, kur atij i vlonçe koka për raportin që duhej të ndodhej në Tiranë të nesërmen në mëngjes e për shumë gjëra të tjera. Por megjithatë ishte i ri Xhako Rina, njëzet e pesë vjeç dhe patjetër mosha do ta bënte herë-herë punën e vet. Tha:

— Dan, mos të ka thënë kush se pamja jote ngjan me filozofët idealistë?

Dani shkroi me majën e shkopit një figurë në dysheme. Kësaj radhe kishte bërë diçka më tepër, diçka që mund të ngjante vetëm me kapërthimin e njëqind gjarpërinjve bashkë.

— S'kuptoj gjë, — tha dhe sytë e tij shprehën çudi.  
— Ç'është ky filozof e ky idealist?

— S'ka gjë, jo, Dan, bëra një shaka.

— Ah, ju të rinjtë!

— Pikërisht! — dhe i buzëqeshi me aq dashamirësi, sa nga fytyra e Danit u zhduk çdo dyshim i rastit.

— E kishim fjalën te Bajazit Palla, komisar, — tha ai. — Ç'kemi hequr nga Bajaziti e nga agallarët e tjerë të fshatit!

— Disa gjëra i kam dëgjuar, por të tjerat i marr me mend ç'keni hequr. Të gjithë kemi hequr nga ata. Të gjithë kemi një të kaluar, Dan, që, sado e ndryshme goftë, në të njëjtën hulli vërtitet.

— Po, e besoj, — thë Dani i rënduar në fytyrë, si për t'u qarë hallin vetes, Xhakos dhe të gjithë të tjerëve të ngjashëm me veten e me Xhakon.



— Edhe unë kam pasur një aga fqinj, çifligar e tregtar bashkë, jo më i mirë se Bajaziti e agallarët tuaj

— E marr me mend. Të gjithë derrat një turi kanë, — tha Dani. — Po tashti, komisar, a s'erdhi koha ta ndezim edhe nga një?

— E ndezim, Dan!

16.

... Fqinji ishte një kokëtul, me fytyrë tërë dhjamëra, por me ca sy të bukur e me bisht, që të paktën, në sipërfaqe, dukeshin tepër të çiltër. I kishte hipur në kokë këtij fqinji të merzte shtëpinë e Kasem Rinës, në mos të gjithë, një pjesë të oborrit të saj, që ishte vërtet i madh, se të tillë ua kishin lënë stërgjiyshërit. Por shtëpia vetë ishte e vogël, gjithë-gjithë me dy dhoma, një zjarri e një gjumi, ku flinin ata të tre, babai, nëna dhe Xhakoja. Çatia dhe pemët e saj, thoshte ai, kokëtuli, më prishin pamjen e verandës, më errësojnë diellin, thoshte, më errësojnë vilën e më sëmurin djalin e vetëm me reumatizëm. Kështu thoshte Xhemë aga Tolluzi.

Por Rinët nuk bindeshin, oborri u duhej për vete, se, përveç poçave që bënte Kasem Rina, rronin disi duke shitur diçka edhe nga portokallet e pemët e tjera të oborrit.

Një natë të errët Kasem Rinën e gjetën pa ndjenja në një rrugicë aty pranë dhe po ashtu pa ndjenja e çuan në shtëpi. Tek shikonte fytyrën e zverdhur si të vdekur të të atit, Xhakoja i vogël fshihej prapa kurrizit të së

ëmës, e cila jepte e merrte me ujë e me uthull për të sjellë në vete të shoqin.

Sakaq, shtëpia që mbushur me fqinjë e midis fqinjëve kishte ardhur aty edhe ai, tregtari e cifligari kokëtul, që quhej Xhemë Tolluzi e që dukej tepër i pezmatuar për fatkeqësinë që kishte gjetur usta Kasemin, siç e kishin bërë zakon ta thërrisnin poçebërësin e qytetit. Bile ky Xhemë kishte ardhur bashkë me doktorin dhe që doktori ai që e solli në vete Kasem Rinën, i cili, me të hapur sytë, me të shikuar Xhemën, kafshoi buzën nga dhimbjet pastaj pyeti:

— Më paske ardhur për vizitë, Xhemë aga?

— Miku i mirë në fatkeqësi njihet, — tha Xhemë Tolluzi.

Usta Kasemi kafshoi prapë buzën nga dhimbja, zgjati krahn në vatrën e shuar, shtrëngoi këmbjen e hekurt e të rëndë dhe tha:

— A s'ishe ti që m'i theve të dyja këmbët?

— Unë?! — briti tepër i çuditur Xhemë Tolluzi.

— Ndërseve tre të tjerë kundër meje, kurse vetë qëndroje i fshehur prapa tyre! — Këto tha usta Kasemi, ngriti këmbjen dhe e lëshoi me sa fuqi mbi kokën tul të Xhemës.

Merret me mend që Xhema u përgjak, bile humbi ose bëri sikur humbi edhe ndjenjat (kjo s'ka rëndësi), pastaj e dërguan në shtëpinë e vet dhe nuk vonoi, pas një ore, ashtu këmbëthyer e të sflitur, usta Kasemin e hipën në një karrocë të shoqëruar me xhandarë.

Një gjysmë viti më vonë, Kasem Rina, që tashmë ecte me paterica, se këmbët ia kishin sharruar, u dënua me shtatë vjet burgim për tentativë vrasjeje, kurse Xhemës, që e kishte mbajtur kokën të lidhur nja dy javë, tashmë nuk i kishte mbetur veçse një shenjë e vogël mbi njërin vetull.

Pas ca kohe, e ëma e Xhakos zgjidhi cepin e shamisë, ku mbante ato pak para që kishte, mori Xhakon për dore, zuri një makinë dhe u nis për të parë të shoqin në burgun e largët. Atje pritën gjithë ditën. Në mbrëmje te porta e burgut u shfaq një oficer, i cili,



pasi i kontrolloi gruas pasaportën, i uli të dy ëmë e bir në një stol prapa disa hekurave. Në anën tjetër të hekurave u ndez një dritë e zbehtë dhe përmes asaj mjegullire u shqua fytyra e dobësuar e Kasem Rinës. I buzëqeshën njëri-tjetrit dhe mbetën një copë herë pa folur. Nën lëkurën e zverdhur të Kasemit dukej sikur qe shtrirë një sëmundje e ligë, e fshehtë e tinëzare. Por gruaja e mblodhi shpejt veten, e mblodhi pikërisht atëherë kur Xhakoja nxori një klithmë dhembshurie. Në fillim as ajo, as ai nuk dinin nga ta nisnin bisedën, mu sikur mendimet e tyre të ishin copëtuar nga hekurat që i ndanin.

— Sa është ora? — pyeti kot usta Kasemi.

— Dhjetë e mbrëmjes, — tha ajo. — Pritëm gjashtë orë derisa...

— Pusho! — bërtiti xhandari që rrinte ulur në një karrige prapa tyre. — Bisedoni për djalin që keni me vete!

— Si je, Xhako? — pyeti ai me ngashërim, duke shikuar nga i biri.

Xhako Rina shtrembëroi buzët dhe u fsheh prapa kurrizit të së ëmës.

— Mirë është, — tha ajo. — Të kujtojmë shpesh...

— Pusho! — bërtiti prapë me hakërrimë xhandari.

— Bisedoni për djalin tjetër!

— S'kemi djalë tjetër, — tha ai.

— Po këmbët? — pyeti e shoqja dhe kafshoi buzët e penduar.

Përtej hekurave i ati ngriti një patericë. Pastaj e uli. Dhe ngriti tjetrën.

— Siç e shikon!

— Pusho, — thirri vrazhdë xhandari. — Tashti bisedoni për gjerbat e shtëpisë dhe për farefisën.

— Baku vdiq, — u kujtua e shoqja.

— Kush është ky Baki? — pyeti xhandari.

— Baki Rina, mësues, — tha ajo.

— Nga se vdiq? — kërcënoi prapë xhandari.

— Nga veremi.

— A-a-a, mundet! — tha xhandari i zbutur. — Vëremit as naltmadhnia e tij s'ka çfarë t'i bëjë!

Ajo shikoi nga i shoqi dhe u pendua: më mirë të mos i kishte folur për vdekjen e të vëllait.

— E varrosën me nderime të mëdha, — tha ajo.

— Kur jsha për të fundit herë tek ai, — tha Kasemi, — më të shumtën e kohës e kalonte në kllapi. Një herë që erdhi në vete, më pyeti, si je vëlla, pastaj piu një gërqe konjak me stërmundim të madh, se i kishin thënë sikur gjoja konjaku do t'i ngordhte fluturat.

— E-e-e-e, — gogësiu i përgjumur xhandari, — ku ngordhin ato të shkreta! — Një çast më vonë xhandarit i qe varur koka dhe një gërhitje e lehtë i shpëtoi nga buzët.

Mbi tarracën e burgut kaluan hapat e patrullës, tek gërvishtnin çimenton me gozhdë. Në mënyrë të vetvetishme ata heshtën derisa hapat u larguan. Tashti dëgjohej qartë frymëmarrja e përgjumur e xhandarit prapa kurrizit. Duke u zgjatur pak përpara, ajo pëshpëriti:

— Më thanë shokët të mos dëshpërohesh, se nuk ke për të qëndruar shtatë vjet në burg. Mbretit po i vjen festja vërdallë, kështu më thanë shokët.

— E marr me mend, — tha qetë ai. — Unë pa këmbë jam, por gishtin e revoles mund ta tërheq. Do ta vras Xhemë Tolluzin sapo të dal i gjallë prej këtu!

— Cilin të vrasësh?... Cilin? — briti me acarim prapa krahëve xhandari, që sapo ishte zgjuar. — Biseda politike, ë, hajde jashtë!

Khako Rina mundi të shikonte edhe një herë fytyrën e dobësuar të të atit e të dëgjonte zërin e tij, tek i thoshte së ëmës:

— Shit ç'të mundësh, sa për të jetuar!

Tek prisnin të dy ëmë e bir që të hapej porta e burgut e të dilnin në rrugë, hapat e patrullës trokitën sërish nga fundi i tarracës dhe Xhakos i bëhej sikur ata hapa do t'ia shtypnin të atin dhe ai nuk do ta shikonte kurrë më.

Kur dolën në rrugë, befas e ëma u shkreh në vaj.



Xhakoja, sado i vogël që ishte, e kuptoi pse qante e ëma. Gjatë vitit të parë, që i ati ndodhej në burg, Xhema Tolluzi ua kishte rrëmbyer gjysmën e oborrit, u kishte marrë shtëpinë me dy dhoma. (Xhakoja kishte dëgjuar të flitej për një gjyq të padrejtë) dhe tashti ata jetonin në magazinën e vjetër në fund të oborrit, ku kishin pasë mbajtur leckurina e ku nuk shikonin diell me sy, sepse Xhema u kishte ngritur përpara një mur më të lartë se magazinja. Por e ëma nuk i kishte thënë asgjë të shoqit për të gjitha këto. Dhe tashti qante. Xhakoja e shtrëngoi në bërryl. Ajo i vuri dorën në kokë. Ai tha:

— Mos qaj, nënë, se do t'ia ndreq unë samarin Xhema Tolluzit kur të rritem edhe pak!

— Ti duhet të shkosh në shkollë një herë, pastaj...  
... Pastaj, pa mbushur mirë tre vjet, usta Kasemi u kthye befas në qytet mbi një karrocë ushtrie. E kishin liruar. Dhe Xhakoja u gëzua, siç do të gëzohej çdo fëmijë, por nëna jo, ajo nuk u gëzua aspak, sepse, me sa dukej, ajo dinte diçka më shumë se Xhakoja. Dhe vërtet, një javë më vonë, ndërsa ai kthehej nga shkolla (tashti Xhakoja bënte klasën e tretë fillore dhe ishte dhjetë vjeç), pa të ëmën dhe shumë gra të tjera, tek rrinin si të gërmuqura mbi kokën e të atit. Atëherë u afrua edhe ai dhe, midis shpatullave të tyre, shqoi fytyrën e të atit, që iu duk si fytyra e një të vdekuri. Njërin faqe (atë që kishte zënë poshtë) e kishte të skuqur, me një skuqje të purpurt prej ethesh, tjetrën faqe e kishte të bardhë si kartë a si farfuri, me një lëkurë të dystë, si të diegër, pa pore, pa gjak, të ndritshme, edhe ajo nën ndikimin e etheve të vazhdueshme, por në një mënyrë tjetër. Nga thellësia e zgavrave të tij shikonin dy sy të zinj, si dy copa të shuara qymyri. E gjithë fytyra i ishte mbushur me zgavra, në faqe e kudo, bile edhe vrima që kishte pasur në majë të mjekrës, tashti i qe shndërruar në një zgavër të zezë.

Ai e shikoi Xhakon me sytë e thellë dhe Xhakoja e kuptoi se të atit i kishte ardhur fundi. Atëherë, sytë e Xhakos u ngulën te recetat në qoshe të vatrës së

*shuar, me gurin e vogël përsipër, po me atë gur që ia kishte vënë ai vetë disa ditë më parë, me shpresë se diçka do të bënin për të sëmurin, sapo të kishin gjetur ca para. Tashti gjithçka kishte marrë fund, tash-ti ata rrinin të gjithë të heshtur dhe dukej sikur shikonin fshehtas njëri-tjetrin.*

— Është në kllapi! — pëshpëriti e ëma.

I sëmuri lëvizi dhe sikur u zgjua, sikur dha shenja se e kishte njohur të birin, por vetëm kaq. Ishte tepër i ligështuar për të thënë një fjalë, tepër i sflitur, tepër mospërfillës për gjithçka që e rrethonte e për gjithçka që shikonte përtej mjegullës të syve të shuar.

— Mbahet me zor! — pëshpëriti e ëma. Kishte kohë që për të atin e për sëmundjen e tij flitej me zë të ulët, ashtu siç është zakon të flitet vetëm përpara kufomave.

Erdhi një çast, që, befas, sytë e të sëmurit shpërehën kthjellim e qartësi të plotë. Ai sikur u gjallërua dhe në çastin tjetër, me ndihmën e së shoqes, nxori nga poshtë jastëkut një shishe konjaku dhe, me gjeste prej fëmije, ia tregoi të birit për t'i hequr tapën dhe po me ndihmën e tij, ktheu një gërqe koniak. Nga shtrembërimi i fytyrës. Xhakoja vuri re se ai e pinte konjakun jo nga dëshira, por i shtyrë nga një zell që e stërmundonte.

Duke bërë një pushim pas çdo fjale e duke ndarë çdo fjalë në rokje, ai tha:

— Një shok më porositi të përdor konjakun në mungesë të ilaçeve. — Ai i hodhi sërish Xhakos një nga ato vështrimet e tij të verdha. — Konjaku, më tha ai shoku, të jep fuqi e të ngordh fluturat e mushkërive! — Kaq munda të thoshte i ati dhe, nën efektin e konjakut, që sapo kishte pirë, ra sërish në një nga ato kllapitë apo dremitjet e tij.

Atëherë Xhakos iu kujtua se, tre vjet më parë, i ati fliste me dhimbje për të vëllanë, që, në mungesë të ilaçeve, pinte konjak e me shishen e konjakut nën jastëk kishte vdekur. Tre vjet më vonë, ashtu vdiq edhe i ati, me shishen e konjakut nën jastëk...



— Të paska vdekur herët babai! — tha Dani dhe sytë i kishte të pikëlluar.

— Herët, — tha Xhako Rina me gjurmët e kujtimeve të hidhura në fytyrë.

Që nga minderi, Dani i hodhi Xhakos një cigare tjetër.

— Ndize, komisar, se duhani ta përmbledh mendjen! — dhe e ndezi për vete me shkrepëse. Me shkrepëse e ndezi edhe Xhako Rina. Dhe një copë herë pinë duhan në heshtje.

— Domethënë jua morën shtëpinë! — tha këshilltar Dani, si të fliste me vete.

— Na e morën dhe unë me nënën u mblodhëm te magazja.

— Atje rron edhe sot?

— Atje. E meremetuam disi.

— Po si rronit pas vdekjes së babait?

— Ashtu, rram-bam. Nëna punonte në tezgjah. Unë mbarova filloren dhe në moshën dymbëdhjetëvjeçare u futa në shkollën qytetëse.

— Edhe neve kësaj nahlie na kanë marrë shtëpi e kasolle e na kanë nxjerrë jashtë në pikë të dimrit me fëmijë, me laçkë e me plaçkë. Edhe neve na kanë vdekur fshatarë burgjeve nga veremi ose janë kthyer e kanë vdekur në shtëpi. Kanë shkuar edhe bedel për të tjetrët. Njëherë u ngrit një aga dhe vrau një aga tjetër. Për ta mbyllur këtë çështje, xhandarmëria ngarkoi me faj dy fshatarë të pafajshëm dhe një ditë i varën të dy te sheshi i xhamisë, këtu në mes të fshatit! — Këto tha Dani dhe fytyrën ia mbuluan sërish kujtime të rënda. — Ka qenë kohë e keqe, jetë plot vuajtje, si në qytet edhe në fshat! — shtoi ai. — Po nuk më the, ç'u bë pastaj me ju e me Tolluzët?

— Xhemë agai, vërtet e quanin Xhemë, por djalit

të vetëm i kishte vënë një emër të ri, Albert. Ky Albert ishte pesë vjet më i madh se unë, pesëmbëdhjetë vjeç, me një trup të gjatë e shumë të fuqishëm. Kur u ktheva nga varrezat, më kërceu në kokë të merrja hakun e babait. Ai ishte ulur te guri në anën e portës së vet dhe më shikonte, si të thuash, edhe me shpoti, edhe me keqardhje. Unë prita sa të largoheshin burrat e xhenazes, që, sipas zakonit, po ktheheshin në magazin tonë. Befas iu hodha në grykë. Më kujtohet se lotët më rridhnin çurg nga hidhërimi për babanë e sapovdekur e nga zemërimi për Albertin e nga gjithë ajo farë, që ishin shkaktarët e fatkeqësisë sonë. Çështë e vërteta, Alberti më mbajti fort përkrahësh e më këshilloi të mos grindesha me të, se ai ishte më i madh e do të më bënte lakër. Por mua më dilnin para sysh patericat e babait, burgu, veremi, shishja e konjakut e pastaj varri, më dilte para sysh vetë Alberti, që, kur na nxorën nga shtëpia, hipi mbi çati dhe, duke fishkëlyer e duke kënduar, hodhi poshtë të gjitha tjegullat, sepse Tolluzët e shembën shtëpinë tonë, pasi u duheshin oborri dhe dielli. M'u kujtuan të gjitha këto dhe ashtu siç isha hundë më hundë me të e godita befas me shkelm aty ku s'rrëfeket me gojë. (Dani: Shiko, shiko!) Pastaj m'u kthye ai e, të të them të drejtën, Dan, më bëri lakër. Në fillim më dha ca grushte në fytyrë. Më plasi gjaku nga hunda e nga goja. E shikon këtë stërdhëmb, ai ma ka shtrembëruar. Pastaj zuri të më përplaste kokën pas murit. Kur unë u trullova dhe rashë në gjunjë, ai, duket nga dhimbja që ndiente akoma aty ku s'rrëfeket me gojë, më shtriu përtokë dhe, me gjithë peshën e tij, se Alberti, siç të thashë, ishte i ngjallur dhe shumë i rëndë, më hipi në gjoks, në bark, më ktheu përmbys e më hipi në kurriz e më goditi ku mundi e sa mundi, derisa unë s'isha më në gjendje as të merrja frymë. (Dani: pa-pa-pa!) Kur u kthyen burrat të më kërkonin pas ca kohe, më gjetën në gjunjë e me kokën të mbështetur pas murit. Unë isha përpjekur të ngrihesha në këmbë, se më vinte, turp të më gjenin të shtrirë, por s'kisha mundur të ngrihesha veçse në gjunjë. Dikush, që me



sa duket na kishte parë, u tha ç'kishte ndodhur midis meje dhe Albertit, pastaj mbaj mend që më hodhën në krah e më çuan në magaze. Edhe sot më bëhet sikur e dëgjoj zërin e nënës që tha, ç'na gjeti, ku u dilet Tolluzëve! Njeriu një herë lind e një herë vdes, tha njëri nga dajallarët e mi. E di ti, motër, se e gjetëm në gjunjë, ngaqë nuk kishte dashur t'i nënshtrohej të birit të Xhemës? Nuk më kujtohet mirë, por e di që u dergja gjatë, ndoshta tre muaj e më shumë se tre muaj, me kokë, krahë, këmbë e brinjë të lidhur. (Dani: Ty-ty-ty!) Pastaj dola dhe shkova prapë në shkollë. Brenda atij viti u rraha edhe tri herë të tjera me Albertin. Tri herë u dergja prapë me kocka të thyera. Vila e Xhemë Tolluzit kishte një dritare nga ana e rrugicës dhe aty nga ajo dritare, Xhema qëllonte shpesh të na shikonte kur ne ziheshim. Kur Alberti më vinte përpara, ai thërriste, bjeri, Albert, ashtu, spërdridhja krahun, jepi një shkelm në bark, ha-ha-ha, qeshte ai më se i kënaqur. Dhe thoshte, ku është dëgjuar që i vogli të mundë të madhin? Bjeri derrkucit, ta marrë vesh mirë se ne jemi të fortë, ata janë raja e tërë jetën do të zvarrisen nëpër këmbët tona. Për dy vjet me radhë vazhduam të rriheshim keq. Sigurisht, Alberti dilte gjithmonë fitues. Një herë më thyente një gisht, një herë më ndrydhte një krah. Unë dergjesha shpesh në dyshek dhe nëna qante, se kishte frikë mos mbeteshja sakat. S'kam gjë jo, i thosha unë. Ajo më shikonte në heshtje, se i dinte e i kuptonte të gjitha, pastaj më pastronte plagët e më lyente nuk e di me çfarë melhemesh. Unë nuk doja që ajo të shkonte te fqinji ynë, të lutej, të ankohej për mua e të përulej. Dhe ajo nuk shkoi kurrë atje. Sapo shërohesha, sapo shikoja Albertin, ktheja rrugë dhe bam, i hidhesha në grykë. Ai, si gjithmonë, më këshillonte, përmbahej e përpiqej të largohej, se atij, me sa duket, i qenë mërziur këto grindje, ose, ku ta dish, ndoshta i vinte edhe keq për mua, por unë i qepesha si mace dhe hajde-e-e. Ai prapë më rrihte. Pastaj më thoshte, shko rritu. Do rritem, i thosha unë. Po unë nuk u rrita shpejt. Kur mbusha dymbëdhjetë vjeç, atë ditë

që po largohesha nga shkolla fillore për të vazhduar mësimet në qytetëse, mësuesi, që e dinte hallin tim, më vuri përpara një libër të vogël e më tha: Dëgjo, Xhako, ky është një libër ushtrimesh gjimnastikore. Po të bësh siç thotë ky, do të të forcohen muskujt dhe... e kupton vetë ti. Dy vjet të tjerë, për aq kohë sa mësova në shkollën qytetëse, unë vazhdova të rrihesha e të mundesha nga Albert Tolluzi. Dy vjet me radhë unë bëra siç thoshte libri dhe, kur mbusha katërbëdhjetë vjeç e kur u largova përgjithmonë nga shkolla për t'u futur praktikant pa pagesë në shtypshkronjën e qytetit, atëherë mbaj mend që iu futa vençe Albertit. Kështu, pra, Dan, mund të them se pas katër vjetësh që kapesha me të e që rrihesha nga ai, katër vjet gjak e plagë nëpër trupin tim, balanca e ndeshjeve sikur pësoi disa ndryshime. Në fillim ky ndryshim mezi u vu re. Bie fjala, një ditë, në fund të ndeshjes edhe hunda e Albert Tolluzit ishte përgjakur. (Dani: Ho-ho-ho-ha-ha-ha!) Më vonë u dukën të tjera plagë në ballë e në faqet e tij, derisa njëra nga betejat përfundoi me humbjen e tij të plotë. Kjo ndodhi në vitin e pestë të ndeshjeve tona. Me sa duket, mosha dhe libri i ushtrimeve, po edhe puna në shtypshkronjë, megjithëse fillestar, kishin bërë të tyren. Alberti ishte vërtet më i mbushur se unë, në pamje dukej edhe më i fuqishëm, unë po, i hollë, bile edhe pak i kërrusur si gjithmonë, por tashmë i gjatë sa Albert Tolluzi. Tashti isha unë që e rrihja dhe i shkaktoja plagë në fytyrë e kudo. Por megjithatë, atë ditë që mbeti i shtrirë për herë të parë, ai tha me një fije zëri se, po të mos i kishin rrëshqitur këmbët, nuk do ta kisha vënë kurrë poshtë. Por Albertit i rrëshqitën këmbët edhe herë të tjera, ai u rrëzua edhe herë të tjera dhe erdhi puna deri aty sa, kur më shikonte mua, gjithë ai katana i madh, me ato derro shpatulla, trishtohej një hop, hapte sytë i tmerruar, pastaj zbrapseej, ndërronte rrugë dhe kthehej andej nga kishte ardhur gati me vrap. (Dani: Ho-ho-ho-ha-ha-ha!) E rraha disa herë gjithë atë vit, por ai heshtte, nuk i tregonte askujt, se i vinte turp,



as ndihmë nuk kërkonte nga shokët, as prita tinëzare nuk bënte, as të tjerë nuk paguante, siç e kishin zakon sëra e tyre. Pastaj, kur unë mbusha të pesëmbëdhjetat, ai të njëzetat, secili nga ne shkoi në punë të vet, ai në shkollë e unë në shtypshkronjë e më vonë unë partizan e ai ballist e pastaj spiun i gjermanëve.

— Dihet, ai stan atë bulmet jep! — tha Dani. Tha prapë: — C'më kënaqe, komisar. A i dinë partizanët vuajtjet e tua?

— Jo, nuk i dinë, por dinë të vetat. Të gjithë me vuajtje jemi rritur. Të gjithë kemi pasur mbi kokë Tolluzë e Bajazitër!

— Mirë e the, — tha Dani.

Dhe pastaj ata heshtën. Dhe u duk që secili u mor me punët e veta. Xhako Rina me raportin. Dani me mendimet e me lëvizjet e shkopit e me qëndrimin mikpritës të zotit të konakut.

Në dhomën ngjitur apo në dhomën tjetër të Rubit u bë zhurmë partizanësh. Jo më kot këshilltar Dani ia kishte qarë hallin komisarit. Do të të bëjnë zhurmë, i kishte thënë ai. S'ka gjë, kishte thënë komisar, mua më vjen keq për teze Rubin. që do t'i duhet të mbaië me bukë dhjetë partizanë. Si gjithë të tierët e si gjithë kohën e luftës, i ishte përgjigjur Dani.

Aty përtej murit dëgjohehin njëzet këmbë tek rrihnin dvshemenë e dhjetë zëra të gjallë e të gëzuar, mbi të cilët zotëronte zëri i ngjeshur i Kozma Petit, që ishte komandant i kompanisë së shtabit.

Ata sapo ishin kthyer nga shërbimi i rojës.

Pasi pat kaluar një kohë e giatë, kur partizanët aty përtej murit matën heshtur disi e komisar pat shkruar shumë e Dani që menduar shumë, befas, ky i fundit tha:

— Pra, komisar, s'dolën gjë fjalët që thoshte Xhemë Tolluzi nga dritarja, kur iu shikonte që rriheshit, se i madhi e mund gjithmonë të voglin. Ja që edhe i vogli e mundka të madhin, ë?!

Dera e dhomës së zjarrit u hap ngadalë, si nga një dorë e pastërvitur dhe e pafuqishme fëmije. Më parë u dukën ca flokë çilë, pastaj një dorë e bardhë ushtaraku të huaj, që, sado e përlyer me baltë, ajo mbetej gjithmonë e bardhë. Drita e kandilit pranë gllanikut u drodh, gati u shua, gjermani u fut shpejt brenda dhe po aq shpejt tërhoqi derën prapa vetes.

Rubi u hodh në këmbë, u zbraps deri në fund të dhomës, dhe, pa e hequr vështrimin nga gjermani, zuri bishtin e një naxhakeje, me të cilën çante dru në dimër. Por gjermani, pa hedhur hapin e dytë, më parë hodhi pushkën. Dhe në çastin tjetër Rubi e ngriti pushkën nga toka, e shikoi me dyshim, si të shikonte një bombë, nga ato që mbanin çunat në brez (e që Rubit i kishin ngjallur gjithmonë një ndjenjë pasigurie), pastaj shikoi prapë gjermanin. Ai, megjithëse i sfillitur, dukej i ri dhe në të vërtetë i ri ishte, përderisa faqet i kishte të mbuluara akoma me një push të verdhë, të përfaqërt me të zogjve të pulës, kur sapo dalin nga veza. Dhe jo aq i zhvilluar nga trupi, po se po më i shkurtër se Rubi (që ishte grua e gjatë), ndërsa sytë i kishte edhe ato pa ngjyrë, siç kishte qerpikët e vetullat, dhe, tek qëndronte mbi prag, të dukej si një fëmijë i rritur, që e kanë veshur gabimisht ushtar. Pastaj ajo shikoi supet e jakën e gjermanit dhe, meqë nuk vuri re asnjë shenjë që të kishte hequr gradat (siç kishin bërë shumica e oficerëve ato ditë), foli me vete:

— Hë-ë, qenke safi ushtar!

Jashtë ishte errësirë dhe heshtje. Veç rosave në qiell, bufëve në pyll dhe kukuvajkave në çati e majë minares, asgjë tjetër s'pipëtinte.

Befas, Rubi lëvizi shulin dhe i futi pushkës një fishek në gojë.



— *Nein, meine Mutter!*)

Rubit iu drodh pushka në dorë.

— Çfarë the?! — briti e pyeti ajo. — Më shave?!

Gjermani e shikoi i hutuar, me pamjen e njeriut që nuk e priste nga një grua e tillë të mbushte pushkën, nuk e priste as një britmë e një ashpërsi të tillë nga një grua gati e thyer në moshë, siç ishte Rubi. Pastaj, si të qe kujtuar se ajo e kishte pyetur dhe si ta kishte gjetur edhe për çfarë mund ta kishte pyetur, tha:

— *Nein, meine Mutter!*

Të sharën ia kishte dëgjuar dy herë Rubi, por që të dyja herët, ashtu si zërin dhe fytyrën, edhe sytë e vështrimin ia kishte kuptuar ndryshe gjermanit. Gjithçka tek ai dukej sikur lutej, sikur kërkonte mëshirë dhe gjithçka tjetër mund të dukej, por vetëm e sharë jo.

— *Nein, meine Mutter!*

— Hë-ë, — tundi kokën pas pak Rubi, si e çliruar nga një e keqe e fshehtë, — kujtova se të kishte kërcyer në kokë që të më shaje!

— *Nein, meine Mutter!*

— Nuk të vras, jo, — tha ajo. Dhe e shau: — Pulisht gomari! Një shokun tënd gati e vrava ca kohë më parë, se e kishte mbushur kupën, por ty jo!

Një copë herë heshtën, pa e hequr vështrimin nga njëri-tjetri. Pastaj gjermani bëri një shenjë me dorë. Që nga ai çast midis tyre sikur u ndeh ura e një mirë-kuptimi.

— Uria të paska bërë një dorë njeri, pulisht... gomari. Ulu aty dhe ngrohu, — tha Rubi.

Gjermani e kuptoi, u ul dhe u ngroh, me duart gati në flakët e zjarrit. Rubi i solli bukë misri avulloshë, djathë, qepë dhe i mbushi një gotë me çaj. Ai hëngri shpejt e me uri. I hëngri të gjitha: bukën, djathin dhe qepën. Dhe çajin e piu. Dhe Rubi i vuri sërish bukë për herë të dytë e për herë të tretë. Pastaj mori pushkën në dorë.

---

1) — gjerm. — Jo, nëna ime!

— Pa ngrehu tashti, gjerman! —tha ajo me fjalë e me shenja.

Gjermani u grrit, u zverdh dhe tha:

— *Nein, meine Mutter!*

— Nuk të vras, jo, — tha ajo. — Po ec përpara, se fashist je, i pabesë je, pulisht gomari je!

Gjermani eci.

Rubi thirri:

— Gjerman!

Gjermani qëndroi.

Rubi këputi një copë bukë të ngrohtë nga çerepi dhe ia futi në xhepin e kapotës. Për herë të parë gjermanit i qeshi fytyra dhe atëherë ai u duk se ishte fare i ri, më i ri nga sa qe dukur. Kur buzëqeshi dhe kur zbuloi dy dhëmbët e parë, që i kishte të bardhë, të vegjël e të rrallë si të fëmijëve, Rubit iu turbulluan mendimet (ndoshta iu kujtuan dhëmbët e së bijës) dhe ndjeu një peshë të rëndë në shpirt.

— Ruaje bukën, — foli kot ajo, si për të mposhtur mallëngjimin për të bijën, — se kushedi kur të fut në forcë Kozma Peti. Ec përpara.

Gjermani eci, duke shikuar me keqardhje nga zjarri që bubullonte në vatër. Dhe bëri një shenjë me dorë.

— Ec, ec, tepër që m'u fute në shtëpi, tepër që të ula edhe në vatër, të ngroha, të ushqeva, por dashke edhe të flesh, zotrote. Ec, ec!

Gjermani eci.

Rubi thirri:

— Gjerman!

Gjermani qëndroi.

— Po pushkën, zotrote, mua do të ma lësh në dorë? E di ti ç'thotë komisari?? Tashti që jemi pushtet popullor, çdo gjë që është e luftës, duhet të shkruhet në defter e të mbyllet në depo. Kështu ka thënë komisar. (Gjermani u drodh, u zverdh dhe u step).

Pas këtyre fjalëve, Rubi hodhi mbi supin e vet vezmet me fishekë, i hoqi shulin pushkës, e futi në xhepin e xhakatës dhe pushkën ia vari gjermanit në qafë. Pas-taj tha:



— Ec përpara, pulisht... gomari!

Dhe ecën.

Kur qenë në mes të oborrit, Rubi tha:

— Jo andej, andej është komisari. (Gjermani u drodh.) Komisari ka punë të tjera, s'ka hallin tënd. Te Kozma Peti do të të çoj. Ai merret me robërit. Dhe mos ki frikë, se ma ha mendja, nuk do të të vrasin. S'besoj të kesh bërë krime. Kaq i ri. Ec përpara!

Gjermani eci.

Në skaj të oborrit, para shkallëve të dhomës ku ndodhej Kozma Peti me shokë, Rubi tha:

— Gjerman, duart lart!

Për instinkt të valëve të zërit, a kushedi për ç'arsye, gjermani e kuptoi urdhrin e Rubit dhe ngriti duart!

— *Nein, meine Mutter!*

— Nuk të vras, jo, pulisht, — tha Rubi dhe fitili i kandilit u drodh në duart e saj. — Tashti që u mundët, u bëtë si delet, por ujq jeni, sa të nuhatni pak erën e gjakut, i ngrini përsëri veshët përpjetë, se ujku qimen ndërron, por jo zakonin. Duart lart!

Dhe gjermani eci me duart lart. Eci dhe sikur i besoi.

Dy minuta më vonë, Kozma Peti e shikonte gjermanin i ngrysur, i pakënaqur dhe tërë inat.

— Rini e Hitlerit, kështu quheshin këta balashë, — tha ai. — Uli duart!

Pastaj Kozmai u kthye nga Rubi, fytyra e së cilës ndriçohej dhe errësohej, skuqej e nxihej nga përpëlitjet e fitilit të kandilit që gati shuhej e prapë ngrihej sipas tekave të erës së nëntorit dhe po ashtu i ngrysur dhe i pakënaqur, dëgjonte Rubin, se si gjermani që futur në dhomën e saj e qe dorëzuar vetë. Kozmai tha:

— Mirë, Rubi, ti e bërë tënden. Shko e çlodhu, se nata është e lagësht e të mbërthen reumatizmi. Tashti do ta çoj vetë balashin te të tjerët në vathë.

— A ke shokë të tjerë? — e pyeti studenti, që ato ditë bënte edhe punën e përkthyesit.

— *Nein!* — tha gjermani i ri dhe e tha në mënyrë të tillë që e besuan të gjithë.

Rubi u zmbraps, duke mbrojtur kandilin me dorë nga vrullet e papritura të erës, por befas qëndroi dhe tha:

— Jo në vathë!

— Po ku? — pyeti Kozmai.

— Nuk e shikon sa i ri është e si dridhet?

Kozmai e shikoi sërish me vëmendje gjermanin dhe thartoi fytyrën, si të kishte shqiptuar fjalën «balash».

— I ka hyrë të ftohtët në palcë, — tha Rubi.

— Mirë, do ta çoj te konaqet e Bajazit Pallës.

— Atje çoje.

— Shko dhe fli, Rubi, se u bë vonë.

— E ku më zë gjumi mua, po nuk fjetët ju!

— Natën e mirë!

— Natën e mirë, — ia ktheu Rubi dhe u tërhoq, por, kur qe në mes të oborrit, pyeti studentin për fjalët që i kishte thënë gjermani dhe studenti i tha:

— Të paska thirrur, nëna ime! *Meine Mutter*, që do të thotë, nëna ime.

— Ah! — klithi mbytur Rubi dhe të gjithë e vunë re tronditjen dhe ngashërimin që e pushtoi. — Dhjetë vjet që s'më ka thirur njeri nëna ime, — tha ajo, u kthye mbi thembra, vrapoi, fitili i kandilit kërciti dhe u shua në mes të oborrit.

— Këta dreqër, — tha Kozma Peti duke shikuar nga gjermani, — edhe kur bëhen ose hiqen si dele, gjithnjë për keq janë. Ku vajti dhe i kujtoi të bijën!



Isë Brezari, që mund të ishte zgjuar nga zhurma në dhomën fqinjë, po shkrepse zjarrin me qëllim që të thante sa më shpejt dy të vegjlit. Nga rrobat e tyre ngrihej akoma avull.

— Si të quajnë ty, shoku partizan? — pyeti djali pesëvjeçar.

— Isa, por më thërresin Isë. Po ty?

— Hasan!

— Can, thuaj, — bëri shaka Isa.

— Can më thërresin, — tha ai.

Vajzës trevjeçare i koteshin sytë për gjumë. E ulur buzë vatrës, ajo kishte futur në gojë gishtin e madh të njërës dorë dhe me gishtin tregues të dorës tjetër rrëmonte syrin e Isës. Isës i pëlqente kjo guduli, prandaj zgjatej me qejf drejt saj, por, meqë vajza s'duhej të flinte pa u tharë, e pyeti:

— Po ty si të quajnë?

— Shegë, — tha ajo.

— E ëmbël apo e thartë?

— Sh'e di, — tha ajo dhe ngriti supet me seriozitet. Cani vuri gishtin te revolja në brez të Isës.

— Shoku partizan, a do të më japësh edhe mua një revole?

Llu-llu-llu, dëgjoheshin buzët e Shegës tek thithnin gishtin.

— Duhet të bësh luftë, që ta fitosh revolen, — tha Isa.

— Tata tha se lufta mbaroi!

— Jo, s'ka mbaruar, — tha Isa me seriozitet. Shikoi nga komisari që shkruante mbi tavolinë dhe tha me zë të ulët: — E di si tha sot komisari para brigadës partizane?... Tashti do të fillojë një luftë e re.

Shega, pa e hequr gishtin nga goja, zuri të qante, si ta kishte pasur vajin në majë të buzëve.

Gjelmani është i keq! — tha ajo.

Shegë, s'ka më gjermanë, — e mori me të mirë  
të... — Ajo do të jetë një luftë pa gjermanë. Kur të  
mritesh, do ta kuptosh e do ta bësh vetë atë luftë. Si  
te të them unë i shkreti. Ja, derri del në errësirë nga  
terra, që të hajë misrin në arën e babait tënd. Babai  
yt, si e quajnë babanë tënd, Shegë?

Ilu-llu-llu...

Tush, — tha Cani.

Babai yt merr një shufër dhe i thotë derrit, ku  
shkon ti, qelbanik? Unë dua të ha misrin në arën tënde,  
përgjigjet derri. Misrin e kam për Shegën e për Ca-  
ni. Na-a-a, ta tregoj unë ty misrin, dhe varda me  
shkop kokës.

Hi-hi-hi, qeshi Shega, pa e hequr gishtin nga goja.

— He pra, shoku partizan, — tha i pakënaqur Cani,  
më jep një revole si tënden!

Zjarri digjej. Fëmijët avullonin. Dani dëgjonte fëmijët,  
dridhte cigare dhe i fuste në kuti. Komisari shkruante,  
Buzët e tij, të modeluara pak shtrembër, sikur po kthe-  
heshin në vendin e tyre. Po i rridhte dora. Tashmë!

Jashtë fryu një gulsh ere. Një gjethe e tharë fiku  
fëshfëriti nëpër oborr. Ca kokrra të imëta shiu çukitën  
në xhamin e dritares. Në të vërtetë ai s'ishte shi, nuk  
ishte as qëmtim, as sqotë. Vetëm pika të rralla e të  
imëta.

Tak-fak, tak-fak, si t'u bënte iso atyre pikave,  
Dani kaloi përmes dhomës, qëndroi me majat e opingave  
buzë vatrës, dhe, pasi ngeci dorezën e shkopit në jakën  
e xhaketës, ia bëri Isës me shenjë, pastaj i tha edhe  
me fjalë:

— Abetaren, shoku pionier!

Isa, i cili e kishte mbyllur me kohë abetaren (qëkurse  
shoku i shkoi të bënte rojë) e që hëpërhë kishte mbyllur  
edhe broshurën e nuk lexonte më, nxori abetaren nga  
nënjastëku dhe ia zgjati. Drejt në këmbë si qiri (me  
shkopin të ngecur te jaka e xhaketës), me një cigare  
në njërin vesh, me flakët e zjarrit që i skuqnin fytyrën  
e që i krijonin dritë e hije në sy, në faqe, në mollëza

e kudo, këshilltar Dani shfletoi abetaren nga faqja e parë tek e fundit. E shfletoi ngadalë dhe gjatë, duke menduar e gati duke bërëbëritur me vete mbi çdo shkronjë e skicë, pastaj e mbylli me zhurmë dhe tha:

— Me bojna!

— Me bojna, — tha Isa pas pak.

— E gjitha me bojna! — përsëriti Dani, i dha abetaren Isës (Isa e vuri nën jastëk) dhe, pasi shikoi me dhembshuri të dukshme Canin e Shegën që avullonin, u kthye (tak-fak, tak-fak) në minderin e tij, pikërisht aty ku kishte ndenjtur ulur tërë mbrëmjen. Atje zgjati përpara opingat e mëdha, shtriu si zakonisht edhe shkopin midis tyre dhe mori cigaren nga veshi. Por nuk e ndezi. E vuri prapë në vesh. nxori nga brezi i brekusheve të zeza kutinë e duhanit dhe drodhi ngadalë e më ngë një cigare tjetër. Por as atë nuk e vuri në gojë. Drodhi një të dytë. Një të tretë. Drodhi shumë, drodhi gati gjithë kutinë e madhe prej fakfoni, e cila, nga ndriçimet e llambës e të zjarrit, dukej sikur digjej përbrenda. Pastaj, pa asnjë paralajmërim, cigaren e veshit ia hodhi me nishan të pagabueshëm komisarit mbi tavolinë, vuri edhe për vete një tjetër në gojë dhe heshti një copë herë.

Komisari shkruante.

Dani tha:

— Ndize, komisar!

Komisari ngriti kokën.

— Do ta ndez, Dan, — tha ai.

Dhe dy shkrepëset gati shkrepninë në të njëjtën kohë.

— Një revole, shoku partizan, një revole si tënden, — u dëgjua sërish te vatra dhe sërish pikat e rralla të shiut rrahën xhamat. Jashtë fryu një gulsh ere dhe një tjetër gjethe u zvarris nëpër oborr.

Llu-llu-llu. Tashmë Shegën e kishte zënë gjumi.



— Gjelmani është i keq! — tha ajo.

— Shegë, s'ka më gjermanë, — e mori me të mirë Isa. — Ajo do të jetë një luftë pa gjermanë. Kur të rritesh, do ta kuptosh e do ta bësh vetë atë luftë. Si të të them unë i shkreti. Ja, derri del në errësirë nga ferra, që të hajë misrin në arën e babait tënd. Babai yt, si e quajnë babanë tënd, Shegë?

Llu-llu--llu...

— Tush, — tha Cani.

— Babai yt merr një shufër dhe i thotë derrit, ku shkon ti, qelbanik? Unë dua të ha misrin në arën tënde, përgjigjet derri. Misrin e kam për Shegën e për Canin. Na-a-a, ta tregoj unë ty misrin, dhe varda me shkop kokës.

Hi-hi-hi, qeshi Shega, pa e hequr gishtin nga goja.

— Hë pra, shoku partizan, — tha i pakënaqur Cani, — më jep një revole si tënden!

Zjarri digjej. Fëmijët avullonin. Dani dëgjonte fëmijët, dridhte cigare dhe i fuste në kuti. Komisari shkruante. Buzët e tij, të modeluara pak shtrembër, sikur po ktheheshin në vendin e tyre. Po i rridhte dora. Tashmë!

Jashtë fryu një gulsh ere. Një gjethe e tharë fiku fëshfëriti nëpër oborr. Ca kokrra të imëta shiu çukitën në xhamin e dritares. Në të vërtetë ai s'ishte shi, nuk ishte as qëmtim, as sqotë. Vetëm pika të rralla e të imëta.

Tak-fak, tak-fak, si t'u bënte iso atyre pikave, Dani kaloi përmes dhomës, qëndroi me majat e opingave buzë vatrës, dhe, pasi ngeci dorezën e shkopit në jakën e xhaketës, ia bëri Isës me shenjë, pastaj i tha edhe me fjalë:

— Abetaren, shoku pionier!

Isa, i cili e kishte mbyllur me kohë abetaren (qëkurse shoku i shkoi të bënte rojë) e që hëpërhë kishte mbyllur edhe broshurën e nuk lexonte më, nxori abetaren nga nënjastëku dhe ia zgjati. Drejt në këmbë si qiri (me shkopin të ngecur te jaka e xhaketës), me një cigare në njërin vesh, me flakët e zjarrit që i skuqnin fytyrën e që i krijonin dritë e hije në sy, në faqe, në mollëza

e kudo, këshilltar Dani shfletoi abetaren nga faqja e parë tek e fundit. E shfletoi ngadalë dhe gjatë, duke menduar e gati duke bërëbëritur me vete mbi çdo shkronjë e skicë, pastaj e mbylli me zhurmë dhe tha:

— Me bojna!

— Me bojna, — tha Isa pas pak.

— E gjitha me bojna! — përsëriti Dani, i dha abetaren Isës (Isa e vuri nën jastëk) dhe, pasi shikoi me dhembshuri të dukshme Canin e Shegën që avullonin, u kthye (tak-fak, tak-fak) në minderin e tij, pikërisht aty ku kishte ndenjur ulur tërë mbrëmjen. Atje zgjati përpara opingat e mëdha, shtriu si zakonisht edhe shkopin midis tyre dhe mori cigaren nga veshi. Por nuk e ndezi. E vuri prapë në vesh. nxori nga brezi i brekusheve të zeza kutinë e duhanit dhe drodhi ngadalë e më ngë një cigare tjetër. Por as atë nuk e vuri në gojë. Drodhi një të dytë. Një të tretë. Drodhi shumë, drodhi gati gjithë kutinë e madhe prej fakfoni, e cila, nga ndriçimet e llambës e të zjarrit, dukej sikur digjej përbrenda. Pastaj, pa asnjë paralajmërim, cigaren e veshit ia hodhi me nishan të pagabueshëm komisarit mbi tavolinë, vuri edhe për vete një tjetër në gojë dhe heshti një copë herë.

Komisari shkruante.

Dani tha:

— Ndize, komisar!

Komisari ngriti kokën.

— Do ta ndez, Dan, — tha ai.

Dhe dy shkrepëset gati shkrepinë në të njëjtën kohë.

— Një revole, shoku partizan, një revole si tënden, — u dëgjua sërish te vatra dhe sërish pikat e rralla të shiut rrahën xhamat. Jashtë fryu një gulsh ere dhe një tjetër gjethe u zvarris nëpër oborr.

Llu-llu-llu. Tashmë Shegën e kishte zënë gjumi.



U hap dera dhe te pragu bëri ballë një gjerman, i shoqëruar nga Tush Sojani ose nga njeriu pa një vesh. Bashkë me gjermanin dhe Tushin në dhomë u fut ajër i freskët, që sikur e solli në vete komisarin e sikur vlejti për ta shkëputur nga raporti.

— Ku e zure? — pyeti Xhako Rina.

— Ngre kokën dhe shikoj matanë gardhit hijen e zezë të një njeriu aq të gjatë, sa, të thuash, i vinte turp të qëndronte drejt në këmbë! — tha Tush Sojani.

Gjermani, që mund të ishte ushtar apo oficer, jo dhe aq i ri e që e kishte kuptuar se flitej për të, shikonte herë Xhako Rinën, herë njeriun pa një vesh (që s'ishte i shkurtër, por që pranë tij dukej i shkurtër).

— Po të më hidhet në grykë, thashë me vete, do të ma marrë shpirtin me duar. Hej, drej o punë, si qenka fati i njeriut, u ruajta për vite me radhë që të mos më gjente asgjë, por megjithatë topi ma përlau shtëpinë nga themelet dhe ja prapë të vdesësh tashti që mbaroi lufta. M'u duk sikur ishte gati të më hidhej, kur unë i brita fort, gjerman, dorëzohu, se të shqeva! Gjermani nuk lëvizi nga vendi. Por ama e kuptova se i kishin hyrë drithmat më keq se mua. Atëherë u kujtova se në duar mbaja një shkop, që e kisha marrë për t'u rënë teneqeve për derrat e egër. E ngrita shkopin si pushkë, ia vura në gjoks, ai ngriti duart lart dhe unë i thashë, hajde shkojmë te komisar. — Nga një gëzim i brendshëm Tushi kroi veshin e vetëm që kishte.

Pasi kaluan çastet e para, Xhako Rina vuri re se gjermani i kishte grisur gradat, por i kishin mbetur shenjat. Sado që përpiquej të mbahej me njëfarë dinjiteti, ai ishte aq i lëshuar, aq i përbaltur dhe pamja e tij ishte aq e çoroditur, sa do të vlente si një karikaturë natyrale për një nazist dikur të vendosur e krenar, tashti të katandisur në një qenie të mjerë dhe jo aq të

zgjuar. Tek e shikonin, të gjithëve u vinte për të qeshur, por ishte vonë, njerëzit ishin të lodhur dhe askush nga të pranishmit s'ia kishte ngenë të qeshte.

— Çfarë grade kishe? — e pyeti Xhako Rina, duke shikuar nga studentit, të cilin e kishin thirrur menjëherë.

Gjermani ngriti supet përpjetë dhe tha:

— Unë s'kisha asnjë gradë. — Zëri i tij ishte pak më i fortë se një pëshpëritje.

Atëherë Xhako Rina u detyrua t'i tregonte me gisht vendin ku kishin qenë gradat.

— *Natürlich!* — u ngatërrua nazisti.

— Grada?

— Major, — dhe si t'i kishte dhënë të drejtë kjo gradë, hodhi një hap përpara, shikoi i trembur anëve me bisht të syrit, siç mund të shikojnë hajdutët amatorë, dhe befasi e me shpejtësi rrëmbeu një copë bukë misri sa një kuti shkrepëse, harruar në qoshe të favo-linës, ku punonte Xhako Rina.

— Lëre aty bukën tonë! — i briti Tushi.

Në çastin tjetër oficeri e kishte shtrënguar bukën në dorë me gjestet e një njeriu që vuan prej kohësh nga uria. U bë shkak kjo gjë e vogël që në dhomë të pasonte një heshtje, e cila thyhej vetëm nga trokitja e gëzhojës në majën e shkopit të këshilltar Danit.

— S'ka gjë, le ta marrë copën e bukës, — tha Xhako Rina dhe s'dihet se pse iu kujtuan kutitë e boshatisura të mishit e gjithë ato copa buke të hedhura kudo nëpër Shqipëri, vazhda e të cilave dëshmonte për rrugën nga kishin kaluar hordhitë e agresorëve. Therin lopët tona dhe hanë grurin tonë, mendonte Xhako Rina gjatë marshimeve të dimrit e të qershorit. — S'ka gjë, le ta marrë copën e bukës! — tha prapë ai.

Oficeri, si ta kishte kuptuar qëndrimin e komisarit, e futi në gojë dhe e kapërdui po me ato gjeste prej të urituri.

— Çojeni te të tjerët! — tha Xhako Rina. — Dhe hetoni.

Kur oficeri ishte gati në të dalë, këshilltar Dani diçka kishte parë tek ai.



— Mbajeni! — thirri.

Oficeri qëndroi, ndërsa këshilltar Dani u ngrit ngadalë me atë durimin e hundës së shtypur, eci tak-fak, tak-fak me këmbën e shkurtër e me shkopin e rëndë me gëzhjojë në majë, futi njërën dorë në xhepin e kapotës së oficerit dhe nxori prej andej një kalli misri të zhveshur. Një të vetëm. Kalliri ishte skërmitur dhe brejtur si nga dhëmbët e minjve. Kokrrat kishin qenë tepër të thara dhe nazisti s'e kishte ngrënë dot, sepse të gjithë e kishin vënë re se s'ishte më i ri: ose i kishin munguar me kohë dhëmbët e parë, ose i ishin thyer në betejën e fundit, ose kishte pasur protezë të pjeshme dhe e kishte humbur. Kështu që kalliri i misrit vetëm sa ishte skërmitur.

Këshilltar Dani e rrotulloi kallirin, si të shikonte diçka të paparë kurrë.

— Merre, Rubi, — tha, duke shikuar nga ajo, që, si zakonisht në raste të tilla, nuk vononte të dukej te pragu.

— Qyqja, pse? — briti ajo.

— Për pulat, — tha Dani.

— Ah, po! — tha Rubi dhe e rroku misrin me neveri, si të rrokte nga bishti një mi të ngordhur.

Tha roja:

— Edhe këtë s'e kishim menduar, s'mjafton derri, na dhe gjermani syrin te misri ynë e paska!

— He-he-e-e! — ia pat Dani me një pashirmë kuptimplote.

Tashmë komisarit i ishte bërë zakon ta shëtiste shpesh vështrimin e lodhur të syve të përhimë nga opingat e mëdha të Danit e nga shkopi te duart e nga duart te fytyra e sytë e Danit. Kështu ndodhi edhe kësaj radhe dhe, kur vështrimet e tyre u përpoqën, ata gati sa nuk e shqiptuan atë gjë apo atë sekret, që u përkiste të dyve e që megjithatë e mbanin akoma të fshehtë nga njëri-tjetri.

Tha Xhako Rina:

— Çojeni te të tjerët. Dhe hetoni mos është kriminel.



Gjermani, që me sa dukej ishte dëshpëruar për kalimin e misrit, të cilin ia kishin hequr nga xhepi atë pa mëshirë, kishte marrë tashti një pamje të hapur kriminelit. Ashtu u nis për të dalë nga dhoma, me sy të përgjakur e si të përlotur.

— Janë bërë si fëmijët, — tha dikush. — E humbi toruan për një kalli misri!

Gjatë kohës që oficeri ndodhej në dhomë, hunda e vogël e Isës kishte nuhatur më se një herë dhe më se një herë kishte shikuar nga komisari, sidomos kur ky i fundit porositi që të bënin hetime për oficerin (si për të gjithë). Mos ndoshta komisari kishte dyshuar në mënyrë të veçantë për këtë eses? Por jo, fytyra e qetë e Xhakos (jo vështrimi, se vështrimin e kishte gjithmonë të shqetësuar ai, kaq e dinte Isa), nuk i thoshte asgjë, d.m.th. edhe ky oficer nuk do të vritej, ai do të mbahej rob e, si shumë të tjerë, do të kthehej në Gjermani. Kështu Isa mbeti atje ku ishte, në anë të vatrës dhe po bëhej gati të shtrihet pranë vajzës së vogël, e cila në gjumë e sipër kishte filluar të kërkonte syrin e tij për ta rrëmuar. Llu-llu-llu, dëgjoheshin buzët e saj tek thithnin gishtin. Por, megjithatë, Isa nuk u shtri, sepse në çastin e fundit ai kishte arritur të diktonte te komisari një diçka, që s'ishte e zakonshme, një diçka që ishte edhe e rëndësishme, edhe urgjente.

Dhe ja çfarë ndodhi... Kur një këmbë e gjermanit tashmë ishte përtej pragut të derës, Xhako Rina se si rrotulloi kokën dhe në këtë rrotullim ai sikur pa diçka të veçantë te gjermani, që e detyroi të shtangte. I kishte parë një të prerë të vjetër në gushë, të cilën oficeri e kishte vetiu shumë të skuqur.

— Ngreje kokën! — i thirri befas oficerit. — Pastrojani baltërat nga fytyra, — u tha pas pak të tjerëve.

Kur oficeri e pat ngritur kokën dhe nga fytyra e tij qenë pastruar disi baltërat, atëherë Xhako Rina u ngrit në këmbë, si pemë e përkulur nga era, por kësaj radhe, ndryshe nga herët e tjera, ai ishte përthyer përpara e jo përpara. Komisari ishte i mendimit se në luftë njeriut i qëllon shpesh të vrasë, por, në qoftë se kjo

është e domosdoshme, atëherë vrasja duhet bërë sa më shpejt e sa më mirë. Kështu mendoj ai dhe vuri dorën në revole, por në çastin e fundit, kur duhej ta nxirrte nga këllëfi, u përmbajt. Gjakftohtësi, tha pas pak me vete, duhet t'i bindesh urdhrin të komandave eprore, të mos vritet asnjë rob. Në raste të veçanta, kur identifikohet një kriminel, atëherë dorëzimi i tij duhet shoqëruar me një informacion sa më të plotë. Kështu do të bënte edhe Xhako Rina. Hoqi duart nga këllëfi dhe tha:

— Largojeni por shënojeni si kriminel nazist. Informacionin për vrasjet e tij do ta shkruaj unë. Hëpërhë dorëzohet Kozma Petit, këtu në dhomën tjetër. (Në dhomën tjetër ngrihej zhurmë gazmore.) Ai e di ku duhet çuar e ç'duhet bërë me të.

Gjermani sikur u qetësua. Tushi, dhe roja që ishin mënjanuar për çdo rast, iu afruan gjermanit dhe e vunë përpara.

Por sërish ndodhi diçka. Para se oficeri nazist të kapërcente pragun, shikoi edhe ai me vëmendje Xhako Rinën dhe papritur shtangu në vend. Tashti si në një rit të përsëritur, por të kthyer anasjelltas, i kishte ardhur radha atij, oficerit, të përthyhej (si pak më parë komisarit) e të përthyhej edhe ai praptas (pikërisht si komisarit).

Tha Xhako Rina ngadalë e si me vete:

— Më njohe, qen i qenit?!

Tha prapë:

— Paske mbetur i gjallë, ë?!

Tha prapë:

— Dorëzohet Kozma Petit si kriminel nazist!

...Pas shpalljeve për «fitoret» e bujshme në Shqipërinë e Veriut e të Mesme, forcat gjermano-balliste ishin hedhur për të shkatërruar «përfundimisht» Lëvizjen Nacionalçlirimtare në Jug të Shqipërisë. Kulmi i këtyre përlëshjeve arriti në dimrin e vitit 1944, por, meqë ato nuk dhanë rezultatet e duhura dhe grafiku i gjeneralëve të Vermahtit nuk u realizuan, atëherë agresorët



dhe armiqtë e brendshëm ndërmorën sulme të vazhdueshme përtej afateve që kishin shpallur.

Në një nga këta muaj të përtejafateve, që nuk ishte as dimër as pranverë e që ishte mars dhe që nëpër libra është bërë zakon të flitet sikur ky muaj sjell afshet e para të pranverës (!) pra, aty nga mesi i këtij muaji, Xhako Rina bashkë me korrierin e batalionit udhëtonte përmes zonave të dyshimta e të pasigurta. Por, në mëngjesin e ditës së dytë, korrieri kishte marrë një të ftohtë dhe s'do të ishte e mundur ta ndiqte në rrugën e gjatë e të vështirë. I kishin thënë Xhakos, aso kohe përgjegjës rinie në batalion, se urdhri i shtabit epror që ai kishte në zarf e që zarfin e kishte në gj, ishte tepër sekret, tepër i rëndësishëm e tepër urgjent. Atëherë Xhako Rina vendosi që shokun e sëmurë ta shtronte në bazën më të afërt. Ashtu bëri. Dhe të nesërmen pa aguar mirë, u largua menjëherë për të kryer detyrën. Tashmë e kishte mbledhur veten: hëpërhë këtë detyrë Xhako Rina do ta kryente vetëm. Atij i kishte qëlluar të udhëtonte në mënyrat më të ndryshme, kishte ditur të kryente detyrat në mënyrat më të ndryshme, vetëm ose bashkë me të tjerët dhe shpesh nuk kishte qenë e mundur të ndiqej një rregull i caktuar. Aq më tepër që kësaj radhe, shtabi epror, duke i dhënë zarfin, e kishte këshilluar t'u qëndronte sa më larg që të ishte e mundur kontakteve me armikun dhe në përgjithësi t'u ruhej e t'u shmangej ndeshjeve me të, sepse zona ku do të udhëtonte ai, i qe nënshtruar një operacioni masiv dhe qe kthyer në arenë betejash të ashpra e për më tepër mjaft të ngatërruara. Shpesh ai nuk kuptonte ku ishin partizanët, ku gjermanët e ku ballistët. Lufta lëvizte, frynte si furtunë dhe disa minuta më vonë, aty ku kishin qenë gjermanët dëgjoheshin pushkët partizane dhe anasjelltas. Atëherë, për t'iu shmangur çdo rreziku, Xhako Rina vendosi të merrte rrugën më të vështirë, por më të shkurtër, vendosi të ngjitei nërrojetë Tomoricës. Por edhe betejat (si për inat të Xhakos) ishin ngjitur e po ngjiteshin bashkë me të drejt lartësive të Tomorit.

Frynte erë. S'ishte as dimër, as pranverë. Por frynte erë dhe ishte ftohtë. Ishte edhe ngricë. Dhe bora kishte mbetur pa u shkrirë.

Pak nga pak shkëlqimi i ditës u zëvendësua me një dritë të mjegulluar trëndafili, që kishte lënë dielli duke rrëshqitur prapa maleve të tiera, por përballë Tomorit e në faqet e Tomorit kjo dritë venitej më ngadalë se kudo e më vonë se kudo. Po sado ngadalë e sado vonë, ajo tregonte se kishte ardhur mbrëmja, që me puhizën e saj kishte ëmbëlsuar shkrepat, guvat e malit, kishte ëmbëlsuar çdo pamje e çdo gjë, vetëm urinë e Xhakos s'kishte mundur ta ëmbëlsonte, as ta zbuste. Kështu ai vendosi të pushonte ose të fshihej diku, të hante bukë, dhe pastaj të nisej prapë për rrugë. Ai duhej të ecte ditë e natë pa pushuar.

Më në fund Xhako Rina gjeti një shpellë në ato lartësira ku lufta s'ishte aq afër e ku bora jo që s'ishte shkrirë, por as kishte sy të shkrinte. Kjo shpellë lidhej me faqen e malit me një rrip të ngushtë toke, që të conte në gojën e saj të madhe, ku mund të futeshin dy qerre bashkë, por brenda, siç ndodh zakonisht, ajo ishte shumë më e madhe se hyrja, ishte gati sa pesë herë hyrja. Ajo ishte një shpellë e çuditshme: ndërsa anëve ndehej gjysmerrësira, mesi i saj ndriconte si njollë e madhe ngjyrë trëndafili. Xhako Rina eci më në thellësi, dëgjoi trokitjen e hapave të vet që jehonin në faqet prej shkëmbi të shpellës dhe, kur arriti te njolla e madhe e dritës, vuri re se tavani i saj ishte i shpuar si një krater vullkani, që Xhakos i kishte rastisur shpesh të shikonte atje në shtypshkronjën e vogël, kur bënte klisheja. Nëpër atë grykë ose sipër atij krateri dukeshin ca shkropa të Tomorit dhe lart, pingul mbi kokë, ai shikoi qiellin bojë jargavani, të aetë e të butë: as lufta e krismat e betejave, që bëheshin rrotull, as era që frynte, nuk e kishin tronditur qetësinë dhe ngjyrën e tij.

Në shpellë toka ishte e thatë, por ishte po aq nericë sa jashtë, se vërtet nuk pikonte, por nga kubeja futej vazhdimisht ajër i ftohtë.



Xhako Rina hoqi gunën nga krahët, e shtroi dhe hëngri bukë misri me djathë e qepë. Pastaj piu ujë nga paguri, por, pa e mbaruar gërqen e fundit, sikur i kapi veshi një zhurmë të dyshimtë, një si kuisje qeni, një si hungërimë zemërimi ose diçka të përafërt me të. Pastaj kuisja apo hungërima e qenit nuk u dëgjua më, sepse atë e kishin mbuluar krismat e betejës, që era e fortë, herë i sillte afër, herë i çonte larg.

Xhako Rina u bë kureshtar. Mblodhi ç'i kishin mbetur i futi në trastë, trastën në krah, gunën në krah, automatikun në krah dhe doli te hyrja e shpellës për të parë se ç'bëhej jashtë. Se vërtet shpellë, por aty armiku mund ta kapte si në kuvli e mund t'i dilte më keq.

Befas Xhako Rina kërceu prapa dhe kërceu shumë, se ishte i gjatë, por këmbët i dukeshin akoma më të gjata, ngaqë kilotat i rrinin të shkurtra e të ngushta. Tre ose katër metra përpara tij qëndronte një ujkonjë me bisht ndër shalë, me qimen përpjetë, me qafën të zgjatur e që në gojë mbante një lepur të mbytur e të gjakosur. Kur Xhako Rina u hodh prapa, ujkonja lëshoi lepurin, por, pa u larguar nga gjahu, hapi gojën, që e kishite të madhe e të thellë dhe zbuloi dhëmbët e gjatë. Me sa dukej edhe për ujkonjën, pas gjahut që ajo kishte siguruar, ky takim kishte qenë i papritur dhe i padëshiruar. Lëvizjet e qafës dhe përkulja e këmbëve të prapme, dridhja e lëkurës së kurrizit dhe kreshpërimi i qimeve, sidomos vështrimi i egër dhe përveshja e buzëve, të gjitha këto lëvizje tregonin se ujkonja ishte bërë nervoze. Tregonin gjithashtu se ajo nuk kishte vendosur akoma: të sulmonte armikun, që i kishte dalë përpara aq papritur, apo të mbronte gjahun, që e kishte lëshuar te këmbët e para.

Ta vriste?... Të shtinte?... Të bënte zhurmë?... Ja çfarë e mundonte Xhako Rinën në ato çaste. Jashtë dëgjoheshin gjëmime. Predhat e plumbat çanin ajrin nga të gjitha anët dhe ajri kërcëllinte si një copë hase kur grisët. Xhako Rina që dëgjonte se predhat e topave po pëlçisnin gjithnjë më afër shpellës ku ndodhej ai, se lufta po i vinte pranë, mendoi se krismat e automatikut

të tij mund të ngjallnin dyshime, mund ta zbulonin. Por ai nuk kishte të drejtë të harronte detyrën, për të cilën ndodhej aty. Ai nuk duhej të zbulohej në asnjë mënyrë, në asnjë mënyrë nuk duhej të shtinte. Pra, me ujkonjën ai nuk duhej t'i lante hesapet me automatik. I vuri sigurecën automatikut dhe nxori thikën, një thikë gjermane me dy presa. Por ky që vetëm një çast, se, në çastin tjetër, mendja i tha diçka që Xhakos iu duk më e mençur, më e urtë: t'i hapte rrugë ujkonjës, dhe sa më shpejt bile. Por si mund t'i hapte rrugë, kur ujkonja e kishte zënë rrëpirën e ngushtë të tokës që ishte e vetmja urë kalimi dhe kur në të dy anët e këtij rripi ishte greminë, ishte hon i thellë. As anash, as përpara nuk kalonte dot. Atëherë?... U zmbraps me kur sytë e ujkonjës shikonin me të keq thikën në duart e tij. Kështu me një kërcim të shpejtë ai u struk pas disa shkëmbinjve në të majtë të brendësisë së shpellës dhe në të njëjtën kohë ujkonja rrëshqiti brenda me lepurin e gjakosur në gojë. Kur ajo u zhduk në gjysmërrësirën e shpellës, Xhako Rina, që nuk desh të humbiste më kohë, vrapoi për të dalë jashtë, por u gozhdua prapë në vend: diku atje poshtë në këmbët e shpellës zhvillohej një betejë e pjesshme gati trup me trup. Xhako Rina nuk arriti të dallonte mirë nga ishin partizanët e nga ishin gjermanët apo ballistët, sepse përleshja, si e shtyrë nga një uragan i fuqishëm, e zhvendosi sheshin e betejës dhe, përveç të vrarëve që kishin mbetur në vend, të tjerët, në luftë e sipër, iu fshehën nga syri prapa honeve, gërxheve e thepave, që në faqet e Tomorit janë të shumtë e gjenden kudo. Xhakoja s'pati kohë të mendohej më gjatë, as të vendoste se ç'duhej të bënte, sepse një tjetër pengesë e papritur e detyroi të gozhdohej sërish: në rrëpirën e ngushtë drejt hyrjes së shpellës ai kishte parë të ngjitej një gjerman, sipas shenjave e kapeles, një graduat, një oficer. Duket qartë se ky oficer, mendoi Xhako Rina, i përplasur nga valët e përleshjes, paska mbetur vetëm dhe tashti hallavitet e vrapon, qoftë për të gjetur të



vetët, qoftë për të gjetur një vend ku hëpërhë të fshehë kokën. Kështu mendoi Xhako Rina.

Pa humbur kohë, u zbraps përsëri, me të njëjtin kërcim që ishte zbrapsur pak më parë nga ujkonja, dhe u struk pas shkëmbinjve, gjithmonë në të majtë të shpellës.

Gjermani u fut brenda me një frymë, si të ishin duke e ndjekur nga pas. Ai ishte një burrë me moshë të pjekur, me mjekër të hollë, me sy të thellë, shumë të çelët, që vështronin rrotull të habitur e të lodhur. Në dritën e thyer të mbrëmjes, që brenda në shpellë bëhej më e zymtë, fytyra e gjermanit dukej gjelbëroshe, e hequr, sytë gjithmonë të habitur e të lodhur, por edhe të egër, dhe e gjithë figura e tij thatime ngjante me kokën e një kaposhi.

Oficerit, me t'u gjendur brenda në shpellë, iu tendosën hojëzat, si të përpiquej të nuhastë nëpër ajër ndonjë të fshehtë. Në të vërtetë ai e kishte vënë re ujkonjën njëzet metra përtej, në gjysmerrësirën e shpellës, që rrinte më bisht me veshët ngritur e pas saj rrinin më bisht tre këlyshët, gjithashtu me veshë të ngritur e me sy të egërsuar, që shprehnin thjesht atë gjë të keqe, që mund të shprehin sytë e një bishe të egër grabitqare. Atëherë gjermani mbeti një hop në mëdyshje, pastaj, pa ditur ç'të bënte tjetër, vrapoi pranë shkëmbinjve, pikërisht në atë krah, ku ishte fshehur Xhako Rina.

Ndërkaq ujqit e vegjël zunë të copëtonin lepurin, ndërsa hungërimat e mbytura të ujkonjës po bëheshin gjithnjë më të shëmtuara, më kërcënuese dhe ardhja e mashkullit më e mundshme dhe fare e mundshme. Çift, ata, mashkulli dhe femra, janë më të rrezikshëm, mendoi Xhako Rina. Por ai mendoi gjithashtu se armiku i tij kryesor në këtë shpellë ishte nazisti, prandaj që nga ai çast Xhako Rina gati e harroi ujkonjën dhe zuri të ndiqte me sy vetëm gjermanin. Ai e kishte bërë prej kohësh planin e tij, të heshtte, të shmangte ndeshjen, të shmangte sidomos çdo krismë: në gji ai kishte një zarf tepër sekret, tepër urgjent, tepër të

rëndësishëm. Por, duke menduar kështu, duke ndjekur me sy oficerin gjerman, ai gati lëshoi një klithmë zemërimi. Një fjalë goje: të heshtte. Po a ishte e mundur një gjë e tillë? A ishte e mundur të takohej hundë më hundë me një eses gjerman dhe të rrinte duarkryq, të fshihej, të mos i hidhej në grykë, të mos e vriste?... A s'do të ishte ky një dënim i përjetshëm, që Xhako Rina mund t'i jepte ndërgjegjes së vet?... Oficeri ishte aty, disa metra larg tij dhe bile ai kishte arritur t'i shikonte edhe një të prerë të vjetër në gushën e kuqe si lafshë gjeli. Esesi vërtitej me kujdes, gjithmonë i shqetësuar, gjithmonë me sytë nga ujkonja, por ashtu si Xhako Rina pak më parë, ndoshta po për atë arsye, as ai s'kishte ndër mend të përdorte automatikun për të vrarë ujkonjën. Si t'ia bënte pra?... Të heshtte?... Ta falte atë agresor dhe vrasës kur, me një të vërtitur të thikës, mund ta hidhte përtokë? Hëpërhë tërë jeta e tij, tërë e kaluara, e tanishmja dhe e ardhmja e tij ishin përqendruar vetëm në këtë shpellë e vetëm në ato çaste, thuajse pjesa tjetër e tokës, pjesa tjetër e rruzullit nuk ekzistonte fare për Xhako Rinën. E megjithatë, një zë i thellë i pëshpëriste, se çdo gjë që do të ndodhte në atë shpellë e çdo gjë që do të ndodhte në ato çaste, gjithë ai përqendrim, gjithë ajo tendosje, gjithë ajo heshtje — të gjitha këto e gjithçka tjetër ndodhnin në emër të pjesës tjetër të tokës e të botës, në emër të asaj që ekzistonte jashtë shpellës e që hëpërhë ajo ekzistonte në formën e një beteje, ekzistonte në vibracionet e pushkëve, të mitralozëve, të automatikëve, të bombave të dorës e të predhave të topave, që kishin filluar të binin rrotull masivit, nën të cilin ndodhej shpella e brenda në shpellë ndodheshin ata të dy, armiq të betuar e të papajtuëshëm me njëri-tjetrin. Dhe ujkonja.

Por të gjitha mendimet e arsyetimet si dhe vetë urdhri i shtabit epror për t'u qëndruar larg betejave e ngatërresave, i shkuan kot Xhako Rinës, sepse në një çast të caktuar oficeri gjerman i doli në një pozicion të përshtatshëm dhe ai, pa mundur të përmbahej, nxori



nga këllëfi thikën me dy presa dhe iu hodh gjermanit mbi kurriz (duke harruar kështu se beteja e forcave ndërluftuese zhvillohej mbi e nën këmbët e shpellës dhe, sa më afër të zhvillohej ajo, aq më kërcënuese ngrihej pyetja: Cilët do të arrinin të parët në shpellë?... Kush tërhiqej e kush fitonte?..)

Oficeri u ndodh më i fortë nga sa kishte pandehur Xhako Rina. Më një lëvizje të shpejtë e me një goditje të fortë të krahut ai mundi t'i shpëtonte thikës së Xhakos dhe pas pak të dy armiqtë u rrokullisën nëpër tokën me lagështirë të shpellës. Kur u gjenden në këmbë, Xhako Rina vuri re se të dyve u kishin rënë automatikët dhe se një thikë e tillë identike tundej e shkëlqente në dorën e gjermanit disa metra përtej.

Kaq. Dueli që për Xhakon kishte qenë i pashmangshëm do të bëhej pa zhurmë, do të bëhej me armë të ftohta. Dhe, si ta kishin bërë me fjalë, dy armiqtë shikuan ose matën me sy njëri-tjetrin, matën forcën, gjatësinë, matën edhe atë të fshehtë që thur personalitetin dhe karakterin e secilit dhe, me një kërcim të shpejtë, u gjendën ballë për ballë dhe fare pranë.

Xhako Rina e kuptoi menjëherë se oficeri gjerman ishte i patrembur. Bile iu bë sikur buzët e gjermanit i nënqeshën me djallëzi. Tashti që e shikonte aq afër, ai u bind edhe një herë se gjermani ishte burrë në moshë, tashmë të piekur, kurse ai, Xhako Rina, ishte në kulmin e fuqive të veta.

Gjakftohësi, Xhako, i tha vetes, i bindur se do ta fitonte këtë duel, dhe nuk e humbi gjakftohësinë edhe kur oficeri zuri të bënte lëvizje mashtruese me thikën e vet duke i ardhur rrotull Xhakos me shkathtësi, duke u skërmitur e duke ngulur këmbët pas tokës, siç kishte bërë pak më parë ujkonja të hyrja e shpellës. Befas, në një mënyrë krejt të papritur, oficeri hoqi kapotën dhe, kur e ndjeu veten të çliruar nga ajo, një buzëqeshje e dytë ironike e djallëzore, më ironike e më djallëzore se e para, zbërtheu nga fytyra e nga buzët e tij gielbëroshe, që përputhej edhe me reflekset e mbrëmjes, tek futeshin e thyheshin brenda në shpellë. Megjithëse

kjo buzëqeshje i gicilonte nervat Xhakos, ai u përmbajt gjakftohtë, aq më tepër tashti që gjermani kishte hequr kapotën dhe kishte zbuluar trupin e tij të hajthëm, të dobët në dukje, por të lidhur mirë. Ndërkaq, ai nuk e hoqi gunën dhe as bëri përpjekje për ta hequr. Atij, që ishte partizan i vjetër, i bëhej sikur kishte lindur me gunë dhe, po ta hiqte, përkundrazi, jo që nuk lehtësohej. por do t'i dukej sikur i mungonte dicka, një si lloj arme e një si mburojë në këtë duel vendimtar.

Duke u rrotulluar e duke u shikuar me egërsi, po më shumë me dinakëri, duke vërtitur thikat, si për të parë lëvizjen instiktive të qepallave të kundërshtarit, më në fund ata kuptuan se kishte ardhur çasti të ndesheshin dhe u ndeshën. U ndeshën trup me trup. U ndeshën një herë, dy, tri herë. po sa herë që ndesheshin, me dorën e lirë mbërthenin dorën e armikut që mbante thikën dhe, si në një spektakël, të mbërthyer me të këtra duart, provonin forcën e niëri-tjerit. përpiqeshin t'i thyenin krahun tjetrit, përpiqeshin t'i përkulnin dorën që mbante thikën, përpiqeshin ta shtynin e ta vinin përpara, me këmbët të ngjeshura fort pas tokës. Dhe sharronin kurrë të vështroheshin sy në sy, si të lexonin aty zhvillimin e mëtejshëm të duelit, atë që do të ndodhte. një çast më vonë, fatin e tyre. të ardhmen, shpresat ose fundin. Po në aoftë se në fillim këto ndeshje ngjani me një spektakël, në aoftë se në ndeshjet e para dukej sikur midis tyre sundonte herë mirëkuptimi për të respektuar rregullat e ndeshjes, herë rrebeshi dhe prapë mirëkuptimi, në ndeshjet e mënastaimë, gjithcka u kthye në tërbim, që i shtynte të dvia palët të hidheshin me kafshëri dhe po me kafshëri t'i spërdridhnin njëri-tjetrit zverkun. t'i shkulnin në copë mish, t'i cirrnin në faqe, ta gjakosnin ku të mundnin e ku të mundnin ta shtypnin e pastaj ta bluanin.

Kjo nuk dihet sa zgjati. Ata që luftojnë për iletë a për vdekje nuk e llogarisin kohën. Por aio që dihet është kjo: pas disa ndeshjeve të tilla, pas disa përplasieve e britmave spontane, Xhako Rina kuptoi se oficeri nazist vërtet nuk e kishte fuqinë dhe hovin që



kishte ai vetë, por mjeshhtërinë, teknikën, siç thoshte shpesh komandanti i batalionit për gjermanët, e kishte më të madhe. Pastaj ai kuptoi edhe një gjë tjetër, që ishte më kryesore: oficeri nazist po tregonte shenja lodhjeje, po jo vetëm kështu, ai sikur kishte rënë ose po binte gjithnjë edhe moralisht.

Po tashti ç'do të bësh, pyeti Xhako Rina me vete, pa harruar se tashti që nazisti po shikonte fundin e vet, do të përdorte të gjitha dinakëritë dhe të gjitha teknikat e ndeshjes. Dhe nuk vonoi. Në një çast të volitshëm, befasi nazisti u zmbraps dhe e zuri thikën nga maja.

Përsëri ajo nënqeshje dinake dhe ironike, ajo nënqeshje djallëzore nga buzët e thara të nazistit. Deshi të kujtohej Xhako Rina, ku i kishte parë ata sy dhe ku e kishte ndier atë vështrim. Ah, një herë ai ecte nëpër një ferrishte dhe, duke ecur, i kishte zënë syri një nepërkë që e shikonte Xhakon tek afrohej... Por jo, vështrimi i nazistit kishte diçka më të egër, më të zezë e më të përbindshme se vështrimi i nepërkës, dhe atëherë ai u kujtua se atë vështrim e kishte parë vetëm tashti, vetëm tek ai, te vetë esesi dhe e kishte parë gjatë tërë kësaj ndeshjeje, nga fillimi deri në çastin e fundit. Bile, në një të qindtën e çastit, Xhakos i shkuan sytë te sytë e ujkonjës, e cila duke qënë në kulmin e zemërimit, nuhaste vazhdimisht ajrin. Por as sytë e ujkonjës, as edhe të ujkut, po të vinte (të dy bashkë, mashkulli dhe femra ishin më të rrezikshëm), as të një kopeje të tërë ujqish nuk do të mund të krahasoheshin nga egërsia me dy sytë e vetëm të esesit. Kështu mendoi Xhako Rina. Dhe s'dihet pse iu kujtuan edhe sytë e Albert Tolluzit, me të cilin qe ndeshur për më se katër vjet me radhë...

Rrotull shpellës dëgjoheshin zhurmat e luftës. Gjithnjë më afër. Më afër dëgjoheshin edhe hungërimat qaramane të këlyshëve të ujkonjës dhe të vetë ujkonjës. Pas pak beteja e dy armiqve sikur u ndërpre ndoshta vetëm për një sekondë, sepse ujkonja, që s'ishte veçse diçka e përhime, diçka e madhe dhe më e madhe se një qen stani u kaloi pranë, gati nëpër këmbë. Ajo ecte ose më mirë të

themi, ajo zvarrisej tinëzisht, me këmbët e pasme të hapura e të përthyera, me barkun gati përtokë, me qafën të zgjatur e me njërin nga këlyshët në gojë. Dy këlyshët e tjerë ecnin pas saj, duke imituar plotësisht të ëmën. Kur qe baras me ta, ujkonja u hodhi një vështrim të egër, bile sikur e mbajti çapin, sikur qëndroi, sikur mendoj diçka të keqe, diçka mizore, ngriti veshët përpjetë, kreshpëroi qimen por shpejt, pa e lëshuar këlyshin nga goja, me barkun gjithmonë gati përtokë, iku drejt daljes së shpellës, e pasuar nga dy këlyshët e tjerë.

Por të gjitha këto lëvizje të ujkonjës, dy armiqtë, të cilët qëndronin ballë për ballë, iu dukën shumë më të shkurtra se një çast dhe me gjithë zemërimin e bishës nënë, ata nuk e kishin hequr asnjëherë vështrimin nga njëri-tjetri.

Kështu, me thikën të kapur nga maja, nazisti, pasi kishte bërë të gjitha matjet e të gjitha llogaritë, shtrëngo i buzët dhe shtrembëroi fytyrën, si të përqeshte armikun përballë.

Hidhe, po ta mbajti, i thoshin sytë e kujdesshëm të Xhakos, hidhe, por ama, po s'më qëllave, mbete pa thikë, mbete i çarmatosur, pastaj e di vetë ti... Kështu të paktën mendonte Xhako Rina.

Por oficeri e hodhi thikën. Xhako Rina bëri një lëvizje, që as vetë nuk e kuptoi, ajo kishte qenë një lëvizje instinktive, ai kishte ngritur edhe duart para fytyrës dhe vetëm një gjë mbante mend: që tehu i thikës i kishte shkëlqyer para syve me nuancat e me reflekset e mbrëmjes. Tjetër gjë as mbante mend, as kishte parë. Por ndjeu dhimbje në krahun e majtë. Pa edhe gjak, që zuri t'i kullonte nga dora e majtë në tokë. Lëshoi një rënkim dhe ky rënkim sikur e lehtësoi. Hoqi thikën që i kishte shpuar gunën sipër bërryllit, e hodhi larg dhe u lëshua mbi oficerin nazist me një britmë të mbytur, që i doli nga shpirti, pikërisht në kohën kur atje jashtë palët ndërluftuese po i afroreshin hyrjes së shpellës.

Por në ato pesë hapa që i ndanin, ai vuri re se na-



zisti befaz vrapoi në drejtim të automatikut të vet. Atëherë Xhako Rina në vrap e sipër hoqi gunën, të cilën e vërviti në drejtim të oficerit dhe pastaj gjermani s'pati më kohë ta largonte gunën që i kishte rënë mbi duar e mbi automatik, sepse Xhako Rina e arriti dhe me dorën e shëndoshë zuri t'ia përplaste kokën pas shkëmbit. Në përplasjen e dytë të kokës, nazistit iu dobësuan duart e këmbët, pastaj sikur u zhvidhos i tëri dhe i tëri ra lëmsh përtokë. Por Xhako Rina e zuri sërisht për flokësh dhe sërisht ia përplasi kokën pas shkëmbit, ia përplasi disa herë, derisa ndjeu atë zhurmë të kafkës e të kockave, që ngjan me zhurmën e shurdhët të vdekjes.

Sakaq, poshtë në afërsi të rripit të ngushtë që lidhej me hyrjen e shpellës, zunë të dëgjoheshin fare qartë britma e fjalë të huaja. Xhako Rina kërkoi me sy thikën që i kishte rënë nga duart kur hodhi gunën, por nuk e gjeti. Kërkoi pastaj me sy automatikun e vet, të cilin e gjeti në çastin e fundit. Ndërsa gjermanët mund të kishin arritur të hyrja, ai sapo kishte dalë nga ajo dhe për të mos u ndeshur me ta, parapëlqeu të kacavirrej nëpër greminë, të rrokullisej, të kapej pas rrënjëve të rastit, derisa, më në fund, gjeti një vend pak a shumë të sheshtë... Kur mendoi se ishte jashtë rreziqut, disa minuta më vonë lidhi krahun e plagosur dhe, kur pat mbaruar edhe këtë punë, ai e ndjeu veten krejt të çliruar nga të gjitha ngjarjet e asaj dite. Atëherë, padashur preku me dorë zarfin që mbante në gji.

Ndërkaq ylli i mbrëmjes, që kishte dalë në një qiell të ngopur me mugëtirë, vallëzonte me një mijë drithërima, Të bukur, si yje të këputura iu dukën Xhakos edhe plumbat me zjarr që çanin hapësirën atje ku bëhej luftë. Dhe ai shikonte e dëgjonte këtë mbrëmje, që, kur u fut në shpellë, ajo kishte qenë e kuqe apo e trëndafiltë, tashti ishte e mugët, më tepër se e mugët, tashti ishte e errët ose gati e errët dhe, përmes kësaj errësire, dukej sikur armët dhe palët ndërluftuese ishin lodhur e po kapiteshin në gjumë. Pak më vonë, kur ai kishte zënë vend mbi një pllajë, pushkët heshtën fare, por,



kur ato heshtën, deri te veshët e tij jehuan ca zëra njerëzish që flisnin në gjuhë të huaj. Ai kuptoi se ata kishin ngritur çadra, që dukeshin si njolla të zeza mbi bardhësinë e borës dhe dëgjoheshin jo vetëm zërat e tyre, por edhe trokëllima e lugëve në fundin e gavetave. Hanin. Pastaj do të flinin, që të nesërmen të vazhdonin luftën e tyre.

Më vonë, në humbëtitat e errësirës ai shqoi disa zjarre të largëta. Tashmë ai e njihte jetën e maleve: ato ishin zjarre barinjsh. Ai ishte partizan dhe e dinte se ato ishin edhe zjarre partizanësh, edhe zjarre populli, që kishte lënë shtëpitë, duke fryrë andej nga shkelte e nuk shkelte lufta. Me sytë nga ato zjarre, sepse hëpërhë ato ishin e vetmja urë dhe e vetmja mundësi, që e mbanin në lidhje me barinjtë, me popullin e me partizanët, Xhako Rina u nis për rrugë. Në gji ai kishte një zarf, brenda në zarf kishte një letër...

Isa kaloi me vrull para syve të Xhakos dhe doli jashtë. Ai kishte hyrë dhe kishte dalë disa herë nga dhoma. Dy fëmijët e vegjël tashmë flinin në anë të vatrës. Dani, që e kishte dëgjuar me vëmendje këtë histori, mori frymë thellë, gati me vërshëllimë.

— Të të them të drejtën, Dan, — tha Xhako Rina, — edhe sot e kësaj dite nuk e di, në bëra mirë që iu hodha në grykë gjermanit, apo duhej të isha përmbajtur.

Dan Zavalli, i lodhur nga punët e ditës së kaluar, po edhe i mërzitur nga kjo mbrëmje e nga kjo pritje e gjatë, ky Dan, pas rrëfimit të Xhakos për gjermanin gushëprerë, që e kishin nxjerrë në oborr, sikur u gjallërua, sikur u rinua dhe pësoi një metamorfozë, aq sa Xhako Rina nuk deshi t'u besonte syve. Përveç hundës së shtypur, zakonisht edhe faqet e Danit i qenë dukur Xhakos të shpërbëra e të lëshuara poshtë, por ja... befas, po jo dhe fare befas, pas mendimit që i kërkoi (në duhej t'i ishte hedhur ose jo gjermanit në grykë) Xhakos iu bë sikur fizionomia e Danit ndryshoi si me magji. Hunda iu ngrit, iu mpreh, d.m.th. iu kthye në

gjendje normale, veçanërisht faqet sikur iu ngurosën e bashkë me këtë ngurosje, edhe ato iu kthyen në muskuj. Dhe përsëriti:

— E, si thua ti, Dan, më bëhet nganjëherë sikur duhej të isha përmbajtur. Të nesërmen, kur u tregova shokëve ç'më kishte ndodhur në një shpellë të Tomoricës, atëherë dolën disa partizanë që treguan historira të tmerrshme për oficerin gushëprerë, që unë pandehja se e kisha vrarë. Ai paskësh qenë një eses i gestapos që ndiqte prapa ushtrinë e që bashkë me vartësit e tij bënte hetime e krime kudo që shkonte e kudo që ndodhej. Disa nga krimet e tij i kam të shënuara edhe tashti në ditarin tim të kujtimeve. Atë ditë, me sa duket, reparti me të cilin vepronte mund të kishte pësuar disfatë, lufta shkonte e vinte si furtunë herë në favorin e njërës palë, herë të tjetrës, ai mund të kishte humbur lidhjet, mund të kishte rënë ngushtë, kishte mbetur i izoluar dhe pa gjetur tjetër rrugëdalje, u fut në shpellë, siç isha futur edhe unë, për të shpëtuar kokën, e për të studiuar gjendjen. Ndosh-ta... Nejse... e kishim fjalën tek ajo që bëra unë. Si thua ti, Dan, të isha përmbajtur, thua?

— Jo, hiçfare! — gati briti Dani dhe kjo ishte hera e parë që ai bërtiste në atë dhomë. — Mirë bëre që iu hodhe në grykë! — Tashti jo vetëm faqet, por e gjithë qenia e tij qe kthyer në muskul. — Nuk mund të durohet hasmi, kur e di që vret e pret njerëzit tanë kudo që i shkel këmba!

Isa kaloi prapë me vrull para syve të Xhakos dhe prapë doli jashtë.

— Më bëhet, Dan, se gjakftohtësia është arma më e fortë që ka në dorë njeriu!

— E-e-e posi, gjakftohtësia, ashtu thonë, një fjalë goje, por ç'u bë njeriu, të gjendet në një shpellë tek për tek me një gjerman nazist dhe të qëndrojë duarlidhur, sepse ashtu u dashka. Posi, gjakftohtësi! Jo, hiçfare s'ke gabuar! As gjermanët, as Tolluzët s'mund të durohen. Hiçfare!

— Nuk di, nuk di! — tha prapë i turbulluar Xhako



Rina nga kjo historia e nëntë muajve më parë. — S'di ç'të të them. Atëherë unë isha përgjegjës rinie në batalion. Kur më bënë komisar batalioni dhe më vonë brigade, unë ua tregova shokëve fill e për pe të gjithë këtë ngjarje, dhe ata, të thuash të drejtën, u lëkundën, në fillim, megjithëse pastaj u bënë të gjithë me mua. Por unë vetë e mendoj shpesh dhe nuk di ç'bëra atëherë, mirë apo keq, që iu hodha gjermanit në grykë, kur isha nisur me një detyrë tjetër aq të rëndësishme...

— Po ai zarfi që mbaje në gji? — pyeti këshilltar Dani.

— Zarfi që mbaja në gji u kushtoi shtrenjtë armiqve!

— Ah! — psherëtiu i ngopur me kënaqësi këshilltar Dani dhe e lëshoi shkopin në prehër, lëshoi edhe duart e mëdha mbi gjunjë, si t'u kishte lejuar atyre (shkopit dhe duarve) të bënin një pushim të vogël.

Befas, diku përtej oborrit të teze Rubit u dëgjua një e shtënë e vetme revolveri. Krisma që e mbytur. Pasoi një heshtje. Këshilltar Dani u ngrit në këmbë (kjo ishte hera e tretë që ai ngrihej në këmbë prej aq orësh) dhe doli jashtë, duke trokitur nëpër shkallët e drunjta me shkopin e rëndë e me këmbën e shkurtër, tak-fak, tak-fak, tak-fak...

Pastaj u dëgjuan sërish një palë hapa të tjerë si prej të vogli. Dikush ngjiti shkallët dhe u fut në dhomë. Isa. Tashti ai nuk ecte me vrull, ai sikur ishte qetësuar. I fryu grykës së revoles, por i fryu si një i madh dhe, pa shikuar nga komisari, shkoi në vendin e vet, në anë të vatrës, d.m.th. pranë zjarrit.

Pas pak nëpër shkallë u dëgjua edhe shkopi me këmbën e shkurtër të këshilltar Danit. U fut në dhomë, edhe ai pa shikuar nga komisari, u ul në minder me pamje të kënaqur, por edhe të hutuar dhe në këto çaste Xhako Rinës iu bë sikur ai nuk e kishte më hundën as shesh, as të shtypur e as të ngritur dhe faqet as të rrëzuara e të varura poshtë, as të shpërbëra e as muskuloze nuk i kishte. Tashti ai s'ishte tjetër, veçse Dan Zavalli i zakonshëm, të cilin e njihte prej më se një viti.

— E vrau oficerin, — tha Dani duke shikuar nga Isa.  
— Isë, pse e bëre këtë?! — qortoi pas pak komisari.  
— Që kur të njohu ty, shoku komisar, nuk i zinte vendi-vend. Kur po e çonim te të tjerët, deshi të ikte, mori vrull të fshihej shkurreve, por unë u ndodha më afër dhe e vrava. — Këto fjalë Isa i kishte thënë si një i madh, pavarësisht nga zëri që i mbetej gjithmonë prej të riu. Pastaj u ul pranë dy fëmijëve që flinin. Që kishin avulluar e që flinin.

Por edhe fshati i gjithë kishte rënë në qetësi. Edhe atje flinin. Flinin vendasit e paktë, që kishin mundur të ktheheshin, flinin partizanë e gjermanë. Partizanët nëpër dhoma. Gjermanët poshtë në ahure e qymeze. Zotër dhe robër. Dhe heshtje. Veç larg përtej heshtjeve dëgjoheshin ca thirrje, ca britma, ca rrahje teneqesh. Por ato ishin të rralla e të pakta. Dëgjoheshin edhe rosat e egra në qiell. E bufët në pyll. E kukuvajkat nëpër çatitë. Dhe prapë britmat e teneqerat e atyre që s'flinin e që kishin misra për të ruajtur.

— Aha-a-a! O-o-Myr-to-o, prite, ore, prite derrin se të erdhi!

Shiu, ai shiu i imët, që s'kishte rënë gati dy javë e që dalëngadalë po bëhej zot i qiellit, vazhdonte të binte butë e të çukiste në xhamin e vogël të dritares së vetme.

— Po, deshi të ikte! — tha prapë Dani që nga minderi i vet.

— Mund ta kishin kapur të gjallë! — tha komisari me ton mospajtimi.

— Ku ta dish, edhe mund ta kishin kapur, — tha Dani si për të mbështetur dëshirën e komisarit, por në të vërtetë s'ishte vështirë të vihej re se gjithçka tek ai, pamja, vështrimi, zëri, bile dhe shkopi, bile edhe opingat e gjithçka tjetër ishin si të ngopura nga kënaqësia për fundin e esesit. — Kërmë ishte, kërmë u bë! — shtoi.

Një çast më vonë u duk sikur edhe komisari, pas një dyzimi të shkurtër, që bashkuar me atë kënaqësi që



shprehte e gjithë qenia e Danit. Dhe jo më kot hodhi vështrimin nga Isa, që edhe ky i fundit shikonte nga komisari, si për të pritur vendimin e tij. Atëherë komisari vuri buzën në gaz, gjë që ndoshta s'kishte ndodhur asnjëherë gjatë tërë asaj mbrëmjeje dhe pastaj i shkeli syrin Isës me çapköllëk.

## 21!

Tashmë në konakët e Bajazit Pallës partizanët kishin zënë pesë dhomat e katit të parë. Ishte mënjanoar kështu në njëfarë mënyre rreziku i ndonjë ngatërrese të rastit. Bajazit Palla, me mendjen pakëz më të mbledhur, eci zbatuar në katin e dytë, ose, më mirë të themi, në pjesën e veçuar të zahireve, u fut si hije aty ku ndodhej zonja Dirë dhe pëshpëriti:

— Asgjë s'kuptova nga qëndrimi i komisarit, asgjë, zonja Dirë. Veç që futën partizanë në dhomat e poshtme...

— As që e zunë me gojë zotin Mafuz?

— Jo!

— Ashtu, ë-ë-ë! — hungëriu ajo me hungërimën, që edhe atë e kishte të bukur.

— Po, zonjë!

— Kështu thua ti, asgjë s'kuptove! — tha ajo me zë që fshihte nënkuptime, të cilat mund t'i kuptonte vetëm zonja Dirë.

— Kuptova, posi, — pëshpëriti ai si me vete. — Kuptova, që ne jemi përmbysur dhe që ata janë shumë të egërsuar me ne!



— Këto që thua, Bajazit aga, unë i di më parë se ti!  
Heshtje errësire.

— Por çdo gjë është e përkohshme, të thashë, e përkohshme! — dhe sytë e saj u ndezën nga një flakë e keqe. — Po ai, komisari dhe ai pionieri nuk dalin asnjëherë nga dhoma?!

22.

Xhako Rina gati nuk dëshironte të hante, nuk kishte as uri, as oreks. Gati nuk dëshironte asgjë, veç donte t'i jepte fund raportit, pastaj t'i lutej këshilltar Danit, që të bënin si të bënin edhe sonte me *derrat e egër*, se natën tjetër e dinte vetë ai, ç'do t'u punonin atyre kafshëve grabitqare... I tillë dukej ai kur hante jahninë me pulë të Rubit. Kurse me këshilltar Danin punët qëndronin ndryshe. Ai ishte ulur në cep të tavolinës dhe hante me oreks, këpuste copa të mëdha nga buka e misrit dhe i hante gati pa u përtypur. Ai ngutej. *Derrat e egër*. Por ishte edhe i durueshëm Dani. Priste.

Rreth vatrës tringëllinin në çanakun prej alumini lugët e Isës, të të dy fëmijëve, të Canit e të Shegës, dhe dëgjohej shpesh ajo pëshpëritje, që ishte e fshehtë, që ishte e gëzuar dhe që u përkiste vetëm atyre të treve: ps-ps-ps...

Rubi u fut me vrull dhe u solli një shtambë me ujë. Komisari piu pak. Piu edhe Dani, shumë sigurisht. Një katrove e çoi në vatrë dhe që nga ai çast pëspëset u bënë më të shpeshta e më të gëzuara. Herë-herë

dëgjohej cingërима e lugëve edhe në dhomën tjetër të Rubit. Edhe atje hanin dhe, duke gjykuar nga heshtja, hanin me oreks. Ata ishin dhjetë partizanë të kompanisë së shtabit të brigadës me Kozma Petin në krye. Xhako Rina përpiqej të shikonte me sytë e mendjes lulen e egër të kuqe të errët në veshin e tij. Po edhe cigaren në veshin tjetër.

Ata pinë prapë ujë. Gjella me lëng ishte e kripur. Por këtë nuk e tha askush: ose pse ishte e tepërt, ose pse nënkuptohej, ose pse në ato kohëra ishte krejt e natyrshme, që gjellët të ishin të kripura.

Njëherë Xhako Rina e pyeti Rubin:

— Keni shumë pula?

— Fare pak, — tha ajo.

— Mos edhe te ju i hëngrën ballistët?

— Jo të gjitha, — tha Rubi. — Shumica e fshatit ishte me partizanët. Ata nuk nguleshin gjatë këtu. Ku ta di unë, u ra një sëmundje. Të tjerat i hëngri skilja. Skilja e ballistët kur mundnin. Luftë, bir! — tha ajo.

Pas pak Rubi hyri përsëri me vrull. Kësaj radhe ajo mbante në duar një helm të gjermane, mbushur me dhé. Aty ishte mbjellë një lule. E vuri helm tën me kujdes në pezulin e dritares dhe tha:

— Dimri i than lulet jashtë!

Por herën e tretë apo të katërt Rubi nuk u fut me vrull. Kjo s'kishte ndodhur kurrë më parë. Ishte futur gati e padukshme, e lehtë, e urtë, e butë si një paqë. Xhako Rina e vuri re menjëherë këtë ndryshim: jeta partizane e kishte kthyer në një njeri shumë të ndjeshëm. Ajo eci ngadalë drejt vatrës, ra në gjunjë pranë Isës dhe i pëshpëriti:

— Isë!

Isa mbeti me lugë në dorë dhe shikoi teze Rubin në heshtje.

— Isë, — tha ajo dhe i përkëdheli shpatullat me dorën e saj të rëndë e të rreshkur nga puna. — A bëhesh djali im?

Isa, që e ndjeu se këto fjalë të teze Rubit s'kishin



qenë as thjesht përkëdhelje dhe as shaka, uli lugën dhe e gjithë fytyra e tij e njomë, sytë e kaltër, që xixëllonin nga zjarri, formuan një pikëpyetje, që kthehej herë nga teze Rubi herë nga komisari. Gjatë këtyre dy javëve që brigada kishte qëndruar e luftuar në Mushibë, ai e kishte ndier në çdo hap afërsinë e teze Rubit e kishte krahasuar me nënën e vet dhe kishte qenë vazhdimisht i prirur ndaj saj.

— Unë nuk e di, nuk e di, — tha Isa më në fund, me një zë që i dridhej nga padija e nga një gëzim i fshehtë.

— Ti e di që unë kam mbetur vetëm, — tha Rubi me një zë të thellë si t'i pikonte helm e trishtim — edhe ti... — Ajo nuk e plotësoi mendimin. — Të rrojmë bashkë. Ti të martohesh, unë të rrit nipërit.

Pasoi një heshtje.

Edhe Xhako Rina me këshilltar Danin kishin ndërprerë vetiu të ngrënë dhe shikonin nga vatra. Por dukej qartë, sado që heshtja të zgjatej, Isa nuk do të dinte t'i përgjigjej kësaj pyetjeje pa ndihmën e komisarit. Andej shikoi. Andej shikoi edhe teze Rubi. Dhe që të dy prisnin përgjigje. Por megjithatë, ose i zbriti vetë Isës një mendim i ri, ose e lexoi atë në fytyrën e komisarit, pas pak tha:

— Komisari ka thënë se unë do të shkoj në shkollë. Do të bëhem oficer ose inxhinier!

— Ani çka, ti shko në shkollë dhe bëhu oficer, unë punoj dhe rrit nipërit e mi. Si thua mirë?

Zgjati një heshtje.

— Hë, Isë? — pyeti Rubi.

Lugët e Canit e të Shegës tringëllinin në çanakun prej alumini.

— Hë, Isë? — pyeti ajo prapë.

— Mirë, — tha pas pak Isa, që kishte vënë re buzëqeshjen e komisarit dhe vetiu hodhi njëren dorë në qafën e teze Rubit.

Teze Rubi e përkëdheli me dorën e rëndë në flokët e shkurtër pastaj e përqafoi Isën, e puthi në faqet e skuqura nga emocioni dhe nuk pati më fuqi të thoshte asnjë fjalë. Pas pak ajo doli nga dhoma, por jo me

vrull si zakonisht, por doli siç kishte hyrë, ngadalë, e urtë, e butë, e pandjeshme dhe e gëzuar si një fitore.

Xhako Rina buzëqeshi. Këshilltar Dani dukej i kënaqur. Pikëpyejtet ishin zhdukur nga sytë e të gjithëve. Dhe të gjithë vazhduan të hanin e të pinin ujë, sepse aso kohe mund të ndodhte që gjellët të ishin me kripë shumë.

Pas pak erdhi aty babai i dy fëmijëve, njeriu pa një vesh Tush Sojani. Ai u ankua se nëpër ara kishte filluar të lëvizte derr i madh kurse ata që i trembnin e që u binin teneqeve ishin të paktë e të rrallë. Por, kësaj radhe, çështja e derrave të egër, hëpërhë doli në plan të dytë, sepse në dhomë u fut Rubi, me një tabaka me filxhanë dhe njerëzit që u ndodhën aty, pinë të gjithë kafe për Isën e për Rubin, që ajo e kishte bërë bir në shpirt. Kurse atje te vatra, vajza e vogël, Shega, pasi hëngri bukë, futi gishtin e madh në gojë dhe me gishtin tregues të dorës tjetër kërkoi një sy për të rrëmuar. Por i vëllai, Cani, nuk pranoi: ai ishte pesë vjeç. Pranoi me qejf Isa, se Isa ishte katërmbëdhjetë vjeç. I zgjati syrin ndërsa buzët e Shegës bënë lullu-llu...llu-llu...

I pari qeshi komisari me të qeshurën e tij njëtonëshe. Pastaj Dani. Pastaj teze Rubi. Dhe në fund i ati, Tush Sojani, që përveç Canit e Shegës dhe Hedijes, kishte edhe dy fëmijë të tjerë, lënë te ca kushërinj në një fshat të thellë.

23.

U kuptua menjëherë se dita e tretë do të ishte vendimtare për betejën e Mushibës — në fakt fatin e saj e kishin vendosur sulmet e kundërsulmet e ditës së dytë



— dhe ishte më se e qartë se dita e tretë do të shë-  
nonte fundin e plotë të forcës armike dhe për këtë ki-  
shin pjesën dhe meritën e tyre edhe përforcime të tjera  
që, me urdhër të Komandës Eprore, kishin ardhur në  
ndihmë të brigadës.

Kështu, ditën e tretë të gjitha të dhënat flisnin për  
fundin e pashmangshëm të gjermanëve, që, pasi kishin  
hequr dorë nga kundërsulmet, bënë luftë të dëshpëruar  
vetëm në rrugë. Por që ky fund të vinte sa më parë,  
u vendos të bëhej sulmi vendimtar i gati një mijë e  
pesëqind partizanëve dhe vullnetarëve të fshatrave aty  
rrotull. Të gjithë e merrnin me mend se ky sulm do të  
kishte edhe anën e tij të bukur, poetike, anën e tij he-  
roike, kur në një çast të caktuar do të ngriheshin në  
këmbë një mijë e pesëqind partizanë e vullnetarë e  
do të lëshoheshin tatëpjetë mbi gjermanët. Ky sulm  
nuk mund të ishte i befasishëm, se gjermanët, duke u  
nisur nga logjika më elementare e luftës, duhej ta pris-  
nin atë nga njëri çast në tjetrin, por, që të ishte i fuqi-  
shëm, shkatërrimtar dhe i pandalshëm, shtabi i brigadës  
vendosi të largonte nga sulmi të gjithë ata partizanë që  
kishin marrë ndonjë të ftohtë, ata që rryma e luftës  
dhe sidomos e betejës së fundit i kishte dobësuar, i ki-  
shte lodhur fizikisht, fundja edhe ndonjë të plagosur  
lehtë, që s'kishte dashur të largohej nga vija e frontit.

Kështu ndodhi, në vazhdim të seleksionimit të for-  
cave, Xhako Rina, që zakonisht e mbante pranë Isë  
Brezarin, jo për ndonjë sentimentalizëm, por sepse ishte  
pionier dhe e kishte treguar me prova se ishte kokë-  
shkretë dhe s'para e merrte parasysh rrezikun, i tha  
Isës të qëndronte me të tjerët, me të sëmurët.

- Pse-e? — pyeti Isa më se i çuditur.
  - Mjaft ke luftuar, Isë, — tha komisari.
  - Unë s'dua të ndahem nga shokët.
  - Kjo është beteja e fundit!
  - Pikërisht, pse është e fundit, s'dua të ndahem!
- Xhako Rina e kishte kuptuar që në fillim të bisedës  
se e vërteta dhe e drejta ishin me Isën dhe, sado që ai



u ruajt nga sentimentalizmi, prej tij nuk kishte qenë e mundur të shpëtonte.

— Por unë nuk dua! — tha ai. Në të vërtetë ai donte t'i thoshte: «Nuk dua të rrezikohesh në betejën e fundit.» Por këto fjalë ai s'mund t'ia thoshte, sepse ato nuk ishin të logjikshme, sepse Isa vërtet ishte pionier, por, para së gjithash, ishte partizan dhe, si çdo partizan, ai nuk mund të dëshironte në asnjë mënyrë t'i shmangej betejës së fundit. Megjithatë, komisari s'deshi të hiqte dorë kaq shpejt nga qëllimi i tij.

— Dëgjo, Isë, — tha ai.

— Të dëgjoj, shoku komisar.

— A më ke vëlla të madh?

— Po, — tha Isa, — ti e di që të kam vëlla të madh!

— Atëherë duhet të më dëgjosh!

— Jo, unë s'dua të veçohem nga shokët!

Në këtë pikë të dialogut Xhako Rina pati një çast mallëngjimi, një çast ekzaltimi të plotë dhe ai u bë gati të tërhiqej, por shpejt e rrëmbeu sërish dëshira për ta ruajtur Isën, e rrëmbeu sërish ajo që nuk dihej ç'ishte, një si parandjenjë, që ndoshta e kishte burimin te vetë pagjumësia dhe lodhja e komisarit (se edhe komisari njeri ishte si gjithë të tjerët).

— Isë, kjo do të jetë një ndeshje e rëndë!

— Mos ajo që bëmë këtu dy ditë me radhë dhe ato që bëmë dimrin e kaluar në Malet e Shqipërisë nuk qenë të rënda?

— A nuk i ke lexuar komunikatat tona se bishat bëhen shumë të rrezikshme kur u vjen fundi?

— I kam lexuar, — tha Isa.

— Kjo do të jetë një betejë trup me trup.

— Po ajo e qafës së Murrizit a s'që një betejë trup me trup?

Pasoi një heshtje.

— A s'të kujtohet, — vazhdoi Isa, — kur gjermani më vërviti mbi kokë kondakun, por unë u hodha matanë, i dola fët e fët nga prapa dhe e vrava, ja, me këtë revole?

Ç'ti thoshte më Xhako Rina këtij Ise? Por i tha edhe një herë gati si një thirrje:

— Je i vogël, Isë!

I tha dhe u pendua, se e dinte që Isës, si çdo pionieri tjetër, nuk i duhej thënë kjo fjalë. Isa mbushi sytë me lot dhe tashmë ishte e qartë se mund të thyente edhe disiplinën partizane. Me kaq Xhako Rina vendosi të tërhiqej, por pa e thënë fjalën «mirë».

Sulmi, ai që kishte marrë emrin *sulmi i përgjithshëm*, u bë në kohën e caktuar. Dhe ai doli ashtu siç ishte parashikuar. I tmerrshëm dhe madhështor. Një mijë e pesëqind partizanë e vullnetarë u ngritën në këmbë, thirrën dhe u lëshuan tatëpjetë njëherësh. Ndërkohë kishin dalë nga pozicionet e tyre edhe gjermanët dhe një minutë më vonë dy fuqitë lëvizëse u ndeshën trup me trup. Të dyja palët ishin të zemëruara e, nga zemërimi, ndeshja u bë me të gjitha mjetet e mënyrat. Partizanët, që tashmë ishin më të shumtë, binin nga lart dhe fare shpejt fusha e betejës u kthye në një rrokullisje të pafund. Pati zigzage, tërheqje e përparime, pati edhe ndonjë stepje të thellë, sidomos në një sektor, kur panë kufomën pa sy të mitraljerit të kompanisë së shtabit. Por stepja nuk zgjati shumë, sepse ajo shpejt u kthye në të kundërtën e vet dhe partizanët u hodhën në sulm me thirrje të njëpasnjëshme, që, tek e fundit, u bashkuan në një thirrje e në një jehonë të vetme. Nuk u deshën më shumë se tridhjetë minuta që gjermanët të shkuleshin nga kodrat e të mblidheshin tërësisht mbi rrugën automobilistike, ku qëndresa e tyre ishte më se e dëshpëruar. Dhe mund të ishte (dhe ishte) minuta e fundit e betejës, kur Xhako Rina thirri:

— Para, partizanë!

Isa ndiqte komisararin. Ky ishte një zakon i vjetër i luftës së tyre. Atje ku ndodhej komisarari, patjetër do të ndodhej Isa. Xhako Rina sapo kishte zbritur në rrugën automobilistike, sapo kishte kapërcyer dy të vrrarë, befas, njëra nga «kufomat» lëvizi, futi dorën në xhepin e



vogël të xhaketës dhe nxori një revole të vogël, që shkëlqeu në rrezet e vrara të diellit.

— Komisar, ruhu! — thirri Isa dhe ra mbi oficerin gjerman si një shqiponjë e vogël, që s'ka mësuar akoma të gjuajë, por ndërkaq lulja e egër ishte shpupurishur nga veshi i Kozma Petit dhe kondaku i pushkës së tij ia kishte ndarë kokën më dysh oficerit. Isës i erdhi për të vjellë kur pa trurin të rridhte e të përzihej me baltovinat e asfaltit e të luftës.

— Dukej si i vdekur! — tha Isa.

— Histori të vjetra, ashtu shtiren, — tha Kozmai.

Për Xhakon, Isën dhe Kozmanë ky kishte qenë episodi që mbyllte ditën e tretë e të fundit të luftës. Ishte as mesditë, as mbrëmje. Pas këtij episodi, ku Isa shpëtoi Xhakon dhe Kozmai shpëtoi Isën, lufta ishte copëtuar gati në të gjithë vijën e frontit prej më së tre kilometrash. Kundërsulmi i përgjithshëm, që zgjati më pak se një orë, kishte marrë fund. Pastaj u zhvilluan përpjekje të veçuara. Pati akoma disa vatra zjarri, të cilat erdhën duke u shuar. Duke u shuar erdhën edhe britmat. Së fundi mbeti një mitraloz. Pastaj një pushkë. Dhe breshëria e ndërprerë e një automatiku, si t'ia kishin zënë grykën me shtupë. Së fundi, pas gjashtëdhjetë e ca orëve, rrugën automobilistike dhe kodrat përreth saj i mbuloi një heshtje tingëlluese, që prishej hera-herës nga disa thirrje të përbashkëta për fitoren e për luftën që kishte mbaruar me gjunjëzimin e nazistëve.

Kështu u fiksuan ato çaste që për Mushibën shënuan fundin e një bote dhe fillimin e një tjetre. Pastaj nisi ai, që mund ta quajmë takimi i madh, që s'dihet kush e filloi, por dihet që nuk mbeti partizan pa u për-qafuar e pa u puthur. Dhe sikur rruga të mos ishte mbushur me tërë atë rrangallë lufte dhe me tërë ato kufoma, mund të besoje fare lehtë se ndodheshe në një dasmë me përmasa të papërfytyrueshme.

U deshën të kalonin akoma disa minuta që të mund të fillonte interesimi për mbeturinat e gjalla të ushtrisë naziste, të cilat, megjithëse gjatë tërë kohës aty rrotull

kishin qenë, vetëm tashti zunë t'u binin në sy partizanëve. Ata dilnin një nga një ose në grupe prapa ndonjë kamioni, tanku të djegur apo topi të rrëzuar dhe dorëzoheshin me duart lart. Midis tyre kishte nga ata që vazhdonin të shikonin pa frikë, bile me egërsi e pabesi tepër të dukshme. Veç që ishin të hutuar, si të kishin rënë në një botë të panjohur. Këtë tip (tipin e egër të armikut) partizanët kishin pasur rast ta njihnin mirë gjatë tërë luftës dhe ky lloj tipi nuk i çudiste aspak. Por kishte edhe të tjerë, të cilët kishin pësuar një metamorfozë të thellë dhe ishte e tmerrshme të shikoje frikën në sytë e tyre. Ata që deri pak kohë më parë vdisnin me «Heil Hitler», ata që deri një orë më parë, deri një minutë më parë hidheshin me tërbim kundër nesh, tashti s'përfaqësonin më veçse një hiç. Dridheshin dhe luteshin me të gjitha mënyrat, veç të mos i vrisje, veç të ktheheshin gjallë në Gjermaninë e tyre, pranë njerëzve të tyre, fundja, veç të jetonin, pa bërë asnjë llogari të mëtejshme. Pothuaj të gjithë ose shumica e tyre kishin ruajtur nëpër xhepa dokumente identifikimi, të cilat i shpalosnin me kujdes e me duar të dridhura, për të vërtetuar ty, armikut, partizanit, se (i pari) ishte i biri i një punëtori nga Silezia apo Dusseldorfi, se (i dyti) e kishte pasur dikur të atin në Partinë Komuniste të Gjermanisë, ose më shkurt (i treti) ishte austriak dhe jo gjerman, i cili gjithnjë i kishte urreyer gjermanët. Ai (i katërti) s'ishte veçse një djalë gjashtëmbëdhjetë vjeç, ja, shikoje çertifikatën, herr partizan, herr komisar, po nuk besove. Mamaja ime (i pesti), për mosbindje të ligjeve naziste, ka qenë tre vjet në burg, ja dokumenti. E kështu me radhë. Por më i rëndësishëm ishte fakti se kishte ardhur një çast që pas katërmëdhjetë muajsh, tërë ajo madhështi, tërë ai pompozitet dhe shkëlqim çeliku, çizmash dhe helmetash, banderolash dhe kryqesh të thyera të vjeshtës së vitit 1943 — të gjitha këto shkëlqime tashmë ja si ishin katandisur në një grumbull kapotash jeshile të shkalfitura e të lodhura, ngarkuar me baltë e shi. Po megjithatë duhet shënuar se tërë ata ushtarë të huaj, të



cilët për vite me radhë kishin qenë egërsira, tashti ishin bërë ose po bëheshin përsëri njerëz, por njerëz të ve-gjël...

Dhe kur erdhi në këtë pikë të shënimeve të tij, Xhako Rina përfytyroi këtë episod:

— Shoku komisar, — tha një partizan, ndërsa tregonte me dorë e me sy kapotën e tij të vjetër dhe ka-potën e re të një nënoficeri gjerman.

— Po, — tha Xhako Rina dhe urdhëroi t'i hiqnin kapotën nënoficerit. Po, kur ia zhveshën, dikujt i zuri syri një thikë, që varej në rripin e pantallonave të gjermanit. Njëri nga partizanët e zuri thikën nga milli dhe e nxori nga këllëfi. Atëherë të gjithë e vunë re se nëpër tehun e saj ishte shkuar cepi i gunës së mitraljerit të sapovrarë e të mbetur pa sy. Ishte vësh-tirë të merrej me mend pse ajo copëz gunë kishte mbetur aty: ndoshta nga pakujdesia e nga rrëmbimi, ndoshta ngaqë kishte harruar ta hiqte në kohën e duhur, ose për njëqind arsye e shkaqe të tjera, por, sidoqoftë, rëndësi kishte fakti që ajo copëz nga guna e partizanit të vrarë e pa sy ishte aty, në tehun e thikës dhe bile ishte e përgjakur, siç ishte e përgjakur edhe vetë thika.

Pasoi një heshtje dhe në fund të kësaj heshtjeje Xhako Rina tha:

— Merreni!

E morën. Nënoficeri u tregua i bindur dhe i nën-shtruar. Ai e dinte çfarë e priste. Ai ndoshta e mori me mend edhe ferrën ku mund ta pushkatonin, se jo më kot eci vetë drejt saj.

...Xhako Rina shkruante dhe në të njëjtën kohë mendonte. Rastësi ta quajmë këtë zbulim? A nuk mjaftonte që ajo ishte një ushtri agresore? Të gjithë ata janë të krimbur me «rastësi» të tilla. Dhe ne duhet t'i mbajmë robër. Nuk duhet t'i pushkatojmë. Dhe nuk do t'i pushkatojmë...



Aty përballë opingat e mëdha të këshilltar Danit nuk lëviznin. As shkopi me gëzhgojë në majë nuk lëvizte. Me një nuhatje të çuditshme, që ndoshta e kishte burimin në fytyrën, në gjestet e në vështrimin e syve të përhimtë, por të ngrysur e të errësuar të komisarit, po edhe në qëndrimin e bustit të tij të hollë e të gjatë, si pemë e përkulur nga era — nga të gjitha këto, këshilltar Dani kishte kuptuar se nuk duhej të bënte lëvizje të kota, nuk duhej ta thithte cigaren, nuk duhej që tymi të shkonte para syve të komisarit dhe, jo se jo, nuk ishte kurrsesi e lejueshme për Danin, si njeri politik dhe luftëtar i orëve të para, që pikërisht në këto çaste t'i fliste apo t'i kujtonte komisarit çështjen e derrave të egër, që tashmë mund të kishin filluar të hanin bukën e ushtrisë e të popullit.

Por komisari foli vetë:

— E di ti, Dan, ç'ndodhi pas mbarimit të luftës?... Erdhën pesë aeroplanë anglezë, që fluturonin në vijë të drejtë, njëri pas tjetrit, kur papritur aeroplani i parë u kthye anash dhe filloi të mitralonte e të bombardonte partizanë e robër. Isa (komisari shikoi nga Isa që flinte sërish) që kishte dëgjuar krismat e para të mitralimit dhe gjëmimet e ndonjë bombe, u hodh nga rruga në një përrua të vogël, për t'u futur pastaj nën urë. Por më parë ai u hodh mbi një ferrë të dendur, ku, për çudinë e tij, ra mbi diçka të butë, që tundej e dridhej e që s'ishte tjetër veçse një gjerman i armatosur. Atëherë Isa vuri re se në ferrë kishte gjermanë të tjerë, të fshehur e të armatosur. Më në fund Isa e mblodhi disi veten dhe deshi t'u drejtonte automatikun, por ferra nuk e lejonte të bënte as lëvizjen më të vogël të krahut. Atëherë ai priti derisa aeroplanët të mbaronin mitralimin e bombardimin dhe pastaj thirri për ndihmë. Por s'qe nevoja, gjermanët dolën vetë një nga një, ndërsa... Isa erdhi pranë meje, theu giunjët dhe me marifet u mbështet tek unë gati pa ndjenja. U bë shkak kjo ngjarje që t'u futeshim ferrave e të zbulonim dyqind gjermanë të tjerë, përveç atyre që na ishin dorëzuar vetë.

Dani tundi kokën, thithi cigaren thellë dhe ngjeshi geleshen deri në veshë, si për të treguar se s'kishte gjë për të thënë, por kishte për të pritur.

Komisari shkroi gjatë dhe pastaj erdhi radha të shkruante këta rreshta:

*Shumica e kufomave të gjermanëve ishin zhytur në baltovinat e përroit e të hendeqeve. Ata ishin bërë baltë. Dhe ashtu të zhytur, kufomat e tyre kishin marrë poza nga më të çuditshmet...*

— Sikur ngece prapë, komisar, — tha Dani pak më vonë dhe tundi kokën në shenjë qortimi. Vetëm gëzhoja e fishekut në majën e shkopit të thantë e të rëndë lëshoi ca vezullime e ca zhurma që mund të merreshin edhe si vazhdim i bisedës, edhe si vazhdim i qortimit. — Ngece! — përsëriti ai. — Prapë ngece!

— Prapë, — tha komisar. — Nesër Tirana pret raportin për luftimet në Mushibë, kurse tashti që arrita në fund të raportit, e shoh se për një mijë e pesëqind e ca të vrarë këtu, për treqind të vrarë atje para ministrive, për katërqind robërit i kam të qarta mendimet, por më duhet pa tjetë të them diçka për qindra gjermanët e hu-mbur. — Këto tha komisar dhe mënyra si i shqiptoi, mënyra si e shikoi Danin, u duk sikur ishte vazhdim i asaj të fshehte, të cilën ai e kishte parë vetë disa herë në sytë e në fytyrën e Danit.

Dani tha:

— Ata gjermanë, thuaj, komisar, zëre se ishin njerëz dhe u bënë derra të egër që morën pyjet!

Kësaj radhe Xhako Rina e hodhi vështrimin papritur në fytyrën e Danit dhe bëri prapë çudi me vete. Sa herë që Dani fliste për gjermanët e humbur dhe sa herë që zinte në gojë derrat e egër, po ajo fshehtësi, po ajo domethënie e po ai lloj nënkuptimi endej mbi fytyrën e tij, që drita e llambës e tregonte herë faqelëshuar, herë faqemuskuloz.

— Por s'janë derra, janë njerëz, — tha Xhako Rina, duke u dhënë fjalëve një theks të veçantë. — Janë armiq. Qindra armiq të padiktuar në tokën tonë, që mund



të bëjnë ndonjë hata të fundit. I kishim aty në rrugë dhe...

— Dhe na ikën, do të thuash ti. Lufta, komisar, u bë e ngatërruar. Dihet që gjatë tri netëve ata kaluan prapa kurrizit tonë në grupe të vogla, u fshehën nëpër kaçuba dhe, kur ua donte puna, dilnin nga ferrat, bënë ndonjë vrasje prapa kurrizit dhe fësht, përsëri merrnin pyllin përpjetë. Pse nuk thua që mbetën andej, pse nuk thua që rrojnë me koçimare e lende dushku, pse nuk thua që ishin gjermanë dhe pastaj u bënë derra?! — Kësaj radhe këshilltar Dani as që kishte bërë përpjekje për të fshehur atë diçka të veçantë që i endej nëpër fytyrë sa herë zinte në gojë gjermanët dhe derrat e egër.

— Besoj, Dan, se këta lloj derrash, për të cilët flet ti, ne do t'i kapim së shpejti! — tha komisar, pa dhënë asgjë të kuptohej më tepër.

— Po kur, pra?

— Të shohim!

— Filloi të lëvizë de-rrri, ko-mi-sar. Jo vetëm derri, por edhe gjermani. Një nga ata iu dorëzua Rubit, një tjetër Tush Sojanit.

— Po, Dan, mund të kenë filluar të lëvizin edhe derrat, edhe gjermanët!

Kjo mbështetje që u bëri komisar fjalëve të Danit, sikur e ngrohu më tepër këtë të fundit. Vuri njërin opingë mbi tjetrën, opingën e këmbës së shëndoshë mbi opingën e këmbës së shkurtër, kaloi pëllëmbën me kallo, përgjatë shklopit të lëmuar nga vitet dhe... heshti... Por heshti i kënaqur dhe i bindur se do të vinte një çast, që do të bëhej siç thoshte e siç donte ai. Dhe tha:

— Unë them sikur t'i nisim korrierët për të bërë lajmërimin!

— Sapo të kem mbaruar raportin, do të jetë afruar jacia, partizanët mund të kenë fjetur edhe ca.

Dani, tashmë i kënaqur disi nga kjo gjysmëmarrëveshje, tha:

— Të mbarosh punë, komisar, të flesh pastaj. Derrat e egër i gjuaj unë me partizanët, me komandantët e ko-

misarët e tjerë... E shoh që je i lodhur. Po thua ti, jo, komisari s'duhet të lodhet. Por ja që lodhet!

Në xhamin e dritares rrëshqiti një gjethe e tharë fiku dhe u dëgjua kur era e mori me vete nëpër oborr. Jashtë, mendoi Xhako Rina, vazhdon procesi i zhveshjes së natyrës. I bukur nuk është, por është madhështor. Fenomen, tha ai me vete atë fjalë, që e kishte radhitur aq herë në shtypshkronjë. Dhe ndjeu dhimbje në kurriz. Dimri do të jetë i ftohtë, sidomos për njerëzit pa strehë. Por duhet patjetër t'i ndihmojmë, t'u ngremë hëpërhe nga një dhomë para se brigada të jetë larguar nga fshati. Nesër, partizanë, popull e robër, o burra në sulm për jetën e re...

— Të pimë nga një cigare, — tha këshilltar Dani, — pastaj ti çlodhu, kurse mua më jep batalionin që ndodhet këtu rrotull e të nisem menjëherë. Sa të zëmë vendet sa të fshihemi, ndërkohë është bërë tamam për gjuetinë e derrit të egër. — Kështu tha Dani dhe që nga minderi i hodhi komisarit një cigare të dredhur, e cila, pasi u rrokullis mbi tavolinë, zuri vend përmbi një fletë të zhubrosur, ku ishin shkruar numrat:  $+3000 - 2200 = +800$  gjermanë të humbur.

Komisari e futi cigaren në gojë, e ndezi te poçi i llambës, befas e ngriti fletën e 800 gjermanëve nga tavolina, e bëri si zar të rrumbullakët dhe e hodhi pikërisht pranë opingave të mëdha e të palëvizshme të këshilltar Danit. Ky i fundit e batisi dhe, kur hoqi opingën, zari gati ishte zhdukur.

— Ç'hodhe kështu, komisari?

— Pse më pyet?

— Të pyes se të pashë që e shkëpute me inat!

— Hodha gjermanët e humbur!

— A, ashtu, ë? — tha Dani dhe opinga e madhe dhe e rëndë ra sërish mbi mbeturinat e letrës, gati të zhdukur pa lënë gjurmë.

— Edhe ti, sikur e shtype me inat atë copë letër! — tha komisari me vështrimin të ngulur në fytyrën e Danit.

— Nuk i shtypa, jo, — tha Dani. — Ata janë robër. Robërit ne do t'i kthejmë në Gjermani pranë familjeve të



tyre. Po u kam vënë këmbën përsipër që të mos më ikin. Se ja, këtu rrotull janë. Ç'bënë derrat, ç'bënë gjer-manët! — tha ai me zë të zakonshëm. — Hala këtu rrotull i kemi. Hala!

— Krrap, krrap, krrap, — imitoi komisari derrat e egër ose këshilltar Danin.

— A-a, të lumtë goja, komisar! — tha Dani. — Krrap, krrap, krrap!

24.

...Kur unë sapo isha ndarë nga nëna jote dhe ajo më porositi, kujdes nga Tolluzët, se janë ballistë e spiunë, befas më doli përpara një trup i madh, që në errësirë mund të dukej edhe më i madh nga ç'ishte, me kokën në tjegullat e murreve, me shpatullat e gjera sa dy veta bashkë e me grahmën e rakisë e të verërave që kishte pirë. Por nuk ishte i dehur. Bile as çakërcejf nuk ishte. Jam Albert Tolluzi, më tha dhe shtoi, a do të vish të flesh sonte me mua? Kam dëgjuar se ai Xhakoja yt i ndërron partizanet çdo natë, si mbreti gratë, kurse ti, moj qyqare, e pret të të kthehet fitimtar. Pa më thua, ç'pate që u fejove me një punëtor, kurse vetë je kaq e bukur dhe se shpejti do të bëhesh edhe mësuese? Tashti je ilegale dhe lufton kundër nesh, ë?! Mos pandeh ti, moj Radije, se ne hamë bar e s'marrim vesh asgjë? Këto më tha dhe, si pa të keq, më zuri për dore. Ai nuk e pa, se ishte errësirë, kur unë, me

dorën tjetër, nxora revolen nga xhepi i pardësytë dhe ia vura grykën në bark. Isha e qetë, tashti Albert Tolluzit i kishte ardhur fundi dhe me këtë vrasje, do të plotësoja detyrën që na ishte ngarkuar nga Komiteti Qarkor i Partisë, se Tolluzët atë e bir ishin dënuar me vdekje. Ai nguli këmbë, a do të vish pra sonte me mua? Unë ngrita ngadalë këmbëzën e revoles dhe diçka m'u drodh përbrenda. Ti e di, ishte atentati im i parë. Mendova: Po sikur të mos më ndezë revolja? Ai më tha prapë, hajde të flesh me mua, po të duash të shpëtosh nga vdekja e nga internimi, si e fejuar partizani që je. Unë mbështeta gishtin në këmbëz. Fundi. Revolja nxori një krismë të mbytur. Ai nuk u rrëzua menjëherë, por hapi krahët e gjatë anash, si për të mbajtur drejtpeshimin. Me krismën e dytë, jo më në bark, por në gjoks, Alberti u rrëzua praptazi dhe zuri të tundte këmbët, si ato breshkat kur mbeten në kurriz...

Xhako Rina, me ballin të rënduar, siç duken njerëzit para kufomave, por edhe me shenja të një buzëqeshjeje të lehtë, e palosi letrën e Radijes, e futi në çantë (prej nga e kishte nxjerrë padashur bashkë me disa shënime të tjera për raportin që shkruante atë natë) dhe një copë herë mbeti i menduar.

Dan Zavalli gërvishti dyshtemenë me majën e shkopit (si për të tërhequr vëmendjen e Xhakos) dhe pastaj tha:

- Veç mendohesh e mendohesh, komisar!
- Ah!... Vërtet mendohem!
- Gjithë ato mendime!
- Tri ditë më parë mbaruam luftën dhe tashti...
- Cfarë tashti?
- Tashti kemi kohë të mendojmë.
- Po sikur po mendoje diçka të rëndë.
- Ku e more vesh ti? — pyeti Xhako Rina
- Edhe sytë t'u bënë si të përhumbur.
- Jam i lodhur, Dan.



— Ashtu vërtet. I lodhur je. Po, kur këndove atë letrën që palose dhe e fute prapë në çantë. në fillim u ngryse, pastaj sikur të shkëlqeu fytyra. Unë thashë, kushedi çfarë këndon në atë letër, kushedi ç'i paska ndodhur komisarit. Ka edhe ai hallet e veta si të gjithë ne. Nuk është vetëm komisar. Nieri është. Kështu mendova, — tha këshilltar Dani dhe e thithi thellë tymin e cigares, i kënaqur, se fundja edhe komisari ishte i kënaqur.

Si t'i kishte pritur me kohë këto fjalë, buzëqeshja e Xhakos u hap, u bë e plotë.

— E po kështu, komisar, të pashë një herë sonte me buzën në gaz!

— Po, Dan, është e vërtetë, në fillim u ngrysa, pastaj më erdhi si për të qeshur.

— Ashtu na vjen të gjithëve. Për të qarë e për të qeshur, si të qëllojë. Jetë i thonë. Çfarë s'ka në jetë e çfarë nuk i ndodh njeriut. Puna është të rrojë me nder e të mos u bëhet urë të tjerëve.

Xhako Rina e shikoi Danin, siç shikojmë njeriun që na gjen mendimet. psherëtiu dhe tha:

— E di pse buzëqesha, Dan? Lexova një letër të Radijes. E mban mend Radijen, të fejuarën time, kur erdhi këndeje vitin e kaluar e më takoi atie ku po u bënim një pritë italianëve dhe me atë rast luftoi edhe ajo bashkë me ne? S'të kujtohet?

— Si nuk më kujtohet Radija?

— Ajo pra e vrau Albert Tolluzin disa muaj më parë.

Dani mblodhi njëren këmbë dhe, në vend të saj, zgjati shkopin. Pastaj tha:

— Na e kanë pasur frikën. posi. Kur e ka dashur puna, kemi luftuar e kemi fituar kundër tyre, përndryshe ne fukaraja do të qemë shuar me kohë nga lakmia e tërbimi i agallarëve e bejlerëve.

Dhe, po me atë pamje të ekzaltuar, dëgjoi pastaj letrën e Radijes. Kur komisari e lexoi letrën deri në fund. Dan Zavalli befas mblodhi këmbët e shkopin në prehër dhe ia plasi një gazi, që i detyroi partizanët në

dhomën tjetër të heshtnin një copë herë e të mbanin vesh. Dani qeshte e fshinte sytë nga lotët, qeshte e sikur qante nga gëzimi.

— C'pate, Dan? — e pyeti Xhako Rina.

— Ç'të kem, komisar, — tha Dani, — ja ashtu, duke bluar nëpër mend historinë tënde me Tolluzët e historinë e fashistëve me Shqipërinë...

— Sigurisht, për të qeshur të vjen!

— Në fillim u lëshuan mbi ju Tolluzët e ju morën shtëpinë, u lëshuan mbi ne italianët e gjermanët, na pushtuan Shqipërinë dhe bënë si u desh qejfi. Pastaj iu lëshuan ne të dy palëve, fashistëve e Tolluzëve, e, megjithëse ishim më të vegjël se ata, varda-a-a!

— Tamam! — tha Xhako Rina, që edhe ai qeshte tashti për Tolluzët e për fashistët e mundur.

— Ja, ç'të shkojmë larg, shiko Mushibën si e përsuan. Se mos u shkante në mendje se do të mbaronin kështu?

— Aspak. Kjo është e keqja, që nuk u shkante në mendje. U nisën për të pushtuar botën, por s'hëngrën dot as Shqipërinë, që u dukej një hiçgjë!

— Paskan qenë budallenj, pra, — briti Dani. — se duhej të na kishin njohur më mirë. S'është hera e parë që Shqipëria bën luftë kundër pushtuesve e kundër Tolluzëve!

— Budallenj nuk mund t'i quajmë, Dan, por ishin të dehur nga fuqia e tyre.

— Baçi im thoshte, askuit mos iu tremb, po pate të drejtën me vete. Sado i madh e i fuqishëm qoftë tjetri, thoshte ai, do të vijë dita që do ta mundësh.

Sakaq, aty pranë vatrës Isa dremiste. Cani dhe Shega flinin të qetë, sic mund të flenë vetëm fëmijët.

Pasi kishte kaluar një kohë, Dani tha po ato fjalë që kishte thënë një herë:

— Ashtu thoshte baçi im, askujt mos iu tremb.

— E drejtë, Dan, — tha komisar, pa i ngritur sytë nga raporti.

Heshtën prapë gjatë. Dhe pastaj Dani tha me keqardhje:



— Vetëm në një gjë na kanë mundur.

— Në ç'gjë, Dan? — pyeti dhe e shikoi i çuditur Xhako Rina.

— Me shkollat! — tha prerë Dani. — Kanë bërë shkolla e kanë kënduar libra, qentë!

Xhako Rina e shikoi prapë i çuditur dhe diç deshi t'i thoshte, por heshti, me pamjen e njeriut të pasigurt për ato që duhej t'i thoshte.

25.

Në dhomë u fut një nuse me një fëmijë në krah, e cila, në vështrim të parë kishte dy gjëra: bukurinë dhe rininë. Ishte veshur me jelek, që s'ishte më i ri, por i pastër e me çitjane, që dikur duhej të kishin pasur ngjyrë manushaqe. Kokën e kishte lidhur me shami, nën të cilën i varej një krelë e zezë flokësh që i bashkohej me vetullat po aq të zeza. Nusja mbante erë borzilok.

— Të erdhi nusja, Dan. — Xhako Rina u ngrit në këmbë tërë gëzim dhe i shtrëngoi dorën.

Nusja u ul në cep të minderit pranë vjehrrit, fëmija zgjati duart drejt gjyshit, Dani e mori në prehër, e përkëdheli dhe pastaj pyeti nusen, pa e shikuar në sy:

— Ç'të solli këtu?

— U bëra merak për ty, babë! — tha ajo.

Me 'sa duket fëmija u mërzit shpejt me baba-gjyshin, lëshoi disa zëra e tinguj të pakuptueshëm, zbriti nga prehri i Danit dhe zuri të ecte duke u mbajtur pas minderit.

— Nuse, sa muajsh ta la Kadriu djalin? — e pyeti Xhako Rina.

— Kur doli partizan, ishte prilli i këtij viti, — tha ajo e skuqur, sepse nuset e reja as duhej t'ia zinin me gojë emrin burrit dhe as duhej të bisedonin për të. — Tashti ky u bë gjashtëmbëdhjetë muajsh.

— Të shkruan shpesh?

— Në letrën e fundit më shkruante se brigada e tyre po nisej për të luftuar gjermanin në Dibër e në Kukës.

Fëmija lëshoi duart nga minderi, eci duke u tundur deri në mes të dhomës, u rrëzua, shtrembëroi fytyrën, por nuk qau, shikoi nga Isa e nga dy të vegjlit e tjerë dhe pas pak u zvarris drejt vatrës, duke tërhequr kështu vëmendjen e të gjithëve...

— Atëherë, Dan, nipi yt ishte dhjetë muajsh, — tha Xhako Rina.

Dani tundi kokën dhe, me sytë të mbushur plot kujtime, shikoi të nipin tek belbëzonte pranë vatrës.

...Gjashtë muaj më parë Dan Zavalli u ndodh në lartësitë e Kërrabës në një mbledhje të Këshillit Nacionalçlirimtar krahinor për të marrë udhëzimet e rastit, lidhur me Operacionin e Qershorit, që forcat gjermano-balliste sapo kishin filluar. Batalioni ku ishte komisar Xhako Rina, pasi kishte kaluar Shkumbinin, qe përhapur nëpër Malësinë midis Elbasanit dhe Tiranës, për t'u gjendur kështu në prapavijat e armikut, me mision çoroditës e pengues, sa të arrinin forcat kryesore partizane. Kështu ndodhi që një kompani e batalionit të Xhakos u caktua të ruante mbledhjen e këshillit krahinor nga disa lëvizje të dyshimta ballistësh e zogishtësh në majat e Kërrabës. Por disa orë pas fillimit të mbledhjes, Xhako Rina thirri këshilltar Danin dhe i tha:

— Dan, duhet të kthehesh menjëherë në fshat. Sapo morëm një informacion nga Komiteti Qarkor i Tiranës që thotë se një grup armiqsh është nisur për të të djegur shtëpinë, për të djegur brenda çdo gjë, ty, nusen dhe nipin, sepse dikush ka spiunuar për pjesë-



marrjen tënde në aksionin e rrugës dy javë më parë, ku u vra majori gjerman.

— Po kthehem, pra, — tha menjëherë Dani, hodhi maliherin në krah, u përshëndosh me Xhakon e me këshilltarët e tjerë dhe u nis tak-fak, tak-fak, me shkopin e thantë e me këmbën e shkurtër.

— Dan! — i thirri Xhako Rina.

Ai qëndroi.

— Duhet të marrësh me vete dy ose tre partizanë, — tha Xhako Rina. U kthye nga skuadra që kishte pranë. — Kozma, do të shkosh ti vetë (atëherë Kozma Peti ishte skuadërkomandant), do të marrësh me vete Halimin dhe Dodën.

— Jo, — tha Dani. — Ju sot mund të bëni një pritë në Kaçolitë dhe keni nevojë për sa më shumë gryka zjarri!

Por Xhako Rina shikoi prapë nga Kozma Peti.

— Kozma, — tha ai.

— Po, shoku komisar!

— Merr edhe Sanën. Do të të duhet një shoqe, le të gjendet pranë nuses dhe djalit.

— Po!

— Merr edhe infermierin, se është rrugë me rreziqe.

— Po, — tha Kozma Peti.

— Kozma, — tha prapë Xhako Rina.

— Po, shoku komisar.

— Nuk mjaftojnë pesë veta!

— Po sa?

— Merre të gjithë skuadrën!

— Shumë, komisar, — kundërshtoi këshilltar Dani.

— Jo, Dan, — tha komisari. — Duhet!

Tri orë më vonë skuadra partizane me këshilltar Danin u gjend përmbi Mushibë, prej nga shikohej i tërë fshati si në pëllëmbë të dorës. Kishin ecur shumë shpejt dhe këmba e shkurtër e Danit nuk ishte bërë fare pengesë. Kur e tregon këtë histori Kozma Peti, ai thotë: tak-fak, tak-fak, me këto dy fjalë onomato-

peike ai shpreh lehtësinë dhe shpejtësinë e atij udhëtimi.

Në të zbritur të fshatit, aty ku kryqëzoheshin disa monopate, ata kishin vënë re një fshatar, nga ata që duken se janë pak tuhafë, pak dembelë, më të shumtën e kohës të papunë, të mundur nga jeta, që kanë humbur çdo besim në vetvete, kanë humbur sedrën dhe qejfin për të jetuar, që vërtiten rrugëve pa qëllim, vërtiten ku t'i çojnë këmbët, pa bërë asgjë të keqe, pa lënduar asnjë, por kudo që ndodhen janë të tepërt, të panevojshëm e të padobishëm. Takoheshin aso kohe njerëz të tillë dhe i këtillë u qe dukur partizanëve ai fshatar i vetmuar, që rrinte ulur mbi një bregore pranë një udhëkryqi dhe kushedi çfarë mendonte. Por ndryshe i qe dukur këshilltar Danit. Ky i fundit, me ta parë, shtangu, si të qe ngurosur i tëri. Por jo më pak shtangu edhe fshatari, që duhej të ishte më i ri se Dani, por i parruar dhe i thinjur kudo. Ai u ngrit dhe deshi të largohej «në punë të vet», por shkopi i Danit e zuri në krah, si kërraba e bariut cjapin dhe e mbajti në vend.

— Ti, Selim, çfarë pret e çfarë përgjon këtu? — e pyeti Dani.

— Jo, hiç, Dan, — tha Selimi.

Pastaj Kozma Peti i kishte treguar Xhakos për çudinë që kishte ndodhur në një minutë, ose pak më shumë se një minutë.

Këshilltar Dani e tërhoqi Selimin me shkopin e thanës dhe Selimi, i cili ndërkaq kishte ndryshuar i tëri e që s'kishte të bënte më fare me atë tuhafin apo dembelin, u përplas pas trupit të ngjeshur të Danit. Ky i fundit e shtrëngoi në kyçe të dorës me pëllëmbën e tij të madhe dhe e pyeti:

— Fol, ç'punë kishe këtu, cilin përgjoje! — Me një të vërtitur, i përdrodi krahun dhe po atë çast u dëgjua ajo shkërmoqja e kockave kur dalin nga vendi ose kur thyhen. Krahu i djathtë i Selimit mbeti varur, si një cule kur tundet në tel sadopak të fryjë era. Selimi klithi e ra në gjunjë nga dhimbja, por u përpoq të kun-



dërshtonte me krahun tjetër. — Fol, se s'kam kohë! — briti Dani dhe po me atë shpejtësi dhe forcë i spërdroddhi të majtin. Tashti Selimi rënkonte dhe të dy krahët i vareshin poshtë. Atëherë dora e madhe e Danit e mbërtheu Selimin për fyti, pikërisht aty ku fikthi i luhatej si thikë e mprehtë.

— Fol, të thashë!

— Më kishin vënë këtu për të të përgjuar ty. Ata e dinin që do të vije nga kjo rrugë, e dinin që ishe në mbledhjen e këshillit krahinor.

— Pastaj?

— Do t'u bëja me shenjë sapo ti të futeshe në shtëpi.

— Unë me nusen e me foshnjën të digjeshim brenda, kurse ti të rroje e të merrje një napolon, ë?

— Jo, një dollar! — tha me zor Selimi, që ndiente gjithnjë më shumë gishtat e Danit tek i shtrëngoheshin pas fytit.

— Ku janë ata, ushtria?

— Në zabelin përmbi xhami!

Pastaj, kishte treguar Kozma Peti, u desh vetëm një gjysmë minute që dora e madhe e Danit të shtrëngonte fytin e Selimit, që trupi i Selimit të dridhej si pulë e therur, që këmba e shkurtër dhe këmba e gjatë e Danit të mbanin të mbërthyera këmbët e Selimit, që hidhnin shkelma agonie, pastaj Selimi ishte qetësuar, trupi i qe nderë i palëvizshëm dhe Dani, që e kishte ngritur me lehtësi me të dyja duart, si një thes byku, e kishte hedhur në një përrua aty poshtë. Trupi i Selimit ishte rrokullisur dhe kishte rënë me fytyrë të zhytur në ujë. Kishte thënë Dani, duke fshirë pëllëmbët pas brekushëve të zeza:

— Dyshonim për këtë qen. Tashti e kemi të qartë sa shokë na kanë vdekur nga ai!

Kështu, duke gjarpëruar monopateve të fshehta, Dani dhe partizanët arritën në shtëpi më parë se armiqtë, morën nusen dhe djalin dhe u larguan menjëherë. Kur dolën te shkëmbinjtë e fshatit Mushibë, pas të cilëve shtriheshin pyjet, shtëpia atje poshtë u mbulua nga tymi e nga flakët.

Pak më vonë skuadra partizane me Danin, nusen dhe djalin do të takohej me një tjetër fuqi gjermane që vepronte atyre anëve. Ata do të fshiheshin në një ferrishte të dendur, por befasi do të gjendeshin të rrethuar, sepse aty në një vend pak a shumë të zhveshur të pyllit, njëzet metra më tej, ushtria gjermane do të ngrinte një fushim të përkohshëm. Punët u ndërlikuan më shumë, kur nipi i Danit, as motak akoma, zuri të qante. Nusja përpiqej ta qetësonte dhe t'i mbvllte gojën me pëllëmbë, por fëmija qante. nxihej dhe bëhej gati si i vdekur nga mungesa e airit. Më në fund, nusja shikoi vjehrrin, shikoi niëmbëdhjetë partizanët dhe as e gjallë as e vdekur, i vuri dorën në fyt fëmijës. Por nuk e mbyti, sepse nuk e la partizania e vetme e skuadrës, Sana, e cila kishte thënë, ose të vdesim të gjithë, ose të hidhemi në sulm të gjithë. (Më vonë Dani do t'i thoshte Xhakos se ai kishte heshtur, se atij i kishte ardhur rëndë të sakrifikohej një skuadër partizane për nusen, për ninin e për atë vetë.) Kështu nusen e detyruan ta hiqte dorën nga gryka e dialit dhe, siç pritej, djali, me të qarar e veta, dha alarmin midis gjermanëve. Atëherë filloi sulmi për të çarë rrethimin në një pikë të vetme. Sipas rrëfimit të të gjithë atyre që e bënë atë sulm, ai kishte qenë jo vetëm i papritur për gjermanët, por edhe diçka e papërshekruar. Skuadra çante përpara me britma, me krisma e me bomba dore, pa harruar kurrë që nëna me fëmijën të ndodheshin vazhdimisht në mesin e saj. Pas një ore, kur kishin dalë jashtë rrezikut, kur kishin prerë kontaktin me armikun, kur kishin fshehur çdo gjurmë, ata varrosnin Sanën (pikërisht partizanen që bëri e para propozimin për të çarë rrethimin me sulm), ndërsa djali bënte guga gëzimi në duart e së ëmës...

Sakaq, nusja, duke parë se Xhako Rina dhe i vjehrrin ishin të zënë me punë, e mori hopa djalin që bënte zhurmë dhe u çapit drejt derës. Te pragu e mbajti zëri i Xhakos:



— Nuse, mos lëviz vetëm. Sidoqoftë, nata ka rreziqe akoma!

Nusja buzëqeshi, duke zbuluar edhe një herë rininë, bukurinë dhe dhëmbët e bardhë, u skuq, si t'i kishte plasur gjaku në fytyrë, përveshi pak jelekun, tregoi millin e thikës së shtëpisë, buzëqeshi prapë dhe u zhduk përtej errësirës...

Kur mbetën vetëm, Xhako Rina, që ndihej i lodhur prej kohësh, ngriti kokën, por jo shumë, e ngriti aq sa i duhej për të shikuar duart e mëdha e leshtore të këshilltar Danit, që ai zakonisht i mbante të mbështetura mbi gjunjë. Ai po bindej gjithnjë më shumë — këtë ia përforcoi edhe kujtesa për fundin e spiunit — se fuqia, kokëfortësia, këmbëngulja, bindja dhe vetë besnikëria e këtij fshatari nuk ishin përqendruar aq tek opingat e mëdha, as te shkopi i trashë, i thantë, me gdhençka e me gëzhhojë në majë, bile as te hunda. që herë i dukej e shtypur, herë jo, sipas lodrave vezulluese të llambës, por te vetë ato duar të mëdha, leshtore e me gishta që ndeheshin të fuqishëm mbi gjunjë. Duar të hekurtë, mbështjellë me doreza kadifeie, mendoi ai me shaka.

— U burrërua shumë gruaja në këtë luftë, Dan, — tha ai.

— Trimëreshë si Sana mua s'më kanë parë sytë, — tha Dani.

— Po, — tha Xhako Rina. — Sana i kishte të rralla shoqet.

— Mbuloi me trupin e vet nënën me fëmijën dhe vetë u vra!

Pasoi një heshtje.

— Nusja shkon shpesh te varri i Sanës në pyll. I ka mbjellë trëndafila të egër nga ata që i mbajnë gjethet deri tashti vonë.

— Së shpejti do të ngrihen varreza dëshmorësh kudo. Kockat e Sanës do t'i kthehen Durrësit.

— Po të jetë ashtu, Sanën do ta çoj në Durrës unë me nusen e me djalin që kam në brigadë. Sanën e kemi njeri të shtëpisë sonë! — tha Dani dhe Xhako Rina vuri re për herë të parë se fytyra e rëndë e Danit u rrëqeth

nga mallëgjimi opingat e mëdha lëvizën, duart u ngritën nga gjunjët, ndërsa shkopi i rëndë dhe i thantë u rrëzua me zhurmë nga prehri i tij.

26.

Rubi u shfaq me një jorgan e batanije ndër duar dhe mbuloi me to fëmijët dhe Isën, që flinin në anë të vatrës. Pastaj mbeti një copë herë pa lëvizur (megjithëse në ballë i shkonin e i vinin mendime të vrullshme). Nga minarja në mes të fshatit, si përmbi shtëpinë e saj që dëgjuar befaz zëri i kthjellët, i pastër, i lartë i hoxhës që thërriste jacinë. Me notën e përhershme të dëshpërimit në fytyrë, Rubi u zhvendos nga vatra, para tavolinës. Tha:

— O komisar, kam një lutje!

— Ç'lutje? — pyeti Xhako Rina, që e kishte vënë re menjëherë shqetësimin e veçantë të Rubit.

— E dëgjon? — Gishti i saj lëvizi në drejtim të zërit të hoxhës.

— E dëgjoj!

— Të na e hiqni këtë hoxhë nga fshati. Gjejmë vetë një hoxhë tjetër!

Komisari nuk iu përgjigj menjëherë.

Tha Rubi:

— Dy javë që na kishin rënë veshët rehat. Kishte shkuar në një fshat atje lart dhe unë thashë me vete, për të këqijat që ka bërë nuk do të kthehej më këtu. A hipi populli në fuqi, komisar?

— Po, teze Rubi!



— A na ke thënë se tash e paskëtaj do të jetë populli që do të vendosë sipas dëshirës së vet?

— Po!

— A jam popull unë?

— Po, teze Rubi.

— Atëherë na e hiqni këtë hoxhë nga fshati. Mjaft e kemi duruar! — Rubi merрте frymë me zor, si një fëmijë që sapo ka pushuar vrapin.

Xhako Rina uli qepallat mbi sytë e përhimë dhe mbeti një copë herë pa folur. Në të vërtetë ai s'e kishte menduar kurrë këtë gjë. Një çast më vonë ai pranoi me vete se para një rasti të këtillë ishte i pazoti të jepte një përgjigje për të qenë. Mos duhej t'i thoshte Rubit që të duronte akoma edhe për ca kohë? Po ç'donte të thoshte «të duronte akoma» dhe a ishte e drejtë kjo? I zhytur midis kontradiktave i nxitur nga urrejtja e brendshme që i shkaktonte sjellja e hoxhës, më në fund ai tha:

— Nuk zgjidhen të gjitha punët e hallet menjëherë, teze Rubi!

Dani e shikonte Rubin me bisht të syrit dhe diçka fliste me vete. Kjo vihej re në buzët e tij, që lëviznin pa nxjerrë zë. Dhe ajo që thoshin ato buzë, s'mund të ishte e keqe, përkundrazi, ajo duhej të ishte diçka e mirë, e ngrohtë e shpresëdhënëse për Rubin, që një jetë tjetër më e mirë e priste përpara.

— Ma prishe qejfin, komisar, — tha ajo.

Komisari, që tashmë ishte shkëputur nga puna e tij, e shikoi Rubin në sy.

— Fjalët dhe punët e tua janë të mençura, — tha Rubi, — por unë nuk e duroj më këtë hoxhë të më këndojë mbi kokë pesë herë në ditë! — Për herë të parë Rubi i hodhi komisarit një vështrim të turbullt, as të bindur, as të pabindur, por thjesht të turbullt. — Ti mos u zemëro me mua, — tha Rubi.

— Jo, nuk zemërohem, — tha komisar, — unë them të flesh tashti, teze Rubi, se je lodhur.

— Ajo ishte kohë e keqe, komisar, s'kishte drejtësi. Më thuaj, si mund të jetojë njeriu pa e vënë të drejtën

në vendin e vet? — Rubi i hodhi sërish një vështrim të turbullt dhe iku befaz.

Dani, me sy të picërruar, nuk shikonte si zakonisht opingat e veta, por pak më tej, majën e shkopit, gëzhoja e të cilit ishte ngulur në një pikë të dyshemesë.

— Se ç'shoh në sytë e Rubit, — tha Xhako Rina, — një mllef të papërmbajtur! — Instinktivisht ai hodhi vështrimin në parvazin e dritares dhe e pa gati me vëmendje helmetën gjermane, ku Rubi kishte mbjellë një lule, nga ato që gjelbërojnë dimër e verë.

Tha Dani:

— Sëpatën me të cilën u nis për të prerë kokën e gjermanit aty e ka, — dhe komisar i vuri re duart e mëdha të këshilltar Danit tek u shtrënguan pas shkopit si pas bishtit të sëpatës. — Kam vënë re se me atë sëpatë Rubi nuk pret kurrë dru!

— E çuditshme! — tha komisar i.

— Rubi është nënë e djegur dhe nënat e djegura janë shumë të fshehta! — tha Dani. — Rubi është nga ato gra që, kur u mbushet mendja për një gjë...

— Mos do të thuash se mund të ketë ndër mend të vrasë hoxhën e fshatit?

— Ku ta dish!

— Ashtu pra! — u çudit sërish komisar i dhe kësaj radhe shikoi më parë automatikun e vet në cep të tavolinës, pastaj vështrimi i tij u ngrit në faqen e murit përballë mbi maliherin që varej pak mbi kokën e Danit. — Të kemi kujdes, — shtoi ai, duke i shoqëruar fjalët e fundit me një gjest, që donte të thoshte: «Kaq. Nuk do të bisedojmë më për këtë gjë!»

Kur këmbët e Rubit në fund të shkallëve ishin shuar qyshkur, këshilltar Dani tha prapë:

— Të kam thënë, s'është puna vetëm te vajza e Rubit. Hoxha ka marrë më qafë edhe vajza e gra të tjera, që kanë vrarë veten, që janë vrarë nga burrat, janë ndarë e janë çmendur nga marazi. Të shkretat, shkonin te hoxha për t'u shëruar se nuk pillnin dhe ktheheshin me barrë. S'rrojmë dot pa fëmijë ne kënde.



Njërën e çojmë për dru, tjetrin për të punuar arën, tjetrin në pazar, tjetrin...

Shkopi i trashë prej thane, me xhunga e me gëzhohë në majë, trokifi në dysHEME, si të trokiste në dyert e arsyet të Xhako Rinës. Opingat e mëdha ishin aty të palëvizshme, të patundshme, kryeneçe e kokëforta dhe, megjithëse Xhako Rina s'para kishte qejf t'i shikonte, sepse ato i kujtonin kërkesën e përsëritur për *derrat e egër*, vështrimi i tij rrëshqiti padashur drejt tyre, pastaj drejt duarve të mëdha mbi brekushet e gjera, e në fund drejt fesit të bardhë e të gjatë si qyp në kokën e madhe të këshilltar Danit.

27.

Kur Rubi zbriti shkallët, frynte një erë e lehtë, por e ftohtë, Ajo hodhi vështrimin lart në pllakën e zezë të qiellit dhe ca pika të rralla e të ftohta shiu i freskuan fytyrën. Po nga lart zbrisnin deri poshtë klithmat e shqetësuara të rosave të egra dhe Rubit i bëhej se ato rosa tërë jetën e tyre e kalonin duke kërkuar një vend të përshtatshëm për të dimëruar. Pak më tej, si nga çatia e xhamisë, si nga selvia e si nga maja e minares së shkurtër dëgjohej kënga e përvajshme e një kukuvajke. Rubi bëri një lëvizje bestytnie, pastaj u fut në dhomën e vogël, prej nga doli me një kandil në njërën dorë e me një çelës të madh e të ndryshkur në dorën tjetër. Me atë çelës ajo hapi derën përballë, çivitë e ndryshkura të së cilës lëshuan ankime dhe bënë zhurmë,

Sakaq, zëri i hoxhës majë minares së shkurtër e të prerë përgjysmë kushedi se kur, qe shuar. Jacia kishte mbaruar.

Rubi u fut ngadalë në dhomën e vjetër e të madhe të zjarrit, të cilën ajo e kishte braktisur këtu e dhjetë vjet më parë që atë natë kur zgjoi vajzën nga gjumi dhe ashtu, nëpër errësirë, ia dorëzoi hoxhë efendiut për ta shëruar. Në dhomë kishin mbetur disa stola të vjetër, një djep i krimbur, ku dikur Rubi kishte përkundur vajzën e vetme. Kishte edhe një sëpatë, që mund të themi se ishte e vetmja gjë e re në mes të të gjitha rrangullinave që ndodheshin aty. Rubi vuri kandilin mbi sepete dhe mbeti një copë herë si e mbërthyer në vend. Nga trarët, nga djepi, nga stolat e kudo e nga çdo gjë dëgjoheshin të brejturat e krimbave dhe për një çast asaj iu bë se krimbi po brente edhe tashun e shkëlqyeshëm të sëpatës. Një sëpatë e re, por një botë e vjetër, një botë e kaluar dhe e jetuar dikur...

...Kur isha nuse e re, burri më çoi në Tiranë. Ishte hera e parë që unë shikoja një qytet me rrugë, me njerëz shumë, me dyqane. Atje ai më bleu një palë këpucë të vjetra. Kur unë i mbatha, ai më tha, ec një herë, Rubi, të të shoh. Unë eca. Ai u gëzua, qeshi, se atëherë edhe ai ishte i ri, pa mustaqe. Mustaqet i la më vonë, kur vajza u rrit dhe ai u bë dyzet vjeç e përpjetë dhe unë plot tridhjetë. Kështu, atë ditë unë eca me këpucë, gjithmonë kisha ecur zbathur, ose, të shumtën, ditën që zbrita nuse e re në Tiranë, kisha mbathur opinga. Ai qeshi dhe tha, sa e bukur më dukesh, Rubi. Më bleu edhe një shami të kuqe për të lidhur kokën. Unë e lidha dhe nxora një cullufe të zezë në ballë. Ai më tha, m'i vrave sytë, Rubi. I mjeri unë! tha. Rrugës, kur po ktheheshim në fshat, ai qëndroi buzë një zabeli, u fut pak më thellë dhe më thirri, Rubi, hajde këtu. Unë shkova, unë e kuptova, atëherë unë isha tetëmbëdhjetëvjeçare dhe të gjithë flisnin se isha nuse e bukur. E shikova burrin



në sy dhe e kuptova çfarë donte ai. Por qëndrova e turpëruar. Ishte ditë. Ishte gati mesditë. Ishte dritë e fortë. Ishte edhe pyll i rrallë. Edhe njerëz mund të kalonin. Ai ma hoqi nga koka shaminë e kuqe që sapo ma kishte blerë, unë ndjeva dhimbje në flokë, por mua më pëlqeu ajo dhimbje, ai më shtrëngoi për beli, më pëlqente forca e burrit tim dhe... duhet të ketë qenë atë ditë që u zura me barrë. Nëntë muaj më vonë linda vajzën time të mjerë, që s'do të bëhej kurrë nuse, siç isha bërë unë, që s'do të mbathte këpuçë, s'do t'i blinte i shoqi shami të kuqe për të mbledhur flokët e pastaj për t'ia hequr me forcë nga koka, për ta rrëzuar në tokë, siç më rrëzoi mua burri... Një hoxhë, që ishte babai i saj nga mosha, do ta tmerronte me xhindet e tij e do ta...

Fëmijët e Bajazit agait, tek i cili ne ishim bujq, ma rrihnin vajzën për higjë. Një ditë im shoq e humbi durimin. Ai kërkoi nga Bajazit agai t'i përmbante fëmijët, por ata më keq. Atëherë unë e bëra zakon ta merrja vajzën në arë për të punuar, kur asaj i luhej me kukulla prej lecke. Dhe vitin e zisë, ndërsa unë dhe im shoq jetonim me barishte, vajza ime, që tashmë ishte katërmëdhjetë vjeçe, hante bukë të mykur, e përtypte gjafë dhe pastaj e përcillte ose e villte. Katërmëdhjetë vjeç ishte atëherë edhe vëllai im i vogël në fshatin tjetër, kur u rrëzua nga shkëmbi dhe theu brinjët. Xherahu donte pare. Por ata s'kishin. S'kishin as ilaçe. I jepnin ujë dhe prisnin të vdiste. Ai kërkonte shpëtim. I shikonte njerëzit në sy dhe heshtte. Dhe duke sikur ishte pjekur dhjetë vjet të tjerë. Kjo sjellje i vriste më shumë të afërimit e njerëzit rotull, që s'kishin ç't'i jepnin veçse ujë dhe... prisnin që ai të vdiste... Dhe ai vdiq. Pastaj i erdhi radha bijës sime nga hoxhë efendiu... nga ky hoxhë që sapo u kthye përsëri sonte në fshat e që pak më parë i dëgjova zërin si dikur e si gjithmonë nga maja e minares së shkurtër. Atë ditë që varrosëm vajzën, im shoq u rrëzua pa frymë mbi varrin e saj, në e ngritëm për krahu, e çuam në shtëpi,

por që atë ditë ai s'e mori më veten. I pëlqente të shullëhej në diell, i pëlqente të shikonte këmbët e veta e të shullëhej në diell, derisa vdiq edhe ai një vit pas vdekjes së vajzës...

Rubi eci me vrull, e zuri sëpatën për bishti dhe, sado i gjatë që ishte bishti i saj, sado e madhe dhe e rëndë që ishte ajo, në duart e në trupin e Rubit, u duk sikur e humbi peshën e vet. Pastaj Rubi eci me hapa të sigurt, si në një rit të vjetër e të përsëritur çdo ditë dhe u ngul para një fotografie dalëboje, me korniza po aq dalëboje, ku brente gjithashtu krimbi. Nga fotografia e shikonte një burrë me mustaqe të gjata (i shoqi) dhe një vajzë e re, së cilës gati i qenë fshirë tiparet, me përjashtim të vetullave të zeza (vajza) dhe pastaj një grua as e re as e vjetër, që shikonte cilindro në bebe të syrit (ajo vetë). Duke qëndruar aty, Rubit i kujtohej se ata kishin zbritur në Tiranë pikërisht atë vit që vajza do t'u sëmurej. Ajo qëndroi para fotografisë aq sa i duhen njeriut për të kujtuar ose përsëritur, se jeta kishte qenë gjithmonë e vështirë, se kudo e gjithmonë kishte qenë e njëjta gjë, kështu kur ajo kishte qenë e vogël, kështu më vonë kur u rrit, kur u martua, kur u bë nënë. Ashtu kishte qenë edhe në fshatin e saj të lindjes, edhe në fshatin Mushibë, që ishte fshati i burrit, edhe në fshatin fqinjë, në fshatrat e tjerë, në vendet e largëta, kudo që i thoshin Shqipëri e kudo që i thoshin botë. Ky ankth, që priste diçka më të mirë, diçka që të ishte e vërtetë e t'i ngjante jetës, e kishte shoqëruar Rubin kurdoherë... e në çdo hap të jetës së saj...

Ajo shtrëngoi me të dyja duart sëpatën e re e të rëndë dhe tha, sonte, sonte do të vras hoxhën, hoxhë efendinë. Tashti. Menjëherë. Erdhi koha ta vras, ja ç'duhet të bëj, ta vras. Këtë mendim unë e kam të vjetër, që atë ditë kur varrosa vajzën, që atë ditë kur gjetëm të vdekur foshnjën shtatanike buzë Erzenit. Por e kam ruajtur për vete, e kam ruajtur thellë, pa ia thënë askujt, bile as vetes. Tashti erdhi koha të bëj diçka.



Kështu thashë përsëri të nesërmen e asaj dite, kur varrosa burrin dhe mbeta vetëm. Unë gjithmonë kam thënë se duhet të bëj diçka, të mos rri duarlidhur dhe këtë e kam thënë qysh atëherë, këtu e dhjetë vjet që më vdiq vajza, këtu e nëntë vjet që më vdiq burri. Tashti erdhi koha, erdhi dita ime, dita e vajzës sime, që vdiq nga hoxha, dita e burrit tim, që vdiq nga hidhërimi, nga turpi për vajzën, nga Bajazit agai, që e shikonte me bisht të syrit bujkun e vet dhe i hidhte thumba e romuze. Ai nuk jetoi. Jetova unë. Më mbetet mua të bëj diçka. Të mos qëndroj duarlidhur. Të vras hoxhën. Hoxhë efendinë. Ai s'duhet të jetojë në Shqipërinë e re, siç e kemi bërë zakon ta quajmë ne. S'duhet. S'duhet. S'duhet. Dhjetë vjet që më vdiq vajza, nëntë vjet që më vdiq burri, kam jetuar vetëm si qyqe, por nuk kam kënduar e vajtuar si qyqe, kam thyer duart në punë, kam thyer belin me bel. Kam punuar tokën, kam mbjellë e kam korrur dhe të gjitha këto i kam bërë për të mos vdekur, për të jetuar, për të marrë hakun e vajzës e të burrit, për të vrarë hoxhën. Hoxhë efendinë. Tashti. Pa vonesë. Për vajzën. Për burrin. Duhet. Duhet... Me këtë sëpatë. Sonte. Tashti. Nesër ose pasnesër komisarët do të nxjerrin ligje të reja, që do të jenë ligjet tona, e ato ligje, kushedi, do të më pengojnë të marr hakun, kurse unë duhet... Duhet. Duhet. Ja, me këtë sëpatë që kam në dorë. Ky është betimi im i vjetër. Është betimi i një gruaje, i një nëne, që mbeti vetëm në lulen e moshës e që tashti gjeti një djalë në shpirt, gjeti Isën, Isë Brezarin, pionierin e brigadës që çliroi Mushibën tonë. Unë dhe Isa kemi nevojë për njëri-tjetrin. Isa mbeti jetim nga fashistët, unë nga e kaluara... Isa do të mbarojë shkollën e madhe për oficer. Kështu tha komisarë. Dhe unë do të shkoj kudo që të shkojë Isa. Por më parë unë duhet të vras hoxhën. Hoxhë efendinë. Patjetër që duhet ta vras... Ta vras... Ta vras... Ja, me këtë sëpatë që kam në dorë.

Kaq qëndroi ajo në këmbë, aq sa iu desh të shqiptonte të gjitha këto. Ne nuk e dimë sa zgjati kjo, se mendimi është më i shpejtë se drita, është edhe më i

ngadalshëm se errësira, por dimë që në fund të këtyre mendimeve Rubi mori kandilin e me sëpatën në dorën tjetër, kapërceu pragun e dhomës. Por befas, pa arritur mesin e oborrit, ajo mbeti e gozhduar në vend. Atje lart në dhomat e saj partizanët po qeshnin e po bënin zhurmë dhe nga e qeshura e zhurma e tyre, shtëpia sikur qeshte edhe ajo, sikur zhurmonte, sikur tundej e dridhej. Një gëzim të tillë e një gaz të tillë s'e kishin dëgjuar prej vjetësh ato mure, as veshët e saj. Dhe u step. U kthye prapë në dhomën e vjetër të zjarrit, e vendosi sëpatën prapa derës, që ta kishte më lehtë kur të kthehej për ta marrë dhe me mendimin e me besimin e palëkundur se hoxhë efendiut do t'ia hiqte partjetër kokën atë natë, ngjiti shkallët gati me vrap, e tërhequr nga thirrjet e të qeshurat e forta të partizanëve atje sipër.

23.

— Ku mbetëm? — pyeti Kozma Peti në mënyrë të atillë që dukej sheshit se ai tallej me ngjarjen që po tregonte.

— Te Mafuzi, pra, — tha një zë.

(Në dhomën ngjitur Xhako Rina dhe këshilltar Dani edhe bënin punën e bisedat e tyre, po edhe dëgjonin me qejf çfarë flitej matanë.)

— Na erdhi njëherë në batalion një pispiling qyteti, — u dëgjua zëri i ngjeshur dhe i fortë i Kozma Petit.  
— Ky biçim njeriu na thoshte se kishte bërë shkollë të madhe dhe mund të kishte bërë vërtet njëfarë shkollë



në Tiranë apo gjetkë, por, për hesapi. tim, ai dukej si shumë i lajthitur. Mafuz, Mafuz Torobojka i thoshin. Që në fillim ky farë Mafuzi na ra në dashuri me Sofinë tonë, që e kisha nga fshati dhe që ishte aq e urtë e aq e turpshme.

— Po si ia kishte shprehur dashurinë? — pyeti një zë i dytë.

— Në fillim, ta merr mendja, vetëm me vështrime, ashtu de!

— Po Sofia? — pyeti po ai zë.

— Buzëqeshte, skuqej e zverdhej, bënte sikur s'kuptonte dhe i thoshte, ti, Mafuz, i ke sytë tamam si të gjyshit tim!

(Të qeshura. Kishin vënë buzën në gaz edhe komisari me Danin në dhomën ngjitur. Këto të qeshura kishte dëgjuar aty poshtë edhe teze Rubi kur doli në oborr me sëpatën në dorë.)

— Por Mafuzi zuri ta humbiste toruan dhe deshi të dinte me këmbëngulje pse Sofia nuk i afrohej. Që thoni ju, ky Mafuz Torobojka, kur fliste me Sofinë, siç e dini një çupëlinë as njëzetvjeçare dhe bile pak e shkurtër, Mafuzi thyhej gati më dysh, se nuk donte që t'i bëhej pengesë gjatësia e trupit. Një ditë ia tha hapur:

— Të dua!

— Mua?! Ë çudit e u trondit Sofia për këmbënguljen e Mafuzit. Kaq gjë e lehtë qenka dashuria?!

— Dëgjo, Sofi, i tha ai. Në të kaluarën dashuritë ishin tepër të rënda. Nga marazi njerëzit vdisnin nga të pangrënët ose nga pagjumësia. Kanë vrarë edhe veten nga dashuria. Por lufta jonë dashurinë e bëri më të lehtë. Mund të fejojesh, mund të ndahesh pas ca ditësh...

— Mafuz, s'je mirë, e shoh unë, iu hap goja Sofisë.

— Fare mirë jam!

— Mos e ke me shaka?

— Aspak. Unë s'di të bëj shaka.

— Mafuz, ti je zverdhur, i thotë ajo.

— Ashtu, qenkam zverdhur, e kërcënoi ai.



Gërvishtën civitë e derës dhe te pragu u dëgjuan këpucët e rëndë të një partizani. Ato ditë shumica e partizanëve kishin mbathur këpucë ushtrie me gozhdë. Këpucë alpine, një nga trofetë, që zemërgjerësia e intenditit të brigadës, s'kishte dashur t'i përfshinte në inventar. Dhe ecnin tepër rëndë, se disa nga partizanët s'para ishin mësuar me këpucë të tilla.

— Kush e ka radhën e rojës? — pyeti ai që hyri.

— Ne të dy, — tha njëri.

— Ç'prisni atëherë?

— Sa shkoi ora?

— Dhjetë!

U bë zhurmë. U ngritën ata që duhej të merrnin shërbimin e rojës dhe dolën jashtë. Dhoma u qetësua.

— Ku mbetëm? — pyeti Kozma Peti po me atë zë lallës për ngjarjen që tregonte. — Ah, u mbërthyen, që thoni ju, gjeti fjala fjalën dhe biseda u bë tërkuzë.

— Nga merakū, — shpjegoi zëri i parë.

— Meraku është më i rëndë se plumbi, — tha zëri tjetër.

— Plotësisht e drejtë, — tha Kozma Peti. — As Sofia s'tundej nga e vetja, as Mafuzi s'donte të hiqte dorë. Por do ti, atë kohë komandanti i batalionit bënte një inspektim dhe i dëgjoi tek po grindeshin. Që të mos zgjatemi shumë, i thirri të dy, këtu e këtu, që thua ti.

Atëherë ishim batalion territorial. Te dera e dhomës u bë prapë zhurmë. Ishin kthyer dy partizanët, që dorëzuan shërbimin e rojës.

— A bie shi?

— Pak — tha njëri nga ata që ktheheshin.

— Ç'bëhet andej?

— Hiçasgjë!

— Po me derrat e egër?

— Ja, i dëgjoni, u bien teneqeve, ndezin zjarre e bërtasin! Na e pinë misrin, tha një fshatar, as që tremben fare, sikur ta dinë që e kemi të ndaluar, të zbrazim pushkë. Fësh ia bëjnë ferrave e koçimareve, tha fshatari. Derr i madh, si miza në dru. As më pleqtë s'mbajnë mend



një derr si ky i sivjetmi. Krrap-krrap-krrap, imitoi partizani fshatarin. Pa më të ngrihen, tha fshatari, me të dyja këmbët e para dhe më të hidhen mbi duajt e misrit, si të jenë njerëz e jo derra. Krrap-krrap-krrap...

— Këto thoshte ai që ishte kthyer nga shërbimi i rojës.  
(Në dhomën tjetër Xhako Rina dhe këshilltar Dani u shikuan midis tyre me nënkuptim. Por këto vështrime nuk zgjatën shumë, si të mos donin akoma t'i zbulonin deri në fund njëri-tjetrit mendimet, dyshimet dhe të fshehtat, që u përkisnin të dyve së bashku dhe secilit veç e veç.)

— Sonte na ka çuditur edhe ai fshatari me shami të kuqe në kokë, — tha partizani tjetër, — ai që e thërresin Turhan e që herë duket si hutaq, herë si i çmendur. E dini ç'po bën sonte?... Po ngre duajt e misrit nga një arë, nga ara ime, thotë, i çon në koliben e vet, pastaj herë merret me ndreqjen e një parmende, herë merr arratinë drejt konaqeve të bardha të një agai dhe thërret, ku je, o Bajazit aga, e mblodha misrin nga ara ime!

— Ai maskara e ka lënë pa tokë, pa njerëzit e vet e pa shtëpi që këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë!

Si t'i mbanin iso kësaj historie, partizanët, shumica e të cilëve ishin fshatarë e që e kuptonin dhe e ndienin si në veten e tyre hallin e Turhanit, qëndruan në hesh-tje, të kredhur në fatkeqësinë e atyre viteve të shkuara...

Pasi ishin ngopur me këtë heshtje, dikush tha:

— Kozma, a do të na e mbarosh ngjarjen me Sofinë e me Mafuzin?

— Ku mbetëm? — pyeti Kozmai, si të kujtohej se kishte akoma për të thënë diçka.

— Aty kur i thirri komandanti i batalionit, — tha zëri i parë.

— Posi, i thirri komandanti dhe u tha, ç'është kjo, si ta quajmë këtë, ç'emër t'i vëmë kësaj, Mafuz? Pa na thuaj, përse ke dalë partizan, për të luftuar apo për të spërdredhur belin para femrave?!

— Shoku komandant, tha rëndë rëndë Mafuzi, për një



Gërvishtën a vitë e derës dhe te pragu u dëgjuan këpucët e rëndë të një partizani. Ato ditë shumica e partizanëve kishin mbathur këpucë ushtrie me gozhdë. Këpucë alpine, një nga trofetë, që zemërgjerësia e intendentit të brigadës, s'kishte dashur t'i përfshinte në inventar. Dhe ecnin tepër rëndë, se disa nga partizanët s'para ishin mësuar me këpucë të tilla.

— Kush e ka radhën e rojës? — pyeti ai që hyri.

— Ne të dy, — tha njëri.

— Ç'prisni atëherë?

— Sa shkoi ora?

— Dhjetë!

U bë zhurmë. U ngritën ata që duhej të merrnin shërbimin e rojës dhe dolën jashtë. Dhoma u qetësua.

— Ku mbetëm? — pyeti Kozma Peti po me atë zë tallës për ngjarjen që tregonte. — Ah, u mbërthyen, që thoni ju, gjeti fjala fjalën dhe biseda u bë tërkuzë.

— Nga merakū, — shpjegoi zëri i parë.

— Meraku është më i rëndë se plumbi, — tha zëri tjetër.

— Plotësisht e drejtë, — tha Kozma Peti. — As Sofia s'tundej nga e vetja, as Mafuzi s'donte të hiqte dorë. Por do ti, atë kohë komandanti i batalionit bënte një inspektim dhe i dëgjoi tek po grindeshin. Që të mos zgjatemi shumë, i thirri të dy, këtu e këtu, që thua ti. Atëherë ishim batalion territorial.

Te dera e dhomës u bë prapë zhurmë. Ishin kthyer dy partizanët, që dorëzuan shërbimin e rojës.

— A bie shi?

— Pak — tha njëri nga ata që ktheheshin.

— Ç'bëhet andej?

— Hiçasgjë!

— Po me derrat e egër?

— Ja, i dëgjoni, u bien teneqeve, ndezin zjarre e bërtasin! Na e pinë misrin, tha një fshatar, as që tremben fare, sikur ta dinë që e kemi të ndaluar, të zbrazim pushkë. Fësh ia bëjnë ferrave e kočimareve, tha fshatari. Derr i madh, si miza në dru. As më pleqtë s'mbajnë mend



një derr si ky i sivjetmi. Krrap-krrap-krrap, imitoi partizani fshatarin. Pa më të ngrihen, tha fshatari, me të dyja këmbët e para dhe më të hidhen mbi duajt e misrit, si të jenë njerëz e jo derra. Krrap-krrap-krrap... — Këto thoshte ai që ishte kthyer nga shërbimi i rojës.

(Në dhomën tjetër Xhako Rina dhe këshilltar Dani u shikuan midis tyre me nënkuptim. Por këto vështrime nuk zgjatën shumë, si të mos donin akoma t'i zbulonin deri në fund njëri-tjetrit mendimet, dyshimet dhe të fshehtat, që u përkisnin të dyve së bashku dhe secilit veç e veç.)

— Sonte na ka çuditur edhe ai fshatari me shami të kuqe në kokë, — tha partizani tjetër, — ai që e thërresin Turhan e që herë duket si hutaq, herë si i çmendur. E dini ç'po bën sonte?... Po ngre duajt e misrit nga një arë, nga ara ime, thotë, i çon në koliben e vet, pastaj herë merret me ndreqjen e një parmende, herë merr arratinë drejt konaqeve të bardha të një agai dhe thërret, ku je, o Bajazit aga, e mblodha misrin nga ara ime!

— Ai maskara e ka lënë pa tokë, pa njerëzit e vet e pa shtëpi që këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë!

Si t'i mbanin iso kësaj historie, partizanët, shumica e të cilëve ishin fshatarë e që e kuptonin dhe e ndienin si në veten e tyre hallin e Turhanit, qëndruan në hesh-tje, të kredhur në fatkeqësinë e atyre viteve të shkuara...

Pasi ishin ngopur me këtë heshtje, dikush tha:

— Kozma, a do të na e mbarosh ngjarjen me Sofinë e me Mafuzin?

— Ku mbetëm? — pyeti Kozmai, si të kujtohej se kishte akoma për të thënë diçka.

— Aty kur i thirri komandanti i batalionit, — tha zëri i parë.

— Posi, i thirri komandanti dhe u tha, ç'është kjo, si ta quajmë këtë, ç'emër t'i vëmë kësaj, Mafuz? Pa na thuaj, përse ke dalë partizan, për të luftuar apo për të spërdredhur belin para femrave?!

— Shoku komandant, tha rëndë rëndë Mafuzi, për një

femër janë përmbysur mbretër e perandorë e jo një Mafuz si unë!

— Po ti, moj, e do këtë biçimsëz, — pyeti komandanti Sofinë.

— Aspak, tha ajo e skuqur në fytyrë dhe gati u fsheh prapa shpatullave të komandantit.

— E dije ti që ky të donte?

— Po. Dhe i kisha thënë të hiqte dorë.

— Pa më thuaj, Sofi, çfarë të shtyn të mos e duash Mafuzin, u bë si më qejf komandanti.

— E para, shoku komandant, ai më shikon si gjyshi im në fshat!

(Të qeshura.)

— Tjetër?

— Ai më premtoi se do të më bënte princeshë, tha Sofia. Sikur nuk i dimë ne mbretin dhe princeshat që i patëm këtu.

— Tjetër?

— Tha që mund të fejojemi e të ndahemi në krye të javës.

— Tjetër?

— Më duket ca si i krisur!

(Të qeshura.)

— Po Mafuzi ç'bënte? — pyeti një partizan.

— Mafuzi kishte varur kokën, kishte lëshuar krahët si ato ikonat në kishën e shën Thanasit, — tha Kozma Peti dhe imitoi Mafuzin ose ikonat. — Por mos kujtoni se ky Mafuz kishte rënë vërtet në dashuri dhe mos kujtoni se ishte ndonjë budalla. Jo, aspak. Ishte një ai, që ç't'ju them! Një herë tjetër iu afrua komisarit, se me komandantin sikur i kishte prerë urat. Shoku komisar, dua të them diçka. Shikoi rrotull si ata që nuk dëshirojnë t'i dëgjojnë të tjerët. Tefiku, tha ai, është duke përkrahur ballistët. Po ç'bëri Tefiku, e pyeti komisari. U hodhi një paketë «Diamant». Ballistët e morën «Diamantin», por s'kishin shkrepëse. Dhe Tefiku po përpiqet t'u gjejë edhe shkrepëse. Ç'do të thuash me këto fjalë, e pyeti komisari Mafuzin. A duhet që një partizan t'u japë armiqve duhan e shkrepëse, pyeti edhe



Mafuzi. Pse nuk ia thua vetë Tefikut, e pyeti prapë komisar, apo mos do që të fitosh simpatinë e komisarit? Mafuzi përcolli pëshlymën, si të përcillte një kokërr arrë. S'është hera e parë që bën kallëzime të fshehta ti, Mafuz, i tha komisar. Këto sjellje janë të pahijshme për një partizan që lufton për të çliruar Shqipërinë dhe nesër do të luftojë për të ngritur Shqipërinë e re. Dëgjon ç'të them? Dëgjoj, shoku komisar, tha Mafuzi i zverdhur. Tashti shko, por ti e di që ballistët janë robër, aq më tepër, që, pasi i shoshitëm, na dolën njerëz të gënjyer dhe ne do t'i lirojmë me kusht që, po i kapëm edhe një herë, plumbin në ballë. Ti e dije këtë? E dija, u përgjigj ai. Shko pra, dhe hiq dorë nga kallëzimet prapa krahëve. Kur Mafuzi kërciti thembrat gjoja i pezmatuar dhe, kur u ndodh te pragu, shoku Xhako i thirri dhe i hodhi një kuti shkrepëse, që Mafuzi e kapi pa rënë në tokë. Jepja Tefikut t'u ndezë cigaret ballistëve, tha ai. E dëgjuat pra ç'njeri ishte Mafuzi? — vazhdoi Kozma Peti. — Ja ç'ngatërresa përpiquej të ngjallte midis partizanëve. Të prishte unitetin, si i thonë, bashkimin midis nesh. Por numri më i bukur është ai që bëri një natë kur ishim bashkë. Ja t'jua them ç'na ndodhi atë natë. Fshatari ku na çuan të flinim na dha një gotë raki, siç e kërkon zakoni. Ai, Mafuzi, Torobojka e thërresin, ia ktheu gotën fshatarit, duke i thënë, nuk e pi, ore ti shoq, unë u largohem alkooleve si eremiti grave. Fshatari shikoi nga unë, pastaj iu kthye Mafuzit, ore, po ktheje një gotë, i tha. Nuk e pi jo, ia priti Mafuzi, jo se nuk më lejojnë principet morale, por sepse dua të bëj karrierë. (Të qeshura.) Fshatari shikoi prapë nga unë, unë hiç. Fshatari prapë shikoi dhe m'u lut që t'ia përktheja fjalët e partizanit, si fshatar që isha. Unë as vetë s'i kisha kuptuar tamam ato fjalë. Të eremitit jo se jo, bari kisha qenë, me lopë e me dhen e dhi, por një çikë më shumë se i zoti i shtëpisë kuptoja, sigurisht. Thotë, i thashë unë, nuk e pi rakinë, sepse kërkon të ngjitet lart. Ku lart, më pyeti fshatari. Lart, i thashë unë. Sipër mbi trarë ai kishte shtruar ca lesa dhe mbi lesa kishte kunguj, kallinj misri, cule e rrangullina të tjera, siç ndodh rën-

dom ndër ne fshatrave. Mirë, tha fshatari në kulmin e gudisë. Kaq tha. Kishte ngut. U kthye me një palë shkallë, bëri njëfarë pastrimi sipër mbi trarë, solli dyshek e jorgan, e shtroi atje dhe na kërkoi falje, se duhej të largohej menjëherë, pasi kishte radhën të vadiste arën. Unë hiç unë. Mafuzi ma kishte sjellë në majë të hundës. U kisha thënë kaq herë komisarit e komandantit të na e hiqnin nga skuadra. Prit, thashë me vete, ku do t'i dalë avazi kësaj muzike. Bile, që ditët e para ne kishim dyshuar për Mafuzin, se mos ishte ndonjë armik i futur me qëllim në radhët tona. Pyetëm atje ku duhej, por ata që e njihnin, na thanë, jo, mbajeni, është ca tuhaf, por ishalla ndreqet e bëhet njeri si gjithë të tjerët. Dhe kështu, që ta kam llafin, në vend të të zotit të shtëpisë, na bëri shoqëri një xhaxha i tij, që ishte plak dhe mezi ecte. Të nesërmen në mëngjes vjen komisar i batalionit, shoku Xhako, për të më takuar, se mahere unë bëja edhe punën e korrierit, kur e lypete nevoja. Shikon ai që Mafuzi fle lart mbi trarë. Ç'bën atje ti, e pyeti komisar. Hiç, ja këtu më shtroi fshatari, tha Mafuzi. Po pse të shtroi aty, pyeti komisar. Nuk e di, u përgjigj Mafuzi. E solli puna që t'ia shpjegoja unë si e qysh kishte ndodhur kjo mesele. Komisar përsëriti me vete fjalët e Mafuzit, por i përsëriti me zë: «Nuk pi, jo se nuk më lejojnë principet morale, por sepse dua të bëj karrierë!» Kështu ke thënë, Mafuz? Po, ashtu kam thënë, u përgjigj qetë Mafuzi. Në të vërtetë t'i qenke njeri i korruptuar dhe i pandreqshëm, tha komisar. Dhe s'je aspak tuhaf, siç kërkon ta heqësh veten. Mos kujton ti se t'i harruam proçkat që deshe të na bëje me dashuritë e tua të lira? Me sa duket Mafuzin e bënë nervoz këto fjalë. Jo unë, por njerëzit e Ballit Kombëtar, si përfaqësues tipikë të borgjezisë shqiptare, ata janë të korruptuar. Gjuhën e kishte brisk Mafuzi, por ç'gjuhëzeza, kujt i hynte në punë ajo. Unë, edhe kur jam në rënie, tha Mafuzi, jam i madh. Sthurja ime është një fenomen i natyrshëm historik nga shkaqe kombëtare dhe ndërkombëtare. Unë jam viktimë e kohës. Jam rrymë idesh!



Partizanët që dëgjonin Kozma Petin, qeshnin, por edhe në gazin e tyre kishte njëfarë trulllosjeje dhe pasigurie, se jo të gjitha fjalët e Mafuzit e kuptonin.

— Këto që po ju them, — tha Kozmai, — as unë nuk i merrja vesh në fillim, por më vonë, kur e sillte radha të qeshnim me historinë e Mafuzit, përsërit njëri përsërit tjetri, derisa i mësova esber!

— Pastaj? — pyeti një partizan.

— Komisari, na-a sytë. Zbrit poshtë, Mafuz, i tha. Mafuzi zbriti. Më brekët e bardha. Vishu, Mafuz, i tha. Mafuzi u vesh dhe pastaj deshi të mbërthente pas belit gjerdanin e pushkës, që i kishim dhënë ne. Jo, i tha komisarari. Ti, Mafuz, do të shkosh andej nga erdhe, në Tiranë. Atje mund të bësh karrierë. Këtu jo, këtu s'ka vend për ty. Iku Mafuzi. Iku duke kthyer kokën prapa e duke shpejtuar hapin, u pengua nja dy herë dhe u zhduk Mafuzi. Pastaj hëngra edhe unë një kritikë, që kisha lejuar Mafuzin të hipte në tra. Por unë e putha në ballë atë kritikë. Hoqa qafe një palaço një orë e më parë, se ai po atje do të përfundonte një ditë. Kur pas një muaji dëgjojmë që ky Mafuz na ishte bërë ballist me halle dhe bile nga ata, që një nga shkrimtarët tanë, në një si bejte të gjatë që paska shkruar për bëmat e Ballit, njerëzve si Mafuzi u paska vënë emrin eksponent, domethënë, njeri me rëndësi në Ballë.. E shikoni pra që Mafuzi s'na kishte qenë as tuhaf as budalla, por thjesht njeri i futur me qëllim në radhët tona. Ndodh, posi! Donte të bënte dashuriçka e t'i bënte partizanët qesharakë në sytë e popullit, duke fjetur trarëve e duke folur për karrierë. Por s'ishte budalla, jo! Ja çfarë pashë me sytë e mi një ditë gjatë Operacionit të Dimrit. Siç e dini, u plagosa në këmbë dhe shokët më vendosën te një i besuar i Lëvizjes. Sa herë që në fshat afroheshin gjermanët e ballistët, i zoti i kasolles më vendoste në zgavrën e një rrapit aty pranë. Ashtu ndodhi, kur një mëngjes në oborrin e kasolles vërshuan armiqtë dhe midis tyre unë shikoj, të veshur civil, një ballist, që thoni ju, një eksponent Balli, zotin Mafuz Torobojka.

— Ku e ke djalin, pyeti ai të zotin e shtëpisë.

— Nuk e di, tha fshatari dhe shikoi gabimisht nga rrapu përmbi kasolle, aty ku isha unë.

— Të ka shkuar me partizanët, ë!

— Nuk e di ku është djali!

Mafuzi kërrusi trupin e gjatë dhe e plagosi fshatarin me revole në këmbë. Ai u rrëzua dhe u përpëliti nga dhimbjet.

— Trego!

— Nuk e di!

Mafuzi i gjatë e plagosi prapë fshatarin në duar e në krah.

— S'di, s'di, s'di, thoshte ai, ndërsa përpëlitej e më kot përpiquej të mbante gjakun.

Një minutë më vonë Mafuzi e vrau fshatarin me një plumb në ballë, plaka ra mbi kufomën e të shoqit, Mafuzi iku dhe krisma të tilla unë dëgjova edhe në oborret pranë. Më vonë mora vesh se i njëjti Mafuz kishte vrarë edhe tre burra të tjerë për shkaqe të ndryshme lufte.

(Në dhomën ngjitur komisarit shikoi Danin, ose, më saktë, shkopin me xhunga të Danit dhe, akoma më saktë, duart e tij të mëdha. Duar të hekurta, mbështjellë me doreza kadifeje, mendoj ai. Dani shikoi komisarin, kërrusur mbi tavolinë, dhe heshti... dhe heshtën të dy me një heshtje që fliste më shumë se çdo fjalë. Isa, që ishte zgjuar me kohë nga zhurma në dhomën ngjitur e që e kishte dëgjuar me ëndje tregimin e Kozma Petit për dashurinë e Mafuzit, tashti shikoi Xhakon, pastaj Danin dhe u ngrys. Dy fëmijët e vegjël, Cani dhe Shega, flinin.)

— Pastaj ndodhi që ky Mafuz të kalonte këndeje me kolonën gjermane, që ndjesë pastë atje ku i ranë kockat. Komisarit, që ishte lajmëruar me kohë, më porositi në mënyrë të veçantë se unë isha ai që e njihja më mirë se kushdo Mafuzin, të hapja sytë, se mos na ikte i gjallë ek-spo-nen-ti i Ballit, tha komisarit. Por Mafuzin nuk e zura unë, siç e dini, atë e zuri Isa me dy shokë të skuadrës së vet sot në mëngjes. Ai shikoi ca këpucët të reja në ferrë dhe u kërrus t'i merrte, por këpucët kishin ngecur diku e nuk lëviznin. Atëherë Isa i tërhoqi



më fort, por bashkë me to doli jashtë nga ferra një goxha Mafuz dy metra i gjatë. Jo kot thotë një fjalë, nga ferrë e vogël del lepur i madh. Isa u zbraps dhe ngriti automatikun.

(Në dhomën tjetër Isa qeshte me vete pa zë.)

— Por Isa, që kishte parë edhe një palë këpucë të tjera në ferrë, thirri, hajde dil edhe ti nga ferra. Kështu doli edhe tjetri. Ç'jeni ju, i pyeti Isa. Mafuzi, që bënte sikur nuk i kishte parë dy partizanët e tjerë, u përgjigj serbes, sikur gjoja s'kishte ndodhur asgjë. Hiç, ore, po flinim, tha Mafuzi dhe, si pa të keq, mori të largohej, e pas tij edhe tjetri. Por Isa u drejtoi grykën e automatikut. Pse, ore çun, me atë hekurishte të ndryshkur do të na vrasësh ti ne? Ju e dini, Isa ka automatik anglez. Kështu bëri shaka Mafuzi dhe prapë mori të ikte. Ecni përpara, u tha Isa dhe, për t'i trembur, u lëshoi ca plumba rrzëzë veshëve, më parë Mafuzit, pastaj atij tjetrit. Por ata hiç, si më parë, sikur gjoja s'kishte ndodhur asgjë. Qëndroni, u thirri Isa dhe u lëshoi përsëri ca plumba rrzëzë veshëve. Atëherë e merrni dot me mend ju se ç'ndodhi? Mafuzi mbeti në këmbë si t'i kishte rënë rrufeja, kurse ballisti tjetër na qenkësh një frikacak, sa ç'të të them... Kur e pa se e kishte të humbur davanë, kur pa se rrotull tyre ishin mbledhur edhe partizanë të tjerë, ai na u shtri përtokë, u zvarris dhe zuri të puthte këmbët e Isës. Por, meqë Isa qëndronte i patundur, atëherë, zo-ti ba-llist vazhdoi zvarrisjen e tij e të puthte çdo këmbë që i dilte përpara, mjaftonte që ato të ishin këmbë. E deri opingat e Turhanit puthi, të atij fatkeqit gjysmë të çmendur e gjysmë... që s'dihet se ç'është. Por Turhani i tha, ik, ore, tutje, dhe me shaminë e kuqe që mbante në kokë fshiu opingën aty ku e kishte puthur ballisti. Ndërsa partizanët qeshnin, ballisti vërtitej si vorbull, duke shikuar me tmerrin e një kafshe të rrethuar... Kjo është me pak fjalë historia e Mafuz Torobojkës dhe e ballistit tjetër, jo Mafuz, por Loduz më duket, që na qenkësh një aga e një ballist jo më pak se Mafuzi.

(Isa qeshte pa zë. Dhe me vete.)



— Po tashti ç'thonë aty ku janë mbyllur? — pyeti një zë.

— Ç'të thonë, — tha Kozma Peti. — Mafuzi shikon rrotull i menduar. Mos kërkon Sofinë, e talla unë. Sofia të bën të fala me shëndet, tashti ajo është komisarë kompanie në një brigadë tjetër që vepron në Veri e që do të peshkojë të tjerë Mafuzë gjatë rrugës për në Shkodër e përtej Shkodrës.

— Dhe s'është aspak tuhaf?

— S'e luan topi! — tha Kozma Peti. — Bile në fillim u përpoq ta hiqte veten si politikan, që kishte qëndruar përmbi krimet, por, kur i thashë se politika jote është tradhti më e madhe se çdo krim e kur i kujtova vrasjen në oborrin e kasolles e në oborret e tjera të fshatit ku u ndodha unë, atëherë vura re se si i ranë pendët menjëherë zo-tit Ma-fuz. Tërë ditën e sotme ka ndenjtur gërmuq atje ku e kemi mbyllur dhe s'kuptohet Mafuzi në dremit apo mendohet, se e di i ziu Mafuz çfarë e pret!... Po sidoqoftë, ai të paktën hesht dhe, siç e kanë zakon të thonë studentët që kemi në brigadë, përpiqet të mbahet me dinjitet. Por ballisti apo ek-spo-nen-ti tjetër, ai që quhet jo Mafuz, por më duket Loduz (të qeshura) e që është një mesoburrë i shkurtër sa i gjerë i gjatë, me një fytyrë të rrumbullakët si hëna pesëmbëdhjetëshe (të qeshura), me faqet labucere të varura poshtë e me mustaqe të ngritura bigë përpjetë, gjithë ai burrë si top dhjami, ka mbetur gojëhapur, shikon si bishë e rrethuar pa shpresë shpëtimi dhe dridhet ditë e natë. Ma ha mendja se, po t'i zgjatësh këmbën, është gati të zvarriset e të ta puthë. T'ju them të drejtën, sa herë e shikoj, më vjen për të qeshur, por unë nuk qesh, nga inati nuk qesh, se më duket sikur atij do t'i pëlqente që unë të qeshja...

Deri këtu e dëgjuan bisedën në dhomën ngjitur të tre ata, komisari, Dani dhe Isa. Jashtë nata ishte e qetë. E qetë ishte edhe qenia e komisarit dhe gjithçka tjetër tek ai. Përjashtim bënin vetëm shikimi i tij i shqetësuar,



si dhe dora e tij, që shkruante paragrafët e fundit të raportit, ose të atij që s'dihej çfarë mund të quhej. Befas, në dhomën ngjitur u bë prapë zhurmë. Por kësaj radhe atje ishte dëgjuar një zhurmë e ndryshme nga të parat. Tashti as tregonin dhe as bisedonin më. Tashti këndonin. Në fillim kënduan e vallëzuan me zë të ulët e me rrahje të dobëta të këmbëve pas dyshemesë. Por pastaj... Kur kënga dhe vallja u ngritën lart, kur ato u ngritën aq sa prekën kufijtë e virtuozeve dhe më vonë u identifikuan me virtuozeve vetë, Xhako Rina dhe këshilltar Dani, pas tyre edhe Isa, si ta kishin bërë me fjalë, u ngritën të tre dhe njëri pas tjetrit shkuan në dhomën tjetër.

Në valle u fut i pari Isa. Me britma gëzimi dhe hareje Isën e nxorën shpejt në krye dhe ai e hoqi vallen si një i madh. U fut edhe njeriu pa një vesh, Tush Sojani, që, tek vallëzonte, e kishte zakon të hidhte kokën prapa e të spërdridhte mustaqet e gjata e të drejta. Pas pak u fut edhe Xhako Rina. Për herë të parë gjatë asaj mbrëmjeje trupi i tij i gjatë dhe i hollë nuk u duk si pemë e përkulur nga era, dhe vallen e hidhte lehtë. Konaku gjëmoi nga kënga e hareja. Teze Rubi, që s'kishte parë e dëgjuar në shtëpinë e saj një gëzim prej aq vjetësh, qeshi e qau e prapë qau e qeshi pa zë, por me lot dhe, kur Isa i erdhi pranë, ajo e zuri për dore dhe doli në krye të valltarëve. Rubi ishte grua e dëshpëruar, por ishte e shkathët dhe e fuqishme, tërë jetën kishte punuar tokën, vetë burrë, vetë grua, në tërë qenien e saj kishte një vrull të përhershëm dhe pikërisht me këtë vrull që futur ajo në valle dhe ndryshe nga të tjerët nxori një shami të bardhë, të cilën zuri ta tundte herë me njërin, herë me dorën tjetër, duke krijuar kështu një ambient të vërtetë dasme.

- Të të rrojë Isa, Rubi!

Këshilltar Dani, me shpatulla pas murit, përplaste duart, i mbante iso Rubit, që ia hidhte bukur si bilbil, që herë-herë qëndronte befas, shikonte si të ishte duke kërkuar diçka, apo si të shikonte valltarin e dytë, Isën, dhe prapë lëshohej përpara me vrull e me hirësi bashkë.

Pas saj lëvizte i gjithë zinxhiri i valltarëve, që ashtu si Rubi edhe ata kishin ngecur për një çast, të mbështjellë nga një re e hollë pluhuri, ngritur nga këmbët e tyre, dhe pastaj dhoma jehonte plot dufe rinore.

— Të të rrojë Isa, Rubi!

29.

Më në fund Xhako Rina arriti ta mbaronte raportin, lëshoi lapsin mbi tavolinë dhe, me një gjest të dukshëm rinor, ngriti krahët e gjatë mbi kokë dhe mori frymë thellë.

Edhe Danit aty përballë i qeshi fytyra. Gati i qetësuar i tëri me shkopin në prehër, me kurriz mbi jastëkun që i kishte vënë Rubi, me sytë gjysmë të mbyllur si i përgjumur, befasi ai u duk dhjetë vjet më i ri, u duk si dyzetvjeçar dhe për këtë e ndihmonin edhe flokët, që, siç e kemi thënë më parë, i kishte pa një thinjë. I gëzuar edhe ai nga gëzimi i tjetrit, tha:

— Të zbrazim një top, komisar!

— Zbraze, Dan!

— Mbarove?

— Po.

— Ata të Tiranës s'paskan punë tjetër, veçse të lexojnë gjithë ato fletë që ke shkruar ti!

— Nuk janë shumë, Dan. Të thashë, nuk janë të gjitha për Tiranën, ca i kam për vete!

— E-e-ej! — u çudit Dani. — Po ç'qenkan ato të tjerat?



— Ca gjëra ashtu, si u bë lufta, por jo për raport. Përshtypje e kujtime të miat!

— E po ç'pret, thirr korrierët që të nisen për Tiranë, sahati dhjetë e ca allafranga.

— Do t'i therres, Dan, ja dhe pak... ca korrigjime.

(Ë leshverdha m'oj trëndelinë... e leshverdha m'oj trëndelinë.

— Ndërro krah, o Zen...

— U bu-bu-bu, — bubulloi ai që mund të quhej Zenel apo Zenun.

— Oj, të paska kërcyer në kokë të na këndosh nëpër gjumë, ti, që s'di të këndosh një këngë me sy hapur.

— U-u-u-u! — Zeneli apo Zenuni.

Pastaj dhomën ngjitur e mbuloi heshtja.)

Edhe në dhomën ku punonte komisari pasoi një heshtje e gjatë, të cilën e prishën ca hapa të rëndë, që ngjiteshin me rrëmbim nëpër shkallët e drunjta.

Ai që hyri ishte i panjohur për Khako Rinën. Kishte fytyrë të madhe, të ngjallur dhe disa njerëz që kanë fytyra të tilla, të lënë përshtypjen se janë të zotët për çdo gjë. Mund t'i quash hajdutë (e beson), mund t'i quash për njerëz të zot e të ndërgjegjshëm (e beson), po mund të jenë një hiç (e beson), mund të duken si budallenj (edhe këtë e beson), mund të duken në të njëjtën kohë të mirë e të këqij (të gjitha i beson). I tillë dukej edhe personazhi që sapo u fut në dhomë, të cilit, sipas rrëfenjave të shenjta, natën e tretë pas lindjes melaqet i kishin vënë emrin Shak Dëllinja.

— Komisar, — tha ky farë Shaku, — kam dëgjuar se do të më arrestoni!

Që në çastin e parë Khako Rina u bind se në sytë e Shak Dëllinjës kishte parë një armiqësi të thellë ndaj të gjithëve, ndaj vetes, Danit, Isës, bile edhe ndaj dhomës e shtëpisë ku ndodhej.

— Kush i ka thënë ato fjalë?

— Nuk e di! Ja këta! — Shikoi nga Dani. — Këta të këshillit!

— E pse?



- Thonë sikur unë paskam bashkëpunuar me armikun!
- Me cilin armik, për shembull?
- Me cilin jo, thuaj, — buzëqeshi Shaku. — Me italianin, me gjermanin, me ballistin, me të gjithë, kështu thonë këta!
- Cfarë bashkëpunimi?
- Nuk e di!

Gjatë kohës që Shak Dëllinja dhe Xhako Rina bisedonin, këshilltar Dani trokiste shkopin në dysheme dhe nga zhurma që nxirrte gëzhoja, nuk ishte vështirë të kuptohej se ai po e humbiste durimin. Instinktivisht Shak Dëllinja ktheu kokën nga shkopi i Danit që trokiste me nervozizëm dhe, padashur, sytë e tij u ngulën mbi duart e mëdha leshtore që mbanin atë shkop. Si për të tërhequr vështrimin e tjetrit mbi vete, Dani u kollit, sytë e Shakut u ngritën nga duart dhe ranë mbi sytë e Danit. Dani tha:

— Nuk e dike ti, Shak aga, pse të kemi quajtur bashkëpunëtor me armikun? — Kur tha këto fjalë, pamja e Danit u duk tepër e përmbajtur. Cigarja e ndezur i tundej midis buzëve si biberon. Që nga ky çast Shaku, si ta pranonte të barabartë Danin, e bëri bisedën me të dy bashkë.

— A do të më ndihmosh, komisar, — tha Shak aga Dëllinja, duke u kërrusur e duke u kthyer herë nga komisar, herë nga këshilltar Dani. Po ta gijkoje vetëm nga vështrimet e syve të tij të vjetër, veshur me atë cipën e lagur e të zvogëluar nga pleqëria ai s'do të të dukej tjetër vecse një njeri i mefshtë dhe gati i mbaruar. Po kjo s'ishte e vërtetë. Një damar i kaltër që i rrihte në tëmtha, duart që nuk i dridheshin fare, llulla që i rrinte drejt në buzë, fjollat e tymit, tek i dilnin me vërtik nga hunda e nga goja, — miaftonin këto, që të bindeshe në të kundërtën. se Shak Dëllinja, pavarësisht nga mosha e thyer përmbi të gjashtëdhjetat, mbabej mirë dhe ishte akoma i fortë, akoma i qartë në mendime e veprime.

(— Ha-ha-ha, të lumtë dora, o Ziko, hidhu edhe një

(bombë tjetër. Ore, po sulm, o Ziko, sulm, ore, sulm!

— Ktheje në krahun tjetër, — tha i përgjumur Zi-koja në dhomën ngjitur.

— Kushedi për sa kohë do të na shfaqet lufta në-për gjumë!)

Tha Shak Dëllinja:

— Jemi njerëz hallexhinj, kemi nipër e mbesa për të rritur!

— Nipërit e mbesat do të rriten edhe pa ty! — e ndërpreu komisari, që tashmë ishte futur në temë dhe ishte orientuar me ç'njeri kishte të bënte.

— ...Kemi edhe goca për të nxjerrë, zotrote...

— S'ka zotrote, shok ose armik!

— ... Shok ti, zotrote, merr rrogë. Bie shi, s'bije shi, pjell a s'pjell lopa, bie ujku në dhen apo ariu në zgjua. ty njësoj të ecën rroga që ç'ke me të. Por na pyet ne një herë si kemi jetuar në kohët e zeza të mbretit, të italianëve dhe të gjermanëve?

Këshilltar Dani shikonte fytyrën e Shakut, por dukej qartë se mendjen e kishte gjetkë. në të kaluarën e jo në të tashmen. (Njihen fare lehtë disa fytyra, kur duan të zbulojnë misteret e së kaluarës.) Xhako Rina jo gjithnjë kishte kohë të dëgjonte: herë-herë diçka shënonte e diçka korrigjonte në letrat që kishte përpara. Më në fund, u duk se do ta përbuzte, por në vend të tij foli këshilltar Dani:

— Të kemi njohur, Shak aga, atëherë edhe sot. Të njohëm gjashtëmbëdhjetë vjet më parë, kur plasi zia e madhe e bukës. Ne vdisnim si mizat, zotrote bëje tregti. Për një çereke misër a grurë na kërkoje dy napolona flori. Ku t'i gjenim ne aq pare për dy javë bukë? Aoo nuk e hodhe pastaj misrin e mykur në Erzen. Dy fëmijë më vdiqën atë vit. Si s'të pas kemi njohur. Me turqit e ke pasur grurë, me princ Vidin. Esad pashën e me Zogun grurë. Të njohëm edhe gjatë Luftës sonë. Sa herë që ushtritë fashiste vinin këtu, ushtarët futeshin nëpër çadra, oficerët në konaqet e tua. Edhe para dy vjetësh, kur na dogji Duçja, edhe para gjashtë muajsh kur na dogji Hitleri, oficerët në konak i kishe. Apo jo?



Ne digjeshim e vriteshim, ju pinit e këndonit! — Gjatë tërë kohës këshilltar Dani kishte folur me zë të përmbajtur, vetëm shkopi i tij kishte rrahur dyshtemenë gjithnjë e më fort.

— U pëlqenin kullat e jo unë, — tha Shaku me zë të ulët, si të mos e kishte humbur fare qetësinë. Shtoi po me atë zë: — Ti, Dan Zavalli, mos fol kot. Populli thotë një fjalë, shtatë herë mate, një herë preje!

— Mbylle! — dhe shkopi i trashë me gdhençka i Danit u ngrit me kërcënim. — Kujton se do të më trembësh me ato fjalë? Perëndoi koha jote, Shak aga. Deri dy muaj më parë s'të flisnim dot një fjalë, se na kishe zët, kurse sot na vjen e na përrallis, si të jesh kaluar. Ik, o Shak, kështu të them unë dhe qepe, ë, qepe, e di vetë ti, qe-e-e-pe! — Fjalët e fundi të Danit, sidomos fjala «qepe» pati një nënkuptim, që kishte të bënte me diçka shumë të rëndësishme.

Pas këtij kërcënimi të Danit, Shak Dëllinja nuk shembëlleu më si qenie e botës bashkëkohore, por si një mbeturinë e brezave të lashtë, kur njerëzit jetonin akoma nëpër shpella, ndërsa sytë iu kthyen në një pellg, që e pasqyron jetën të turbullt në ujërat e tij të zeza, të trasha, të qelbura e të palëvizshme. Tashmë e gjithë fizionomia e tij shprehte njëherësh hutim e dinakëri, frikë e pandershmëri dhe njëqind mendime e ndjenja të tjera negative. Në çastin e fundit, kur po bëhej gati të zmbropsej, shpalosi një shami, që e kishte mbajtur në dorë gjatë gjithë kohës dhe e vuri me kujdes në cep të tavolinës.

— Kthehu! — thirri komisarari.

Shak Dëllinja do të kishte ikur, po të mos ia kishte zënë derën trupi energjik i Rubit, që sapo kishte ardhur.

— Kthehu, Shak, — i tha ajo. — E di zotrote ç'do të thotë kur të thërret një komisar?

— Ç'është? — pyeti ai duke shikuar nga komisarari.

— Jam unë që duhet të të pyes, ç'është kjo pako që më vure këtu? — tha Xhako Rina me zemërim dhe bëri një hap përpara.

Shak Dëllinja, të cilit s'dihet si e qysh i shkuan



sytë te këpucët e Xhako Rinës, nguli një copë herë vështrimin në majat e tyre të grisura. Pastaj, me pamje keqardhëse, tha:

— E ç'është ajo që të kam vënë përpara, komisar, asgjë!

Komisari, shikoi edhe ai këpucët e veta dhe mezi mbyti një valë tjetër zemërimi, kësaj radhe jo kundër Shakut, por kundër vetvetes, që s'ishte kujtuar akoma t'i thoshte intendentit për një palë këpucë të reja.

Sakaq Rubi zgjati dorën, zgjidhi spangon dhe hapi pakon. Në tavolinë u përhap një tufë e madhe bankë-notash të reja. Mijëshe. Të gjitha mijëshe.

— Merri prapë, — tha komisar.

— S'ke turp, — tha Rubi. — Dhe përhap fjalë sikur partizanët s'paskan vrarë as dyqind gjermanë, ë?!

— Ti pusho, — tha ai, duke shikuar nga Rubi. — Për ushtrinë, shoku komisar, ndihmë nga unë!

— I ke të vjedhura, — tha Rubi, — ke vjeshur djersën tonë.

— Rri urtë, Rubi, mos bëj zullume e shpifje!

— Të njohim, Shak aga, — tha Rubi. — Tashti po përpiqesh ta kthesh prapë fletën, të lidhësh miqësi me komisarë e me partizanë, por s'të ecën më!

— Edhe ti, komisar, që je kaq i urtë e kaq i mençur, e dëgjon këtë grua, që zoti e ka dënuar në vetmi?

— Jashtë nga shtëpia ime, — tha Rubi dhe e tërhoqi me forcë për mënge. — Miku dhe shoku yt ishte ai që më vrau vajzën e vetme, por Partia më bëri me djalë, ja ku e kam!

Shak Dëllinja hodhi sytë e turbullt e të lagur si të genit plak nga vatra, ku digjeshin ca kërcunj të mëdhenj e ku flinin dy fëmijët e Tushit, Cani pesëvjeçar dhe Shega trevjeçare. Por shpejt vështrimi i tij u përqendrua vetëm tek Isa që, me broshurë në prehër, dëgjonte bisedat e të mëdhenjve. Shaku e pa mirë Isën dhe e pa me vëmendjen që dinë të shohin njerëzit e moshës së tij por që dinë të fshehin ndjenjat e mendimet e rastit dhe, si të kishte mbaruar punë në dhomë,

prapë kërkoi një shteg për t'u larguar, por Rubi hapi krahët dhe zuri derën.

— Kthehu, Shak, të marrësh paret! — i tha ajo.

Shak agai mori paratë si me pahir dhe u zmbraps, por zëri i Xhako Rinës e gozhdoi në vend:

— Sa dhoma ke ti, Shak a-ga!

— Pesëmbëdhjetë konaqe, — tha Rubi. — Sa Bajaziti, konaqe e mall e toka!

— Dan, e kupton vetë ti! — tha Xhako Rina.

— E kam vënë në defter. Nesër do të strehoj disa nga familjet që kanë mbetur pa shtëpi.

— Po unë ku do të jetoj? — pyeti i tronditur Shak aga Dëllinja. (Kështu ishte tronditur ca orë më parë edhe Bajazit Palla.)

— Hëpërhë ty do të të lëmë aq sa ke nevojë, — tha Dani. — Më vonë shohim e bëjmë!

— Ashtu, ë, ashtu, Dan Zavalli! — gati e kërcënoi ai. — Po kjo është e padrejtë!

— Ore, Shak aga, — ia priti Dani me atë qetësinë dhe durimin e tij që s'njihnte caqe, — më duket se zotrote kishe dalë dje te sheshi para xhamisë, kur festuam çlirimin e Tiranës. A s'të kujtohet si tha Partia? (Dani shikoi nga Xhako Rina.) Gjërat e tepërta që kanë disa, tokat e ku ta di unë, do t'u pjesëtohen të gjithëve. Tashti dëgjo Danin ti, iku koha e babaqemos, s'ka më disave t'u këndojnë bilbilat, të tjerëve qyqet. Hajde marsh, se kemi punë ne këtu!

Shak agai deshi të thoshte akoma diçka, por Rubi i vuri dorën në kurriz dhe e shtyu përpara. Ai u tregua i bindur dhe i urtë, por, para se të kapërcente pragun, shikoi edhe një herë nga Rubi, kësaj radhe si t'i kërkonte ndjesë, pastaj shikoi nga Isa dhe tha si me vete:

— Të të rrojë djali, Rubi! — dhe u shkri me errësirën e shkallëve.

Ata që mbetën aty heshtën një copë herë, aq e madhe ishte neveria për atë që iku, ndoshta më e madhe sesa kur të hedhin përsipër një gjarpër të ngordhur.

Xhako Rina tha:



— Kam lexuar një material për historinë e Revolucionit Proletar e për socializmin në Bashkimin Sovjetik. Kur u ashpërsua lufta e klasave përbrenda vendit, këta njerëz i shpallën kulakë, domethënë armiq nga klasat e pasura.

— Ta shkruajmë në defter këtë fjalë, — tha këshilltar Dani. — Ta shpallim kulak Shak aganë e të mos i zërë këmba dhé. Kemi edhe Bajazit Pallën, edhe hoxhën, që ka po aq toka sa të tjerët, edhe Zyber aganë atje sipër, edhe Yzeir aganë me Can Bishtin atje poshtë te lumi e ndonjë tjetër përveç atyre që u bënë komandantë Balli dhe u humbi vula pa nam e nishan. T'i shpallim kulakë këta gen të tërbuar!

— Ne kemi një dyshim të fortë për Shakun, — tha Rubi.

— Para një viti, — e mori fjalën prapë Dani, — këtu te monopati midis koçimareve u gjend një partizan i vrarë. Dyshojmë se kjo vrasje është bërë nga Shak aga Dëllinja. Ata ishin grindur një natë më parë, se Shaku kishte folur kundër Këshillit Nacionalçlirimtar.

— Tashti kemi organet tona të posaçme, që do t'ua zbulojnë të gjitha rrënjët e fshehura, — tha Xhako Rina dhe hodhi vështrimin në rreshtat e fundit të raportit që kishte përpara, pastaj diçka lexoi e diçka korrigjoi...

Sa herë që komisari mbante lapsin në dorë, kjo bëhej shkak që të tjerët të heshtnin e të mbylleshin në botën e tyre.

30.

Frynte nga pak, por megjithatë nata e nëntorit vazhonte të ishte e butë. E butë dhe e zezë. Të zez dukeshin edhe ata të dy, edhe ajo vetë, e cila qëndronte pakëz



më tej. Ata nxirrnin pushkët nga dengjet e barit, mbushnin krahët dhe i vendosnin me kujdes në arkat e mëdha në fund të gropës, hapur në qoshe të grazhdares. Nuk shikonin asgjë nga njëri-tjetri, veç siluetave, por vështrimet i ndienin fare mirë nga drejtimi që merrnin zërat e tyre të ulët e zvarritës.

— Shumë pushkë paske marrë, Shak! — tha Bajazit Palla.

— Ishte luftë e madhe ajo, dasmë e madhe. Hendeqet ishin mbushur plot me të vrarë e me pushkë deri afër shtëpisë sime.

— Mirë, vallahi, ata bëjnë luftë, ne armatosemi, — tha Bajazit Palla. — Por shumë paske marrë. Lakmia e madhe të bën gropën.

Shak Dëllinja shikoi nga zonja Dir, gjë që u kuptua nga drejtimi i zërit të tij:

— Pse, zonjë, s'do të na duhen shumë pushkë?

— Patjetër do të na duhen, — pëshpëriti zonja Dir. — Në këtë kohë pushka na duhet më shumë se çdo gjë tjetër. Kryesorja është këtu brenda. Duhet të luftojmë ne këtu, që të na ndihmojnë miqtë e jashtëm. Mua s'më pëlqyen aspak disa nga njerëzit tanë, burra e gra qofshin, që me të parë të afrohej fundi, mbushën vali-xhet dhe ikën nga sytë këmbët, duke i kthyer krahët Shqipërisë sonë e duke e lënë atë në duart e fundërrinave. Ja pse më tepër se çdo gjë tjetër, pushka e besa na duhen sot.

— Por duhet kujdes i madh me këta, — tha Bajazit Palla. — Po t'i gjetën, të fikën!

— E di, — tha Shak Dëllinja. — Unë pse të thirra të më ndihmoje. Me t'u ndarë me komisarin e tyre, i thashë vetes, shtrëngo rripat, Shak, me këta nuk bëhet shaka.

— Që s'janë budallenj, këtë ta jap unë me ferman, — tha Bajazit Palla, vibracionet e zërit të të cilit rrahën fytyrën e zonjës Dir, si rreh tingulli gati i shurdhër i një pareje kallp.

— Por ne do t'i mundim, — tha zonja Dir. — E kur t'i mundim, e kur të kthejmë përsëri kohën tonë, atë-

herë ju do të më thoni se ata nuk paskëshin qenë fare të zgjuar!

Dy agallarët shkonin e vinin nga dengjet e barit në gropën e hapur dhe zonja Diri, që ndiqte padashur siluetat e tyre, mendohej të përfytyronte sytë e shkruar, të verdhë e të ngushtë të Bajazitit, që kishin vështrimin e zgjuar e tinëzar të gjarprit, kur ai zvarriset drejt viktimit. Ajo kishte pasur më se një rast për t'i fiksuar një herë e mirë tiparet e tij të vogla e nazike, hundën, buzët, si dhe mustaqet e gjata, të drejta, të holla e pak të thinjura, si të gjeneralëve të Kiplingut. Zërin ai vërtet nuk e kishte të fortë e të kumbueshëm, siç e kishin ata gjeneralë, por në këtë natë të zezë, edhe zëri i saj, edhe zëri i atij që quhej Shak Dëllinja, kishin humbur çdo tingull, çdo karakteristikë, ishin kthyer në zëra zvarritës e mjaft të shurdhër. Sa për tiparet e Shak Dëllinjës ajo nuk kishte arritur akoma të krijonte një përfytyrim të qartë. Shumë-shumë mund të mendonte se Shak Dëllinja ishte një aga me kokë të madhe (konturet e së cilës shquheshin paksa në errësirë) e si rrjedhim edhe me fytyrë të madhe. Por të nesërmen ajo do të kishte kohë të njihej e të familjarizohej edhe me Shak Dëllinjën. Të nesërmen! Të nesërmen!... Ndoshta, duke menduar se nata dhe errësira do të kalonin dhe se e nesërmja, dita, drita do të ishin në favorin e fitimtarëve, ajo shpejtoi të thoshte:

— Agallarë, mbaroni punë, se kemi shumë gjëra për të biseduar e për të bërë!

### 31.

Kur Rubit iu duk se fshati ishte qetësuar, se kthimi i të shpërngulurve ishte ndërprerë ose rralluar dhe në shtëpinë e saj partizanët flinin të gjithë, me përjashtim



të Xhakos e të Danit, që rrinin përballë njëri-tjetrit e të Isës që mund të ishte duke lexuar, atëherë ajo u vërtit edhe pak nëpër shtëpi, pastaj mori kandilin dhe u fut në dhomën tjetër të zjarrit. Tashmë gjithçka tek ajo ishte qetësuar. Dhe, nga kjo qetësi, lëvizjet i kishte të buta Rubi, i kishte çuditërisht të kundërta me natyrën e saj të vrullshme. Duke ecur ngadalë pranë dritares me sëpatën në dorë, (si të mos qe nisur për të vrrarë një hoxhë) këmbët i qëndruan vetvetiu e ajo hodhi vështrimin përtej xhamave. Por aty ishte errësirë dhe nuk shikoi e nuk shqoi dot asgjë...

...Edhe atë mëngjes, gati një vit më parë, në dhjetorin e vitit 1943 aty qe ndodhur Rubi, pikërisht në këtë dhomë e pranë kësaj dritareje. Partizania, që kishte fjetur dy net me radhë tek ajo, u përqaftua me të dhe ngjiti të përpjetën e rrugicës përballë, që të çonte te sheshi i fshatit para xhamisë, ku zakonisht mbledheshin partizanët para se të largoheshin. Tëk e ndiqte me sy të ngjitej, Rubi se ç'ndiente një boshllëk. Ajo s'mund të thoshte se kjo partizane i kujtonte vajzën e vet, mbytur në Erzen dhjetë vjet më parë, por s'mund të shprehte as të kundërtën. Të paktën ishte e sigurt se lartë e të shurdhër Rubin, si dhe vetë shtëpinë e saj. Në çastin e fundit, kur partizania kapërcëu oboirin e shtëpisë dhe mori të përpjetën, Rubit iu kujtua t'i dhuronte një pajë e së bijës, që ajo i ruante akoma në sepete. Ja pse qe ndodhur Rubi në këtë dhomë e pranë dritares, ku në fillim dëgjoi vetëm një krismë, pastaj një rrebesh në të gjithë fshatin. Rubi u zgjat në dritare dhe shikoi partizanen, që kishte rënë në rrugicës e pak më vonë automatik.

Në krahun e djathtë të partizanes ajo pa një gjer-man prapa një gardhi. Duhej të kishin qenë plumbat



e automatikut të tij që thyen xhamat e dhomës ku ndodhej Rubi e që pak më vonë rrëzuan nga muri fotografinë e së bijës dhe pam, pam, pam tre kallinj misri ranë me radhë në dysheme. Rubi u zgjat te dritarja dhe shikoi partizanen, tek i kishte kthyer kurrizin gjermanit, që shtinte nga prapa gardhit. Me sa dukej partizania s'e kishte vënë re atë dhe hëpërhë luftonte kundër një tjetri, që duhej të ishte në krahun e majtë e që Rubi nuk e shikonte dot. Pastaj ajo pa një gjerman të tretë, tek i doli partizanes përballë, por ai u rrëzua shpejt e s'u ngrit më. Bile Rubi vuri re edhe fjollat e pluhurit që u ngritën rrotull trupit të shtrirë të gjermanit. Më në fund partizania hodhi një batare dhe u ngrit gjysmë e kërrusur për të zënë një pozicion të ri. Dhe e zuri. Por para se të arrinte atje, ajo kishte vënë dorën në bark dhe Rubi u bind se tashmë partizania ishte plagosur. Dhe duhej ta kishte plagosur gjermani që shtinte nga krahu i majtë. Rubi bëri një rrotullim mbi thembra, shikoi nëpër dhomë si për të kërkuar diçka, rrëmbeu sëpatën, mbështetur pas murit, dhe u lëshua gati me vrap nëpër oborr...

Ajo nuk deshi të merrej me këto kujtime. Jo se kishte ngut. Përkundrazi, ishte mjaft e qetë për gjithë sa kishte vendosur të bënte atë natë. Por kujtimet e ditës së dhjetorit të vitit 1943 i rëndonin shpirtin, jo më pak se sa kujtimet e plagës për të bijën. Hoqi sytë nga dritarja, përtej së cilës s'dukej gjë tjetër, përveç errësirës, shoi kandilin dhe me sëpatën në dorë kapërcëu pragun e dhomës.

Jashtë frynte po ajo erë e lehtë si pak më parë dhe Rubi i bëhej sikur frynte apostafat për të, për t'i ardhur në ndihmë, për ta shtyrë drejt qëllimit të saj. Në errësirë pemët e zhveshura ose pothuaj të zhveshura të oborrit kishin humbur madhësinë e tyre të vërtetë.



të Xhakos e të Danit; që rrinin përballë njëri-tjetrit e të Isës që mund të ishte duke lexuar, atëherë ajo u vërtit edhe pak nëpër shtëpi, pastaj mori kandilin dhe u fut në dhomën tjetër të zjarrit. Tashmë gjithçka tek ajo ishte qetësuar. Dhe, nga kjo qetësi, lëvizjet i kishte të buta Rubi, i kishte çuditërisht të kundërta me natyrën e saj të vrullshme. Duke ecur ngadalë pranë dritares me sëpatën në dorë, (si të mos qe nisur për të vrrarë një hoxhë) këmbët i qëndruan vetvetiu e ajo hodhi vështrimin përtej xhamave. Por aty ishte errësirë dhe nuk shikoi e nuk shqoi dot asgjë...

...Edhe atë mëngjes, gati një vit më parë, në dhjetorin e vitit 1943 aty qe ndodhur Rubi, pikërisht në këtë dhomë e pranë kësaj dritareje. Partizania, që kishte fjetur dy net me radhë tek ajo, u përçafua me të dhe ngjiti të përpjetën e rrugicës përballë, që të çonte te sheshi i fshatit para xhamisë, ku zakonisht mblihdeshin partizanët para se të largoheshin. Tëk e ndiqte me sy të ngjitej, Rubi se ç'ndiente një boshllëk. Ajo s'mund të thoshte se kjo partizane i kujtonte vajzën e vet, mbytur në Erzen dhjetë vjet më parë, por s'mund të thoshte as të kundërtën. Të paktën ishte e sigurt se largimi i kësaj partizaneje do ta linte përsëri të heshtur e të shurdhër Rubin, si dhe vetë shtëpinë e saj. Në çastin e fundit, kur partizania kapërceu oborrin e shtëpisë dhe mori të përpjetën, Rubit iu kujtua t'i dhuronte një shami me hoje shumëngjyrëshe e një palë çorape nga paja e së bijës, që ajo i ruante akoma në sepete. Ja pse qe ndodhur Rubi në këtë dhomë e pranë dritares, ku në fillim dëgjoji vetëm një krismë, pastaj një rrebesh krismash nga të dyja anët e rrugicës e pak më vonë në të gjithë fshatin. Rubi u zgjat në dritare dhe shikoi partizanen, që kishte rënë në gjunjë e që shtinte me automatik.

Në krahun e djathtë të partizanes ajo pa një gjerman prapa një gardhi. Duhej të kishin qenë plumbat

e automatikut të tij që thyen xhamat e dhomës ku ndodhej Rubi e që pak më vonë rrëzuan nga muri fotografinë e së bijës dhe pam, pam, pam tre kallinj misri ranë me radhë në dysheme. Rubi u zgjat te dritarja dhe shikoi partizanen, tek i kishte kthyer kurrizin gjermanit, që shtinte nga prapa gardhit. Me sa dukej partizania s'e kishte vënë re atë dhe hëpërhë luftonte kundër një tjetri, që duhej të ishte në krahun e majtë e që Rubi nuk e shikonte dot. Pastaj ajo pa një gjerman të tretë, tek i doli partizanes përballë, por ai u rrëzua shpejt e s'u ngrit më. Bile Rubi vuri re edhe fjollat e pluhurit që u ngritën rrotull trupit të shtrirë të gjermanit. Më në fund partizania hodhi një batare dhe u ngrit gjysmë e kërrusur për të zënë një pozicion të ri. Dhe e zuri. Por para se të arrinte atje, ajo kishte vënë dorën në bark dhe Rubi u bind se tashmë partizania ishte plagosur. Dhe duhej ta kishte plagosur gjermani që shtinte nga krahu i majtë. Rubi bëri një rrotullim mbi thembra, shikoi nëpër dhomë si për të kërkuar diçka, rrëmbeu sëpatën, mbështetur pas murit, dhe u lëshua gati me vrap nëpër oborr...

Ajo nuk deshi të merrej me këto kujtime. Jo se kishte ngut. Përkundrazi, ishte mjaft e qetë për gjithë sa kishte vendosur të bënte atë natë. Por kujtimet e ditës së dhjetorit të vitit 1943 i rëndonin shpirtin, jo më pak se sa kujtimet e plagës për të bijën. Hoqi sytë nga dritarja, përtej së cilës s'dukej gjë tjetër, përveç errësirës, shoi kandilin dhe me sëpatën në dorë kapërceu pragun e dhomës.

Jashtë frynte po ajo erë e lehtë si pak më parë dhe Rubi i bëhej sikur frynte apostafat për të, për t'i ardhur në ndihmë, për ta shtyrë drejt qëllimit të saj. Në errësirë pemët e zhveshura ose pothuaj të zhveshura të oborrit kishin humbur madhësinë e tyre të vërtetë.



Me hap të ngadalshëm, por e bindur se nuk do të kthehej poshtë, pa hequr kokën e hoxhës, ajo kaloi përmes oborrit të shtëpisë dhe mori të përpjetën e rrugicës.

...Por, kur po ecte përpjetë rrugicës Rubi vuri re se kishin ndodhur përsëri ndryshime. Automatiku i partizanes shtinte nga një tjetër pozicion, jo më kundër gjermanit prapa gardhit, sepse ai kishte rënë përmbys dhe, me sa dukej, ishte vrarë, por në një drejtim të panjohur për Rubin. Aty në rrugicë ajo kuptoi edhe një herë se bëhej luftë e madhe në të gjithë fshatin, deri poshtë në xhadë, deri lart te shkëmbinjtë buzë pyllit. Kudo bëhej luftë. Rubit nuk i kujtohej sa zgjati beteja rrotull shtëpisë. Një minutë. Dy. Pesë. Jo, asaj nuk i kujtohej asgjë. Kur kapërceu oborrin dhe mori përpjetë rrugicës për t'i shkuar në ndihmë partizanes, e cila me një dorë shkruhe automatikun (gjithnjë më rrallë) me tjetrën mbante barkun, befas, po në atë rrugicë pa një gjerman të zbrapsej me kurriz drejt saj. Në qoftë se Rubi donte ta ndihmonte partizanen, në qoftë se ajo donte ta shpëtonte atë partizane, duhej që çdo gjë ta bënte sa më mirë e sa më shpejt që të ishte e mundur, aq më tepër që gjermani vazhdonte të shtinte e vazhdonte të zbrapsej, pa dyshuar aspak për rrezikun që mund t'i vinte nga prapa krahëve. Rubi vrapoi, ngriti sëpatën dhe mendoi se do ta kishte ca vështirë t'ia priste kokën atij gjermani, sepse jo vetëm që ndiente një si zbrazëti e një si drithërimë brenda vetes për këtë vrasje të parë në jetën e saj, por edhe sepse ajo vraponte nga poshtë-lart, kurse gjermani zbrapsej nga lart-poshtë dhe, përveç kësaj, ai ishte ose të paktën duhej të ishte më i gjatë se ajo. Por, kur Rubi u ndodh prapa shpatullave të tij, përkundrazi, doli se gjermani nuk ishte nga të gjatët dhe megjithëse ajo nuk i mban mend të gjitha hollësitë, të paktën i kujtohet mirë shkëlqimi i hirtë që la nga pas tehu i sëpatës, para se të ngulej në qafën e gjermanit. Megjithatë nuk ishte Rubi ajo që e vrau gjermanin, nuk ishte ajo që i preu kokën,

sepse, me sa duket, një plumb e kishte qëlluar më parë gjermanin dhe asaj i kujtohet trupi i tij që i ra te këmbët si trung pa jetë, duke zënë të gjithë rrugicën. i kujtohet edhe helmata e tij që u rrokullis me zhurmë tatëpjetë zhurishtës, derisa ngeci te pragu i pahisë...

Tashti Rubi ishte e qetë dhe ecte ngadalë. Ajo vërtet kishte sëpatë në dorë, por s'të linte fare përshtypjen se po shkonte për të vrarë një njeri, një hoxhë. Shtëpitë e fshatit ishin të rralla dhe akoma më të rralla të padiegurat dhe fare të rralla ato që ndriçonin. Ndriçonte llamba e saj, kishte edhe një dritë në një dhomë të Bajazit aga Pallës, një tjetër te konaqet e Shak aga Dëllinjës. Pofhuaj asgjë tjetër. Pothuaj. Në të vërtetë fshati as flinte, as rrinte zgjuar. Për këtë dëshmonin zjarret, britmat e teneqetë në arat buzë lumit. Vende vende fshati ngjante me një llogore të braktisur pas një beteje të gjatë e të egër. Aty nga mesi i tij, rrethuar gjithashtu me llogore, ngrihej xhamia me minaren e shkurtër, që në errësirë dukej e shëmtuar, po megjithatë zotëronte fshatin si një plakë gungaçe. Edhe atje kishte dritë. Dhe Rubi drejt asaj drite shkonte. Drejt së përpjetës së rrugicës me zhurishtë.

...Ajo nuk i kishte dalë akoma në krye së përpjetës me zhurishtë për të arritur partizanen e plagosur, që ishte tërhequr duke luftuar, kur befas përballë saj u gjend një partizan.

— Shoqe, merre. — tha ai, duke i zgjatur partizanen e plagosur. — Ne do të kthehemi këtu në rastin më të parë. Bëj ç'është e mundur. Fshihe, mjekoje, shoqja jonë ka marrë plagë të rënda! — Kaq tha partizani, i vuri Rubit mbi kurriz të plagosurën, gati pa ndjenja dhe vetë u ngjit sërish përpjetë, duke lëshuar breshëri të gjata.

Rubi, me një dorë te partizania e plagosur, me tjetrën duke shtrënguar sëpatën, zbriti tatëpjetë rrugicës, kapërceu kufomën e gjermanit, kapërceu edhe helmetën



që kishte ngecur te pahia dhe hëpërhë e futi partizanen në dhomën e zjarrit.

Pastaj beteja qe zhvendosur në krye të fshatit. Në mesditë krismat e saj qenë dëgjuar më larg. Kurse ato që kishin ndodhur në atë dhomë nga mëngjesi deri pasdite, kur partizania kishte dhënë frymën e fundit, Rubi i ruante thellë si kujtimet më të dhimbshme të jetës, të cilat, duke u përpjekur të mos i përmendte kurrë, duke u përpjekur t'i harronte fare, përkundrazi, çdo ditë që shkonte, i bëheshin më të fuqishme e më të gjalla.

Atë mbrëmje Rubi i kishte veshur partizanes së vdekur çorapet, që kishte dashur t'ia dhuronte, i kishte lidhur në kokë shaminë shumëgjyreshe, i kishte veshur ato pak rroba të pajës që kishte mundur të sajonte aso kohe për të bijën, e kishte krehur dhe e kishte bërë partizanen të bukur si nuse, pastaj kishte hapur mortjen në fshat. Shtëpia e Rubit ishte mbushur me gra, me burra e me të reja. Bashkë me partizanen, ajo kishte qarë edhe të bijën, edhe të shoqin e vëllanë e vogël, që kishte vdekur duke pirë ujë në vend të ilaçeve. Pas Rubit kishin qarë të gjitha gratë, kurse atje tej krismat e betejës shkonin gjithnjë më larg, gjithnjë më lart, drejt majave të shumta të Kërrabës...

Ajo ecte e qetë dhe ngadalë. Hoxha kishte heshtur qyshkur dhe Rubi mendonte se ajo kishte qenë thirrja e tij e fundit nga maja e minares. Era kishte rënë pak, ishte zbutur, ndërsa pika të vogla e të rralla shiu trokisnin lehtë nëpër errësirën e plotë, pa asnjë të qarë. Poshtë, përtej xhades së automobilin dëgjohej uturima e lumit, që edhe ai dilte nga errësira dhe zhdukej po në errësirë. Këtu, atje, afër dhe larg kishte thirrje, rrahje teneqesh e pikëzime të kuqe zjarresh, të gjitha të atyre që ruanin misrat nga derrat e egër. Ishin larguar nga qielli rosat e egra. Pas hoxhës, edhe ku kuvajka kishte heshtur, veç bufët jo, ata këndonin buzë



pyllit e brenda në pyll dhe dukej qartë se u gëzoheshin natës dhe errësirës.

Kur Rubi i u afrua xhamisë, hapi i saj u bë akoma më i ngadalshëm. Por, ashtu i ngadalshëm, ai dukej më i vendosur. Në kokën e saj tashmë s'kishte mbetur tjetër mendim, përveç sëpatës që shtrëngonte me të dyja duart dhe hoxhës aty afër. Dhe ajo e arriti hoxhën kur ai po shuante llambat.

— Mos i shuaj të gjitha, — tha Rubi.

Hoxha nuk i ngriti sytë ta shikonte. Ai e kishte njohur atë zë dhe e dinte nga ç'trup kishte dalë. Ashtu, pa e shikuar, si një milingonë e gjendur para një pengese, ai ktheu rrugë.

— Qëndro, hoxhë efendi! — Në të vërtetë hoxhën nuk e kishte arritur vetëm zëri, por edhe hapat e Rubit, që i kishte prerë rrugën, i kishte zënë derën e brendshme, që të çonte në dhomat e shtëpisë aty pranë.

Hoxha ndaloi me vështrim të papërqendruar midis sëpatës dhe fytyrës së Rubit. Sytë, që i kishte pasur gjithmonë të rrumbullakët, të mëdhenj dhe shprehës, me kalimin e viteve i qenë zvogëluar e vagëlluar, por, duke humbur gjallërinë, ata kishin shtuar dinakërinë. Qimet e gjata të vetullave, të përmbysura mbi qepallat e tij. Çdo gjë tjetër ishte thinjur, thinjur deri në bardhësinë apo deri në shkëlqimin e borës. Buzët i qenë varur dhe kudo nëpër fytyrën e rrudhur, njollat e vjetra mavi, të ngjashme me hematomat, i qenë zmadhuar.

— Ç'ke ndër mend të bësh, Rubi? — pyeti ai me zërin, që iu shua në grykë.

— Kam ndër mend të të vras, hoxhë efendi!

Hoxha u duk sikur nuk shikoi Rubin, por zërin e saj dhe drejtimin që kishte marrë ai zë.

— Do të bësh në gjynah të rëndë, rob i perëndisë!

— Ashtu thua ti, hoxhë efendi!?

— Ashtu them, rob i perëndisë!

— Po gjynahet e tua ku do të lahen?

— Unë s'kam gjynahe!

Sëpata lëvizi në duart e Rubit, tehu i saj lëshoi

vezullime të kuqe. Ndërsa hija e trupit të Rubit kishte pushtuar një faqe muri, hija e sëpatës rrëshqiti nëpër tavanin e xhamisë. Atje shikoi hoxha, në tavan, dhe tavanin u duk sikur foli:

— Mendohu, bija ime, zoti do të të ndëshkojë rëndë!

Kaq mundi të thoshte hoxha, se pastaj, si milingona që i kanë zënë rrugën, u zbraps, por, në hapin e dytë, sëpata e Rubit i kishte prerë një pjesë të kokës dhe njërin vesh. Goditja tjetër i kishte çarë kokën mes për mes dhe trupi i hoxhës u shemb para këmbëve të Rubit.

Nga dera e brendshme e xhamisë doli një qenie e zezë, e tharë, me sy të groposur, me flokë të thinjur e të lëshuar nën shaminë që kishte humbur ngjyrë. Ajo mund t'i ngjante gjithçkaje, një djalli... një dhelprë... një galë, por vetëm një gruajë jo. Ra me klithmë mbi hoxhën dhe trupi i saj u duk i lehtë si shkop i tharë.

— Ty që më vrave vëllanë, flama do të të zërë, buka helm do të të bëhet! — dhe mbeti ashtu gojë-hapur e pa dhëmbë si magji e vjetër e si dëshpërim i pafuqishëm.

E rreptë, e stolisur dhe madhështore nga vetë nuri i saj, si një portret i Van Gogut, teze Rubi mbeti në këmbë, e heshtur dhe e patrembur.

— U bëre me bir në shpirt, ë? — kërcënoi ajo, djalli, dhelpra, galë etj. Kordat e zërit ishin tendosur në grykën e saj thatanike. — Me një Isë, ë?!

Me të dëgjuar emrin e Isës në gojën e saj, për një ose për njëqind shkaqe dhe arsye, Rubi kërcëu prapa e tronditur.

— E paske marrë vesh?

— Po ç'bëjmë ne këtu, hamë kashtë?

— Edhe emrin ia dike?

— Isë! — shqiptoi ajo.

Rubi prapë u drodh.

— Mos ia zër emrin në gojë, — iu lut ajo.

— Isë!

— Mos!

— Mos e gëzofsh Isën! — tha plaka, djalli, dhelpra, ose e motra e hoxhës, ndërsa duart dhe krahët e saj të



tharë u dukën si çapokët e galave. Po zëri, me gjithë kordat e tendosura në grykën thatanike, nuk të kujtonte aspak krrokatjen e galave, përkundrazi, ai zë megjithëse kishte një tingull të shurdhër e të ngjirur, të kujtonte vetëm zërin e një gruaje të mjerë e po aq fatkeqe sa vetë Rubi. Dhe ishte pikërisht kjo grua që bëri sikur diçka pa nëpër ajër, diçka fryu nëpër ajër, diçka murmuriti me vete, që për Rubin mbeti e pakuptueshme, pastaj tha:

— Ta vraftë zoti Isën me gur të nxehtë!

Teze Rubi nuk deshi t'ia zgjaste asaj gruaje, që me gojën e hapur pa dhëmbë, si gryka e një shpelle të qelbur, priste t'i gllabëronte Isën. Iku, e ndjekur nga disa pasthirrma, nga disa u... u... u... e vu... vu... që e ndiqnin nëpër errësirë dhe sikur i ngeceshin Rubit nëpër cepat e rrobave. Përtej pragut të xhamisë ajo ktheu padashur kokën prapa dhe shikoi atë qenie të tmerrshme të hapte krahët, të hidhte kokën prapa, të lëshonte një klithmë dhimbjeje e të rrëzohej mbi kufomën e hoxhës me këto fjalë:

— Vëlla, ku ike e më le mua kërcuren!

### 32.

Komisarit, që e shikonte me bisht të syrit, i dukej sikur brëkushet e gjera të Dan Zavallit po bëheshin gati për t'u ngritur: kishte filluar të lëvizte ajri brenda tyre. Por në të vërtetë, në vend që të ngrihej, Dan Zavalli rrinte si më parë, ulur në minder, mbërthente e zbërthente kopsat e xhaketës ushtarake pa grada,



veshur mbi xhamadanin e zi, dhe, po ashtu, hiqte e vinte qeleshen apo fesin e bardhë, të gjatë si qyp kokëposhtë.

Isa i shikonte të dy. Duke e gjykuar nga pamja, kuptohej qartë se edhe atij i kishin lindur ca mendime, ose, më mirë të themi, ca dyshime.

Më në fund, komisari mënjanoi letrat që kishte përpara, shikoi duart nervoze të Danit dhe befas pyeti:

— Mos e ke fjalën për Rubin?

Dani, si ai njeriu kur i gjejnë vendin e plagës ku i dhemb më shumë, nxori ajrin me teftik, duke psherëtirë si top kur shfryhet.

— Aty e ke edhe ti komisar! — tha ai. — E shoh unë, edhe ty s'po të punohet!

— Po, — tha Xhako Rina.

— Rubi s'po bëhet e gjallë për një kohë të gjatë! — shtoi Dani.

— Mos do të thuash me këtë se do të ketë shkuar për të vrrarë hoxhën?! — pyeti Xhako Rina.

— Ashtu them!

Sikur të kishte munguar vetëm kjo frazë, për ta kthyer në realitet dyshimin, si për atë që e kishte dëgjuar, si për atë që e kishte thënë, si dhe për Isën që ishte bërë tërë sy e veshë te këndi i vatrës, të tre ata u ngritën me vull. Dani rrëmbeu pushkën varur në mur, komisari dhe Isa rrëmbyen automatikët, njëri nga cepi i tavolinës, tjetri nga këndi i vatrës dhe po me atë gjallëri ecën të tre drejt pragut, por sakaq përballë tyre u shfaq Rubi me sëpatën ndër duar. Shikoi Isën, shikoi Danin, të fundin shikoi Xhakon dhe pastaj tha, duke ecur përmes dhomës, tashmë me hapin e saj të vrullshëm:

— Tashti, komisar, bëj ç'të duash me mua! — Ajo ishte zverdhur, kishte një dridhje të lehtë në duar dhe po aq në buzë. Mbështeti sëpatën në anë të tavolinës dhe befas ia plasi të qarit.

— Pse qan, teze Rubi? — pyeti Xhako Rina, edhe ai i tronditur.

— Qaj vajzën time, — tha ajo. — Pas dhjetë vjetësh,

qaj edhe një herë vajzën time. Qaj edhe burrin që më vdiq nga marazi. Qaj edhe partizanen, që më vdiq në duar. Edhe vëllanë e vogël, që në vend të ilaçeve pinte ujë!

— Ah, e paske vrarë? — pyeti komisari, duke vënë re sëpatën e gjakosur.

— E vrava!

Pllakosi një nga ato heshtjet, ku, siç është bërë zakon të shkruhet, mund të dëgjohen edhe rrahjet e zemrës. Isa shikonte i habitur rrotull, pa mundur të mblidhte veten dhe mendimet.

— Ja, siç e shikon, me këtë e vrava! — Me duart e ashpra Rubi preku tehun e mprehtë të sëpatës.

— Isa në fillim eci ngadalë, pastaj më shpejt, befasha në gjunjë dhe mbështeti kokën në prehrin e Rubit. Ajo i përkëdheli flokët dhe lëshoi lot.

— Të mos e kishe vrarë, teze Rubi, — tha Xhako Rina. — Së shpejti ne do të vendosim drejtësi për të gjithë e për gjithçka.

— Këtë ditë e kisha pritur që kur në fshatin tonë erdhi për herë të parë çeta partizane dhe që kur atje sipër te shkëmbi krisi pushka e parë! — Këto tha Rubi dhe doli jashtë me hapin e vrullshëm e me vrugat e lotëve në sy e në faqe.

Jashtë fryu një gulsh ere. Një gjethe e tharë fiku u fërkua lehtë pas xhamit dhe po aq lehtë u zvarris nëpër oborr. (Ajo ishte një vjeshtë, që vetëm gjethet i kishte të lehta.)

### 33.

Ndërkaq Xhako Rina hodhi vështrimin nga këshilltar Dani, por jo si zakonisht nga opingat e mëdha, që fundja nuk i thoshin asgjë tjetër përveç këmbënguljes,



as nga shkopi, as nga duart, etj. etj., bile nuk shikoi as fytyrën e Danit, por vështrimi i tij u ngjit menjëherë në faqet e murit atje ku maliheri i Danit varej prej disa orësh. Por fjalën nuk ia drejtoi Danit.

— Isë, — tha.

— Po, shoku komisar! — Isa, si ta kishte pritur me kohë këtë thirrje, ishte ngritur në këmbë dhe fërgëllonte i tëri, që më në fund komisari do ta ngarkonte me një detyrë. Ia pat qejfi Isës të përfytyronte plumbin që mund të hante koka e ndonjë oficeri tjetër kriminel dhe sikur u zverdh pak, sepse sa herë që Isa ndodhej në prag të një hakmarrjeje të re (të vërtetë apo të përfytyruar), i kujtohej ajo natë e llahtarshme, dëgjonte thirrjet e së motrës, o ma-a-a, o ba-a-a, o li-i-i-së, i kujtohej pastaj zhdukja e prindërve në bodrumet e SIM-it, zhdukja e Dhimitrit, pas tij e Kristinës së bukur dhe e Bedenëve të tjerë, nga të cilët kishin mbetur gjallë vetëm dy çapaçulet me Stefanin tetëvjeçar, ashtu siç kishte mbetur vetëm ai nga Brezarët dhe...

— Isë, lajmëro urgjent që batalioni i dytë dhe kompania e shtabit të mbliidhen menjëherë te sheshi i fshatit!

Isa mbeti një hop i zhgënjyer, pastaj sikur e mori veten, sikur u kujtua, se duhej të zbatonte një urdhër, se ky urdhër gati në mesnatë mund të ishte më tepër se një hakmarrje e vetme (dhe Isa diçka dinte e diçka kishte kuptuar e dëgjuar gjatë asaj nate), eci me vrap përmes dhomës dhe, kur ishte në të dalë, dëgjoi sërish zërin e komisarit të zinte me gojë edhe emrin e intendentit të brigadës.

Kur mbetën vetëm, Xhako Rina ngriti sytë e përhimë aq sa i duhej për të shikuar errësirën përtej xhamit të dritares së vogël. Nga shprehja që i kishte marrë fytyra, mund të mendoje se në atë çast sytë e tij shikonin arat me misër, pastaj ato qenie të çuditshme, as derra as njerëz, që rrethonin duajt, këpusnin kallinjë, zhvishnin lëpushat dhe hanin krrap-krrap-krrap misrin e pullit, misrin e ushtrisë. Tek qëndronte ashtu



me sytë në errësirë përtej xhamit, më në fund u duk sikur në ballin e tij të lodhur, por gjithmonë të ri, shkruhej pothuaj qartë se ky vendim do t'i vinte pikën çdo enigme, se ata do t'i gjenin së shpejti qindra gjermanët e humbur prej tri ditësh, e, bashkë me ta, do të gjenin edhe numrin e saktë të humbjeve të armikut në betejën e Mushibës. Për të arritur në këtë vendim e në këtë përfundim, duhet të themi se Xhakon e kishte ndihmuar edhe këshilltar Dani, që rrinte ulur me orë të tëra, që e shikonte me durim e me bisht të syrit e që me shkopin magjik bënte figura pas figurash.

— S'po durohen më këta de-rra të e-gër, Dan, — tha Xhako Rina.

— E pra, — tha Dani aty për aty.

— Krrap-krrap-krrap, — qeshi komisarari.

— Apo jo!

— Këta de-rra që ecin vargan-vargan, që s'u tremben krismave, që ngrihen me dy këmbët e para dhe krrap-krrap!

— Sikur nuk thashë! — qeshi edhe Dani.

Xhako Rina i palosi letrat pa kujdes, edhe ato që ai thoshte se kishin të bënë me raportin, edhe ato që thoshte se nuk i kishin dalë si raport, por si diçka tjetër, që i kishte quajtur me vete «Shënime të ndryshme nga lufta», të gjitha këto letra, pa ndryshim e pa i ndarë, Xhako Rina i palosi dhe i futi në çantë, duke thënë se korrierët do t'i niste në Tiranë, në mëngjes herët. Derisa bëri këtë punë, ai ruajti qetësinë, ruajti natyrën e tij të zakonshme, por pastaj një nxitje e brendshme, të cilën s'qe në gjendje ta përmbante, e ngriti në këmbë dhe, kur sytë e tij u takuan me të këshilltar Danit, tha:

— Kështu pra, Dan, — ai shikoi prapë nga maliheri mbi kokën e Danit, — derrat e egër do ta kenë pisk sonte!

Këshilltar Dani, që e kishte kuptuar me kohë këtë ndryshim të komisarit e që e kishte shprehur me kohë gjendjen e re që ishte krijuar midis tyre, nxori kutinë e duhanit, i hodhi një të dredhur komisarit, vuri edhe për vete një në gojë dhe tha:

— Sa të pimë nga një cigare, aq herë...

— Dua të të bëj një pyetje, Dan!

— Bëje, komisar, pse të mos e bësh?!

— Më thuaj të drejtën, mirë që më bëre nder si zot konaku, por unë dua të di si munde të presësh kaq orë për gjuetinë e derrit të egër?

— Fare lehtë, komisar. Nuk doja të ngutesha, se punët e luftës janë të vështira, mund të dalësh i gabuar, turpëroresh, mbetesh me gisht në gojë, aq më tepër me fashistët, që janë treguar edhe ujq, edhe skile, por pastaj e kuptova se edhe ti kishe të njëjtat dyshime si unë, e kuptova se edhe ti, me të mbaruar raportin e me të ardhur koha e përshtatshme për të rrethuar këtë lloj derri, do të ngriheshe menjëherë në këmbë. Këtë unë e kuptova pothuaj që në fillim. Dhe prita. — Kështu e mbaroi Dani këtë ligjëratë që ishte një nga më të gjatat e asaj nate.

— E-e-ej!

Pasi i thithën cigaret e trasha dredhur me letër të trashë, pasi e lëshuan fjollë tymin nga goja e nga hundët, pasi qëndruan në heshtje, kur i kishin pirë gati në gjysmë, atëherë fytyrat e tyre treguan se të gjitha ato që kishin ndodhur atë natë kishin mbetur prapa dhe se që nga ai çast fillonte për ta një veprimtari e re, që do të kërkonte të tjera mendime dhe të tjera përpjekje.

Khako Rina pyeti:

— Dan, sa burra bëhen sonte në fshat që janë në gjendje të na ndihmojnë?

Dan Zavalli nuk u përgjigj menjëherë. Ai bëri një llogari me vete, pastaj tha:

— Nëntë!

— Na duhen për të drejtuar skuadrat e kompanitë nëpër arat e misrit.

— Po ja, Tushi një, (dhe instinktivisht Dani shikoi nga Cani e Shega që flinin te këndi pranë vatrës), një i ri tjetër që ka qenë partizan, por që është kthyer me gjithë pushkë, se ka thyer një këmbë, dy.

— Si e ka këmbën?

— Me jaki, por ecën me një patericë.

— A mund të jetë në gjendje të na ndihmojë?

— Posi, kërcen pup-pup?



- Tjetër?
- Një fqinji im. I papërzier gjatë gjithë luftës, por derrat s'po i duron dot!
- Mos është i dyshimtë?
- Jo-o-o!
- Tjetër?
- Të pestët dhe të gjashtët janë dy vëllezër, të dy sallahakë dhe dritëshkurtër, por sa për këta derra që e kemi fjalën ne, e bëjnë punën.
- I shtati?
- I shtati dhe i teti janë dy prindër partizanësh që po u bien teneqeve.
- I nënti?
- Nëntë, thashë unë?
- Po.

Këshilltar Dani u mendua.

— Me sa duket, i nënti jam unë vetë, — tha pas pak. — Kaq jemi ne, komisar. Ka pleq e plaka që s'kanë lëvizur nga shtëpitë, por ata s'janë në gjendje. Të tjerë s'ka. Ca janë partizanë nëpër çeta e brigada, ca janë shtyrë më thellë me fëmijët. Ca po kthehen që sonte, por ata s'i ke për derrat, shumica i gjejnë shtëpitë të djegur e të shembura, kurse pesëmbëdhjetë djemtë e burrat që vunë yllin partizan para dy javësh e që luftuan bashkë me brigadën në Mushibë, i kemi në batalionin përtej lumit.

— Lëri ata, — tha Xhako Rina.

— Kaq jemi ne. Kryetari dhe dy këshilltarët e tjerë, siç e di, shkuan bashkë me zëvendëskomisarin në Tiranë për të marrë udhëzime të reja.

— Na mjaftojnë. Vendasit do të marrin nga një skuadër apo nga një togë secili dhe do t'i vendosin nëpër shtigjet që dinë ata vetë.

— Këtë punë, komisar, më lër mua. Mos u bëj merak. Ti fli, se nesër të presin punë të tjera!

— Jo, — tha prerë Xhako Rina. — Do të vij edhe unë.

Te dera u fut intendent i brigadës, duke fërkuar sytë e duke hapur gojën nga pagjumësia. Por drita e llambës



dhe komisari përballë, që e priste me padurim në këmbë, me sa duket ia nxorën gjumin.

— Sa elektrikë dore u kemi zënë gjermanëve? — pyeti Xhako Rina.

— Përmbi një mijë, — tha intendent i jo pa çudi.

— Batalioni i dytë dhe kompania e shtabit të pajisen menjëherë me elektrikë.

— Të gjithë kokë për kokë?

— Të gjithë.

— Mua më thanë se do të gjuajmë për derra! — tha ai.

— Për derra, — tha komisari.

— Pse gjithë ky nder derrave?

— Me sa duket derri i Mushibës e meriton një nder të tillë, — qeshi komisari.

— Por drita e tremb derrin! — nguli këmbë prapë intendent i.

— Derrin e Mushibës jo, dhe mos harro, se do t'i ndezim vetëm pasi t'i kemi rrethuar!

Intendenti tundi kokën i pabindur dhe ngriti supet i çuditur, megjithëse një hije dyshimi u ndeh nëpër fytyrën e tij të sapozgjuar.

— Jemi vonë, — tha komisari.

— Ja ku u nisa, — tha intendent i. — Me leje të largohem?

— Shko, — tha komisari.

Intendenti doli.

Kur mbetën vetëm, Xhako Rina mbështeti dy bërrylat mbi tavolinë — kishte dhimbje në kurriz — dhe shikoi nga këshilltar Dani. Këtij të fundit, (megjithëse e kishte nxitur vazhdimisht komisarin të shpejtontë dhe s'kishte lëvizur akoma nga minderi), brekushet e gjera sikur kishin filluar t'i merrnin ajër nga horet e para të muskujve. Tha:

— Tashti, komisar, si thua ti, a të shkoj të mbledh bashkëfshatarët?

— Të shkosh, Dan!

— Ja ku shkova, — tha Dani, zgjati krahun drejt maliherit dhe pas pak u dëgjua te shkallët e drunjtja ajo

trokitje e veçantë, që i përkiste vetëm Danit, i përkiste vetëm këmbës së shkurtër dhe shkopit të tij me gëzhojë në majë: tak-fak, tak-fak, tak-fak...

34.

Mesnata e nëntorit ishte bërë e ftohtë. Qëmtonte si për borë. Por kishte mjaftuar ky qëmtim që toka, bimësia e gjithçka të ishin lagur, bile e lagur dukej edhe vetë errësira. Ndihej mbi kokë se grumbuj të mëdhenj resh të zeza kalonin ngadalë dhe shtriheshin të rënda në majat e larta të Kerrabës, duke zbuluar rrallë e tek draprin e hollë të hënës së re. Atje poshtë Erzeni uturinte me uturimën e ujërave të fryra e të turbullta.

Njëshkollonat partizane u lëshuan tatëpjetë drejt sheshit para xhamisë, që ishte mesi i fshatit Mushibë. Minarja e shkurtër mezi shquhej pak mbi gungën e rrumbullakët të çatisë. Dëgjoheshin kudo, si një përgjumje vjeshtake, parullat e kundërparullat dhe do të mjaftonte të gjykoje lëvizjen e atyre zërave, që të kuptoje drejtimin nga vinin e nga shkonin skuadrat.

Kur batalioni i dytë dhe kompania e shtabit u mbledhën te sheshi e kur komandat kërkuan të mos bëhej zhurmë, atëherë që nga brendësia e xhamisë u dëgjuan ca fjalë, ca vajtime të një zëri të shurdhët dhe, siç ndodh në raste të tilla, të gjithë e morën vesh se pak më parë teze Rubi kishte vrrarë hoxhën e fshatit. Ata që s'e kishin ditur, morën vesh edhe historinë apo arsyen pse e kishte vrrarë. Dhe të gjithë, ndërsa fërkonin sytë akoma të përgjumur, shanin hoxhën, sidomos gjer-

manët e humbur, të cilëve s'ua kishin pasur borxh një shqetësim të tillë, pikërisht pas disa netëve pa gjumë e sidomos pas gjashtëdhjetë e ca orëve të betejës së fundit.

Pasi u bënë të gjitha sqarimet e rastit, pasi u shpjegua edhe një herë qëllimi dhe vëmendja që duhej treguar gjatë këtij operacioni, që mori emrin *Gjuetia e derrit të egër*, njëshkolonat u vunë për rrugë.

— Komisar, — pëshpëriti Dani, ndërsa ecte herë përpara, herë prapa Xhako Rinës, — ne të dy do të zëmë shtigjet e Arave të Thella. Më është dukur sikur atje ka bubërruar *derr* i madh gjatë netëve të fundit.

Ecën një copë herë në heshtje, ecën duke dëgjuar secili zhurmën e çapave të vet tek zhyteshin nëpër baltovinat e monopateve.

— Të kujtohen Arat e Thella?

— Aty ku gjetëm më se dyqind kufoma gjermanësh, të vendosura si në një turrë drush, e që thamë se i kishin vendosur vetë gati për t'i djegur?

— Por s'patën kohë, — shtoi këshilltar Dani.

— Më kujtohet, posi, Arat e Thella pranë lumit e pyllit, rrethuar me kaçuba.

— Tamam, — tha këshilltar Dani. — Atje do të shkojmë bashkë.

— Mirë.

— Besoj se do të bëjmë gjueti të bukur!

— Do t'i verbojmë me elektrikët e dorës, — tha me shaka e me seriozitet Xhako Rina.

Prapa tyre zbriste në heshtje njëshkolona partizane. Veç këmbët u lloçoqiteshin nëpër baltovinat. Ajri ishte i lagësht, i papëlqyeshëm. Retë vozisnin dhe pastaj sikur ngecnin majave të Kërrabës. Binte shi i imët, i butë, i qetë. Dhe nuk frynte.

Tej, si nga mali i Dajtit e si nga Tirana u dëgjua prapë ai mitralozi i rëndë, kllu-kllu-kllu, shoqëruar me krisma pushkësh dhe automatikësh, që ngjanin si të lehura konesh.

— Do të jetë ndonjë përpjekje e partizanëve me



mbeturinat e çetave të reaksionit, — tha Xhako Rina.

— Do të kemi ca telashe me to!

— Do të kemi, — tha Dani, — por s'kanë më krah!

— S'kanë.

— U mungon gjermani, — tha Dani.

Pasoi një heshtje.

— Mbetën jetimë të shkretët! — u tall Dani.

— Fare jo, — korrigjoi Xhako Rina. — Edhe brenda do të gjejnë ndonjë bazë si gjatë luftës, edhe nga jashtë do të kenë përkrahje.

Disa hapa përpara tyre u dëgjuan çapitje njerëzish dhe bagëtish. Dhe pastaj një pëllitje e fortë. Dani mbajti vesh sipas zakonit. Tha:

— Kaun e ka vënë përpara Rama si gjënë më të shtrenjtë, pastaj robtë e shtëpisë.

Kur u afruan, Dani e pyeti:

— I solle sagllam fëmijët, Ramë?

— Sagllam, Dan, po ti si i ke?

— Mirë i kam.

— Shyqyr! — Rama qëndroi pak. — Veç që u ktheva pak tek ara ime përmbi rrugë.

— E, ç'pe atje?

— Gjylet e topit e të mortajës ma kishin cuar dëm grurin e mbjellë. Pëllëmbë e gropë. Prapë do të më duhet ta mbjell.

— Nesër do të merremi me të gjitha, Ramë. Me shtëpitë e diegura, me arat që duhen punuar rishtas, se pōthuaj shumicës ua kanë mbjellë arën me gjyle topi. Do t'i lutemi edhe komisarit të na japë për një javë ca kuaj ushtrie për të tërhequr parmendat. Të gjitha i kam vënë në defter, mos ki merak!

— S'më ka mbetur asnjë kokërr grurë për farë, — tha Rama.

— Edhe këtë e kam vënë në defter. Do të gjejmë farë për ty e për të tjerët, mos këtu, në depot e Tiranës. Sa për shtëpinë, bëj si të bësh sonte, përderisa këshilltarit tuaj i ka hipur në kokë të gjuajë derra të egër, që po na ngrenë misrin nga arat, pa nesër të rregulloj unë ty në konaqet e agallarëve.

— Dan, ti e di, katundari do koliben e vet!

— Edhe kolibet do t'i ndreqim bashkarisht, por do të mësohemi edhe në kullat e në konaqet e agallarëve e të bejlerëve!

Njëshkolona zbriti në rrugën automobilistike. Ajo zuri atë anë të sai që ishte spastruar disi nga trofeja, atë anë që kishte më pak pengesa, më pak mbeturina topash, mortajash, kamionësh, karrocash, tankesh e kuaj të ngordhur. Dukej sikur njëshkolona ecte nëpër një muze të hapur natyror, të zymtë, të braktisur e të mbetur në errësi. Tashti këmbët e partizanëve nuk zhyteshin në baltë, por bënë një zhurmë tjetër, zhurmën e lashtë e të njohur të gozhdës që fërkohet pas asfaltit dhe zhurmat e tjera akoma më të lashta e më të njohura të llojeve të ndryshme të opingave, që u përkisnin të gjitha anëve e krahinave të Shqipërisë. Por ajo ishte gjithmonë një e ecur me përvojë, e mënçur, e kujdesshme, vigjilente, një e ecur partizane. Në njëfarë vendi njëshkolona u shkëput nga rruga, dhe një copë herë eci paralel me uturimën e uërave të fryra e të turbullta të Erzenit derisa u fut nëpër disa shtigje të ngushta, ku bisqet e ferrave zgjateshin si duar të zeza dhe u pickonin partizanëve fytyrat e qafat.

Terreni doli tepër i gjerë e tënër i thyer, me përrrenj, me brigje e shkarrëzime. Xhako Rina i ishte përveshur vetë punës me zell, bile edhe me pasion. Tashmë ai kishte formuar bindjen se diçka do të dilte nga kjo gjueti e natës.

Partizanët e treguan shpejt e shpejt aftësinë e tyre për të zënë në fshehtësinë më të madhe çdo monopati, çdo ferrë dhe arë, në mes të të cilave ngriheshin atë-këtu nëpër errësi duait e misrit, si ca çenie të gjalla e të cuditshme, kur presin të ndodhë diçka e jashtëzakonshme.

**Drejt Arave të Thella, që ishin më të dendura me misra e ferra, u zvarrisën disa skuadra me Xhako Rinën e këshilltar Danin në krue, të gjithë me armën në një dorë e me elektrikun e dorës në tjetrën.**

Një zog lëshoi një klithmë grabitqare dhe u dëgjuan



krahët e tij që fërfëllinë nëpër errësirë. Nata shtrihej e plotfuqishme dhe e heshtur. Lumi dilte nga errësira dhe humbiste në errësirë. Qetësi gjumashe. Ishte pra koha më e përshtatshme për të mbrojtur misrat nga cilëtdo parazitë qoftë, nga derrat e vërtetë apo nga derrat-njerëz. Kjo rrethanë, sigurisht, i kishte bërë shumë të gjallë e mjaft kureshtarë partizanët.

Ishte edhe koha, kur nëpër errësirën e dendur nontonte aroma e papërcaktuar e lagështisë, që shkaktonin pikat e imëta të shiut të ftohtë, si qëmtim e si shtrat bore.

35.

Ashtu siç pritej, për herë të parë derrat u dukën në Arat e Thella, që ishin më të fshehura e për më tepër ishin arat e para që kufizoheshin me pyjet, të cilat fillonin aty dhe pushtonin pastaj të gjitha malet e Kërrabës, zinxhir njëri pas tjetrit. Derrat ecnin mbi katër këmbët e tyre dhe errësira të jepte përshtypjen se ishin të shumtë, se ishin të gjithë të mëdhenj, se ecnin me një rregull gati të përsosur, gati për një (sigurisht ndodhnin edhe çrregullime, grumbulloheshin e prapë shpërndaheshin, se derra ishin), por ajo që ishte më e çuditshme, çapiteshin dhe nuk bënë fare zhurmë. Kështu u zvarrisën përmes arave dhe pastaj, befas, u shpërndanë nga tre e nga katër, nga pesë e nga dhjetë rrotull duajve me misër, që edhe ato mezi shquheshin nga errësira. Por, me të arritur pranë duajve, aty e treguan menjëherë veten se ishin derra, u hodhën me tërbim mbi degët e mbi ka-



llëzat e misrit, i thyenin, i këpusnin, i zhvokshin me noçkën e tyre plot përvojë dhe kudo filloi të dëgjohej zhurma që bën misri, kur bluhet midis nofullave.

Krrap-krrap-krrap...

Khako Rina, këshilltar Dani, si dhe të gjithë partizanët, të struktur pas ferrave dhe hendeqeve, heshtnin me një heshtje të thellë dhe kudo rreth e rrotull s'dëgjohej tjetër përveç klithmave grabitqare të atij apo të atyre zogjve nate, jehona e të cilëve përhahej në pyll, buzë pyllit e nëpër pemët e çatitë e fshatit. Dhe:

Krrap-krrap-krrap...

Khako Rina pëshpëriti:

— Si kështu, mos dolëm të gabuar, Dan?

Pëshpëriti edhe Dani:

— Po të jetë për gabim, i pari e bëra unë!

— Atëherë s'je i bindur se kemi gabuar?

— Jo, — pëshpëriti i pavendosur këshilltar Dani. Pëshpëriti prapë: — Unë e njoh mirë derrin. Tërë jetën e kam gjuajtur, por derr që të mos hungërojë nuk më kanë zënë veshët!

— Dale, prit, — pëshpëriti Khako Rina, — ja, a nuk është hungërimë kjo?

Dani mbajti vesh nga ara ku buburronin derrat mbi katër këmbët e tyre dhe mbeti një copë herë pa folur. Ato ishin disa zhurma vërtet hundore, por jo tamam hungërima derri, as tamam bërëritje njeriu.

— E di ç'bëjmë, — tha Dani.

Khako Rina heshtte.

— Unë them të presim ca, — tha Dani. — Të rrethuar se të rrethuar i kemi!

— Pastaj?

— Po të dalin derra, u futim nga një plumb. Po dolën gjermanë, në dorë i kemi, s'kanë nga të na ikin.

— Sigurisht, gjëja më e lehtë është të presim, por si është e mundur të jenë gjermanë dhe asnjëri nga ata të mos dojë të ngrihet të paktën një herë në këmbë?!

— Unë, pra, dyshoi se ata janë gjermanë! — tha më

**në fund, me zë më të vendosur këshilltar Dani.**  
**Pas këtyre fjalëve të Danit, tashti i kishte ardhur**

radha Xhako Rinës të heshtte e të mendohej, por elektrikun e dorës e kishte bërë gati.

Krrap-krrap-krrap...

Xhako Rina kishte bërë gati edhe automatikun. Tha:

— Një gjë është e sigurt, këta që kemi përpara, qofshin derra, qofshin gjermanë, s'para kanë ndryshim midis tyre!

Dihet se, në raste të këtilla, gjuetarëve nuk u pëlqen zhurma, por Xhako Rinës, që as kishte qenë dhe as ishte gjuetar, nuk po i pëlqente fare qetësia dhe as po e duronte dot. Prandaj, kur vendosi të mos përgjonte më, kur erdhi çasti të thyente heshtjen, ai ndjeu njëfarë lehtësie dhe gëzimi dhe para se të jepte sinjalin me tri të shtëna, sipas fjalës së bërë, ndezi elektrikun e dorës, ndriçoi me të duajt e misrit, ndriçoi edhe derrat e egër, që u ndodhën më në afërsi.

Krrap-krrap-krr....

Një çast më vonë, ose më pak se një çast, elektrikët e dorës ishin ndezur nga të gjitha anët. Ara me misrat e me derrat dolën çipllak. E megjithatë zotëroi një heshtje e thellë, askush nuk shtiu, askush nuk foli. Derrat kishin pushuar së brejturi dhe heshtja që bërë më e thellë. Më në fund Xhako Rinës zuri t'i dridhej elektriku ndër duar. Pas pak e njëjta gjë duhej të kishte ndodhur edhe me elektrikët e partizanëve. Të gjitha dritat lëkundeshin, dridheshin, zhvendoseshin sa në një cep në cepin tjetër të arës, ndriçonin herë një ose pesë derra, herë dy ose dhjetë derra. Dhe ktheheshin përsëri nga ishin nisur, gjithçka ishte në lëvizje e në heshtje habitore, vetëm derrat kishin mbetur në vendin e tyre si të mbërthyer, thuaise një fuqi misterioze i kishte ngurosur, i kishte bërë derra të pangjashëm me vetveten. Pastaj, fuqia misterioze sikur i çliroi pak nga pak dhe ata, derrat, morën forma nga më të ndryshmet, por vetëm formën e derrit jo, me të vetmin përjashtim, se qëndronin mbi katër këmbë si derra të vërtetë. Megjithëse kjo që po ngjante para syve të partizanëve ishte një gjë e pritur dhe e paralajmëruar, prapëseprapë kjo e vërtetë e pabesuar i gozhdoi gjatë ata. Kur pat

kaluar ngurimi i parë, habia e parë, vetëm atëherë  
njëri nga partizanët thirri tërë sinjeritet:

— Gjermanë me katër këmbë!

Përtej dritës së elektrikëve të dorës, dhe përtej e  
rrotull gjermanëve me katër këmbë, errësira të linte  
përshtypjen e një shushurime. Shushurinte lumi atje  
poshtë.

36.

Deri në mëngjes operacioni që ishte quajtur *Gjuetia  
e derrit të egër* kishte marrë fund. Ishin pothuaj 500  
*derra*, ose, më saktë, me një firo të vogël 2 për qind, që  
do të thotë 494 *derra* — nazistë. Nga ara në arë kopetë  
e derrave u bashkuan me njëra-tjetrën, të qeta, të urta,  
të kapitulluara. Ose për inerci, ose pse midis tyre kishte  
vepruar një ligj epidemik, njëshkollonat e robërve imi-  
tuan njëshkollonën e parë, që doli nga Arat e Thella:  
ata ecnin të gjithë këmbadoras, pa guxuar të ngriheshin  
në këmbë.

— Çohuni! — u thërrisnin partizanët.

Por ata s'çoheshin. Bënin plluc-plluc nëpër baltovinat  
e Mushibës.

— Paskan mjaftuar tri ditë e tri net që të zvarri-  
seshin ferrave, për të harruar të ecin në këmbë! —  
çuditeshin partizanët.

— Ç'është njeriu, një qime e ndan të quhet kafsha më  
e mençur dhe më e egër!

— Kështu si janë katandisur këta, s'mund të quhen  
asgjë!



— Çohuni!

— Më keq bile, më keq se derrat e egër!

Kishte nga ata nazistë që, duke ecur këmbadoras, dukeshin të nemitur e të bindur si engjëj. Në fytyrat e disave dalloheshin tipare zhgënjimi të thellë, ca dukeshin si zogj pule të lagur e të sëmurë, ca si kaposhë të sapomundur, të lodhur e të sflitur, ca të linin përshtypien si të goditur me dru në kokë apo të mashtruar si fëmijë. Një babiloni e tërë fizionomish, që mund të thuash se i bashkonte pamja e vetme që u jep njerëve një histori e pashpresë, një disfatë e pashmangshme. Por përbindëshi zvarranik zgjatej e zgjatej dhe vinin të tjerë përbindështa (njëshkolona) gjithmonë të heshtur, gjithmonë si balona të shfryra, të llangosura kudo me baltë. Kishte mbetur prapa zhurma e Rajhut të Tretë dhe e Rendit të Ri. kishin mbetur prapa fitoret e dikurshme të ushtrisë së Vermahtit, ishin harruar fjalët e premtimet e Hitlerit për armën sekrete, që do t'i iepte fund luftës, e bashkë me këto shumë ëndërrime të tiera të një skizofreni. (aë atie në Berlin e kishte akoma pushtetin në duar). të gjitha këto ishin bërë oluhur e hi. ishin kthyer në fluska sapuni pa asnjë vlerë. Por tek ecnin ashtu, vërtet si derra të egër me katër këmbë, veçanërisht të llangosur me baltë, me shiun e imët, që binte si ironi mbi kurrizin e tyre, megjithatë dukeshin sikur ishin bërë më të zgjuar, më të urtë, më të arsyeshëm. Ndoshta. Por, sidomos, ata vazhdonin të ecnin këmbadoras, dhe, me gjithë thirrjet që u bënin partizanët për t'u ngritur, askush nuk mori guximin të ecte në këmbë, sepse ndoshta ata pandehnin se, kush do të guxonte të ngrihej, do të ishte pikërisht ai që do të hante plumbin i pari. Por në ato rrethana të caktuara, midis tyre mund të vepronin edhe shkaqe e ligje të tiera të pashkruara nër psikologjinë e të mundurve, ligje këto që mund të ishin kthyer në një bestytini të panjohur edhe për ata vetë. Dhe përbindëshi zvarranik vazhdonte të zvarrisej si më parë, duke formuar një zinxhir të gjatë, që dukej e zhdukej baltërave, hendeceve dhe monopateve të Mushibës, që, duke qenë një i tërë, herë fshihte njërën

pjesë të tij, herë një tjetër, herë kokën e bishtin, apo anasjelltas, si një vargan magjirash të heshtura e të demaskuara. Askush nuk kthente kokën e nuk hidhte vështrimin gjatë përveçse brenda vetes. Askush nuk fliste. Veç njëri prej tyre, i veshur me kominoshe (shofer apo tankist etj) tha një herë me zë të lyster si me vaj:

— Kamerad!

Dhe asgjë më tepër.

Por kishte edhe nga ata, oficerë apo ushtarë, kjo s'dihej (sepse asnjëri prej tyre s'kishte lënë shenja të dukshme), që, megjithëse në pozicion të papërshtatshëm e në situatë të disfavourshme, hidhnin vështrime të zemëruara, fytyrat u karakterizoheshin nga vija të ashpra, si të të gjithë njerëzve që janë marrë me vepra të ulëta e të poshtra. Kishte ikur koha kur bota e brendshme e kriminelëve nazistë i ngjante një kasaforte të mbyllur. Tashti në ballin e tyre mund të lexoje gjithçka që ngjan me njeriun, kur ai ka rënë në fatkeqësi e kur i ka humbur të gjitha shpresat për të dalë nga ajo.

Njëherë ndodhi një trazirë. Në një nga unazat e përbindëshit të giatë plasi një grindje e shkurtër, por e shpejtë dhe barbare. Në fillim nazistët zunë të skërmiteshin me njëri-tjetrin si në një xhungël majmunësh. Pastaj ndeshia u bë e egër dhe e dëshpëruar. Me sa duket, sipas rrëfimeve të partizanëve që u ndodhën më afër, njëri nga ushtarët, duke u zvarrisur, e qëlloi tjetrin që i vinte pas me këmbë në fytyrë. Atëherë ai që u gjakos në hundë, ka të ngjarë të ketë qenë oficer, u hodh mbi tjetrin dhe e zuri për gryke. Të tjerë u lëshuan mbi të tjerët dhe kacafytja, klithmat e britmat u përhapën në të gjitha ose gati në të gjitha unazat e përbindëshit. Thanë disa partizanë, nga ata që kishin pasur rast ta shikonin në jetë se kjo pamje i ngjante nepërkës kur e zënë të gjallë e kur ajo, duke humbur të gjitha shpresat për të shpëtuar, kafshon vetveten, helmohet dhe ngordh. Kështu ndodhi edhe me njëshkolonën zvarranike, e cila u bë kapicë, u ndesh, u kafshua, u përgjak, u nxjerrë klithma, e heshtur si gjarpri, derisa, më në fund, partizanët mundën të ven-



dosnin rregullin. Kur përbindëshi vijoi rrugën më tej, u pa të kishin mbetur prapa katër nga unazat e tij të sakatuara. I katërti nuk kishte vdekur akoma, por gurmazin e kishte të shkukur, ishte pa sy e pa hundë dhe hiqte, por nuk vdiste.

— Ta vrasim, ta shpëtojmë! — tha një partizan, hoqi pushkën nga supi, shënoi në zemër dhe shtiu.

Gjermani, i ri ose jo (ata ishin bashkuar me baltën), oficer apo ushtar, pa gurmaz, pa sy e pa hundë, tundi këmbët, harkoi trupin dhe pastaj u qetësua ngadalë.

Disa minuta më vonë edhe partizanët shqiptarë u mësuan me këtë përbindësh zvarranik, që nuk donte të ngrihej në këmbë (që dukej aq i nënshtruar, por që s'ishte veçse një barbar) dhe gati-gati partizanët harruan atë që përbënte thelbin e kësaj ngjarjeje dhe pamjeje të jashtëzakonshme, dhe gati-gati çdo gjë, çdo gjest, çdo vështrim e zemërim i mbeturinave të ushtrisë naziste, zuri t'u dukej krejt i natyrshëm dhe fare i zakonshëm. Ndërsa ecnin në të dyja anët e përbindëshit, megjithëse të lodhur e të pagjumë, ata ishin të çelur e të gëzuar dhe flisnin tërë gjallëri, siç mund të flasin njerëzit në çastet e fitores përfundimtare. Ndoshta kjo ndjenjë e kjo ndërgjegje për fitoren e tyre, i tregonte edhe hije rëndë, aq sa mund të duken njëzetvjeçarët, sepse dihet botërisht se shumica e partizanëve shqiptarë rreth kësaj moshe vërtitej.

— Le të shpresojmë, — tha dikush me zë të thellë si për t'iu përgjigjur një mendimi po aq të thellë, — se ushtarët filluan luftën kundër oficerëve të tyre nazistë!

— Ore shokë, t'i vrasim të gjithë them unë! — thirri një partizan i sugjestionuar. — Këta që paskan harruar të qëndrojnë në këmbë e që po hanë njëri-tjetrin, do të vijë një ditë që do prishin botën!

— Lëri ato fjalë ti, — tha një tjetër. — Ata s'e prishën dot botën kur patën fuqinë në dorë e jo tashti!

— Atyre nuk u ndihmoi as gulashi i Bavarisë! — u tall një i tretë.

— As suxhuku dhe salçiqet e Frankfurtit! — një i katërt.



Pas këtyre fjalëve, si një gjë e pritur, pllakosi një heshtje e plotë, e prapë si një gjë e pritur, plasi një e qeshur e fortë, që kaloi gojë më gojë e që përfshiu të gjithë batalionin. I pari qeshi me notën e vetme komisarit, Xhako Rina, pastaj partizanët dhe këshilltar Dani. I fundit e ndërpreu të qeshurën Isë Brezari.

Pyeti një partizan:

— Po këtij, shoku komisar, pushtet demokratik popullor i thonë?

— Kujt?

— Këtij që zë armiqtë duke ngrënë misrin nëpër ara si derrat e egër!

— Po, — tha me seriozitet Xhako Rina, por shpejt u shkreh në një të qeshur tjetër, që partizanët rrallë e kishin dëgjuar. E pas tij qeshën e qeshnin të gjithë dhe vetëm në këto çaste hareje, partizanët vunë re se gjermanët përtypnin akoma mbeturinat e misrit dhe hidhnin vështrime të verdha.

Partizanët qeshën edhe një herë tjetër, qeshën të gjithë sa ishin aty dhe kjo ndodhi kur kishin dalë në rrugën automobilistike e kur një turmë fshatarësh, pleq, gra e fëmijë, që ktheheshin në Mushibë, u rreshtuan vetiu në të dyja anët e rrugës dhe shikuan në heshtje të thellë atë zvarranik të përbaltur, aq qesharak e aq të zhburrëruar. Pikërisht pas kësaj heshtjeje, erdhi përsëri e qeshura.

— Ore, po ç'kanë këta? — pyeti një fshatar.

— Janë telikosur, — tha një partizan. — Nuk mbahen dot mbi këmbët e veta!

Kaq. Sikur ishte mbushur kupë. Kozma Peti u hodh përpara (lulja e egër u tund në veshin e tij, u tund edhe cigarja në veshin tjetër, por as lulja as cigarja nuk ranë) dhe thirri:

— Stop! — Thirri prapë: — Stop! Stop!

Zvarraniku shikoi me një sy të vetëm, të ngjashëm e gjithmonë të verdhë dhe, më në fund, qëndroi.

— Hajde, ngrehuni në këmbë! — thirri ai dhe ua shpjegoi edhe me dorë. — Ç'prisni, se kemi rrugë për të

bërë. Apo s'ju mjafton që na ngritët tërë baltën e arave!

Ata vazhduan të hidhnin vështrime të përhumbara a plot mosbesim.

Atëherë Kozma Peti eci përpara, mbërtheu të parin për jake dhe e ngriti në këmbë. Ngriti edhe të dytin. Pastaj s'qe nevoja, se i treti dhe pas të tretit të gjithë të tjerët u ngritën vetë. Por, si për t'u mbrojtur nga një sulm i papritur, ata bënë përsëri diçka jo të zakonshme: u ngjitën dhe u qepën pas njëri-tjetrit, si sklevërit në basorelievët e Egjiptit të vjetër. Dhe ashtu ecën, vërtet në këmbë, por si në faqet e mureve të tempujve e pallateve të faraonëve.

Mbi kodrat e ulëta buzë rrugës automobilistike, veshur me koçimare e me ullinj, vërshëlleu një erë e fortë dhe e ftohtë, që vinte nga Veriu dhe shkonte tutje, tatë-pjetë honeve dhe grykave të Jugut. Kjo erë u bë shkak të ndërpriste shiun e imët dhe të shkulte nga poshtë togjet e mëdha të mjegullës, të cilat zunë të pështjelloheshin, të lëviznin e të zhvendoseshin ngadalë e si me përtim faqeve të malit. Mëngjesi ishte akoma i zbehtë, por megjithatë ai kishte zbritur në Mushibë, pa u ndier, ishte futur pa trokitur dhe tashti zmbrapste të gjitha mbeturinat e muzgjeve, që kishte lënë prapa nata e gjatë e nëntorit. Në një nga këto lëvizje e zmbrapsje të mjegullnajës, para syve të partizanëve e të robërve gjermanë u hap një pamje, megjithëse e njohur, por gjithmonë e pazakonshme dhe e paafrueshme për jetën e njeriut. Diku andej poshtë, përfund një kodre të vogël me ullinj, vërtiteshin si hije mugëtire qindra gjermanë të gjallë, që groposnin qindra gjermanë të vdekur. Ata kishin hapur gropa të thella me diametër mbi njëzet metra dhe, tek i shikojë nga lartësitë e para të Mushibës, ato gropa dukeshin si kratere vullkanesh të shuara. Robërit gjermanë e mbërthenin kufomën për shpatullash e për këmbësh dhe, pasi e kolovitin disa herë, e hidhnin në gropë me një «oh» që pikonte trishtim, por që ishte kryesisht një lëvizje, një



koordinim mekanik i forcave, që u duhej të gjallëve për të përbulluar peshën inerte të të vdekurve.

Kjo pamje që doli përpara syve të përbindëshit, shkaktoi një stopim të vetvetishëm, ashtu sikurse shkaktoi edhe një heshtje të ngrirë e mjaft të thellë. Të gjithë shikonin atje, tashmë të harruar cilët ishin, nga vinin e ç'u kishte ndodhur. Të harruar nga vetvetja e nga rreziqet e përfytyruara, të harruar që ishin mundur me gjithësej, e kështu, pa qenë fare të ndërgjegjshëm, ata bënë gjestin më të zakonshëm, bënë diçka që është më tepër se një shprehje: u shkitën nga njëri-tjetri dhe morën qëndrime të zakonshme gati pa u vënë re nga askush. Vetëm disa minuta më vonë, njëri nga partizanët, që e shikoi i pari këtë ndryshim, shprehu çudinë, kur tha:

— Më në fund, morën pamjen e njerëzve!

— Por kjo s'do të thotë akoma se u bënë njerëz! — buzëqeshi komisari dhe, duke treguar me dorë grumbullin e robërve, urdhëroi Kozma Petin që t'i strehonin, t'u jepnin për të ngrënë dhe të bënin hetime, se midis tyre duhej të fshiheshin kriminelë me damkë. Dhe shtoi:

— Kujdes, janë të uritur e të çoroditur dhe duken të dorëzuar plotësisht. Por, mos pandehni se u hiqet aq lehtë nga koka racizmi, fodullëku dhe bindja për Gjermaninë e madhe, me të cilat i ka edukuar Hitleri vite me radhë!

Ndërsa njëshkolona e robërve largohej, e shoqëruar nga kompania e shtabit, atje poshtë dëgjoheshin si refren i një kënge të përmortshme, ofshamat e robërve të gjallë, tek groposnin shokët e tyre të vdekur, o-o-oh, o-o-oh, o-o-o-oh!...

Dani, pa thënë asgjë, u ul mbi një gur (pas tij u ul komisari dhe gati të gjithë partizanët), ndezi një cigare, që u tund si biberon midis buzëve, dhe, me gjithë moshën pesëdhjetëvjeçare, i hipi në kokë të bënte një gjest çapkenllëku: e thithi shumë cigaren dhe pastaj tymin ia lëshoi komisarit në fytyrë. Një çast, dhe ata të dy qeshën. E ndërsa qeshnin, komisari zbuloi më në fund gabimin



optik, që e kishte shoqëruar gjatë tërë natës: tashti, në dritën e mugët të mëngjesit, hunda e këshilltar Danit nuk ishte e rrafshët dhe as e ngjashme me hundën e dashit. Doli ashtu siç e kishte menduar ai, se për këtë shpërfytyrim të pjesshëm, fajet i kishte pasur llamba e teze Rubit, ndoshta edhe mërzitja apo pritja e gjatë e Danit, që e kishte detyruar të ngujohej me orë të tëra në minder. Po, megjithatë, kjo s'do të thoshte aspak se hunda e tij ishte krejt e rregullt... Këto mendoi Xhako Rina dhe aty për aty mori hak: tymin e parë të cigares ia lëshoi këshilltar Danit në fytyrë. Por Xhakos ky gjest i kishte më lezet, se vërtet ishte komisar brigade, por s'ish-te veçse një i ri njëzetepesëvjeçar.

— Si thua, komisar, a të dolën hesapet tashti?

— Të gjithëve na dolën hesapet, Dan, — tha Xhako Rina. — Për turp u katandisën! E me turp e mbaruan luftën!

— Aty mbahu, komisar, — u gjallërua i tëri Dan Zavalli.

— E di si i thonë kësaj, Dan?

— Si i thonë, komisar?

— Atë që thamë ca orë më parë në dhomën e teze Rubit. I vogli munda të madhin!

— Aty ta kam fjalën! — tha prapë Dani më se i gjallëruar.

Oo-o-oh, oo-o-oh, oo-o-o-oh...

— Dy mijë e ca gjermanë të vrrarë, të plagosur e të zënë robër, kundrejt njëzet partizanëve! — tha Xhako Rina.

Padashur të gjithë partizanët, komisari dhe Dani hodhën vështrimin atje poshtë buzë rrugës, ku ndodheshin njëzet varret e reja, me dherat akoma të freskëta e me kurora lulësh të egra.

— Le ta varin, pra, vath në vesh këtë që u ngjau te ne pesë vjet me radhe e le ta shkruajnë edhe në defter, se u bën fajde!

O-o-oh, o-o-oh, o-o-oh...

— Mirë e the, Dan, — tha Xhako Rina. — Ne i mundëm ata po për ato shkaqe që janë mundur kudo gjetkë ushtritë e huaja, sa herë kanë dashur të pushtojnë një vend tjetër. Edhe ky gjerman që u mund e po mundet keq nga popujt e Evropës, sado që ta joshin në të ardhmen Hitlerët e rinj, duan apo s'duan, këtë mësim të historisë do t'ua thonë brezave të ardhëm!

Pas këtyre fjalëve komisar i heshti i menduar e vetullngrysur. Dan Zavalli mbajti frymën, sepse, sado që ishin takuar shpesh me njëri-tjetrin, ai nuk e kishte parë asnjëherë komisarin, as atë natë, as më parë aq të menduar e aq të merakosur. Vetiu që vendosur një heshtje e zakonshme, sepse, me sa dukej, edhe të tjerët, d.m.th. partizanët që ishin ulur aty rrotull, kishin kuptuar se komisar i kishte thënë fjalë të vërteta jo vetëm për fitoren e luftës në Shqipëri, po për diçka tjetër edhe më të rëndësishme, për diçka që kishte të bënte me të ardhmen e afërt e të largët të secilit prej atyre që e kishin dëgjuar.

37.

Bisedat e tyre i ndërpreu një krismë e vetme. Ajo që një krismë e zakonshme. Krismë pushke. Por e mbytur. Prandaj solli menjëherë shqetësim. Dhe heshtje të thellë, të plotë, e cila shembëlleu me një qenie të gjallë, që priste e përgjonte dikë. Pastaj midis partizanëve u bë zhurmë, që, megjithëse e pritur, u duk pa vend, sikur



theu diçka që s'duhej thyer, prishi heshtjen dhe heshtja, si qenie e gjallë, kishte vdekur menjëherë.

Nga një monopati midis koçimareve vrapoi drejt batalionit një partizan që lëvizte një dorë e që diçka donte të shpjegonte nga larg, por nuk kuptohej. As zëri, as fjalët nuk i vinin të qarta: era i merrte me vete dhe i çonte tutje.

— Isa, Isa... — Vetëm kaq u dëgjua nga zëri i partizanit.

Komisari, pas komisarit partizanët e pas partizanëve këmba e shkurtër dhe shkopi me gëzhgjë në majë i këshilltar Danit, tak-fak-tak-fak, shkuan të gjithë në atë drejtim që u thërriste partizani.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti nga larg Xhako Rina.

Partizani:

— Shpejt! Isa! Isa!

Komisari vrapoi dhe pyeti:

— Çfarë i ka ndodhur Isës? — Ai kështu pyeti, megjithëse tashmë e kishte kuptuar se Isës duhej t'i kishte ndodhur një gjëmë e madhe.

Komisari e gjeti Isën të gjallë dhe për më tepër akoma në vete. Bile Isa ngriti me mundim një dorë dhe, me pulpat e gishtave të vegjël, fshiu lotët e Xhakos. Pastaj Isa mbylli sytë dhe nuk dihej nëse do t'i hapte ndonjëherë; asgjë s'dihej me siguri; dihej vetëm që Isa ishte plagosur rëndë; plumbi e kishte marrë në shpatullën e djathtë dhe i kishte hapur një vrimë në gjoks; ishte zverdhur, merrte frymë me zor e me zhurmë dhe tashmë kishte humbur vetëdijen.

Mbi kokën e Isës u duk mjeku i brigadës, me flokët e pakrehur dhe akoma i përgjumur.

Tha Xhako Rina:

— Doktor, Isa duhet të jetojë!

— Më parë t'i presim gjakun! — tha doktori, ndërsa i zbrëthente xhakëtën dhe i griste këmishën.

Dy partizanë, edhe ata të infermierisë, sollën një vig, e vendosën Isën me kujdes dhe, gjatë rrugës për në shtëpinë e Rubit, doktori përpiqej ta mbante në një pozicion sa më të përshtatshëm.



— Si të duket, doktor? — pyeti prapë Xhako Rina.

— Po t'i ndalojmë gjakun, mund të kemi shpresë! — tha doktori.

Në dhomën e zjarrit, aty ku kishte punuar tërë natën Xhako Rina e ku dy fëmijët e Tushit u zgjuan të trembur, Rubi çau turmën e partizanëve dhe turma u hap sa për të kaluar ajo. Rubi kishte vënë një ulërimë të shurdhër, që nuk e ndryshoi as kur erdhi pranë Isës së përgjakur. Partizanët e dëgjonin me respekt vajtimin e saj dhe mugëtira e mëngjesit i jepte një kuptim të veçantë dhimbjes së Rubit për gjendjen e rrezikshme të Isës. Por, kur Rubi ndeshi me vështrimin e Xhakos, që tashmë e kishte marrë disi veten, ajo e kuptoi menjëherë se nuk duhej të vajtonte, por të ndihmonte doktorin, që lyente plagën e Isës me ilaçe, që e mbyllte me pambuk e me fasho e që përpiqej ta mbante Isën në një pozicion, që shpatulla e plagosur të mos prekte hasrën. Rubi kafshoi buzën e poshtme e bashkë me të edhe cepat e shamisë që lidhte flokët.

Isa hapi sytë dhe sikur nënqeshi. Ajo ishte një nënqeshje e lehtë, e mjegullt, që i dukej vetëm në sy. Asnjë tipar tjetër dhe asnjë muskul i fytyrës nuk i lëvizte. Por megjithatë u duk sikur pati një qartësim të çastit. Ishte një qartësim që i vinte nga brenda.

— Mbahu, Isë! — i tha Xhako Rina. — A mund të na thuash kush të plagosi?

Isa e shikonte me sytë e kaltër, të turbulluar nga dhimbja, dhe nuk fliste.

— Doktor, ai duhet të jetojë! — tha Xhako Rina.

Doktori nuk i dha përgjigje. Ai punonte për t'i ndaluar gjakun në vrimën që i kishte hapur plumbi në gjoks e në shpatull.

Rubi lagu një pecetë me ujë dhe i njomi Isës buzët e thara e të nxira. Isa tashti shikonte teze Rubin, por dukej qartë se ato ishin shikime të kota, pa kuptim, pa domethënie.

— Fol, Isë! — iu lut komisari. — Kush të plagosi?

Isa tashti shikonte komisarin.

— Isë, fol, si ngjau!

Isa lëvizi buzët. Bashkë me lëvizjen e tyre, lëvizën edhe shpatullat e kokat e partizanëve që ishin futur në dhomë.

— Përpiqet të flasë, — tha Dani.

Por Isa, që nuk fliste dot, i mbylli prapë sytë si i vdekur. Ndoshta e kishte lënduar doktori.

Tashmë jashtë në oborr dhe rrotull shtëpisë së Rubit brigada ishte mbledhur gati e gjitha. Të gjithë ishin prekur nga kjo ngjarje dhe ishin në këmbë.

U bë zhurmë te pragu i dhomës. Xhako Rina ngriti kokën.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti.

— Bajazit aga Pallën e gjetëm me pushkë në dorë të fshehur midis koçimareve! — Partizanit që shoqëronte Bajazitin këto fjalë i kishin dalë si breshëri fishekësh nga gryka e një pistolette.

Xhakos, që kishte qenë i përqendruar te gjendia e Isës, iu desh një çast i tërë të futej në brendinë e fjalëve të partizanit. U kujtua se këtë fytyrë, me sy e me vështrim të verdhë e të ngushtë, ai e kishte parë pikërisht natën që kaloi, dhe iu kujtuan menjëherë fjalët e këshilltar Danit për miqësinë e këtij agai me parinë balliste të kryeqytetit.

Këshilltar Dani shikonte në heshtje nga Bajazit aga Palla dhe shkopi i tij me gëzhojën në majë trokiste ritmikisht në dysheme, si të shoqëronte rrymën e fshehtë të mendimeve që i kalonin nën lëkurën e ballit.

— Ishte fshehur, të? — pyeti për t'u siguruar Xhako Rina, por edhe për t'i dhënë vetes kohë të mendohej akoma.

— Po, — tha partizani, — dhe, kur më pa, bëri sikur po ia merte një kënge me fishkëllimë.

— Unë, more zotëri, — foli ai me zërin fisnik, të matur e gjakftohtë, — po kthehesha nga arat e misrit.

— A s'e di ti që ne kemi lëshuar një urdhër, askush të mos mbajë armë pa leje të veçantë? — pyeti Xhako Rina.



— Po.

— Atëherë ç'të duhej pushka me vete?

— Gjermanët, zotëri!

— Për gjermanët kemi vënë rojë të fortë!

— Natë, punë derri, zotëri! — tha prapë me të butë Bajazit aga Palla.

— Pse të duhej të fshiheshe?

Bajazit aga Palla heshti me gjestin e njeriut që e quan të tepërt të përgjigjet.

Xhako Rina e përkuli trupin përpara dhe e shikoi më nga afër Bajazit Pallën, fytyra e të cilit kishte marrë ngjyrën e vdekjes, midis së bardhës e së verdhës. Por mbahej qetë.

Opingat e mëdha të këshilltar Danit ishin bërë sërish të palëvizshme. Ai qe skuqur, gjë që s'i kishte ndodhur një natë të tërë, kur si zot shtëpie priste me durim dhe i bënte nderet e mikut komisarit. Shkopi i rëndë, i thantë, me gëzhojën në majë që pasqyronte dritat e mëngjesit, lëshonte reflekse prej bakri, si të kishte marrë flakë nga brenda — ky shkop ishte ngritur paksa nga dyshe-meja, si një paralajmërim e në të njëjtën kohë si një kërcënim ndaj Bajazit Pallës.

— E gjetëm të kërrusur midis koçimareve rrugë pa rrugë, — shtoi partizani.

— Æshtu, ë?! — foli komisarit dhe shikoi nga Isa, i cili, pas fashimit që i kishte bërë doktori, kishte hapur sytë. — Afrohu, — i tha komisarit Bajazit Pallës. Por Bajaziti pati njëfarë ngurrimi, atëherë partizani e shtyu me grykën e pushkës në kurriz.

— Isë, — tha komisarit, — e njeh këtë fytyrë?

Isa hodhi vështrimin nga Bajazit Palla.

Doktori i pari, pastaj të gjithë me radhë, shprehën gëzim: Isa kuptonte, Isa kishte ardhur në vete.

Tushi e kishte marrë hopa vajzën, Shegën, ndërsa djall Cani, ishte ngjeshur pas këmbëve të tij. Shega thithte gishtin në gojë dhe, nga lartësia e të atit, zgjaste dorën tjetër për të rrëmuar syrin e Isës. Por çuditej që nuk e arrinte. Dhe prapë zgjatej.

Jashtë u bë përsëri zhurmë. Pastaj zhurma u afrua



te pragu dhe i pari u fut Kozma Peti, që tërhiqte për mënge Shak aga Dëllinjën, i cili ecte gjysmë i kërrusur, me pushkën pa lloz varur në qafë.

Këshilltar Dani diçka kishte nuhatur në paraqitjen e mjerë të Shakut, ngriti shkopin dhe me kokën e tij i zuri Shakut njërin krahu. Kur ia tërhoqi, krahu i Shakut u tund si cule e varur në tel.

— Ti? — e pyeti Dani Kozmanë.

— Po, unë, — tha Kozmai.

Dani nuk foli menjëherë, por vetëm e shikoi Kozmanë me një gëzim të brendshëm, siç mund të shikojë një usta i mirë çirakun e vet, kur i ka marrë zanatin.

— Pse? — e pyeti prapë.

— Më kundërshtoi! — tha Kozmai. — Ja thika që deshi të më qëllonte pas shpine.

— Mirë ia paske bërë! — ndërhyri Xhako Rina dhe e tërhoqi Shak aga Dëllinjën pranë Bajazit Pallës dhe që të dy i afroi mbi kokën e Isës.

— Isë. — tha komisari, — mos ishin këta të dy që të plagosën?

Isa mbylli sytë dhe mbeti një copë herë gati pa marrë frymë. Po, kur i hapi, vështrimi i tij kaloi disa herë nga Bajazit Palla te Shak Dëllinja. Pastaj sikur bëri një përpjekje për të folur, por buza e poshtme i mbeti e varur, ndërsa e sipërmja i dridhej, pa mundur të shqiptonte asnjë fjalë, bile as tingull nuk nxori.

— Isa sikur foli qartë! — tha një partizan.

— Shoku Dan, po ta ngarkoj ty si anëtar i këshillit nacionalçlirimtar i fshatit që je, t'i arrestosh të dy! — tha Xhako Rina dhe, kur tha këto fjalë, shikoi nga Bajaziti e nga Shaku.

— Duhet fakte, zotërinj, fakte... — Por i mbeti fjala në gojë. Fytyra e tij simpatike që shtrembëruar nga një dhimbje e fortë: ishte dora e madhe e këshilltar Danit, që e kishte shtrënguar në kyçe.

— Dan Zavalli, — tha ai midis dhembjeve, — mate shtatë herë, prej një herë!

— Bjer në gjunjë, Bajazit Palla, do të të lidh duart! — briti Dani me inat.

Si më parë, Bajazit Palla shtrembëronte fytyrën nga dhimbja në kyç të dorës, por sytë e tij të egërsuar, që hidhnin vështrime të ngushta e të verdha, dëshmonin se ai s'kishte ndër mend të bindej. Këshilltar Dani i lëshoi dorën, vari shkopin në atë krah që kishte këmbën e shkurtër, hoqi si më nge rripin, me të cilin shtrëngonte xhaketën ushtarake, lidhi me të brekushet e zeza dhe po ashtu si më ngë, nxori ushkurin e brekusheve dhe befasi e mbërtheu sërish Bajazitin në kyçin e dorës. Që nga ky çast çdo gjë u krye me shpejtësi të rrufeshme. Bajazit Palla u rrokullis nëpër dysheme dhe kjo rrokullisje u duk se nuk do të kishte të mbaruar, po të mos që mbështetur opinga e madhe e Danit mbi gjoksin e tij. Pastaj, me dorën tjetër këshilltar Dani tërhoqi nga krahu i shëndoshë Shak aga Dëllinjën (ky i fundit u gremis në gjunjë pranë Bajazitit) dhe, me të njëjtin ushkur, zuri t'i lidhte të dy bashkë.

— Isha betuar që një ditë me këtë ushkur do t'u lidhja duart armiqve! — tha Dani.

Bajazit Palla dhe Shak Dëllinja, të zverdhur si meitë, shikonin Danin si dy gjarpërinj nën gur. Ishin të mposhtur, por të egër. Dhe dinakë:

Tha Xhako Rina:

— Kur të jenë mbledhur të gjithë banorët e Mushibës, ja aty, te sheshi i fshatit do t'ua bëjmë gjyqin!

Tush Sojani me njëren dorë shtrëngonte djalin pranë këmbëve, me dorën tjetër mbante vajzën hopa. Ajo, po, vazhdonte të thithte gishtin e madh llu-llu-llu dhe të zgjaste gishtin tregues të dorës tjetër në drejtim të Isës për t'i rrëmuar syrin. Por nuk e arrinte. Dhe çuditej. Kurse Isa flinte. I verdhë, dhe flinte. Dhe Shega qante.



(Shkak për hapjen e kësaj paranteze u bë një fshatar, që mbartte misrin nga ara në shtëpi. Në një nga ecejaket e tij, në kohën kur po ndahej nata nga dita, befas para syve iu shfaq një grua e re, veshur me të zeza, që ecte me hap të nxituar dhe që dukej mjaft e zemëruar. Në fillim fshatari se pse e humbi toruan, e mori për njeri jo të kësaj bote, e mori për shtojzovalle të bukur dhe, meqë monopati ishte i ngushtë, ai u mënjanua për t'i hapur rrugë, por më vonë, kur pa nga larg se gruaja me të zeza nuk zbriti monopateve të fshatit, por u fut në pyllin sipër, ai mbeti në këmbë me një peng në zemër e me një dyshim të madh në mendje. Njëherë vendosi të lëshohej prapa saj, por që i detyruar të hiqte dorë shpejt nga ky vendim, sepse në njëfarë vendi të zhveshur të pyllit, ai shqoi gruan me të zeza të takohej me dy njerëz të armatosur e të zhdukej në mugëtirën e drurëve të dendur. Atëherë, fshatari lëshoi në shesh thesin me kallëza misri dhe vrapoi për të lajmëruar këshillin e fshatit.

Pasi e dëgjoi ëderi në fund, Dan Zavalli, që po lidhte kotkën e fundit të ushkurit në duart e agallarëve, tha:

— E shkrova në defter! — dhe pa e bërë të gjatë, hoqi nga supi maliherin për të shkuar në ndjekje, por Xhako Rina e mbajti Dan Zavallin dhe urdhëroi të nisej menjëherë një skuadër për kërkime në pyll.

Cfarë do të bëjë ajo skuadër, do të kthehet pas një ore apo pas dhjetë orësh, me ose pa gruan e re veshur me të zeza, kjo s'ka rëndësi, rëndësi ka fakti se ajo skuadër partizane, që u nis nëpër pyjet e Kërrabës me detyrën luftarake, shënoi për fshatin Mushibë fillimet e betejave të reja, që do të bënte populli shqiptar për vite me radhë kundër përpjekjeve të reaksionit të brendshëm e të jashtëm për t'i kthyer Shqipërisë të kaluarën. Duke mos pritur rezultatet e gjurmimeve të skuadrës



partizane, jemi të detyruar ta mbyllim këtu parantezën e sapohapur dhe le t'i shkojmë deri në fund kronikës së asaj nate të gjatë e të shqetësuar nëntori.)

39

Kur dolën nga shtëpia e Rubit me Isën në vig, një erë e lehtë dhe e ulët sillej si gjarpërushe rrotull këmbëve të tyre dhe rrotull ullinjve e koçimareve, dhe kudo Kërraba e tërë, mbuluar me re, lundronte si një kryqëzor i sapodalë nga mjegullat. Tashmë mëngjesi kishte rënë i plotë, i mugët, i ftohtë, i lagësht, me qiellin të ngopur me shi të imët, që kishte rifilluar të vesonte. Pemët, degët e gjithçka kishin rënë në qetësi, siç bien e siç janë koralet në fund të deteve. Bisqet e tyre pa gjethe e të lagura kishin marrë një vezullim të turbullt, ndërsa hijet poshtë në lugina, edhe ato po tërhiqeshin tashmë të mundura. Diell s'do të kishte (do të kishte re, do të kishte edhe shi), por megjithatë ndihej se dielli së shpejti do të voziste diku prapa tyre. Kudo të bënte përshtypje ajo qetësi që kanë të gjitha gjërat, të cilat qëndrojnë pranë natyrës — përfshirë këtu edhe vetë partizanët, edhe fshatarët e Mushibës, që ishin bërë të shumtë e që përcillnin vigun në heshtje. Veç era, era e lehtë dhe e ulët frynte e sillej si gjarpërushe dhe të dukej sikur ishte ajo që shtynte natën e me krahë të padukshëm tërhiqte ditën.

Zogjtë këndonin 'qartë. Isë, mbahu Isë, mbahu, mbahu, sikur thoshin ato këngë, këngët e tyre. Dhe, duke gjykuar nga fytyrat e partizanëve e të fshatarëve,

të dukej vërtet sikur zogjtë kishin lëshuar një mesazh të ri, që i futej secilit thellë në mendje e në shpirt.

Nga larg, atje poshtë dukeshin robërit gjermanë, që vazhdonin të hidhnin në gropat e mëdha kufomat e shokëve të tyre: o-o-o-oh, o-o-oh!... Dëgjohej edhe zhurma e sëpatave, e sharrave dhe e çekanëve, ku fshatarë, partizanë e robër ngrinin mure e hidhnin çati. Këto e të tjera zhurma të punës ndërtimore sikur i nxorën njerëzit nga një ëndërr e keqe dhe i kthyen në realitetin e ditëve të para të pasbetejës e të pasluftës së madhe. Në një arë rrëzë një kodre mbiu si nga dheu figura e Turhanit me shami të kuqe në kokë. I zhytur i tëri në vetvete, ai ngiste parmendën që tërhiqej nga dy kuaj të fuqishëm ushtrie dhe as që donte t'ia dinte ç'ndodhte rrotull tij. E gjithë njëshkolona me vigun në krye sikur u trondit kur e pa, mbajti frymën, mbajti edhe çapin dhe pastaj mori prapë rrugën me një pëshpërimë të përgjithshme. Kur i kaluan pranë, Turhani qëndroi për një çast dhe u kthye nga njerëzit e nga vigu. Fytyra e tij, punuar e tëra nga rrudha të thella, shprehte vëmendje, çakërdisje, trishtim dhe hare bashkë. Qëndroi ashtu sa të kalonte vigu, pastaj u grahu kuajve me rrëmbim.

Kur njëshkolona e heshtur, me Isën në mes, ra në rrugën automobilistike, Xhako Rina, që ecte në krye të saj, padashur ngadalësoi hapin. Ata mezi dredhuan midis topave e tankeve, midis makinave e rimorkiove, karrocave e kuaive të ngordhur, veturave të djegura, mitralozëve të lehtë e të rëndë, pushkëve, motoçikletave, kuzhinave lëvizëse, municioneve nga më të ndryshmet, thasëve me sheqer, me kafe, çaj, miell e makarona etj. etj. Kishte akoma kufoma të pangritura, ushtarë e oficerë të djegur e të kthyer në mumje brenda makinave. Kishte aty-këtu edhe ndonjë flamur me kryq të thyer, që, ose e kishin hedhur në baltë, ose kishin dashur ta fshihnin diku, me shpresë se mos u buzëqeshte fati dhe e valëvitnin përsëri. Ja pse Xhako Rina ecte ngadalë dhe pas tij lëvizte po aq ngadalë njëshkolona e heshtur me vigun në mes. Por, duke parë edhe një herë gjithë



këtë trofe, që të kujtonte mbeturinat që lënë nga prapa hordhitë barbare, në ndërgjegjen e Xhakos u ngulit sërish ndjesia se lufta kishte marrë fund dhe vendin e saj e kishin zënë paqja dhe liria. Për një çast Xhakos iu duk e çuditshme që s'kishte më ushtarë të huaj, të cilët kishin gëluar prej pesë vjetësh në këtë vend me kapelet e tyre me pupla e pupza të zeza e më vonë me kryqin e thyer në helmetë. Të gjitha këto kishin marrë fund, të gjitha ishin zhdukur dhe do të mbeteshin vetëm material, për muzera, vetëm shifra, shifra fatale dhe tingëllim kambanash sa për t'u kujtuar të kaluarën historike mbarsjeve të reja të agresorëve të ardhshëm. Tashti, ai, Xhako Rina, ta zëmë, mund të ngrihej e të shkonte p.sh. ku të donte e nga të donte. Mund të shkonte edhe te Radija, për të cilën e kishte marrë malli, te nëna, që banonte e vetmuar në magazin në fund të kopshtit e që me siguri shikonte malet dhe priste Xhakon t'i trokiste te porta. Këto gjëra mendonte e përfytyronte Xhako Rina e pastaj tha me vete se duhej të fillonin sa më shpejt t'u jepnin leje një nga një partizanëve për t'u çmallur me njerëzit e afërt.

Kur trofeja e luftës që kishte lënë prapa hordhia barbare zuri të rrallohej, diku atje poshtë i priste një tank i ndezur, me skapamenton që nxirrte tym të dendur e të zi. Partizani-shofer mori drejtqëndrim dhe tha:

— Shoku komisar, gati për nisje!

— Si të duket, do të na çosh deri në Tiranë? — pyeti Xhako Rina, me zërin gjithmonë të butë e niëtonësh.

— Patjetër, shoku komisar!

— Isën e kemi në gjendje shumë të rëndë, — tha Xhako Rina.

— E di, butë-butë, — tha partizani-shofer. — Asnjë tronditje, — shtoi ai.

— Hipni! — tha Xhako Rina.

Isën e vendosën me kujdes mbi tank. Rubi zuri vend në njërin krah të tij dhe e mbuloi Isën me jorganin më të mirë që kishte: prej atlasi të kuq. Në krahun tjetër zuri vend doktori, i shqetësuar, por gjithë vëmendje te frymëmarrja e thellë e Isës. I fundit



mori të hipte komisari, por një dorë e rëndë iu mbështet mbi shpatulla. Ai ktheu kokën dhe pa fytyrën e Danit, që shprehte njëqind mendime njëherësh.

— Hë, Dan, ç'ke për të më thënë?

— Po të shkojë mirë puna e Isës, — tha Dani, — unë dua të më mbarosh një hall në Tiranë.

— Ç'hall, Dan?

— Nuk shikoj, jam i verbër, nuk di të shkruaj e të këndoj. Unë vërtet u them njerëzve, e kam vënë në defter, por haje dreq në kam vënë gjë në defter e në di goftë një harfë të vetme të shqipes!

— Do të hapen kudo kurse kundër analfabetizmit, — tha komisari. — Njëra nga shtëpitë e agallarëve që arrestuam, do të bëhet shkollë, sapo të jetë gjendur një mësues për fshatin Mushibë!

— Nuk më pret puna mua, komisar, — tha Dani. — Dua të më gjesh në Tiranë një abetare me bojna si ajo që kishte Isa. Në pranverë, kur të ketë çelur gjethi i ri, unë dua të kem arritur te Z-z-z-z-ja.

— Abetaret i kemi këtu. Me t'u kthyer unë, e rregullojmë këtë punë!

I shtrënguan dorën njëri-tjetrit, por Dani nuk e lëshoi.

— Kam edhe një hall tjetër, komisar, — tha ai. — Dua të shkosh deri tek ajo zyra e ligjeve pranë qeverisë, sepse nuk më pëlqen të më thërresin Dan Zavalli. Në Shqipëri, me sa ma pret mua, s'do të ketë më zavallë!

Komisari vuri buzën në gaz dhe pyeti:

— Dan, si do të të pëlqente të të thërrisnin?

Dan Zavalli u mendua si për të fundit herë, pastaj tha i vendosur:

— Shkëmbi, Dan Shkëmbi, kështu dua të më thërresin, Dan Shkëmbi!

— Mos u bëj merak, të gjitha do të rregullohen, — tha komisari. — Pushtetin e kemi tonin!

Atëherë Dani ia lëshoi dorën, bëri një gjest, që s'e kishte bërë gjatë tërë natës, i ra qeleshes me yll dhe e ktheu mbi sy. Komisar i hipi mbi tank, atë çast shikoi këpucët e grisura në majë, u inatos me vetveten që s'qe

kujtuar t'ia thoshte me kohë intendentit, skapamentoja nxori shtëllunga të dendura tymi dhe tanku gjerman nr. 909 u nis. Kryqin e thyer nazist e kishin lyer me bojë të zezë dhe pranë tij ishte skicuar me bojë të kuqe ylli partizan.

— Ndal! Ndal! — thirri Kozma Peti, duke tundur në dorë një çantë, çantën e komisarit.

Tanku qëndroi.

— Raportin, shoku komisar, harruat raportin që punuat tërë natën!

Komisari tha:

— Ma jep, Kozma, por, meqë po shkoj vetë, raportin e vërtetë e kam të gjithë në kokë!

— Kozma Peti mbeti një hop si i hutuar, pastaj, si ai njeriu, i cili duhet patjetër të bëjë diçka, hoqi nga veshi lulen e egër dhe e hodhi mbi Isën.

Por tanku s'pat bërë akoma lëvizjen apo kërcimin e parë, kur Tush Sojani, befas, i zgjati Shegën komisarit, ngriti edhe Canin, pastaj hipi vetë.

— Po ti? — e pyeti Xhako Rina.

— Deri në Tiranë, — tha Tush Sojani. — Do të kërkoj Hedijen time, se mos e gjej atje! — Pastaj u zgjat nga komisarit, i afroi buzët te veshi dhe i pëshpëriti: — Të të them të drejtën, shoku komisar, as vetë nuk e di pse ma paska qejfi t'i hipi një herë një tanku të Hitlerit!

Komisari qeshi pa zë. Sakaq, Shega, që kishte zënë vend në prehrin e tij, s'deshi të lëvizte edhe kur i ati zgjati duart ta merrte. Bile, me gishtin në gojë, ajo kërkonte tashti me dorën tjetër syrin e komisarit. E kishin zgjuar herët Shegën e vogël, prandaj i mbylleshin sytë. Komisarit e mbuloi me cepat e kapotës dhe e shtrëngoi pas vetes.

Kur tanku që larguar goxha, prapa tij u pa të vraponte intendentit i brigadës, duke tundur mbi kokë një palë këpucë të reja. Ai nuk e arriti tankun, por ashtu nga larg, i hodhi ato dhe komisarit mundi t'i kapte në ajër.



Qielli ishte i ulët, i ngopur me re. Binte shi. I imët.  
Dhe i butë.

Atje prapa, në asfaltin e zi të rrugës, partizanët e  
fshatarët nderonin me grusht largimin e Isës.

Viti 1980

Albinoza A  
Kombinatit Poligrafik Shkup  
1981  
240 A  
(B. 1000)  
(B. 1000-31)  
A 14

Trudni 10000 Kopejki  
Kombinatit Poligrafik Shkup  
1981